

BAJRAM SELMANI



FILOZOFIA

PËR VITIN IV
TË GJIMNAZIT TË REFORMUAR

BAJRAM SELMANI

FILOZOFIA

PËR VITIN IV
TË GJIMNAZIT TË REFORMUAR
(BOTIMI II)



PROSVETNO DELLO ShA
SHKUP, 2018

Redaktor:

Vesna DUKOSKA

Recensues:

Doc. Dr. Etem AZIRI, profesor në Universitetin
e Evropës Juglindore – Tetovë

Florie IBRAHIMI, profesoreshë në Gjimnazin
„Zef Lush Marku” – Shkup

Selim SELIMI, profesor në gjimnazin „Mirko
Milevski” – Kërçovë

Со решение на Министерот за образование и наука
на Република Македонија бр. 11-4559/1 од 18.08.2005
година, се одобрува употребата на овој учебник.

Me vendim të Ministrit të arsimit dhe shkencës të
Republikës së Maqedonisë nr. 11-4559/1 të datës
18.08.2005, lejohet përdorimi i këtij libri.

I. NJOHURI HYRËSE PËR FILOZOFINË

1.1. Ç'ËSHTË FILOZOFIA – LËNDA E FILOZOFISË

Pyetja se „ç'është filozofia” nuk është e lehtë dhe e thjeshtë për t'u përgjigjur. Përgjithësisht gjatë tërë historisë së filozofisë çështjet filozofike kanë qenë dhe sot e kësaj dite janë kontestuese. Meritojnë një vështrim më të gjerë, më gjithëpërfshirës, ngase për aq kohë sa ka pasur filozofë të njohur, për aq kohë kemi edhe përkufizime e doktrina të tyre filozofike. Filozofia nuk është njëra ndër shkencat e veçanta, edhe pse dikur në vete të gjitha ato i përmbante, ajo është diçka më qenësore se aq. Ajo asnjëherë s'e ka humbur lidhjen, raportin ndaj të përgjithshmes e të veçantës, e kjo në të njëjtën kohë e bën atë ajo që është në esencë dhe si e tillë që mbetet. Filozofia është tërësi ndriçuese e proceseve orientuese ligjore të materjes botërore, me atë që synon të japë përgjigje: prej nga, ku dhe përse këto procese; për më tepër ajo na orienton në ndodhitë botërore, në atë mënyrë që nga afër t'i njohim dhe t'i ndryshojmë e adaptojmë për veten tonë; së fundi ajo është rrugë që kërkon dhe udhëheq në kërkime: rrugë e zëfilljes së fillimit pa iluzione e mashtrime.

Filozofia si njohje, dije a mendim kritik u lind në Greqinë e lashtë skllavopronare, e cila ishte jo vetëm djep dhe vatër e filozofisë, por edhe e tërë kulturës së Evropës Perëndimore në përgjithësi. Vetë shprehja filozofi ka prejardhje prej greqishtes së lashtë „*filozofia*” – e cila përbëhet prej dy fjalëve – „*filo*” që do të thotë dashuri, dashamirësi, jam mik dhe „*sofia*” që do të thotë i urtë apo i mençur. Bile filozofët e lashtë grekë mendonin se **mençuria** ka qenë e kapshme vetëm për perënditë, e njerëzit mund të jenë vetëm kureshtarë të saj, të ushtrohen me të, të synojnë drejt saj duke mos iu afruar kurrë. Edhe në filozofinë bashkëkohore nuk kemi ndonjë përkufizim unik e të përgjithshëm me të cilin nëse jo të gjithë, atëherë shumica do të ishin pajtuar: pra, disa mendojnë se filozofia është arritje „kulmore e njerëzve gjenialë”, që kanë depërtuar në fshehtësitë e botës dhe ekzistencës së njeriut; të dytët nuk e çmojnë dhe largohen prej saj duke ua lënë „imajinuesve të kotë”, të cilët e kanë humbur lidhjen me jetën dhe botën; për të tretët, filozofia është e kapshme për të gjithë ata që „mendojnë me arsye të shëndoshë”; e për të tjerët, ajo është e rëndë për t'u kuptuar dhe është e „kapshme vetëm për një numër të vogël njerëzish të zgjedhur”. Dikur filozofia konsiderohej „shkenca më hyjnore” e „mbretëreshë e shkencave”, që pastaj të ulet deri në „shërbetore të teologjisë”, e „shkencave

të veçanta", prej disa filozofëve bashkëkohorë. Problemi për kuptimin e filozofisë, si duket, vështirësohet edhe për shkak të mospërkufizimit unik „të mençurisë”, që mjerisht edhe ajo ndryshe-ndryshe të kuptohet prej mendimtarëve: prej disave çështjet e mençurisë – filozofike janë „çështje të mallkuara”, sepse çfardo që mendohet për filozofinë, qoftë ajo e „gurit filozofik” (alkimia), ku metalet mund të shndërrohen në ar, qoftë *panacea*, barrë që shëron të gjitha sëmundjet, e vdekje të mos ketë, ose për të tretët „belbëzim i kotë” e „sharlatantizëm i zakonshëm” për mashtrimin e mendjelehtëve, problemet filozofike prore mbeten, nuk mund të tejkalohen njëherë e përgjithmonë, ngase njeriu për nga esenca e tij është qenie që filozofon. Për rrjedhojë mendja e nxjerr në shesh fuqinë e vet, ndërsa filozofia aftësinë e vet, që në mënyrë metodike e sistematike të kërkojë të vërtetën për botën objektive.

1.2. LËNDA E FILOZOFISË

Nëse njeriu për nga esenca e tij përkufizohet si qenie filozofike, për rrjedhojë edhe lënda e filozofisë është e lidhur ngushtë me të, pra me kuptimin, aftësitë njohëse dhe krijuese të tij. Së këndejmi, se filozofia është *studim i ideve*, që paraqiten gjatë historisë së mendimit njerëzor, ndërsa paraqitja e tyre nuk është e njëtrajtshme dhe moskundërthënëse, andaj kuptimi i tyre, në rastin më të mirë është përmes kuptimit të kontradiktave të tyre. Të kundërtat, pra janë kushti themelor që të kuptohet filozofia, do të thoshim dy do të ishin kryesore, ato të shkencës dhe të teologjisë. Shkenca ka të bëjë me përvojën, lind nga përpjekja për ta kuptuar botën ashtu si është. Çdo shkencë formulon një varg pyetjesh, që tejkalojnë kufijtë njohës të saj, për këtë arsye do të jetë e „pafuqishme” t’i zgjidhë ato, si fjala vjen, të natyrës së ekzistimit të gjërave. Me fjalë të tjera, shkenca lind pyetje, që kapërcejnë kufijtë e aftësisë së saj për t’i zgjidhur. Të tilla pyetje e përbëjnë një pjesë të brendësisë së filozofisë.

Gjatë shqyrtimit të problemeve filozofike njerëzit mund t’i drejtohen teologjisë, sistemit të dijeve mjaft autoritative, e mund të gjejnë përgjigje duke iu lutur Zotit si shkak i parë dhe qëllim përfundimtar i gjithçkaje. Çdo përpjekje për t’i dhënë teologjisë bazë racionale, përbën në vetvete një formë mendimi filozofik. Nuk është për t’u habitur se, edhe pse vetë teologjia nuk është vetë filozofi, çështja e mundësisë së teologjisë ka qenë dhe deri diku ende është çështje kryesore në filozofi.

Lënda e filozofisë studion edhe çështjen e metodës në përgjithësi që përbëhet prej dy pjesëve: epistemologjisë – teorisë njohëse dhe logjikës, pastaj mund të shtojmë atë të etikës, estetikës, filozofisë politike etj. Në anën tjetër mendimi filozofik cilësohet prej dy tiparësh, apstrahimit dhe kërkimit të së vërtetës. E para nënkupton se çështjet filozofike lindin në fund të mbarimit të kërkimit shkencor dhe ato kanë prirje t’u flasin sferave të mundësisë dhe të domosdoshmërisë; të flasin për atë që mund të ishte dhe atë që duhet të jetë, më fuqishëm se ajo që është. Ndërsa i dyti, kërkimi i së vërtetës, nënkupton çdo përgjigje „filozofike” duhet vlerësuar, duke dhënë arsye për të menduar se është i vërtetë ose i rremë dhe në qoftë se dikush sugjeron një përgjigje, ai duhet të japë arsye që të besohet.

Lëndën e filozofisë së fundi duhet kërkuar ndërmjet shkencës dhe teologjisë në njërën anë dhe shkencës e letërsisë në anën tjetër, për aq sa në studimin e ndërvarur të historisë së filozofisë dhe historisë së ideve. Lënda e filozofisë, pra, studion botën në tërësinë e saj, tërë atë që njeriu e ka njohur si qenie shoqërore të zotëruar në çfardo mënyrë ose synon ta njohë e ta zotërojë.

1.3. PROBLEMET DHE DISIPLINAT E FILOZOFISË

Filozofia është shkencë qenësisht problematike. Duke shtruar pyetje të ndryshme për botën në përgjithësi, shoqërinë, njeriun e jetën e tij shpirtërore e mendore, ajo shtron pyetje që kanë të bëjnë edhe me vetë përkufizimin e lëndës së saj. Nga këtu pyetjet filozofike maten me atë se cilat shtrohen e jo cilat zgjidhen, nga se kjo varet nga koha dhe rrethanat e caktuara. Për rrjedhojë *problemet e filozofisë janë ato që kanë të bëjnë me njeriun, kuptimin, mundësitë njohëse e krijuese të tij; përmes filozofisë ai e shpreh shkallën më të lartë të ndërgjegjes së tij, i cili synon të përgjigjet në pyetjet, se deri ku shtrihen kufijtë e njohjes - dijes njerëzore, çka mund e çka nuk mund e nuk duhet të bëjmë, si dhe në çka bën e në çka nuk bën të shpresojmë.* Por njëri ndër problemet më themelore të filozofisë prapë mbetet *ai i qenies, me të cilën kuptojmë njohjen e esencës së gjithçkaje që ekziston.* Zaten filozofët e kohërave të ndryshme janë përpjekur të vërtetojnë qenien e vërtetë të sendeve, pra të botës në përgjithësi, në njërin anë, dhe të gjejnë shkaqet e fundit ose nxitësit e çdo lëvizjeje e ndodhie, në anën tjetër. Të kuptuarit më të afërt të problemeve të filozofisë do të ishte ai, përmes nocioneve themelore të saj.

1.4. NOCIONET THEMELORE TË FILOZOFISË

Nocioni më i përfolur i filozofisë është ai i *qenies* – diçkahut, i asaj që ekziston, qenieson për dallim nga i *mosqenies*, asaj që nuk ekziston, që nuk është. I lidhur ngushtë me nocionin e qenies është ai i të qeniesuarit, ajo që është në proces të të qeniesuarit, ajo individualja, që dallohet nga çdo gjë tjetër.

Qenia manifestohet përmes dy anëve të saj: *materjes* dhe *shpirtit*. Materja (nga lat. *mater* – nënë) është ajo që ekziston jashtë dhe pavarësisht nga njeriu. Aristoteli, në vend të termit materje përdori termin „*hyle*” me të cilin nënkuptonte material ndërtimor, ajo nga e cila ndërtoheshin sendet e botës. Natyrën grekët e lashtë e quanin *physis* (nga gr. *phya* – lind). Shpirti (lat. *spiritus* – shpirt) është tipar i dytë i materies, që ekziston jomaterjalisht, në formën e frymës njerëzore. Mandej shpirti ekziston si „parim hyjnor” që i krijon të gjitha sendet e botës – materjale dhe jomaterjale, por edhe vetë shpirtin e njeriut. Shpirti mendohet se është i pavdekshëm, dhe se ka paraekzistencë para trupit të njeriut; ai madje kuptohet edhe si aftësi mendore dhe si intelgjencë.

Lëvizja është aftësi e sendeve dhe fenomeneve që ta ndërojnë vendin në hapësirë dhe të kalojnë prej një forme në formën tjetër. Dallojmë lëvizje mekanike dhe dialektike, si dhe lëvizje progresive e regresive.

Hapësira është renditshmëria e sendeve dhe dukurive njëra pranë tjetrës. Në të shumtën e rasteve kuptohet si zbrastësi ku janë të renditura sendet, e në raste të tjera zbrastësira e hapsirës nuk pranohet, ashtu si nuk pranohet kufishmëria, përkatësisht pakufishmëria e saj. Hapsira ka tri dimensione: gjerësinë, gjatësinë dhe lartësinë-thellësinë. Sot më shumë flitet për polidimensionalitetin e hapsirës dhe lidhëshmërinë e saj me lëvizjen dhe kohën.

Koha është ndodhia e sendeve dhe dukurive njëra pas tjetrës. Rrjedh në një drejtim, pakthyeshëm, është proces ireverzibil në drejtimin: dje, sot, nesër. Lëvizja, hapsira dhe koha janë vetëm forma të modifikuara të materjes.

Nocione themelore filozofike janë edhe ai i njohjes si pasqyrim i saktë i botës dhe shpirtësisë njerëzore dhe ai i të vërtetës që ka të bëjë me „pasqyrimin e drejtë të ekzistimit objektiv” të njohjes njerëzore.

Nocioni qendror dhe gjithësesi njëri nga më të rëndësishmit të filozofisë është ai i njeriut. Nuk ka filozof dhe filozofi e mos t’i kushtohet atij. Ai, si objekt i të menduarit, në tërësinë e tij, në përcaktimet e tij themelore, është i mëvetësishëm, nga të gjitha sendet dhe dukuritë tjera; qofshin ato të gjalla ose jo të gjalla, ngase sipas natyrës së tij, ai është i mirë, krijues e kurorë e krejt krijimtarisë, ose mund të jetë anasjelltas.

1.5. DREJTIMET DHE DISIPLINAT E FILOZOFISË

Zhvillimi i disiplinave të filozofisë është i lidhur ngushtë me problemet që i shtron ajo, në njërën anë, dhe në anën tjetër me drejtimet që zhvillohen si rezultat i dhënies përgjigje ndaj pyetjeve që shtrohen.

1.5.1. Drejtimet e filozofisë

Drejtimet më të rëndësishme filozofike do të ishin materializmi dhe idealizmi.

Materialistët mendojnë se e para është materia, natyra, bota reale dhe se shpirti, mendimi është i dyti, i dalë nga materia. Të kundërtën mendojnë **idealistët**: shpirti është i pari, në njëfarë mënyre e krijon materien, e kushtëzon dhe gjithësesi edhe e asgjëson. Siç dallojmë materializëm **mekanik** – bota është lidhje mekanike ndërmjet sendeve dhe pjesëve të saja dhe **dialektike** – bota është tërësi e ndërlikuar e kundërthënëse që zhvillohet në procesualitet, ashtu dallojmë **idealizëm objektiv** – shpirti është i dhënë para materjes, ekziston objektivisht dhe pavarësisht nga njeriu dhe njohja njerëzore, dhe **subjektiv** jashtë njohjes shqisore nuk kanë asgjë, e bota është përfytyrim i yni dhe se sendet janë vetëm kombinim i shqisave tona. Solipsizmi (*solus* – vetë dhe *ipse* – i vetëm) është forma më ekstreme e **idealizmit subjektiv**.

Relativistët mendojnë se bota mund të njihet vetëm në raport me subjektin që njeh. **Konvencionalistët** kujtojnë se njohja është rezultat i konvencionit (marrëveshjes) ndërmjet njerëzve, për atë se çka llogaritet e vërtetë e çka e rrejshme. Sipas **fiksionalizmit** njohja është vetëm grumbull i fiksioneve të dobishme të marra me mend.

Dallojmë edhe **senzualizmin** (nga latinishtja *sensuz* – shqisë, ndjenjë) i cili si burim të njohjes llogarit shqisat. I ngjashëm është edhe **emiprizmi** (nga gr. *empeiria* – përvojë) sipas të cilit burim i njohje është përvoja. **Racionalizmi** (nga lat. *ratio* – arsye) i cili burim të njohjes e konsideron mendjen.

Janë të mundshme aspekte të ndryshme të çështjes për qenien, nga këtu dallojmë monizmin, dualizmin dhe pluralizmin, ndërsa në etikë dallojmë individualizmin dhe kolektivizmin, egoizmin dhe altruizmin si dhe hedonizmin – kënaqësinë, edudaemonizmin – fatëbardhësinë dhe utilitarizmin – dobishmërinë.

Sa i takon vetë njohjes, dallojmë: **dogmatizmin** (gr. *dogma* – mendim i vërtet), në të cilin nuk mund të dyshohet. **Agnosticizmin** (nga gr. *a-jo, gnosis*-njohje), bota nuk mund të njihet dhe **skepticizmin** (nga gr. *skeptomai* – shikoj prapa, dyshoj) dyshon në njohjen apo mosnjohjen e botës.

1.5.3. Disiplinat filozofike

Disiplinat më të rëndësishme të filozofisë janë:

Metafizika (nga gr. *meta-ta* – pas, në atë anë, *fizis* – natyrë) studion atë që është e para dhe atë që është e fundit. Ajo studion çka është qenia, të jesh, qeniesimin, lëvizjen, formën, materjen, substancën, shkakun, qëllimin etj. Aristoteli filozofinë e parë e përcaktoi shkencë „për shkaqet e para dhe parimet e para”, ajo pyet për qenien si qenie. Emrin **metafizikë** e mori më vonë, nga nxënësit e tij të cilët filozofinë e parë e radhën pas (matanë) fizikës (*physis* – filozofia e natyrës). Fjala **physis** burimisht do të thotë krejt ajo çka është, saktë ajo që është në lëvizje. Metafizika, përkundrazi, pyet për qenien në esencën e saj. Ajo është dije, shkencë për atë çka është matanë fizikës, shkencë për atë që i takon qenies për kah esenca e saj.

Ontologjia (nga gr. *on* – veta e dytë, *ontos* – ekzistuese, qenësore dhe *logia* – shkencë), ose metafizika e përgjithshme studion qenien, ekzistuesen si ekzistuese. Kjo na shpie kah përcaktimet e përgjithshme të qenies, kategoritë filozofike.

Gnosologjia (nga gr. *gnosis* – njohje dhe *logia* – shkencë) është teoria e njohjes, e cila na mëson për mundësitë, burimet dhe kufijtë eventuale të njohjes. Njihet edhe me emrin **epistemologjia** (nga gr. *episteme* – shkencë, dije, njohje) e cila kuptohet edhe si shkenca për shkencën, për aplikimin praktik, tekniko-teknologjik të saj.

Logjika përkufizohet si disiplinë filozofike që merret me studimin e formave dhe ligjeve të mendimit të drejtë, atë të vërtetë. Dallojmë logjikë formale, të cilën e formoi Aristoteli, formaliste, psikologjistike, fenomenologjike, analitike, simbolike etj.

Etika (nga gr. *ethos* – zakon) është shkenca për moralin (nga lat. *mos-moris* – zakon, adet, rregull) e cila na mëson si ta rregullojmë jetën tonë që të jetë në përputhje me normat e shkruara apo të pashkruara shoqërore. Për më tepër ajo na mëson të dallojmë të keqen e të mirën, si të përcaktohem për të dytën, ajo çka është e lejueshme, çka afirmohet si e këtyllë, virtuty, përkundër të parës, të ligës, që mohohet e dënohet. Etika si sjellje praktike na mëson se si mund të gjendet e të krijohet fati, në mënyrë që të sigurojmë lumturi në jetë.

Estetika, (nga gr. *aistezis* – ndijim, perceptim) është disiplina e filozofisë që studion të bukurën, veçmas të bukurën në krijimtarinë artistike, të madhërishtmen, të shëmtuarën etj. Ajo studion kushtet, normat dhe kriteret se kur një send ose dukuri do të llogaritet e bukur ose jo.

Antropologjia (nga gr. *antropos* – njeri) objekt studimi dhe interesimi e ka njeriun, vendin e tij në botë, vlerën dhe kuptimin e jetës së tij. Njeriu vërtet nga fillimi i filozofisë është objekt shqyrtimi dhe problem themelor i saj, andaj me të drejtë llogaritet disiplina themelore e filozofisë.

Aksiologjia është disiplina filozofike që merret me studimin e esencës, llojeve, hierarkisë, mënyrës së ekzistimit dhe mënyrës së të çmuarit të vlerave. Është disiplina më e re e filozofisë, që rrjedh nga gr. *aksios* – vlerë dhe *llogos* – shkencë, pra shkenca për vlerat.

1.6. HISTORIA E FILOZOFISË

Filozofia është e pandashme prej historisë së filozofisë. Ajo merret me studimin „e procesit të sajimit dhe zhvillimit të ideve”, pikëpamjeve dhe problemeve filozofike, si edhe me kushtëzimin e tyre shoqëror, kulturor e historik. Prandaj, që të paraqitet ndonjë „filozofi krijuese” është e domosdoshme njohja e historisë së filozofisë, e cila për dallim nga ajo e shkencave të veçanta, është pjesë përbërse e saj – filozofisë; ajo edhe vetë është filozofi: Historia e filozofisë, si problem filozofik, në mënyrë të pashmangshme zgjon interesin e çdo filozofi.

Themelues i historisë së filozofisë është Hegeli, i cili edhe i dha dimension filozofik. Historia e filozofisë duhet t’i sqarojë „filozofitë e veçanta” në lidhshmërinë e tyre historike, e të paraqesë një pasqyrë të zhvillimit të filozofisë, dhe duhet t’i vlerësojë ato në mënyrë kritike. Në të njëjtën kohë ajo duhet të jetë vlerësim i përparimit të mendimit njerëzor dhe se kriteri i vlerësimit mbetet problemi themelor i saj.

Filozofinë mund ta kuptojë vetëm ai që e fillon studimin duke e përcjellë historinë e saj, dhe anasjelltas, ai që dëshiron ta kuptojë historinë e filozofisë duhet ta njohë vetë filozofinë. Veprat e vjetra filozofike nuk mund të ndërrohen me veprat e reja, si nuk mund të ndërrohen veglat e vjetra teknike me atë të rejat, më të përsosura. Vështirë është të merret me mend që dikush sot, në kohën tonë, të mund të fillojë si Sokrati, Platoni e Aristoteli: prandaj, njohja e filozofisë bashkëkohore kur nuk mund ta zëvendësojë filozofinë e lashtësisë greke. Pra, lëndën e historisë së filozofisë e përbëjnë edhe të gjitha ato krijime filozofike, të cilat janë ruajtur në mënyrë të vazhdueshme si forma të pikëpamjes ndaj botës dhe vlerësimit të jetës.

Historia e filozofisë përfshin këto periudha: filozofinë antike, filozofinë mesjetare, filozofinë e kohës së re, filozofinë bashkëkohore dhe atë më të re të ditëve të sotme.

PYETJE:

1. Si definohej filozofia dikur, e si definohet sot?
2. Ç’është lënda e të studiuarit të filozofisë?
3. Cilat janë problemet e filozofisë?
4. Thujat nocionet më të rëndësishme të filozofisë!
5. Numëroji drejtimet më të rëndësishme të filozofisë!
6. Cilat janë disiplinat më kryesore të filozofisë?
7. Çka studion „historia e filozofisë”?
8. Thujat periudhat e historisë së filozofisë!

„Ajo që dihet ka vlef të dyfishtë nëse në të njëjtën kohë për atë që nuk dihet pranohet që nuk dihet”

A. Shopenhauer

II. FILOZOFIA ANTIKE

2.1. LINDJA E FILOZOFISË ANTIKE

Edhe para se të lindë filozofia, njeriu ka synuar sa me më sukses të përgjigjet për pyetjet në botën, për krijimin e botës e për krijimin e sendeve, për pozitën e tij në botë dhe në përgjithësi për jetën. Përgjigjet dhe shpjegimet e para kanë qenë në formë të miteve e të fantazisë, e jo si rezultat i të menduarit, i cili është i drejtuar kah njohja. Prandaj kur paraqitet filozofia, ajo nuk zhvillohet prej mitit, por përkundër mitit, si synim i të mendurit, synim që në mënyrë mendore të njihen fshehtësitë e botës e të jetës. Filozofia fillon e zhvillohet si përpjekje e përgjithshme e mendjes që në pyetjet për natyrën të përgjigjet në mënyrë të natyrshme, thënë ndryshe të zbulojë natyrën e themeltë të saj, parimin natyror nga i cili gjithçka krijohet.

Filozofia paraqitet kah fundi i shekullit VII dhe fillimi i shekullit VI p. e. r. në Greqinë e lashtë dhe zgjat deri në shekullin II të e. re. dhe më tutje deri në shekullin V të e. re. me shkatërrimin e Perandorisë Romake. Kur u paraqit ajo, **qyteti-shtet (polisi)** tani më ishte ngritur e zhvilluar, brenda për brenda të cilit zhvilloheshin artizanatet. Grekët e lashtë duke bërë tregti me popujt e ndryshëm u njohtuan me besimet, zakonet e botkuptimet e tyre, i krahasuan ato dhe u bindën në dituritë e tyre relative; në atë se edhe ato ishin krijim të njeriut. Me fjalë të tjera kërkësia dhe mendja e tyre e kthjelltë i bëri ata të mbledhin aq dije e përvojë, që rrallë më do të përsëriten ndonjëherë te popujt e tjerë. Themelohet e zhvillohet demokracia skllavopronare ku proklamohet barazia dhe liria individuale e të gjithëve. Liria individuale e njeriut edhe ishte kushti qenësor pa të cilin nuk do të ishte e mundshme as edhe vetë lindja dhe mundësia e filozofisë. Përfundimisht fryma greke do të çlirohet prej traditës e mitit dhe orientohet kah kërkimi i lirë.

Grekët e lashtë dhanë shembull të zhvillimit të veprimtarisë kulturore, të zhvillimit të gjithanshëm të personalitetit, njerëz me ekuilibër harmonik ndërmjet trupit e shpirtit, njerëz të aftë që të kryejnë aktivitete në të gjitha fushat e krijimtarisë, me çka u mundësua edhe lindja e filozofisë.

2.2. ANTIKA – THEMEL DHE SHTYLLË E CIVILIZIMIT DHE KULTURËS EVROPIANE E BOTËRORE

Filozofia dhe shkencë greke nuk janë paraqitur pa ndonjë ndikim nga jashtë, të arriturat e saj ndërlidhen me të arriturat e popujve të lindjes, me të cilët kanë mbajtur lidhje të përhershme kulturore, ekonomike e tregtare. Tek ata popuj shekuj me radhë kishte lulëzuar civilizimi e ishin krijuar bazat e shkencës, si bie fjala e matematikës, astronomisë e astrologjisë; madje që zhvilluar edhe bujqësia me tërë atë rrjetë kanalesh për shfrytëzimin e lumenjve Nil, Tigër e Uefrat. Në Egjipt dhe shtetet e lindjes, fjala vjen, zejtarët arritën përsosshmërinë në prodhimin e gjërave të ndryshme prej metali, argjili e pëlhure, veçanërisht kishte lulëzuar arti i ndërtimitarisë, pikturës e letërsisë. Pallatet madhështore, tempujt dhe varrezat grandioze edhe sot e kësaj dite ngjallin respekt të vizitorët e mbeturinave të tyre, edhe sot e kësaj dite na impresionon kolosaliteti dhe shkathhtësia e tyre me të cilat janë ndërtuar.

Marrëdhëniet shoqërore skllavopronare dhe forma despotike e qeverisjes politike e shteteve të lindjes konsistonin në mirëmbajtjen dhe ndërtimin e rrjetit të kanaleve, ruajtjen nga armiqët e jashtëm dhe të brendshëm, me çka njerëzit i mbanin të nënshtuar dhe nën padrejtësi të tmerrshme, ndërsa religjioni luante rolin vendimtar ideologjik. Sundimtarët që personifikoheshin me perënditë qiellore e tokësore, vazhdimisht i shtypnin shtetasit e tyre duke ua marrë pjesën më të madhe të të hyrave. Në këto rrethana mendimi për vdekje ka qenë më i pranishëm se sa për jetë, ndërsa kujdesi për perënditë çdo herë ishte para kujdesit për njerëzit.

Krijues të kulturës antike janë grekët e lashtë, ndërsa romakët kanë meritën se e vërejtën madhështinë e saj, e përvetësuan dhe e përkthyen në gjuhën e tyre latine si dhe e bartën në tërë perandorinë e tyre ku ishin përfshirë shumë popuj e që nuk i kishte përfshirë bota greke. Edhe vetë fjala antik (nga lat. *antikus* – e vjetër, e lashtë) zakonisht nënkupton Greqinë e lashtë dhe Romën e vjetër, përkatësisht të arriturat e tyre në lëmin e kulturës, artit, shkencës e filozofisë. Grekët e lashtë paraqitën aftësi të tillë krijuese, me të cilat krijuan vepra nga çdo lëmi të kulturës, përfshirë filozofinë, artin e shkencën, para të cilave edhe sot e kësaj dite çuditëmi e mahnitëmi. Kultura helene jo vetëm që është kusht për paraqitjen e civilizimit evropian, por ajo edhe e supozoi paraqitjen e saj, ngase ajo në mënyrë të begatshme është përhapur e përfshirë në kulturën evropiane përgjithësisht, e veçmas në lëmin e filozofisë, pa të cilën ajo as që do të mund të merrej me mend. Prandaj janë të prekshme edhe sot e kësaj dite format e llojllojshme të mendimit grek dhe vërtet mahnitëse është përsosshmëria e artit të tyre. Helenët shekuj me radhë kanë paraqitur mrekulli nga shkathhtësia e shprehja për punë, si dhe zgjuarsia dhe inventiviteti që nuk i ka paraqitur as një popull tjetër në histori.

Shkëlqimi i civilizimit grek është aq tërheqës sa me të drejtë disa mendimtarë e llogarisin për befasi, si diçka që është paraqitur papritmas, si fryt „i mëshirës së posaçme” dhe forcave që tejkalojnë fuqinë e njeriut. Bertrand Raseli, filozof bashkëkohor anglez, në lidhje me paraqitjen e civilizimit grek do të thotë: „Në tërë historinë nuk ka asgjë aq befasuese dhe aq vështirë të kuptueshme sa paraqitja e befasishme e civilizimit grek. Ajo që grekët e arritën në lëmin e artit e të kulturës ndoshta është e afërt për secilin, por atë që ata e arritën në lëmin intelektual është vërtet diçka ekskluzive. Ata të parët e gjetën

matematikën dhe shkencën e filozofisë; të parët e shkruan historinë për dallim nga kronikat e thjeshta; ata të parët menduan për natyrën dhe për botën si dhe për qëllimet e jetës pa qenë të lidhur me prangat e cilitdo qoftë ortodoksi". Ngjashëm do të shprehet edhe historiani i filozofisë, gjermani E. Celer, se „grekët i formuluan të gjitha problemet themelore të filozofisë teorike dhe praktike dhe u përgjigjen në ato me qartësi të tejdukshme që është veçori vetëm e frymës helene".

Megjithatë, filozofia greke paraqitet në mënyrë të mëvetësishme. Kultura të mëdha të Lindjes si ajo e Egjiptit, Persisë, Indisë e Kinës nuk ndikuan aq esencialisht. Filozofinë greke si djep të kulturës perëndimore do ta cilësonin këto përparësi kryesore:

- Derisa popujt e lindjes dijen dhe mençurinë e lidhnin dhe e përcaktonin përmes religjionit dhe traditës, filozofia greke është studim, kërkim i lirë;

- Njeriu i lindjes është i tërhequr, ai është pasiv ndaj botës, përkundrazi, grekët ishin të dhënë, realistë e optimistë në kërkim ndaj botës, ata besonin në përpërlimin që vetë e krijojnë. Tek ata është i theksuar mendimi i lirë, zotërat janë të ngjashëm me ta, i kanë të njëjtat virtyte e vese sikurse njeriu, për atë ai me atë fliste e bisedonte;

- Grekët e lashtë ishin të parët që dijes dhe njohjes i dhanë karakter shkencor e spekulativ.

2.3. FILOZOFËT E PARË

2.3.1. Shkolla e Miletit


Në bregdetin perëndimor të Azisë së Vogël, në qytetin e Miletit jetuan dhe vepruan filozofët e parë. Ky bregdet që në periudhat parahistorike ka qenë i banuar me fise greko-jonike, prandaj edhe emrin e mori Jonia, popullsia e të cilit u mor me zeje, lundrim detar, ndërtimatri të anijeve dhe me tregti përmes së cilës i lidhte popujt e lindjes me ata të perëndimit. Joniasit ishin të shpërndarë në udhëkryqe të përshtatshme detare, në mënyrë të shkathët i shfrytëzuan këto kushte e përparësi për të krijuar parakushte shoqërore-politike e për të siguruar mirëqenien e tyre materiale dhe shpirtërore.

Qytetarët e Miletit, Efesit e Kolotonit u bënë të famshëm me shpirtin, dhuntinë dhe talentin e tyre të shumanshëm e të çiltër. Në këto qytete ishte tubuar pasuri e madhe, si rezultat i së cilës, një shtresë e njerëzve fitoi kohë të lirë, të cilën do t'ia kushtojë veprimtarisë politike dhe krijimtarisë kulturore. Banorët e Jonisë, Babiloninë e Egjiptit njiheshin me të arriturat e popujve të tyre, dituritë që i fitonin atje, madje i bartnin në vendlindjen e tyre, i përsosnin duke i çliruar nga premisat mistike.

Joniasit ishin të interesuar që botën ta sodisin esull, pa paragjykime që para syve të tyre shfaqej me tërë bukrinë dhe rendin e saj harmonik e të çuditshëm. Kozmosi (nga gr. *cosmos* – stoli, diçka e rregulluar bukur) është tema kryesore, ndërsa zbulimi i esencës dhe forcave lëvizëse të tij mbetej qëllimi kryesor. Ata të parët arritën ta ndajnë shkencën dhe filozofinë prej religjionit duke e lënë atë (religjionin) në një lëmi të lidhur me traditat dhe zakonet. Kjo edhe është ndër kthesat më rrënjësore në tërë historinë e mendimit njerëzor dhe kulturës në përgjithësi.

Përfaqësuesit e shkollës së parë filozofike, Talesi, Anaksimandri dhe Anaksimeni nga Mileti do të pyesin: *ç'është ajo që botën e bën kozmos, të rregulluar e të renditur, e jo kaos, parregullësi totale e gjithëçfarë e grumbulluar dhe e hudhur andej e këndej?* Nëse mendimi religjioz përgjigjen e këtyre pyetjeve e kërkonte në forcat mbnatyrore, miletasit e kërkonin në vetë botën. Megjithëse, mendoni se në esencën e shumëllojshmërisë së gjërave dhe dukurive qëndron diçka qenësore, që persiston në të gjitha ndryshimet, që është përcaktuese dhe nga e cila krijohet e në të cilën sërish kthehet, ata nuk dhanë ndonjë përgjigje të njëjtë, ndërsa divergjencat po i vëmë në dukje, në vijim e sipër.

2.3.2. Talesi (625-547 p. e. r.)



Talesi

Për Talesin nuk dimë aq sa do të donim të dinim, dhe ajo që dimë është më shumë e një natyre anekdotësh. Ai nuk ka lënë shkrime, rreth tij kemi referime fragmentare nga autorë të mëvonshëm, të cilët kanë shkruar për episode të paharrueshme të karrierës së tij. Kur udhëtonte në Egjipt zgjodhi problemin e matjes së lartësisë së piramidave duke përdorur një teknikë të thjeshtë, matjen e hijes së piramidës në atë orë të ditës, kur hija e njeriut është e barabartë me gjatësinë e tij. Ai i pari ka filluar t'i argumentojë teoremat gjeometrike në mënyrë racionale, i pari ka ditur ta parashikojë zënieën e diellit.

Për Talesin parabaza dhe fillimi i çdo gjëje, të asaj që lind çdo gjë dhe në të cilën kthehet çdo gjë, është uji. Bota është një, e parabaza e saj është e amshureshme dhe e pafund, në lëvizje të përhershme, në ndërtim e çndërtim. Vërtetonte se bota është e gjallë dhe me plot forca krijuese. Një këtë kuptim do të thotë edhe për magnetin se ka shpirt, duke e nënvizuar tërheqjen dhe rrefuzimin e fushës magnetike. Mendonte se toka është e rrafshët e cila lundron mbi ujë. Pavarësisht nga saktësia e analizës për përbërjen e sendeve, Talesi arriti të ngrejë çështjet që kanë të bëjnë me natyrën e vërtetë të botës.

2.3.3. Anaksimandri (610-546 p. e. r.)

Anaksimandri ishte bashkëkohës më i ri dhe nxënës i Talesit. Paraqitet si shkencëtar dhe filozof gjenial; i pari e përpiloi hartën gjeografike dhe hartën e qiellit, si dhe i pari e konstrukttoi orën. Toka për atë është trup natyror me formë cilindrike, që është e lartë sa një e treta e gjerësisë së saj, gjendet në qendrën e botës e fluturon në zbrazëti, por nuk bie. Rreth Tokës, si qendër, gjenden



Anaksimandri

fushat nëpër të cilat lëvizin qiejtë e pafund, planetet, Dielli dhe Hëna. Kemi të paraqitur sistemin e parë gjeocentrik të trupave qiellorë. Ekzistojnë pra, botëra të panumërta si kjo e jona, dhe se edhe njeriu e ka prejardhjen prej shtazëve, përkatësisht nga peshqit, - thoshte Anaksimandri:

Anaksimandri mendon se esneca e botës dhe shkaku i parë i të gjitha sendeve dhe dukurive është **apejroni**, siç e quan ai. **Apejroni është plotësisht i papërcaktuar për nga cilësia dhe është i pafund për nga sasia.** Për argumentimin e këtij pohimi ai **përdori metodën e të reduktuarit në pamundësi.**

Sipas Anaksimandrit, opejroni është i pakrijueshëm, i amshuar, gjendet në qetësi të rëndomtë dhe në lëvizshmëri të pandërprerë për shkak të natyrës së tij kundërtëse, ai përmban dy palë kontradiktash, nxehtësinë dhe të ftohtin, thatësinë dhe lagështinë. Këto kontradikta janë në ndërveprim të përhershëm. Me bashkimin e të nxehtës dhe të thatës shkaktohet zjarri, e nxehtëta dhe e lagëta na japin ajrin, e ftohta dhe e lagëta lind ujin, ndërsa nga i ftohti dhe e thata lind Toka. Nga këto katër elemente kontradiktore krijohet gjithçka që ekziston, por edhe që mund të ekzistojë. Ndryshimet në botë janë objektive, të domosdoshme dhe të pavarura nga ndonjë vullnet i vetëdijshëm. Me fjalinë e vetme, që ka mbijetuar nga shkrimet e tij, Anaksimandri na lë të kuptojmë se: *„nga ai burim që lindin sendet, po atje kthehen nga domosdoshmëria kur shkatërrohen, sepse ato vuajnë dënimin dhe riparojnë njëri tjetrin për padrejtësitë e tyre sipas rregullit të kohës”*. Është e qartë se në këtë fragment shprehet ideja e determinizmit, përkatësisht parimi i kauzalitetit.


2.3.4. Anaksimeni (585 – 528 p. e. r.)

Filozofi i tretë dhe i fundit nga Mileti është Anaksimeni, i cili ka qenë „shoqëruesi” më i ri i Anaksimandrit. Për ta bashkuar nocionin e Talesit mbi një substancë të përcaktuar me konceptin e ri të Anaksimandrit mbi të pakufishmen në lëvizje të vazhdueshme, **Anaksimeni e përcaktoi ajrin si substancë primare nga e cila rrjedhin të gjitha sendet.** Ajri është elementi jetëdhënës, që kur merr frymë dhe lëshon frymën çdo gjë jeton e pa-atë vdes. Ai u përpoq të japë shpjegim shkencor për transformimet që ndodhin në natyrë, përkatësisht **mendonte se sendet dhe dukuritë lindin me rrallimin dhe dendësimin e ajrit.** Duke u rralluar ajri bëhet zjarr, ndërsa duke u dendësuar krijohet era, retë, dheu, guri e çdo gjë tjetër. Duke shpjeguar se si ajri është origjina e të gjitha sendeve Anaksimeni akceptoi një ide të rëndësishme, sipas së cilës ndryshimet në kualitet shkaktohen nga ndryshimet e kuantitetit.

Përfaqësuesit e shkollës së Miletit ishin materjalistë, në të vërtetë materjalizmi i tyre ishte spontan e stihik, i pandërtuar dhe i pambështetur më thellë dhe se zhvillimi i mëtutjeshëm i filozofisë greke do të hapërojë rrugës, drejt thellimit të nocioneve dhe botëkuptimeve të tyre.

2.3.5. Pitagora (570-493 p. e. re)

Formimi i pikëpamjes së parë idelaiste për botën në Greqinë e lashtë është i lidhur me emrin e Pitagorës. Jo larg nga Mileti në Detin Egje ndodhet ishulli i vogël Samos, që është edhe vendlindja e Pitagorës. I pakënaqur me kushtet jo vetëm të vendlindjes, por përgjithësisht me të



Pythagora

bregdetit Jon si dhe të sundimit tiranik të Polikratit të pasur, emigron në Italinë e Jugut dhe vendsoet në qytetin e pasur grek të Krotonit. **Për dallim nga miletasit, Pitagora dhe pitagorasit thanë se sendet përbëhen prej numrave.** Pitagora u interesua për matematikën, me sa duket, në rend të parë për arsye fetare. Është themelues i një sekti fetar - me vendosjen në Kroton ai themeloi të ashtuquajturën Lidhjen Pitagoriane, ndërsa ajo që bëri të lindet një sekt i tillë, ishte dëshira ndërmjet njerëzve për një besim të thellë shpirtëror, që mund t'u siguronte njete për pastrimin e shpirtit e për t'u garantuuar prej imoralitetit. Origjinaliteti i tij mund të themi qëndron në bindjen e tij se studimi i matematikës është pastrim më i mirë i shpirtit.

Ishte i pari Pitagora që dalloj tri ndarje të shpirtit, tri lloje të ndryshme jete, duke porositur se tri lloje njerëzish shkojnë në lojrat olimpike; disa shkojnë për të

fituar nderime, ndërsa më të mirët për të soditur se çfarë ndodh atje. Me soditësin ai e ilustron mendimtarin, filozofin, veprimtaria e të cilit atë e çliron nga zhvillimet e jetës së përditshme dhe papërsosshmëria e saj.

Pitagora thotë se baza e botës nuk është materiale, por ajo e numrit dhe, që t'i njohim sendet dhe dukuritë e ndryshme, në fakt duhet ta njohim numrin e tyre. Bota dhe ligjshmëritë e saj shprehën me raporte numrash ose proporcionesh. Këtë e ilustronin, me atë që numrin një e paraqitnin me pikë, numrin dy me vijë, tre me trekëndësh, ndërsa katërshin me piramidë. Kështu, ata me këtë e lidhën aritmetikën me gjeometrinë. Pitagorës i atribuohet zbulimi se katrori i hipotenzës është i barabartë me katrorin e dy kateteve në një trekëndësh këndëdrejtë, ndryshe e njohur si „*Teorema e Pitagorës*” e në lidhje me këtë edhe ajo e zbulimit të numrave iracionalë. Për nder të zbulimit të këtyre të fundit, ku në mënyrë të qartë vjen në shprehje edhe fuqia thuaja hyjnore e tij, Pitagora flijoi hektakombë 100 qe.

Për pitagorasit edhe kozmosi është i rregulluar si nga ndonjë matematicient hyjnor. Sipas mendimit të tyre, të gjithë trupat qiellorë janë të rrumbullakët në trajtë të sferave (sfera është trupi më i përsosur gjeometrik). Në qendër të kozmosit gjendet Toka, rreth së cilës sillen sferat e shtatë trupave qiellorë dhe sferat e yjeve të palëvizshme; më vonë në qendër të kozmosit vendoset zjarri qendror, dhe vërtetuan se Toka sillet rreth boshtit të vet, për ç'arsye shkaktohen ditët dhe netët. Kozmosi medoemos të jetë vepër e forcës hyjnore, i cili paraqet dhjetëshin para të gjithë numrave të tjerë, duke prodhuar harmoninë qiellore që mund të dëgjojnë dhe të bien në ekstazë vetëm ata që i janë kushtuar mësimi të Pitagorës.

Por mënyra se si u kuptuan numrat, i çoi pitagorasit në formimin e konceptit të tyre më të rëndësishëm filozofik, atë të **formës**.

Forma për ata do të thotë kufi, e ai është i kuptueshëm vetëm në gjuhën e numrave. Dy janë artet ku mund të aplikohet koncepti i kufirit: muzika dhe mjekësia. Në të vërtetë, pitagorasit e shihnin trupin e njeriut si të ishte një instrument muzikor, duke thënë se shëndetin e kemi kur

trupit është „i akorduar” dhe se smundja është pasojë e fërkimeve të papërshtatshme ose humbje e akordimit të duhur të telave. Për më tutje, numri për pitagorasit përfaqëson zbatimin e të kufizuarës (formës) tek e pakufizuarja (materja) dhe ata iu drejtuan muzikës dhe mjekësisë vetëm për ta ilustruar konceptin e tyre filozofik se të gjitha sendet janë numra. Shkëlqimi i pitagorianëve matet edhe me atë se në çfarë shkalle ndikuan filozofët e mëvonshëm, veçanërisht mbi Platonin. Domethënë, ka shumë ide të Platonit që erdhën në shprehje në sajë të mësimave të Pitagorës.

2.4. KUNDËRTHËNIET FILIZOFIKE

2.4.1. HERAKLITI DHE SHKOLLA E ELESË

Në vijim do të shqyrtohen dy shkolla bashkëkohëse me njëra tjetrën dhe të kundërta ndërmjet tyre, shkolla jonike, filozof i së cilës ka qenë Herakliti dhe ajo eleatike, filozof i së cilës ka qenë Herakliti dhe Parmenidi. Gjatë tërë historisë së filozofisë kanë mbetur dy simbole, ndihmesa e të cilave nuk ka pushuar kurrë së përmenduri në paraqitjen e problemeve themelore filozofike. Mandej edhe sot mund të thuhet për disa mendimtarë se janë „heraklitianë” ose „eleasë”, si fjala vjen Spinoza është filozof eleas e përkundër tij, Hegeli është „heraklitian”.

Të dy shkollat e shtruan problemin e ndryshimit dhe të rrjedhës kohore, të së përkohshmes dhe të së përhershmes, të asaj që është një dhe e vetme dhe të asaj që është e shumëfishtë. E përkohshmja i takon botës së shumësisë, botës së numrit shumë, ndërsa e përhershmeja ka të bëjë me atë që është një e pandryshueshme. Këto probleme janë të „afërta” ndërmjet tyre dhe janë shtruar si nga shkolla jonike ashtu edhe nga ajo eleatike. Dhe pa këto kundërshti themelore: në njërin anë të kërkesës së arsytimit tonë për identitetin, identikën dhe të njëjtën dhe, në anën tjetër, të qartësisë së vetëvetishme, të eksperiencës sonë të përditshme, që s’është gjë tjetër veçse vetë procesi i ndryshimit, nuk do të ishte as vetë filozofia.

2.4.2. Herakliti (550-480 p. e. r.)

Herakliti prej qytetit të Efesit të bregdetit të Azisë së Vogël, filozof më i dalluar grek i cili lidhet me të arriturat e miletasëve, ishte me origjinë aristokrate dhe si i tillë kundër demokracisë. Për shkak të bindjeve të tij politike, kurrë nuk mori pjesë në jetën publike, por u tërhoq në rrethinën e qytetit të tij të lindjes dhe jetoj krejtësisht i vetmuar. Vepra e tij „Për natyrën” nuk është ruajtur e plotë, gjithsej janë ruajtur 138 fragmente të shpërndara nëpër veprat e komentuesve të tij. Herakliti shkruante në mënyrë koncize, shpesh herë në formë të aforizmave dhe me mjaft metafora, për këtë arsye ai edhe e mori nofkën që në antikë, i errëti. Nga bashkëkohësit e tij, thuhet se paqartësia e shprehjes gjuhësore vinte nga



Herakliti

ngatërueshmëria dhe thellësia e problemeve që i shtronte dhe synonte t'i zgjidhte. Është krijues i prozës filozofike si dhe është themelues i dialektikës dhe materjalist i dalluar. Herakliti thotë: „*Këtë botë të njëjtë për të gjithë, nuk e ka krijuar asnjë njeri dhe asnjë perëndi, por gjithmonë ka qenë e do të jetë zjarr i gjallë që me masë ndizet dhe me masë shuhet*”. Nga këtu parabaza e të gjitha sendeve dhe dukurive të botës është zjarri. Zjarri me flakamën e tij të përhershme më së miri e shpreh mësimin e tij për lëvizjen. „*Panta rei*” – çdo gjë rrjedh dhe „*në të njëjtin lumë hymë dhe nuk hymë, jemi dhe nuk jemi*”. Në botë, pra, lind gjithçka diçka e re.

Sipas Heraklitit, rrjedha botërore është e papërsëritshme dhe është e pavarur nga qeniet tokësore e mbitokësore. Bota është e amshueshme, gjithëpërfshirëse dhe gjithëkrijuese, nuk ka fillim e as fund, nga vetja lind çdo gjë dhe sërish në vete e kthen, pra „*çdo gjë këmbëhet për zjarrin dhe zjarri për çdo gjë, si malli për ar e ari për çdo gjë*”. Edhe procesi i „krijimit” dhe „shkatërrimit” të botës zhvillohet në mënyrë të ligjshme, ndezja (krijimi) dhe shuarja (shkatërrimi) kryhet me masë, përndryshe çdo gjë do të kishte qenë „kaos” e jo „logos”. Logosi, me të cilin herë-herë e nënkupton ligjëshmërinë që sundon në kozmos dhe sipas këtij logosi, drejtimi i transformimit të zjarrit është dykahësh; në njërin anë kemi zjarrin – ajrin – ujën – e në anën tjetër dheun – ujin – ajrin – zjarrin.

Duke e zhvilluar mendimin e tij më tutje, Herakliti depërton në „thellësinë” e lindjes së botës, ku njerëzit para kësaj ndalen si para humnerës. Dhe kjo është rezultat i luftës së pandërprerë, të amshueshme, prandaj Herakliti thotë: „*Lufta është baba i çdo gjëje, i çdo gjëje mbret, disa i ka bërë perëndi, të tjerët si njerëz, disa i ka krijuar skllëvër, të tjerët të lirë*” dhe vazhdon: „*Lufta është e përgjithshme, drejtësia është luftë dhe çdo gjë lind sipas domosdoshmërisë*”. Madje në luftë kërkon „*pajtueshmërinë*”, „*harmoninë e fshehur*”, e cila është „*më e fortë se e hapura*”, me çka vë në dukje pikëpamjen e tij deterministe. Pastaj diçka më shumë, Herakliti thotë se të kundërtat depërtojnë njëra në tjetrën, identifikohen; me këtë ai shkon përpara në të menduarit dialektik, e deri në fundin e saj. Me thënë të drejtën për një gjykim e arsye të shëndosh nuk ka diçka më të papranueshme se të thuash janë identike një dhe e njëjta, ajo që është aq e kundërt me të, kundërtshënësia, kontradiktorja, ose siç shprehet Herakliti: „*Një dhe e njëjta në ne është e gjalla dhe e vdekura, e zgjuara dhe ajo që flet, e reja dhe e vjetra, ngase e para porsa ndryshohet, është tjetra dhe e kundërta, tjetra para se ndryshohet, është e para*”.

Te Herakliti njohja fillon prej shqisave, por ajo që e mundëson urtësinë-mençurinë është mendja. Mendja vepron sikur ai që lan rërë, duhet të lajë shumë për të fituar pak ari, domethënë se dituria e shumtë e njeriut atë ende nuk e bën të mençur. Edhe shpirti për Heraklitin është zjarr, por ai është më i lëmuar dhe më i thatë.

Madje te Herakliti do të gjejmë fragmente që shprehin edhe aristokracizmin e tij, si kjo: „*një për mua është më i mirë, se sa disa dhjetra mijë, nëse është më i miri*”, në tjetrën anë edhe fragmente ku do të shprehen ide kozmopolite që do të vijnë në shprehje më vonë te stoikët si „*arsyeja është e të gjithëve e përgjithshme*”. Pra, ndikimi i Heraklitit jo vetëm në antikë, por edhe në kohën tonë ndihet mjaft fuqishëm, sidomos aplikimi mjaft konsekuent i dialektikës së tij.

2.5. ELEASIT

Materjalizmin e shkollës së Miletit e morën si pikënisje të persijatjeve të tyre filozofike si Herakliti ashtu edhe filozofët e qytetit të Elesë. Por, përfaqësuesit e shkollës së Elesë shkuan edhe më tutje: ata synuan ta kuptojnë çështjen esenciale të qenies dhe mënyrën se si arrihet deri te njohja njerëzore. Janë racionalistët e parë antikë, që kuptuan rolin e rrjedhimeve deduktive dhe rëndësinë e ligjeve dhe konsekuancave logjike në ndërtimin e sistemeve shkencore.

2.5.1. Ksenofoni (570-478 p. e. r.)

Themelues i shkollës filozofike të Elesë është Ksenofoni prej qytetit Kolofona të Azisë së Vogël. Kur i pushtuan Persianët qytetet greke të Azisë së Vogël, ai u detyrua ta lëshojë vendlindjen e tij dhe të bridhte nëpër Greqi si rapsod popullor duke i kënduar këngët e veta, por edhe të tjerëve. Më vonë do të vendoset në Elea, qytet përparimtar në anën perëndimore të Italisë Jugore. Pikëpamjet e veta i shprehu në poemën „*Për natyrën*”, ku lufton kundër besimeve dhe iluzioneve të kota të religjionit popullor. „*Njerëzit, – thotë Ksenofoni, – vetitë e veta ua mveshin Perëndive dhe se ato (Perënditë) janë produkt i imagjinatës së njerëzve. Njerëzit i kanë krijuar perënditë sipas natyrës dhe kushteve të tyre dhe nëse qetë, kuajtë, luajtë do të kishin mundësi të pikturonin, sigurisht se do t'i kishin paraqitur ata sipas natyrës së tyre, – tallej Ksenofoni. Ai ishte kundër lojrave olimpike dhe lavdërimit të forcës fizike, përderisa forca mendore lihej anësh e nënçmohej.*

Për t'u kuptuar se ç'është qenia, thoshte ai, duhet vërejtur botën si tërësi unike. Dhe, ajo e vështruar kështu na paraqitet si një, e amshuar dhe e pandryshueshme, mandej ndonjëherë e quan edhe Zot. Zoti është, pra, tërësia e botës që ka formën e sferës. Në anën tjetër, Ksenofoni e mohonte ndryshueshmërinë, shumëllojshmërinë dhe lëvizjen në botë.

2.5.2. Parmenidi (540-460 p. e. r.)

Parmenidi ishte mik dhe nxënës i Ksenofonit, rridhte prej një familjeje aristokrate të qytetit të Elesë. Vepra më e njohur e tij është „*Për natyrën*” e cila dallohet me thellësinë e të shprehurit filozofik, por edhe me bukurinë e të shprehurit poetik. Është filozof që deri te njohja vjen përmes „metodës së deduksionit” dhe është i pari filozof racionalist në antikë që i ka aplikuar me tërë përpikmërinë ligjet themelore të logjikës formale, ligjin e identitetit dhe ligjin e jokundërthënies në gjykimet e tij filozofike. Pikëpamjen e tij për botën e shpreh përmes pohimit „*qenia është, joqenia nuk është*”. Të thuhet qenia është, kjo për Parmenidin është identike me „qenien qenieson”. Ja një shembull tipik i ligjit themlor të logjikës formale, ligjit të identitetit, që thotë: „*joqenia nuk është*”, domethënë „*joqenia nuk qenëson*” ose „*jo – A nuk është A*” (ligji i jokundërthënies).

Të thuhet qenia qenëson, kjo do të thotë se ajo nuk është krijuar, nuk ka lindur. Po qenia nuk ka fillim e as mbarim në kohë e hapsirë. Parmenidi thotë: „*nëse qenia është krijuar, ajo doemos do të jetë krijuar ose nga asgjëja ose nga diçka*”. Parmenidi argumenton me shpënie e pohimit në absurd. Supozimi i parë gjithsesi bie, sepse joqenia nuk ekziston – nga asgjëja nuk mund të krijohet. Mandej joqenia as nuk mund të merret me mend, nga se çdo mendim është mendim për diçka – për qenien. Supozimi i dytë: „*krijimi i qenies nga diçka*”, do të thotë qenia të krijohet nga qenia, rrjedhimisht nga vetvetja, pra ajo nuk ka prejardhje fare. Në mënyrë të njëanshme ai argumenton edhe pohimin e dytë, se qenia nuk ka fillim e as mbarim, kurrë nuk humbet. Kur „*qenia qenëson*”, ajo as nuk lindet e as nuk humbet, ajo është unike, një dhe e amshuar.

Më tutje vjen një pohim i çuditshëm, për mendjen e thjeshtë, se qenia është e pandashme. Nëse qenia është e ndashme, ajo duhet të ndahet në diçka, që nuk është qenie, pra në joqenie. Ne tanimë argumentuam se „*joqenia nuk ekziston*”. Pasi „*joqenia nuk është*”, atëherë rrjedh konkluzioni i domosdoshëm: qenia është e palëvizshme. Nëse ekziston lëvizja, kjo do të thotë ajo „*të lëvizë në hapsirë të zbrazët*”, në joqenie, ndërsa ne kemi thënë tanimë se „*joqenia nuk është*”. Rrjedhimisht **nuk ekziston lëvizja, nuk ekziston hapsira**. Kjo do të thotë se, **ekziston vetëm qenia**, që është e amshueshme, që s'ka fillim e as mbarim, e palëvizshme dhe unike (e njëlojshme). Ajo, madje ka formën e sferës, trupit më të përsosur gjeometrik.

Parmenidi shkoi në Athinë ta mbrojtë pikëpamjen e vet për qenien. Me vete mori nxënësin dhe mikun më të dashur Zenonin. Derisa ai argumentonte doktrinën për qenien e nuk pranonte lëvizjen e kohës, Diogjen ciniku lëvizte nëpër dëgjuesit e tij, duke e përgënjeshtruar dretjepërdrejt doktrinën e tij.

2.5.3. Zenoni (490-420 p. e. r.)

Zenoni nga Elea ishte nxënësi më i shquar i Parmenidit. Pikëpamjet e mësuesit ndaj oponentëve i mbrojti me mendjehollësi të veçantë, duke thënë se nëse janë të çuditshme pohimet e Parmenidit për qenien, atëherë janë edhe më të çuditshme pohimet e kundërshtarëve të tij. Zenoni thotë se qenia nuk mund të njihet me anë të shqisave, por vetëm me anë të arsyes. Ai kërkonte „*të shikohet paluhatshëm me sy intelektual në atë që nuk është para syve, si në atë që është*”. Zenoni në mbrojtje të mësuesit të vet u shërbye me metodën e të shpënit në absurd të pohimit të kundërshtarëve, pra u shërbye me apori (*apori* – parrugdalje, qorsokak) të tij të njohura, ndër të cilat po përmendim:

Dihotomia. Besohet se ekziston lëvizja, por ai që do të niset nga vendi A për të arritur në vendin B, kurrë nuk do të arrijë në atë vend. Ai më parë duhet ta kalojë gjysmën e asaj rruge, mandej gjysmën e gjysmës së mëparshme, pastaj gjysmën e së mëparshmes së tij, e deri në infinitum. Pra lëvizja nuk ekziston.

Akili dhe Breshka. Besohet se ekziston lëvizja, por Akili i shpejtë kurrë nuk do të mund ta arrijë breshkën. Derisa Akili të arrijë atje ku ka qenë breshka, ajo duhet të jetë larguar

prej një distance. Akili duke vazhduar vrapimin, vazhdon ta zvogëlojë distancën, por kurrë nuk mund ta eliminojë në tërësi. Akili kurrë nuk e arrin breshkën, nga se nuk ekziston lëvizja.

Shigjeta. Shumë njerëz mendojnë se shigjeta fluturon. Në të vërtetë ajo nuk fluturon, por stagnon. Shigjeta që fluturon, në secilin moment të dhënë gjendet në një pikë të caktuar të hapsirës; meqenëse ajo gjendet çdoherë në një pikë të caktuar, shigjeta është në qetësi, ajo nuk lëviz, ngase lëvizja nuk ekziston.

Zenoni me „logoi” (fuqinë e mendjes, përxjerjen logjike) i ka kthjellë bashkëkohësit, por edhe brezat e ardhshëm. Ai mendjen e njeriut e vuri përballë humnerës, të botës së pafundshme shqisore, të cilën ka sprovuar ta hudhë me forcën e të menduarit logjik. Kjo nxiti konteste të shumta, ku u inkadruan shumë mendje të mëdha të botës. Aristoteli, Zenonin prej Elesë e quajti „baba i dialektikës”. Nga kjo kohë e këndej dialogu del në rend të parë, ku si oponenti (kontestuesi) ashtu edhe ata që marrin pjesë gjatë diskutimit kontestues, duhet të binden në të vërtetën: mendimin tonë. Kur kemi dialog, njerëzit pranojnë pozitën e barabartë, janë të vetëdijshëm për këtë dhe pajtohen që të respektojnë gjykimin e drejtë.

Por shpesh herë dialogu shndërrohet në atë që thuhet si „mendje e madhe”, në të cilin vjen në shprehje jo vetëm mendja dhe gjykimi i mbështetur në të, por edhe dëshira që me çdo kusht të refuzohet kundërshtari dhe me atë të „argumentohet” qëndrimi ynë. Atëherë përdoren edhe përfundime jo të drejta dhe premisa në dukje të vërteta, në të cilat duhet të mbështetet konkludimi i drejtë. Me këtë rast pohimet marrin karakter emocional, fraza bëhet kryesorja dhe kontesti kalon në zënkë (gr. *eris, eridos* – zënkë, grindje), pra dialugu (dialektiku) kalon në grindje, fjalosje (**eristik**). Tanimë qëllimi shtrohet, jo e vërteta, por vetëm të krijohet iluzioni i të vërtetës, përkatësisht gënjeshtra të paraqitet si e vërtetë. Për më tepër, kundërshtari duhet të përqeshet, t’i ekspozohet dënimit publik, me një fjalë të tregohet se nuk është i denjtë për funksione politike ose të tjera publike. Me këtë rast dialogut e kontestit i bashkohet edhe interesi i njerëzve, dhe nga shkathhtësia e kontestimit dhe oratorisë është varur shprehshërë edhe jeta e njerëzve. Kjo është bërë çdoherë para opinionit, së këndejmi retorika fiton rëndësinë e dorës së parë, që më vonë veçmas do të vijë në shprehje te sofistët.

Rëndësia historike e Eleasve qëndron, pra, se duke u mbështetur në tërësinë e pandryshueshme të botës, i kontribuan formimit të nocionit të ligjit e ligjëshmërisë.

2.6. ATOMISTËT ANTIKË

Filozofia e lashtësisë greke nëpërmjet Heraklitit dhe Parmenidit paraqiti dy doktrina (pikëpamje) të këndërta, njëkohësisht të arsyeshme: e para ka të bëjë për të zënit fill të pandërprerë dhe për shumëllojshmërinë e sendeve në natyrë, ndërsa dyta e ka të bëjë për një qenie të pandryshueshme të botës. Lipsej nevoja që këto dy pikëpamje, në një farrë mënyre të të bashkohen, e në punën e tyre për t’i sintetizuar mendimtarët e lashtësisë greke erdhën deri te botëkuptimi atomist i botës.

2.6.1. Leokipi (450- p. e. r.)

Themelues i pikëpamjes së ashtuquajtur **atomizëm** ishte Leokipi, jonias i lindur në Milet. Shënimet për jetën e tij janë të dyshimta, kurse disa historianë të filozofisë dyshojnë se ka ekzistuar fare. Diogjen Luerti thotë se Epikuri e mohonte ekzistimin e Leokipit. Por, sipas Aristotelit dhe nxënësit të tij Teofrastit, ai ka ekzistuar dhe se në Elea i ka dëgjuar ligjëratat e Parmenidit. Teofrasti bile thotë se ai u distancua nga mësimi i Ksenofonit dhe Parmenidit, duke mohuar se ekzistojnë atomet në një mori formash të pafundshme. Mësimi i tij prej autorëve të mëvonshëm u quajt atomizëm. Aristoteli thotë se Leokipi e shkroi veprën „*Rregullimi i madh i botës*”.

2.6.2. Demokriti (460-370 p. e. r.)

Demokriti u lind në Abderë të Trakisë dhe është përfaqësues më i dalluar i materializmit në antikë. Meqenëse ishte i pasur, ai udhëtoi shumë në Egjipt, Babiloni, Persi dhe nëpër Greqi, e mblodhi shumë dituri. Kur u kthye në vendlindje u ftua në gjyq që të përgjigjet për shkapërderdhjen e pasurisë, siç mendonin bashkëqytetarët e tij. Kur u arsyetua se përse e kishte shpenzuar pasurinë, jo vetëm që u arsyetua, por mori mirënjohje dhe falenderime.

Prej shumë veprave të tij, të cilat përfshijnë të gjitha fushat e atëhershme të interesimit shkencor, „*ky, si duket, për çdo gjë ka menduar*”, thotë Aristoteli, janë ruajtur vetëm fragmente, ku përfshihet teorinë e njohjes, fizikës, matematikës, etikës e astronomisë. Për veprat e tij dijmë prej veprave të filozofëve të tjerë (Aristotelit, Diogjen Luertit), se sa prej veprave të tij. Janë ruajtur 299 fragmente dhe 352 dëshmi për të.



Demokriti

Sipas Demokritit, qenia është e ndashme, ndërsa ndarja e saj nuk mund të vazhdojë deri në pakufi, por medoemos të ndalet në disa pjesë, të cilat më tutje nuk mund të ndahen. Demokriti ato i ka quajtur atome (gr. *atomos* – i pandashëm). Atomet janë thërmia kuantitativisht shumë të imta, janë hapësinore, të pandryshueshme, të pandara dhe elemente të padukshme të çdo gjëje ekzistuese. Demokriti këtu është shërbyer me një argument të Zenonit, ku thotë: „*Nëse sendet ndahen në pakufi, në pjesë gjithnjë e më të vogla, atëherë do të ketë numër të pafund pjesësh, e këto ose kanë madhësi ose nuk kanë madhësi, e treta nuk është e mundshme: edhe të ketë madhësi edhe të mos ketë në të njëjtën kohë. Kjo është absurde, e pakuptimtë. Mandej edhe supozimi i dytë se nëse këto pjesë nuk kanë madhësi, çojnë në një pasojë të mundshme: shuma e numrit të pafund të pjesëve të një*

sendi pa madhësi, jep sendin pa madhësi. Nga këtu edhe ky supozim është i pakuptimtë, absurd. Rrjedhimisht çdo send që ka madhësi të caktuar, është i përbërë nga atomet. Ndërmjet tyre atomet dallohen për nga madhësia, forma, pozita dhe rendi, ndërsa lëvizja e tyre është e përhershme sikurse edhe ato vetë”.

Sic thotë Aristoteli, duke i shpjeguar atomet e Demokritit, ato sipas **formës** dallohen si A prej B, sipas **pozitës** si N prej Z, e sipas **rendit** si AB prej BA, ndërsa madhësia e atomeve vjen prej formës, por varet edhe prej **peshës** së tyre. Pesha e atomit pra përcakton madhësinë e tyre.

Veprimi i atomeve njëri me tjetrin zhvillohet nëpërmjet kontaktit dhe goditjeve (ndeshjeve), për shkak se atomet më të rënda që i godasin ato të lehtat, bien më shpejt. Nga lëvizja e atomeve në rreth krijohet vorbulla që është fillim i krijimit të botrave dhe kur e kalon pragun „e ndieshmërisë” ajo është e kapshme për njohjen shqisore. Sipas Demokritit, botërat krijohen e shkatërrohen, e shkatërrimi ndodh prej goditjes me njëra-tjetrën, bota më e madhe çdo herë e mund atë më të voglën. Botëra ka shumë, ashtu siç ka shumëllojshmëri të atomeve, prej atyre botërave vetëm një është, bota në të cilën jetojmë ne.

Meqë realiteti është i përbërë prej atomeve, sikurse edhe çdo gjë tjetër, tokën, pra, e përbëjnë atomet e rënda, zjarrin atomet e vogla e të rrumbullakëta dhe të lehta, ndërsa shpirtin e përbëjnë atomet më të holla dhe më të lëvizëshme të rrumbullakëta dhe të lëmuara, që janë të renditura nëpër tërë trupin e njeriut dhe pas vdekjes shkatërrohen. Demokriti mendon se të ndodhurit në botë është i determinuar dhe zhvillohet sipas ligjeve të domosdoshmërisë rigoroze. Thoshte se për mua më mirë është të zbulohet një shkak se sa të më jepni fronin mbretërorë të Persisë.

Sa i përket njohjes, Demokriti dallon njohjen e **qartë** dhe të **errët**. Njohja e errët është ajo që mbështetet në shqisat, ndërsa ajo e qartë mbështetet në mendje, e na jep dituri për atomet dhe zbrazëtirën. Vetitë e sendeve të zbulueshme me anë të shqisave i kanë vetëm krijesat e ndërlikuara, së këndejmi ato janë veti sekondare, për ndryshim nga forma, pozita dhe rendi që janë veti primare. Megjithatë, që të dyja janë objektive, pasi janë të lidhura për dukuritë objektive.

Në etikë Demokriti pohonte se kuptimi i veprimit të njeriut nuk është në arritjen e kënaqësisë trupore e të kalueshme, por të arrijë te pasuria e vazhdueshme dhe e vlefshme e shpirtit, në kthjellësinë dhe qetësinë e tij. Ai thotë: „*Përsosshmëria e shpirtit korrigjon dobësinë e trupit, mirëpo qëndresa e trupit pa urti nuk e bën shpirtin aspak më të mirë*”.

Demokriti duke u shprehur për maturinë, kërkon t’i përmbahemi mesit të artë. Është në anën e demokracisë, e në një fragment të tij, na e thotë edhe këtë: „*Varfëria në demokraci është për aq më e vlefshme nga e ashtuquajtura mirëqenie, fatbardhësia, nën mbretëri, për aq sa është liria më e mirë se skllavëria*”.

Demokriti është materialist, mekanicist, ndërsa determinizimi i tij kalon në fatalizëm, për rrjedhojë njeriu nuk mund të bëjë jashtë përcaktimit të fatit të vet. Për më tepër duke i shqyrtuar problemet e ndryshme të natyrës, ai i takoi periudhës së parë kozmologjike të mendimit filozofik grek.

2.7. SOFISTËT

Deri në paraqitjen e sofistëve dhe Sokratit, mendimi grek kryesisht u kushtojë çështjeve kozmologjike. Çështja se ç'është njeriu, ç'është virtyti, në çka mbështeten besimet e njerëzve, çfarë është natyra e drejtësisë që e caktojnë dhe e mbrojnë ligjet, çka mund të dijë njeriu i vdekshëm dhe çka nuk duhet të dijë e të synojë, tanimë janë në qendër të vëmendjes dhe janë më të rëndësishme se çështjet e kozmosit. Periudha e lindjes së mendimit kozmologjik grek, mund të merret në njëfarë mënyre si periudhë e lindjes së shkencave natyrore. Përpjekjet që të fitohen dituri të vërteta mbi dukuritë kozmike e lanë pasdore vetë natyrën e njeriut, jetën, shoqërinë e shtetin në të cilin ajo natyrë e njeriut gjen shprehjen e vet.

E krejt kjo ndodhi në shekullin V p. e. r., pas disfatës që Greqia ua shkaktoi Persianëve. Athina qëndroi në krye të „Lidhjes athiniane” të vitit 477 p. e. r. e cila inkadronte një numër të madh qytetesh-shtete. Ajo u bë qendër e fuqisë politike, si dhe qendër e lulzimit ekonomik e kulturor. Forcohet demokracia, me këtë vjen në shprehje një liri intelektuale dhe politike e paparë deri atëherë. Procesi i demokratizimit të Athinës filloi me reformat e Solonit, poet dhe njëri nga shtatë të urtit, i përfundon Klisteni në fund të shekullit të përmendur, ndërsa Perikleu për krejt këtë periudhë reformash do të shkruante: „*me rregullimin tonë shtetëror, ne nuk krijojmë institucionet e huaja, ne vetë më tepër shërbejmë si shembull për të tjerët, se sa i imitojmë të tjerët. Ky rend quhet demokraci, pasi që në të pushteti nuk i takon pakicës por shumicës së qytetarëve*”.

Kjo është koha kur shteti dhe të gjitha fushat e jetës publike ishin në duart e qytetarëve të lirë që mblidheshin në Agorë (shesh në Athinë). Ky kuvend popullor ishte pushteti suprem që vendoste për të gjitha çështjet me interes të përgjithshëm. Krejt nëpunësit shtetërorë zgjedheshin e ishin nën kontrollin rigoroz të popullit. Zgjedhjet bëheshin me short dhe me garë si dhe me votim për detyrat ku kërkoheshin profesion. Çdokush që donte të fitojë famë e fuqi dhe pasuri, si dhe të zgjedhej në ndonjë funksion qeverisës, ushtarak ose gjyqsor, ishte i detyruar të paraqitej publikisht që ta argumentojë aftësinë e tij se s'do të punojë me sukses për dobinë e përgjithshme. Tani, dituria, përkatësisht zgjuarësia që të paraqitej publikisht, të flitej e të arsyetoheshin qëndrimet e veta e të hudheshin ato të oponentit, fitoi rëndësi të posaçme. Kjo është koha që kërkon përhapjen e ditorisë në popull, për më tepër mbretërimin e saj me fjalë, që nënkupton posedimin e njohurive dhe përgatitje profesionale. Llogaritej se retorika është mbretëresha e krejt krijimtarisë artistike, ndërsa „*madhështia e të folurit është dhuntia më e bukur që perënditë e pavdekshme ndonjëherë kanë mundur t'i dhurojnë njeriut*”. Në fjalimet e oratorit të famshëm Demostenit, duke i lexuar njëherë Filipi i Maqedonisë, pat thënë: „*Jam i lumtur që nuk qesh i pranishëm, përndryshe më duket, vetë kundër vetes do të isha hudhur*”. Kurse, kur fliste Gjeorgjiu, sofist i famshëm athinasit, atë ditë e llogarisnin festë. Në këtë kohë kuptimin e jetës së lirë njerëzit e kërkonin në garë për funksione publike, të bëjnë punë të mëdha për atdheun, ta përparojnë qytetin e ta zhvillojnë shkencën, artin e filozofinë me të cilat edhe ata edhe qyteti do të bëheshin të famshëm.

Shekulli V p. e. r. ndryshe quhet edhe shekulli i Perikleut. Që zgjedhur në kontinuitet për strateg të këtij shekulli. Ndryshe ky është shekulli i artit, i zhvillimit të demokracisë, shkencës e filozofisë. Gjatë kësaj periudhe u krijuan disa prej veprave më të mëdha të arkitekturës dhe pikturës, por edhe letërsia pati zhvillim të dukshëm. Skena e lashtësisë greke,

ku dëgjoheshin fjalët sublime të shkrimtarëve të mëdhenj të tragjediave si të Eskilit, Sofokliut dhe Euripidit, por edhe punës së artistëve gjenialë si Fidia, Mironi e Prikanteli, u bë shkollë e moralit për të gjithë qytetarët grekë. Pastaj edhe shkenca greke, posaçërisht astronomia dhe matematika, shënuan përparime, ndërsa Hipokrati i lavdishëm u bë baba i medicinës. Athina u shpall panteon i Elades, ushqyese shpirtërore dhe fidanishte e arsimit, ajo u shpall qytet i urtësisë (vetë fjala Athinë do të thotë perëndeshë e urtësisë, mençurisë).


Në një situatë të këtillë të përgjithshme shoqërore sifistët (gr. *sofist* – dijetar) bëhen „njohës profesionalë” të gjërave të urta, profesioni i tyre mbetet që dituritë e tyre t’ia përcjellin të tjerëve, me një kompensim të caktuar në të holla. Hegeli këta do t’i quajë iluministët (arsimuesit) e parë të popullit. Sofistët, posaçërisht e çmuar dhe e zhvilluar shkathtësinë e retorikës, oratorinë dhe aftësinë që t’i mësojnë qytetarët e lirë për paraqitje publike: që ata të mund t’i shprehin mirë mendimet e tyre, ta zbukurojnë mirë dhe me atë të ndikojnë në mendjen dhe zemrat e dëgjuesve, e t’i bëjnë për vete.

Brenda në Athinë, sofistët janë të huaj, ata vijnë prej qyteteve tjera dhe derisa athinasit prej tyre mësonin „mjeshtërinë e të folurit” që u shërben për të fituar autoritet në shtetin demokratik, në të njëjtën kohë shfaqen edhe shenjat e para të dyshimit ndaj tyre. Tani e tutje fjala „sofist” e „sofistik” do të marrin konotacion negativ, përkatësisht u bë emërtim i njerëzve që „*paratë, interesin i vënë para të vërtetës*” dhe se „*për shkak të interesit material më e rëndësishme është që të bëjnë diçka që të duket se është e vërtetë se sa me të vërtetë, të jetë e vërtetë*”. Sofistët mandej për një kohë të gjatë kanë mbetur në zë për të keq, sidomos për shkak të kundërshtimit të ashpër ndaj tyre, prej kundërshtarëve më të mëdhenj të tyre si Sokrati, Platoni e Aristoteli.

Por, edhe përkundër dobësisë së tyre, disa merita kurrë e nuk mund t’iu mohohen, si bie fjala, zhvillimi i oratorisë e retorikës, që mund të keqpërdoren, por poashtu edhe të përdoren e të jenë në dobi e kënaqësi të njerëzve. Si askund tjetër, e zhvilluan retorikën, por edhe dialektikën dhe eristikën. Në fakt ato edhe nuk u paraqitën si ndonjë shkollë, më tepër llogariten si lëvizje kulturore historike që dallohen për nga mënyra e shprehjes së mendimit, të kuptuarit të qëllimit të arsimit si dhe se demokracia është rendi më i mirë për njerëzit.

2.7.1. Protagora (481-411 p. e. r.)

Protagora nga Abdera është sofisti më i njohur dhe më me ndikim. Fuqia e tij oratorike i ka fascinuar degjuesit, që nën ndikimin e tij ishin si të magjepsur. Në moshën tridhjetëvjeçare zgjodhi profesionin e mësuesit, ndërsa në vitin 411 u akuzua për ateizëm dhe u detyrua ta braktisë Athinën. Vepra më e njohur e tij „*Për perënditë*” u dogj publikisht në shesh, është libri i parë që u dogj sipas urdhërit të shtetit. Në këtë vepër Protagora thotë: „*Sa u përket perëndive, unë për këtë nuk mund të di asgjë; as se ekzistojnë, as se nuk ekzistojnë, sepse ka shumë gjëra që e pengojnë këtë njohje: si paqartësia e vetë çështjes, ashtu edhe jeta e njerëzve, që është aq e shkurtër*”. Sipas Protagorës „*njeriu është masa e të gjitha gjërave, të atyre që janë se janë, kurse të atyre që nuk janë se*



Protagora

nuk janë". Ky qëndrim tregon se si të gjitha gjërat nuk ekzistojnë absolutisht, por vetëm relativisht, domethënë në raport ndaj subjektit njohës. Çdo akt i njohjes pra supozon objektin vetëm si objekt i subjektit të caktuar. Në këtë mënyrë njeriu është kuptuar si qenie e pavarur dhe e lirë, i cili vendos për veten dhe mbi botën, duke mos dëgjuar as perëndi as autoritet njerëzore.

Njeriu është masë edhe i akteve të njohjes dhe i vlerave etike. Ky qëndrim i Protagorës është bazë e gjithë sofistikës dhe fjalës më të thellë, më mendore, me të cilën nga problemet kozmike dhe antologjike filozofia kaloi në periudhën e vet frytëdhënëse antropologjike.

2.7.2. Gjorgjiu (483-375 p. e. r.)

Gjorgjiu prej Sicilisë është njëri prej retorikëve më të shkëlqyer të botës antike. Stili i zbukuruar oratorik i tij me të vërtetë i ka mahnitur dëgjuesit deri në atë masë sa masovikisht kanë qenë të impresionuar prej tij, të gjithë synonin të oratorojnë si ai ose „gjeorgjiojnë”. Në veprën „*Për natyrën*” ose „*Për të paekzistuarën*” argumentoi me mendjemprehtësi këto tri teza: 1. *Asgjë nuk ekziston*, 2. *Në qoftë se edhe ekziston, diçka kjo nuk mund të njihet dhe* 3. *Madje edhe në qoftë se mund të njihet, nuk mund të thuhet, shpjegohet*. Disa mendojnë se me këtë Gjorgjiu ka dashur të përqeshë pikëpamjen eleaze për qenien – ai thoshte: „*çdo gjë është joqenie* (gr. *meon*, lat. *nihil* – asgjë) dhe mënyrën e tyre të të argumentuarit. Në etikë ai është relativist, se a është diçka e mirë ose e keqe varet nga koha, vendi e rrethanat”. Në fund duke u larguar prej filozofisë Gjerogjiu, u kthye te retorika dhe u përpoq ta përsoste atë si artin e bindjes.

2.7.3. Trasimarku

Trasimarku, orator nga Kalkedonia, pohonte se drejtësia është e drejtë e të forti, që të bëjë ç’ të dojë, ndërsa perënditë as që kujdesen se ç’ bëjnë njerëzit. „*Ligjet*, - thoshte ai, - *janë bërë nga grupe sunduese për interesat e tyre. Këto ligje përcaktojnë se çfarë është „e drejtë”*. Në të gjitha shtetet e drejta ka të njëjtin kuptim, ngase „e drejta” është në interes të grupit që është në pushtet. Pra e drejta është kudo e njëjtë: *interesi i grupit më të fortë*”.

Te Trasimarku, kemi një reduktim të moralit në forcë. Kjo të gjithë sofistët i çoi në një qëndrim nihilist ndaj të vërtetës dhe etikës. Sqarimi i paqartësive logjike të sofistëve dhe krijimi i nocioneve për të vërtetën, si dhe vendosja e disa themeleve të qëndrueshme të gjykimëve morale, u bë preokupim kryesor i Sokratit.

2.7.4. Sokrati (469-399 p. e. r.)

Sokrati nga Alopeku, bir i gurgdhendësit Sofronisk dhe i mamisë Fanareta, është personi më i dalluar në historinë e mendimit filozofik grek. Nuk shkroi asgjë nga se thoshte: *po ta pyesim librin, ai hesht*. Veprimtarinë filozofike e zhvilloi duke zhvilluar dialogje edhe për

çështjet më të ndërlikuar me njerëz në sheshe, arena gjimnastikore, tubime të qytetarëve, në rrugë, në dasma dhe çdokund ku mund të gjendeshin ata. Ai, me ata, në mënyrën e vet bën diskutime, i detyron të mendojnë, thjesht u shtron pyetje dhe në përgjigjet e pyetjeve të tjera, krejt me qëllim që t'i bëjë të mençur, të fillojnë dhe ato të merren me filozofi. Ka qenë shumë i popullarizuar, veçmas ndër të rinjtë, rreth tij mbledheshin lulja e rinisë atinase. Mësimin e tij e njohim prej dëshmive të nxënësve dhe miqëve të tij, si Aristofoni, Platoni, Ksenofoni, por edhe prej veprave të Aristotelit. Nuk udhëtonte si sofistët, por më tepër asnjëherë nuk u largua prej qytetit të vet.



Sokrati

Jeta e njeriut ka kuptim vetëm përmes virtutit, respektimit të ligjeve, maturisë, vetëpërmbytjes. Prandaj Sokrati thotë: „*njihe vetveten*“, kjo që sklaitur në të hyrë të tempullit të Delfesë. Është i shqetësuar për rënien e moralit dhe luhatshmërisë së çuditshme të qytetarëve të tij, ngase ata synojnë kah pasuria, kënaqësitë dhe fama, e jo ndaj virtutit e të vërtetës. Sokrati dëshiron ta përmirësojë shoqërinë, t'i riedukojë bashkëqytetarët e tij, t'i orinetojë kah idealet. Sokrati, fuqishëm e zhvilloi kuptimin jetësor etik e praktik të filozofisë, të cilës i imponon funksion edukativ, pra nuk bën tjetër gjë por pyet, qartëson e këshillon. Të gjithëve me radhë u dëshmon se nuk dinë atë çka duhet të dinë dhe çka mendojnë se e dinë. Shumë njerëzve ua zënë për të madhe, krejt me qëllim që t'ju ndihmojë në vetëdijësimin e tyre që të bëhen më të mirë dhe më fisnik.

Sokrati është ihtar i aristokracisë, atë e konsideron udhëheqje më të mirë, ngase më të mirët janë ata që dinë. Është kundërshtar dhe kritik i pushtetit të dështuar të shumicës në demokraci, si dhe e mbështeti tiraninë e të tridhjetëve në Athinë. Të rinjtë shkojnë pas mësuesit të tyre të frymëzuar, të mençur e fisnik, janë të lumtur pranë tij, ngase pakompromis e kërkon të vërtetën dhe virtutin. Sokrati i vë në gjendje të palakmueshme jo vetëm sofistët, por edhe aristokratët e njohur. Krahas shumë nxënësve dhe miqëve ai bëri edhe shumë armiq, me veprimet e veta kritike ndaj kundërshtimit të demosit. Atë e paditi në gjyq Aniti, mjeshtër lëkurash dhe tregtar, kundërshtar i madh i sofistëve dhe anëtar autoritativ i pushtetit demokratik. Në padi thuhej: „*Sokrati është fajtor sepse e prish rininë dhe po nxjerr perëndi të reja të cilat shteti nuk i njeh, prandaj propozoj dënim me vdekje*“.

Sokrati tanimë edhe në mënyrë praktike e aplikon respektimin e vet parimor të ligjeve, e shmang mundësinë e aratisjes, ngaqë me këtë do të nenvlerësonte synimet e veta etike.

Filozofi shtatëdhjetëvjeçar e pin kupën e helmit dhe nga jeta shkon i qetë, dinjitoz dhe ngadhënjyes. Vdekja e tij heroike bëhet fama dhe sitorja e tij më e madhe. Në dialogjet „Fedoni“ dhe „Kritoni“ Platoni i përshkruan bisedat, ditët e fundit dhe vdekjen e qetë të mësuesit të tij të madh.

Sokrati, megjithatë, nuk është tradicionalist, nuk është i kthyer nga e kaluara. Në synimin e vet mësimor nuk pendohet për autoritetet e tejkaluara të mitit dhe polisit, përkundrazi vërteton frymë të re të kohës, duke theksuar përgjegjësinë e individit dhe gjykimin e tij individual. Nëse njeriu vetë është masë e të gjitha gjërave, kjo nuk do të thotë fitore e relativizimit. Njeriun, pra, nuk e përcaktojnë vetëm shqisat, por, para së gjithash, mendja; jo vetëm epshet, por edhe ndjenja e detyrës dhe vetëdija e ndërgjegjia morale.

Me pasion Sokrati ju këndërvu sofistëve, ngaqë në mësimin e tyre më së shumti e rrezikojnë të rinjtë, edhe ashtu tanimë vetëdijën e luhajtur morale të shoqërisë greke. Nëse është fjala për të vërtetën, atëherë relativizimi është i paqëndrueshëm. „*Ne kemi nevojë për njohje të qarta, sepse ai që di nuk gabon. Njeriu mund të jetë i keq dhe të gabojë vetëm nga mosdija. Kush është i mençur, kush di çka është e mirë, ai edhe vepron mirë dhe arrin fat e lumturi. I mirë është ai që di. Është e pamundur që dikush edhe të dijë se çka është e mira dhe të bëjë keq*”. Sokrati, pra, e barazon **virtytin me dijen**, përkatësisht **dijen me virtytin**. Intelektualizmi etik e çoi deri tek optimizmi etik. Dhe në synimet që në mënyrë përmbajtësore të përcaktojnë virtytin, e theksoi virtytin e maturisë, vetpërmbajtjes, vetëngritjes, respektimit të ligjeve. „*Padrejtësinë më mirë është ta durosh se sa ta bësh*”, thoshte Sokrati.

Për studimin e natyrës Sokrati pati bile më pak kuptim se sofistët. Dija dhe njohja janë të mundshme për të, vetëm në çështjet e etikës dhe moralit. Duke kërkuar dije, atë çka vlen për të gjithë, ai i ka gjetur në nocionet, në njohjen e të përgjithshmes. Ai i pari e ka përcaktuar esencën e të menduarit si njohje e të përgjithshmes, njohje konceptuale (nocionesh).

Sokrati ju kundërvu sofistëve të gjithëdijshëm që në pyetjet të përgjigjen shkurt dhe qartë, sepse thotë ai është i harueshëm. Mendjehollë dhe i urtë Sokrati dëshmon: „*Di se asgjë nuk di*”. Në këtë „produkt” të qartë përmbahet një metodë parimore sokratike: „*të kthjellurit nga mosdija është hapi i parë, fillim i dijes*”. Hap i parë „negativ” i metodës sokratike të bisedës ishte „ironia”, ai që do të dëshmonte se si diçka do të ballafaqohet me mosdijen e vet dhe do të vërente se sa dija është e vështirë. Në bisedën e mëtutjeshme të zhvilluar me pyetje, Sokrati i ndihmon bashkëbiseduesit e vet, që të vijë deri te e vërteta, ta njohë dhe ta pranojë botërisht, të nxjerrë (lindë) atë që në vete secili njeri e përmban. Kjo shkallë e dytë „pozitive” e metodës së tij quhet, „majuetika” sokratike: shkathtësia e të lindurit. Metoda e Skoratit, pra, është në esencë metodë kërkimore.

Nga pikëpamja logjike është e qartë se këtu bëhet fjalë për „metodën e induksionit”, për kryerjen e veprimit induktiv. Shumë: pyet Sokrati, çka është drejtësia, miqësia, guximi, virtyti, e mira, e keqja, në mënyrë që të vijë deri te e përgjithshmja, që vlen për të gjithë, dhe përfundimisht me definicion t’i japë përcaktim të saktë konceptual. Në rrjedhimet praktike të këtyre veprimeve logjike, Sokrati do të ketë merita të mëdha për vënien e themeleve të logjikës.

Sokrati është intelektualist, konsideron se dija, përkatësisht njohja mendore e së vërtetës, është veprim dhe virtyt themelor i njeriut; është një ndër më të njohuri që ndikoi në Platonin, e Platoni në Aristotelin, ai ndikoi në krejt filozofinë perëndimore. Niçe ashpër e ka kritikuar pikëpamjen e tij moraliste dhe intelektualiste, si të njëanshme, të huaj dhe armiqësore.

Prej Sokratit rrjedhin shumë shkolla sokratike, si ajo e Megorës, Kinike dhe Kirenaike. Çdonjëra prej këtyre është e lidhur me ndonjë element të mësimin sokratik. Megarianët u ndalën në kërkesën e diturisë absolute dhe të mirës kalimtare, kinikasit iu kushtuan kritikës së civilizimit bashkëkohor qytetar dhe u bënë të degjueshëm në jetën e tyre të rëndomtë, të afërt me natyrën, ndërsa kirenaikasit e përkrahën etikën e kënaqësisë.

2.7.5. Platoni (427-347 p. e. r.)

U lind në Athinë dhe është nxënës më i dalluar i Sokratit. Emri i tij i vërtetë është Aristokle, kurse Platon e mori më vonë, për arsye të ndërtimit atlet të trupit (*plato*, në greqisht do të thotë „i gjerë”, „shpatullgjerë”). Rrjedh prej një familjeje të pasur aristokratike. Në rini u mor me poezi dhe gjimnastikë. Filozofinë e mësoi te Heraklitiani Kratil, por ndikim vendimtar tek ai ushtroi Sokrati, të cilin e njohi në moshën njëzet vjeçare dhe e ndoqi deri sa vdiq, duke mbetur nxënës më besnik i tij. I dëshpruar nga vdekja e Sokratit, bile me një rast pat thënë: „*Njeriu i arsyeshëm patjetër ta çojë zërin e tij nëse i duket se shteti keq udhëhiqet, por vetëm deri në atë masë sa nuk i kërcënohet vdekja*”. Platoni shkoi në Megarë të Euklidit, pastaj në Egjipt dhe në Kirenë. Një kohë mandej veproi si mësues në Athinë dhe rreth vitit 388 përsëri shkoi në Sirakuzë dhe Sicili ku u njoh me pitagorianët dhe mbërin në oborrin e Dionisit të vjetër. Pasi u kthye në Athinë në vitin 387 themeloi shkollën filozofike të quajtur Akademi, që ka ekzistuar deri në shek. VI, përkatësisht deri në vitin 529 kur mbreti Justinian shpalli dekretin e tij të njohur: „*Askush më në Athinë të mos shpjegojë filizofinë*”.



Doktrinën filozofike të Platonit ne e njohim në mënyrë burimore prej veprave të tij, të cilat janë shënime të vërteta filozofike dhe janë të ruajtura pothuajse në tërësi. Gati të gjitha janë të shkruara në formë të dialogut ku personazh kryesor është Sokrati që bisedon e polemizon me sofistët dhe është bartës i medimeve të Platonit. Këto janë vepra, jo vetëm që reflektojnë mendim gjenial, por vepra edhe ku vjen në shprehje aftësia e shkëlqyeshme e të shprehurit artistik. Historianët e filozofisë dallojnë disa periudha të zhvillimit filizofik të Platonit edhe atë: periudha sokratike me veprat „*Apologjia e Sokratit*”, „*Protagora*”, „*Lakesi*”, „*Shteti I*”, „*Lisidi*”, „*Harmidi*”, „*Eutifroni*”, periudha kalimtare, me veprat „*Gjeorgjiasi*”, „*Menoni*”, „*Eutidemi*”, „*Hipia i vogël*”, „*Kratili*”, „*Hipia i madh*”, „*Menekreni*”; periudha e pjekurisë e njohur me veprat „*Simpoziumi*”, „*Fedoni*”, „*Shteti II-X*”, „*Fedari*” dhe veprat e periudhës së vonshme si „*Taeti*”, „*Parmenidi*”, „*Sofisti*”, „*Burrështeti*”, „*Krita*”, „*Ligj*” etj. Gjithësej janë të ruajtura 35 vepra dhe 13 letra. Platoni me veprat e tij i përfshin të gjitha problemet filizofike dhe në mënyrë sistematike i përpunon ato, duke filluar nga antologjia, gnosologjia, etika, estetika e deri tek ato sociale dhe politike. Ashpër i ka kritikuar sofistët duke flakur senzualizmin objektiv dhe reletivizimin e tyre për njohjen.

Në mësimin e tij për qenien Platoni krijoi teorinë për idetë. Ai bëri dallimin ndërmjet njohjes shqisore dhe mendore. Të menduarit të shpie deri te e vërteta, dija, ndërsa shqisat në njohjen e errët, të opinionit, të rrejshme. Platoni tanimë dallon jo vetëm njohjen, por edhe vetë objektin e njohjes. Të menduarit për objekt të vetin njohës e ka ngjarjen e vërtetë, të vërtetën reale, botën e ideve, suazën mendore, të vërtetën mendore. Në anën tjetër, njohjes shqisore, të vërejturit i përgjigjen të vërtetat kalimtare, bota e fenomeneve, ekzistuesja, ndryshimi, kalimtarja, shumësia e llojllojshme e sendeve të veçanta. „*Idetë janë të përjetshme dhe të pandryshueshme,*

qenie të çdo gjëje". Ato janë qenie dhe qeniesuese, sipas tyre, në përgjithësi diçka është ajo që është. Idetë janë burim, shkak dhe shkas i çdo gjëje, paradigmë e çdo sendi. Ato janë të përsosura dhe reale, për dallim prej sendeve të veçanta materjale, që janë kopje, derivat, shprehje e ideve. Përmes „Metaforës së shpellës”, ai në mënyrë figurative e paraqet mësimin e tij filozofik për idetë dhe se kjo doktrinë më së miri e dëshmon idealizmin objektiv të tij.

Ndërmjes njohjes racionale të ideve dhe të perceptuarit shqisor qëndron **mendimi matematik**, të cilin Platoni e konsideron **përgatitje për filozofi**. Format gjeometrike dhe numrat janë ndërmjetësues midis botës ndijore dhe botës së ideve. Thonë se në dyertë e akademisë i shkroi këto fjalë: „*Le të mos hyjë askush që nuk e di gjeometrinë*”.

Ideja e së mirës është më e larta në hierarkinë e ideve, ngase e mira në të vërtetë është e mira absolute, përkatësisht hyjnia, shkaku i krejt ekzistimit dhe njohjes. Përkundër ideve, materia është e papërcaktuar, e papërsosur, e pakufizuar, masë koatike që plotëson hapësirën, në realitet ajo është joqenie.

Njeriu është i ndarë në trupin që i takon botës kalimtare të materjes, dhe në shpirtin i cili është i pavdekshëm dhe i amshueshëm. Shpirti ishte dhe do të jetë, ai përfshihet në botën shpirtërore të ideve. Shpirti edhe para kësaj jete ekzistonte njësoj si ideja, si shpirt i kulluar pa trup, ndonëse në frymë njerëzore. Prandaj njohja e vërtetë nuk është asgjë tjetër veçse kujtim i shpirtit për idetë të cilat i ka kundruar në parajetën e vet. **Teoria e njohjes**, në të vërtetë, është **teoria e anamnezisë**, e kujtesës, rikujtesës së botës së ideve. Platoni sugjeron që të çlirohemi prej botës shqisore, atë mos ta llogarisim të vërtetë, e vërteta sipas tij është vetëm bota e ideve.

Rrugat më e mirë për njohjen e ideve është **metoda dialektike me të cilën ai nënkupton shkencën për idetë**; ajo është aftësi që tërësia e sendeve të kuptohet si unitet dhe gjatë bisedës të fitohet njohja e nocionit. Është të diturit e të shtruarit pyetje të drejta dhe të dhënit përgjigje të vërteta; ajo na aftëson për njohjen e vërtetë, të kujtuarit për idetë. Dialektika na aftëson të zbulojmë botësinë e së mirës, të vërtetës dhe të bukurës, domethënë jo vetëm idetë por edhe hierarkinë e tyre.

Platoni, ashtu si Sokrati, më parë idealin për moralin e shihte në synimin për të arritur virtytin, i cili mbështetet në dituri. Qëllimi i diturisë është që ta arrijë virtytin, ngase virtyti qëndron në dituri të idetë. Gjatë veprimit moral njeriu udhëhiqet nga dituria e vet dhe nëse ka arritur te dituria e vërtetë, atëherë duhet të veprojë gjithmonë në pajtim me idenë e së mirës. Kur e njeh idenë e së mirës njeriu ngritet mbi kënaqësitë shqisore mashtruese deri te mbretëria hyjnore e ideve, prej ku rrjedh shpirti, ndërsa pas pastrimit me anë të virtytit kthehet përsëri atje. **Ideali etik i Platonit nuk është vetëm përsosja e individit, por edhe jeta e lumtur e njerëzve në bashkësinë njerëzore, sepse ideja e së mirës mund të sendërtohet jo vetëm në një individ, por edhe në të njëjtën kohë edhe në shtet.**

Problemi etik dhe ai politik te Platoni janë të lidhura, ato e kushtëzojnë njëri tjetrin. Politika ka të bëjë me rregullimit më të mirë të shtetit. Platoni kësaj i ka kushtuar dy vepra të rëndësishme: „*Shteti*” dhe „*Ligjet*”. Vepra e parë është interpretuar në mënyra të ndryshme. Derisa ajo përshkruan një shtet ideal, për të tjerët kjo paraqet një zmadhim të njeriut individual në mënyrë që ta kuptojmë më mirë si duhet të jetë njeriu. Sipas Platonit, shpirti i njeriut përbëhet prej tri pjesëve që u përgjigjen edhe virtytet përkatëse: pjesës ndijore – maturaia, vullnetit – guximi, trimëria dhe mendores – mençuria. Por, shpirti i njeriut është i pavdekshëm, kur derdhet në trup jep jetë, e ku kur do ta lëshojë atë vjen vdekja. Shpirti shpërngulet prej një


trupi në tjetrin (metopsikoza) që në fund i papërmirësueshëm të rrëzohet në Tartarë (humnerë sipas mitologjisë greke) ose si i mirë deri në fund të shpërngulet në ishullin e fatbardhësisë. Edhe shteti si analog i shpirtit të njeriut përbëhet prej tri shtresave: punuese, së cilës i përgjigjet matura, ushtarake që i përgjigjet trimëria dhe udhëheqësisë që i përgjigjet mençuria. Harmonizimi i mirë i këtyre virtytve, shtresave, jep virtytin e katërt: drejtësinë, virtyt kyç në shtetin e Platonit. Në të vërtetë „Shteti” i Platonit është dije për udhëheqësit dhe mbretërit që duhet të jenë të mençur ose siç thotë ai: „*derisa filozofët nuk bëhen mbretër, derisa të ashtuquajturit mbretër të sotëm... nuk i përkushtohen filozofimit të vërtetë dhe të themeltë dhe derisa këto të dyja nuk shkrihen në një..., gjatë gjithë kësaj kohe shtetet nuk do të mund të çlirohen nga e keqja*”. Platoni ashpër e kritikon demokracinë, sepse në të masat e paarsimuara dhe egoiste e kanë fjalën kryesore. Për Platonin shteti i lumtur dhe i drejtë në mënyrë ideale është ai në të cilin secila shtresë e kryen detyrën e vet në mënyrë më të mirë që di.

Problemi i së bukurës zë vend të rëndësishëm në filozofinë e Platonit. Ai thotë se ndryshe nga objektet e bukura dhe fjalët e bukura, ekziston ideja e së bukurës, e bukura në vetvete, e cila gjithmonë është identike me vetveten. Vetëm ai që e njeh idenë e së bukurës mund të përfundojë për shikollën e së bukurës edhe në objektet e veçanta. Për Platonin arti është imitim i sendeve të botës, që janë hije të ideve. Atëherë arti nuk është asgjë tjetër përveç se e imiton të imituarën. Arti është hije e hijes. Disa vepra të artit janë të dëmshme e disa jo. Veprat e dëmshme i ka ndaluar në shtetin ideal të tij.

Pavarësisht nga vlera dhe kualiteti i problemeve antologjike, gnosologjike, etike e estetike, që i shtron në dialogjet e tij, pavarësisht prej dualizmit të tij, të pakapërcyeshëm ndërmjet botës së ideve dhe realitetit si dhe mohimit të vlerës së krijimtarisë artistike në gjithë historinë e tij të ideve, Platoni padyshim është njëri nga filozofët më të mëdhenj në të gjitha kohërat.

2.7.6. Aristoteli (384-322 p. e. r.)

U lind në qytetin Stragirit të Trakisë Kalkidike. Ishte nxënës më i dalluar i Platonit. Babai i tij Nikomahu ishte mjek në oborrin mbretëror të mbretit maqedonas Amintit, babait të Filipit dhe gjyshit të Lekës së Madh. Aristoteli lindi përafërsisht në kohën kur u themelua akademja e Platonit. Kur ishte gjashtëmbëdhjet vjeç shkoi në Athinë, ku aso kohe vepronin dy shkolla: shkolla retorike dhe politike e Isokratit dhe Akademia e Platonit. Aristoteli së pari ishte te Isokrati, ndërsa pastaj shkoi në Akademi, ku qëndroi deri sa vdiq Platoni, plot 20 vjet. Në akademi, kishte reputacionin e të qenurit „lexues” dhe „mendja e shkollës”. Gjatë kohës sa ishte në Akademi, ai ishte jo vetëm nxënës, por edhe anëtar i barabartë i kësaj bashkësie të shkëlqyeshme intelektual-kërkimore. Detyra e Aristotelit ishte të mbante ligjëratë dhe t’i udhëhiqte ushtrimet nga retorika.



Aristoteli

Megjithatë, edhe kur ishin së bashku në Akademi, ishin të dukshme dallimet në temperament. Platoni ishte shumë më i interesuar për matematikën, ndërsa Aristoteli për të dhënat empirike. Është fakt se Aristoteli nuk u nda nga Platoni, derisa qëndroi në Akademi, deri në vdekjen e Platonit. Por periudha e tij „platonike” përfundon me vdekjen e Platonit, kur drejtimi i Akademisë kaloi në duart e nipit, djalit të motrës së Platonit, këmbënguljen e të cilit për matematikë nuk e duroi. U tërhoq prej Akademisë dhe u largua prej Athinës. Shkoi te miku i tij Eternea, bregdet i Azisë së vogël. Me ftesën e mbretit të Maqedonisë Filipit të II, bëhet mësues dhe eduktor për tri vjet me radhë të Lekës së Madh. Në ftesë Filipi i II i shkruante: „Dije se më lindi djalë, por unë nuk u jam aq mirënjohës zotërave që ma kanë dhuruar aq sa kanë urdhëruar që të lindet për të gjallë tëndin. Unë shpresoj se moshë juaj dhe dija juaj do ta bëjnë të jetë i denjë për mua dhe mbretërinë e vet të ardhshme”.

Më t’u kthyer në Athinë, në vitin 335 e themelon shkollën e vet e quajtur Lice. Kjo zaten është koha e ndërrimit historik të epokave: asaj **helene**, kur grekët ishin të lirë por të përçarë dhe të lidhur përmes traditës dhe religjionit, dhe në atë **heleniste** kur grekët më nuk janë plotësisht të lirë në aspektin shtetëror dhe politik, por janë të bashkuar nga hegjemonia maqedonase dhe romake.

Liceu konsiderohej si themelatë promaqedonase, prandaj kur vdiq papritmas Leka i Madh athinasit ngritën padi kundër Aristotelit. Atëherë ai u dësht të ikë në mënyrë, siç thoshte, „të mos ju jap athinasve mundësi që për herë të dytë të gabojnë ndaj filozofisë”. Anëtarët e Liceut të Aristotelit ndryshe janë quajtur peripatetikë (nga gr. *peri patoc* – shëtitje, vizitë, sjellje rrotull). Në të vërtetë Aristoteli ligjëratat e veta i mbante duke biseduar me nxënësit e tij nëpër shëtitoren, kopshtin e Liceut. Liceu i Aristotelit u dallua nga Akademia e Platonit me atë se nuk pati pretendime të përgatisë qeveritarë, filozofë ose filozofë qeveritarë, por u mor pastër me shkencë dhe politikisht nuk u angazhua. Në Lice organizoheshin dy lloj ligjëratash: të paraditës ekzoterike, për anëtarët e brendshëm të Liceut dhe të pasditës ekzoterike ose për anëtarët e jashtëm, të cilat fatëkeqësisht janë humbur.

Aristoteli, të gjitha dituritë ekzistuese i ndau në tri grupe, edhe atë në shkencë poetike, praktike dhe teorike. Për nga kuptimi i tyre këto fjalë sot dallohen; sot kanë tjetër kuptim ngase kishin atëherë. Pra, në shkencat poetike bënin pjesë: poetika, retorika dhe logjika; në shkencat praktike: etika, politika dhe ekonomia dhe në atë teorike: matematika, fizika dhe metafizika. Ndarja e kështillë për nga rendi i të mësuarit edhe sot ka mbetur që njëra tjetra i nënshtrohen vertikalisht, pra, arsimit fillor, i mesëm dhe i lartë.

Aristoteli është munduar sa më shumë të jetë e mundur, të lirohet nga ndikimi i Platonit, në këtë përpyetje rrallë Platonin e përmend drejtpërdrejt. Kryesisht flet në shumës, „ata” ose „krijuesit e doktrinës për idetë”, ku ndër të tjera thotë: „*Amico Plato, sed magis amiko veritas* – e dua Platonin, por më shumë e dua të vërtetën”. Ndërmjet Akademisë dhe Liceut, që nga çasti i themelimit ka qenë vendosur marrëdhënie rivaliteti. Pas vdekjes së Platonit, Aristoteli ua zë për të madhe akademistëve „se e kishin bërë filozofinë matematikë”. Në atë kohë akademia kishte marrë drejtim pitagorian, por kundërshtimi që u bë Aristoteli pikëpamjeve të Platonit, më i rëndësishëm është ai në shkencën e ideve.

Teoria e Platonit për idetë, thotë Aristoteli, është e gabueshme, sepse njëmendësinë pa nevojë e ndan në botën e ideve dhe botën e sendeve. Rrjedhimisht kjo nuk shpjegon asgjë, por vetëm e komplikon shpjegimin e asaj që ekziston. Teoria e Platonit i shton vështirësitë e problemit, në vend që t'i thjeshtësojë. Aristoteli bën vërejtje se, nëse idetë janë të përsosura dhe më të bukura, atëherë si është puna me idetë e tilla si plehu; e nëse idetë janë harmonizim i qenies, atëherë çfarë bëhet me idetë negative, siç janë, vdekja etj.

Të kujtojmë se Aristoteli është themelues i logjikës, si parapërgatitje për çdo shkencë dhe për filozofinë. Logjika e tij, me tezat e saj themelore e ka ruajtur vlerën e saj deri më sot, ajo merret si model për themelimin e logjikës elementare. Logjika në radhë të parë merret me nocionet, gjykimet, përfundimet dhe argumentimet. Nocionet janë esencë ose formë e sendit, njohja e të cilit është qëllim themelor i të menduarit. Nocionet e llojit (Sokratit), si më të ulta, bëjnë pjesë në atë të gjinisë (njëri) më të lartat, të cilat janë kategori. Kategori të tilla sipas Aristotelit janë dhjetë: substanca (gr. *ansia* – pasuri, esencë) – Sokrati, kuantiteti – 173 cm, kualiteti – filozof, raporti – bir i Fanaretës, vendi – në shesh, koha – në drekë, pozita – ri në këmbë, pasuria – me roba të vjetra, veprimi – flet, pësimi – i ekspozohet talljes. Nga kjo që thamë, vërejmë dy gjëra: e para Aristoteli synon që manifestimet e llojllojshme të qenies t'i nxjerrë nga gjuha, rrjedhimisht ngjashmëria e madhe ndërmjet „kategorive” dhe formave gramatikore dhe e dyta, katagoritë janë forma të paraqitjes së qenies, domethënë përmes shkencës pasqyrohet esenca e sendeve.

Kategoria e substancës në rend të parë shënon objektin individual, ky njeri, ky kalë, kjo tavolinë, pra diçka e perceptuar përmes shqisave aty për aty, diçka që është prezente. Kjo është substanca e parë. Ajo përmban në vete cilësi të caktuar sipas së cilës ajo është, ajo që është. Por, substanca e parë është e lidhur me substancën e dytë. **Kjo lidhshmëri paraqitet si ndihmë e domosdoshme për definicionin.** Në pamjen më të thjeshtë, ky njeri që e shikojmë është i përkufizuar me emër e mbiemër. Mbiemri tregon gjininë më të afërt, ndërsa emri tregon dallimin e llojit. Ky inkuadrim i qenies individuale në të veçantën dhe të përgjithshmen, sipas logjikës dhe metafizikës së Aristotelit, është lidhshmëri e domosdoshme e asaj që ekziston; zbulohet pjesërisht në çdo definicion, ndërsa tërësisht në sistemin e gjithëmbarshtëm të shkencave. Mirëpo për të njohur të veçantën dhe për të folur për të përgjithshmen, nevojitet të theksohen katër shkaqe: material, formal, veprues dhe final. Fjala vjen, për t'u shpjeguar kjo statujë e Sokratit që është në tavolinë, duhet të vëhet në dukje shkaku material, – pllaka e mermertë, shkaku formal – pamja e Sokratiti, shkaku veprues – aktiviteti i skulptorit dhe shkaku synues ose final – të zbukurohet dhoma, apo për përfitim material. Për objektet natyrore shkaku formal është në të njëjtën kohë edhe shkaku veprues edhe synues (final).

Kur forma i qaset materies fillon procesi i lëvizjes, i cili zgjat përderisa forma nuk realizohet. Posa materia e dhënë si potencial formësohet, lëvizja ndërpritet. Çdo gjë që ekziston paraqet unitetin e materjes dhe formës. Aristoteli ndërkaq e abstrahon materjen pa formën, siç e quan materje e parë, e cila është e palëvizshme dhe nuk ka veprim ekzistues – aktual, por është vetëm ekzistim i forcës. Kjo është lëndë e përgjithshme ndërtimi – hyle, materje, prej së cilës çdo gjë ndërtohet. Materja e parë, kur në njëfarë mënyre do të formësohet, atëherë fitohet materja

e dytë, që është gjithashtu unitet i materjes dhe formës dhe mund të shërbejë si „hyle” material ndërtimor për ndonjë formë tjetër, si për shembull argjili për tjegulla, tjegulla për mur, e muri për shtëpi, etj. Sa më e formësuar është materia, gjithnjë e më shumë formësohet forma, bëhet pastër formë, që tek Aristoteli fiton status të veçantë antropologjik, status të qenies. Forma e pastër në të vërtetë është Zoti, lëvizësi i parë i palëvizshëm. Megjithatë, kjo formë e pastër është e mbushur me njëfarë përmbajtje materjale, pra me mendimin që mendon vetveten. Nëse, më parë Aristoteli filozofinë e përkufizon si shkencë për ekzistencën si ekzistuese – antologji, tani ai do ta përkufizojë si mësim për formën e pastër, pra, shkencë për Zotin.

Në veprën „Për shpirtin” tek Aristoteli dominon mendimi se vetë shpirti është i palëvizshëm, por njëkohësisht e vë në lëvizje trupin, si formë dhe qëllim të tij të brendshëm e substancial. Shpirti në trup paraqet parimin e jetës dhe të organizimit, formësimit të tij. Ekzistojnë tri lloje të shpirtit: vegjetativ-bimor, animal-shtazor që konsiston me aftësinë për të lëvizur në hapsirë dhe shpirti racional-njerëzor, që ka aftësinë e të menduarit. Te njeriu dallojmë mendijen pasive, që është e lidhur me aspektin material dhe është kalimtare, sikurse individët; ndërsa mendja aktive është e pavdekshme.

Etika e Aristotelit është realiste, ajo i drejtohet jetës së kësaj bote. Teoria etike duhet të nisët prej përvojës morale të njerëzve, e jo prej idealeve të paarritshme. Objekt i etikës, sjellja praktike e njerëzve është sendërtimi praktik i së mirës në jetën e njeriut. E mira më e lartë që njeriu mund ta arrijë është lumturia. Që të jetë dikush i lumtur, është e nevojshme të ketë shëndet, të jetë i bukur, të ketë pasuri, të ketë pozitë autoritative dhe të ketë miq. Lumturia është kënaqësia më e madhe, diçka më e mira, më e bukura dhe më e këndshmja. Në fund, ai porosët: „T’i përmbahemi mesit të artë. Virtyti i vërtetë, pra, është çdoherë ndërmjet dy ekstremeve, fjala vjen trimëria është mes, ndërmjet frikës dhe guximit”.

Aristoteli mendon se njeriu si qenie morale manifestohet vetëm në bashkësi. Njeriu për nga natyra është „*antropos zoon politikon*” – qenie e gjallë shoqërore. Njeriu që nga fillimi jeton në bashkësi, në familje, prej së cilës përbëhet, zhvillohet shteti. Shteti, pra, është forma më e lartë e organizimit shoqëror, ku ai thotë: „Ai i cili nuk ka nevojë për asgjë, sepse i mjafton vetvetja, nuk është pjesë e shtetit, andaj është ose bishë ose perëndi”. Njeriu i lirë gjen vërtetim më të lartë në veprimtarinë publike, ku fiton lavdi dhe mirënjohje. Në shtet Aristoteli dallon tri grupe të qytetarëve: të pasurit, të mesmit dhe të varfërit. Shtylla kryesore e shtetit të mirë, thotë ai, është shtresa e mesme. Forma e udhëheqjes shtetërore janë monarkia, aristokracia dhe republika, ndërsa këto kur prishen, kemi tiraninë, oligarkinë dhe demokracinë. Forma më e mirë e udhëheqjes shtetërore është aristokracia, sundimi i më të aftëve dhe moralisht më të ngriturve.

Me interpretimet e tij të krijimit dhe të përjetimit artistik, Aristoteli themeloi shkencën për artin – estetikën. Arti, thotë ai, është imitim i sendeve të njëmendësisë objektive dhe si imitim ai, ka vlerë më të madhe se sa kopjimi besnik. Prej krijimtarive artistike më së shumti e çmoi tragjedinë, ngase ajo shikuesit i spastron nga pasionet me anë të frikës dhe dhimbshurisë. Veprimin etik të tragjedisë ai e quajti katarsisë – pastrim shpirtëror.

Për dallim nga Platoni, veprimtarinë e vet filozofike Aristoteli e paraqiti në mënyrë sistematike. Nga opusi i madh krijues i tij, është ruajtur ajo që është më e rëndësishme si

veprimtari filozofike. Ndër veprat më të rëndësishme, po i përmendim: shkrimet logjike të përfshira në titullin e përbashkët „*Organon*” – „*Mjete*”; shkrimet e shkencave natyrore „*Fizika*”, „*Për shpirtin*” etj; „*Filozofia e parë*”, më vonë e quajtur „*Metafizika*”; shkrimet etike, „*Etika e Nikomahut*” dhe „*Etika e Eudemit*”; shkrimet politike, „*Politika*”; shkrimet retorike „*Retorika*”, „*Poetika*”, ose „*Për krijimtarinë poetike*” etj.

Aristoteli jo vetëm që është filozofi më i frytshëm në krijimtarinë filozofike, por është edhe një nga më me ndikim në të gjitha periudhat historike. Me shkallën e lartë të refleksionit, njohjen e gjithanshme, dijen sintetike e sintetizuese në tërësi, me shekuj ai ka qenë shkalla më e lartë e dijes.

2.8. FILOZOFIA HELENISTE

Leka i Madh i Maqedonisë krijoi perandori të madhe. Gjatë sundimit të tij Greqia arriti kulminacionin e fuqisë së jashtme. Pas vdekjes së Lekës së Madh filloi rënia e ndikimit helen në botën antike; trashëgimtarët e tij e ndanë këtë perandori kolosale, që shtrihej në tri kontinente, në shtete të vogla. Në këto shtete tanimë i tërë pushteti u takonte monarkëve dhe klikave të tyre ushtarake, u shkatërrua qyteti-shtet grek që disa shekuj ishte themel dhe suaza politike e jetës shoqërore e kulturore, ndërsa së bashku me këtë u shkatërrua edhe demokracia skllavopronare greke. Jeta politike në „poliset”, që dikur ishte e bujshme, tani vjen e fashitet, qytetari i lirë që dikur zgjidhte shumë çështje të jetës publike, tani e tutje shndërrohet në shtetas të pafuqishëm të shtetit të madh botëror, në të cilin për çdo gjë të rëndësishme vendoste rrethi i vogël i oborrit mbretëror.

Në këtë periudhë heleniste në shekullin IV – I p. e. r, shumë popuj të botës u njohën dhe u afruan ndërmjet veti, e ndikuan në njëri-tjetrin. Nga të gjitha këto ndikime reciproke, më i rëndësishmi padyshim ishte ai i grekëve, që ushtruan te popujt e lindjes dhe natyrisht edhe anasjelltas, por ai ndikim ishte më i vogël. Është e pakuptueshme kjo, sidomos kur dihet se grekët me kthjellësinë e mendjes së tyre, me krijimtarinë kulturore, i kishin tejkaluar të gjithë popujt e kohës së lashtë.

Në periudhën heleniste grekëve u ra hise të ishin mësuesit e popujve të tjerë. Në njërin anë tradita, doket e filozofia vijnë e përhapen dhe bëhen një e mirë kulturore e të gjithë popujve, e në anën tjetër edhe popujt tjerë të kësaj kohe i futën në kulturën botërore të atëhershme traditave dhe botkuptimit si dhe vlerat kulturore të grekëve. Në suazat e perandorive të mëdha, shtete të mëdha monarkiste, që përbëheshin prej njerëzve të etnive të ndryshme shpërndahen dhe dominojnë teoritë kozmopolitike, për barazinë e të gjithë njerëzve. Pra, kozmopolitizmi, të njohurit reciprok i popujve të ndryshëm dhe gërshetimi i kulturave të tyre paraqisnin një tendencë pozitive të zhvillimit historik të periudhës heleniste.

Krijimet e kësaj kohe paraqesin një rënie evidente, në krahasim me ato që grekët e krijuan gjatë shekujve VI dhe IV. p. e. r. Vetëm krijimtaria e shkencave natyrore, historike dhe historiko-letrare shënoi një lloj ngritjeje, në krahasim me periudhën helene. Përveç Athinës, si qendra të krijimtarisë u afirmuan edhe Aleksandria, Rodosi, Pergami dhe Antiohia.

Krijimtaria filozofike e kësaj periudhe tashmë e ka humbur atë gjerësi të përfshirjes dhe atë thellësi të zgjidhjes së problemeve, që ishin karakteristikë për periudhën paraprake.

Me shkatërrimin e „polisit“, pozita e individit ndryshoi që nga themeli. Nëse më parë ishte i rëndësishëm si faktor politik, tani e tutje ai më nuk ka kurrëfarë rëndësie dhe meqë fati i shoqërisë së tij gjendej jashtë ndikimi të tij, njeriu i kësaj periudhe e ndien veten të vetmuar, të huaj prej pushtetit dhe jetës politike. **Etika tanimë ndahet prej politikës, interesimi për politikën vjen e zhduket.** Etikës i mbetet të kujdeset për lumturinë e individit, si të tillë. **Lumturia e tij nuk kërkohet në bashkësinë politike, por në jetën private të individit.**

Ndër shkollat filozofike të periudhës së helenizmit u dalluan Akademia e Platonit, Liseu i Aristotelit, stoicizmi, epikurizmi dhe skepticizmi. Në dy shkollat e para është filozofuar në frymën e themeluesve të tyre dhe se themelore ka qenë që të ruhen dhe përshkruhen, të komentohen dhe interpretohen me besnikëri veprat e tyre.

2.9. CINIKËT

Përfaqësuesit më të njohur cinikë janë Antisteni dhe Diogjeni nga Sinopa. Sipas filozofisë cinike, **lumturia mund të arrihet vetëm me heqjen dorë nga kënaqësitë ndijore dhe me reduktimin maksimal të nevojave, ngase mosplotësimi i tyre shkakton shqetësim dhe fatkeqësi.**

Antisteni (444-368 p. e. r.) është themlues i kësaj shkolle që predikonte një teori etike, sipas së cilës **virtuti dhe lumturia është e njëjta gjë.** Të jetosh në harmoni me natyrën, përkatësisht në mënyrë natyrore, duke i reduktuar nevojat, dëshirat dhe duke hequr dorë nga kënaqësitë, do të thotë të jetosh në mënyrë të lumtur dhe të virtutshme. Antisteni thotë: „*më mirë është të çmendesh se sa të kënaqesh*“.

Diogjeni nga Sinopa (400-323 p. e. r.) është personifikim i mënyrës cinike të të jetuarit. U ngrit kundër kënaqësive ndijore, kundër kulturës dhe institucioneve kulturore dhe shoqërore si produkte, si kreaturë jonatyrore dhe të dëmshme. Thoshte: „*duhet frenuar epshet, duhet reduktuar nevojat, duhet hequr dorë nga kënaqësitë, lavdia e lavdëratat, fama, pasuria, nderimi etj*“. Një anekdotë thotë se Diogjeni nga Sinopa, për të treguar praktikisht mënyrën cinike të jetesës u fut në një vazgë dhe aty jetonte e meditonte. Kur Leka i Madh i premtoi se do t'i plotësonte çdo dëshirë dhe e pyeti çfarë dëshironte, iu përgjigj: „*që të largohet prej diellit sepse po i pengon me rastin e rrezitjes*“. Me fjalë të tjera, cinikët u bënë sinonim i mospërfilljes së njerëzve dhe normave, thirrjes me fjalë, me ç'rast nënvlerësohen mendimet, meritat, vlerat e tjetrit apo tjerëve, pafytyrësia e nënçmimi.

2.10. SKEPTICIZMI

Themelues i skepticizmit (nga greqishtja *skeptuj* – heqje dorë, dyshim) është **Pironi** (360-270 p. e. r.) prej Eleidhës. Sikurse edhe Sokrati, nuk shkroi asgjë, prandaj edhe nuk dihet diçka e sigurt për ekzistencën dhe krijimtarinë e tij filozofike.

Qysh sofistët paraqitën tezën për karakterin relativ të së vërtetës, por si konceptcion të zhvilluar skeptik e themeluan filozofët e epokës helene. Ashtu si epikurianët e stoikët, edhe Pironi mendonte se qëllimi i jetës është paturbullushmëria shpirtërore – ataksioni. Por që të

arrihet deri te kjo së paku duhet përgjigjur në tri pyetje themelore edhe atë: prej çka janë të përbëra sendet, si duhet të sillemi ndaj tyre dhe çfarë dobie mund të kemi prej raportit ose sjelljes sonë të kësaj ndaj tyre. Në pyetjen e parë Pironi u përgjigj se në bazë të të vërejturit tonë nuk mund të njohim kurrë esencën e sendeve; skeptikët e mëvonshëm bile thoshin se as me anë të të menduarit racional nuk mund të njihet asgjë me siguri. Për këtë arsye njeriu i urtë nuk do ta shqiptojë gjykimin (përgjigja në pyetjen e dytë), ndërsa dobia që kemi prej qëndrimit tonë të kësaj është patrubullueshmëria shpirtërore (përgjigja në pyetjen e tretë).

Dyshimi i skeptikëve në mundësinë e të shprehurit të gjykimeve të caktuara, të vërteta dhe të argumentuara, fundi i fundit është i drejtuar kundër vetë filozofisë. Kjo kundërthënie e brendshme e tij është dobësia themelore e skepticizmit. Por skeptikët luajtën edhe rol pozitiv. Me luftën e tyre kundër dogmatizmit dhe me kërkesat që të sudijohen të gjitha argumentet „pro et contra” (për dhe kundër) të një pohimi, ata e aftësuan të menduarit filozofik për kërkimin më të thellë të së vërtetës.

2.10.1. Epikuri (341-271 p. e. r.)

Themelues i kësaj shkolle është Epikuri prej Same. Prej vitit 307 në Athinë e themloi shkollën e quajtur „Kopshti i Epikurit” ku i tuboi rrethi vetes miqtë dhe adhuruesit e tij, me të cilët kaloi jetë të përbashkët në të studiuar dhe në kënaqësi të paturbullueshme. Qëllimi i filozofisë është që të arrihet lumturia personale. Këtë mund ta sigurojë drita e arsyes dhe qetësia e shpirtit. Kur arsyeja na tregon rregullimin e përnjëmend të kozmosit, atëherë do të zhduket çfarëdo shikaku i frikës dhe vuajtjeve tona. Epikuri mendonte se frika zë fill prej besimeve tona në fuqitë mbinatyrore dhe prandaj e hodhi poshtë çdo interpretim religjioz dhe idealist të kozmosit.

Epikuri miratoi atomizmin e Demokritit. Natyra përbëhet prej atomeve të amshueshme, të pandryshueshme dhe të pandashme, që prej amshueshmërisë sillen në hapsirën e zbrazët e të pafund. Por, për dallim nga Demokriti që supozonte se ekziston një domosdoshmëri e lëvizjes së atomeve, Epikuri mendonte se lëvizjet drejtëvizore paljetër duhet të kenë ndonjë lakim-deklinim, të rastësishëm, të një mori të atomeve. Vetëm me këtë deklinim të atomeve është bërë i mundshëm formimi i botërave në proces, e herë zënies fill e herë të shkatërrimit të tyre. Ky konfirmim mbi deklinimin e atomeve është në lidhje me tezën e Epikurit për lirinë e vullnetit të njeriut që paraqet supozimin e të vepruarit moral. Edhe shpirti është i përbërë prej atomeve suptile që janë të zhdaravitura nëpër tërë trupin dhe me rastin e vdekjes ato shpërbëhen. Epikuri thotë se edhe ndodhitë natyrore nuk



Epikuri

varen prej neve e as prej perëndive të pabrengosura që jetojnë në botën e intermundimeve (vende ndërmjet yjeve) dhe se ato nuk interesohen as për botërat e as për njerëzit. Me këtë mendon Epikuri, se i çliron njerëzit prej frikës nga perënditë dhe frikës prej vdekjes, që është vetëm zbërthim i atomeve të shpirtit material dhe se nuk ka jetë pas varrit ku njerëzit presin dënimet ose shpërblimet. Epikuri thotë: „Derisa ne ekzistojmë nuk ka vdekje, kurse kur arrin vdekja, atëherë ne më nuk jemi”.

Teoria për njohjen e Epikurit është senzualiste. Fizika dhe gnosologjia shërbejnë për themelimin e pjesës kryesore të filozofisë, etikës. Ky qëndrim senzualist e çoi atë te botëkuptimi për të mirën si kënaqje. Kënaqësitë e përherëshme dhe më të dëshirueshme janë ato deri te të cilat vijmë me të marrurit me veprimtari shpirtërore. Nga këtu qëllimi kryesor i të filozofuarit është të arrihet ataruksioni, paturbulueshmëria shpirtërore. Në „Kopshtin e Epikurit” në Athinë, që ishte e tërhequr nga jeta publike, Epikuri në mesin e miqve dhe nxënësve të tij ka synuar të krijojë atmosferë të këndshme dhe të besimit, respektit dhe kushteve për kënaqje të denjë për filozofinë.

2.11. STOICIZMI

Themlues i stoicizmit është Zenoni nga Kitoni i Qipros (336-264 p. e. r.). Shkolla e mori emrin sipas fjalës „stoicizëm” (gr. *stoa poikile* – sallë e larme), kjo ishte një sallë në shtylla dhe e zbukuruar me pikturat e Polignotit, në të cilën ligjëronte Zenoni. Kjo filozofi është e shprehur në mënyrë sinkretike, domethënë bashkon në vete mësimet e filozofëve të tjerë origjinalë si Heraklitit, Empedoklesë, Anaksagorës, cinikëve, Aristotelit, Ksenokratit etj.

Sipas stoikëve, filozofia nuk është dhe nuk duhet të jetë një spekulim, një persiatje e thjeshtë teorike për botën, kozmosin në përgjithësi, por një çështje e njeriut si individ, e jetës, moralit, lumturisë, fatit e lirisë së tij. Filozofia duhet të mësojë e të aftësojë njeriun për një jetë harmonike, jetë në njëri me natyrën dhe arsyen. Stoikët filozofinë e ndanin në tri disiplina: në fizikë, logjikë dhe etikë. Duke e krahasuar filozofinë me vezën, stoikët thoshin se fizika është lëvozhga, logjika të bardhët dhe etika të kuqtë e vezës, ose kur e krahasonin me një kopsht thoshin: drunjtë e kopshtit paraqesin fizikën, gardhi paraqet logjikën, ndërsa frutat paraqesin etikën. Me çdo gjë që e krahasonin filozofinë stoikët, etikës i jepnin vendin e parë dhe kryesor, fizika dhe logjika duhet të jenë në shërbim të etikës.

Bazën më të thellë të çdo gjëje e përbëjnë dy parime themelore, materia ose substanca pasive (toka, uji) dhe Zoti, logosi aktiv (ajri dhe zjarri). Zoti është në vete substancë edhe në çdo gjë e jo jashtë saj, ai është një „zjarr” krijues dhe një „logos farë” nga i cili çdo gjë zë fill dhe në të cilin sërish kthehet. Në jetën e njeriut dhe të shoqërisë mbisundon domosdoshmëria e hekurit që i nënshtrohet edhe vetë Zoti si „pneumu” (frymë). Fatit si „arsye e botës” si zinxhir i shkaqeve nuk mund t’i shmanget njeriu. Çdo gjë ndodh, ekziston dhe përfundon ashtu siç ndodh, ekziston e përfundon e assesi ndryshe. Rastësia nuk ekziston. Liria e njeriut qëndron në të pajtuarit dhe të vepruarit tonë në pajtim me domosdoshmërinë dhe me fatin tonë. Gnosologjia stoike është senzualiste, përfytyrimet me të cilat zë fill njohja janë objektive dhe e dorës së parë.

Detyra kryesore e folozofisë, sipas stoikëve, është që ta mësojë edhe aftësojë njeriun të jetojë në pajtim me natyrën, përkatësisht në pajtim me arsyen e tij, si pjesë e arsyes hyjnore. Njeriu duhet të jetojë në mënyrë harmonike, domethënë në mënyrë të virtytshme duke iu ikur veseve dhe duke mos vuajtur për asgjë që nuk varet nga ai. Vetëm në këtë mënyrë mund të sigurohet qetësia dhe patrbullueshmëria shpirtërore (ataraksia) dhe indiferenca apo apatia. E mira e cila është një e vetme, përbëhet nga katër virtyte themelore: mençurisë, maturisë, lumturisë dhe drejtësisë. Ai që i posedon këto virtyte është i urtë, kurse ai që nuk i posedon është i marrë, – mendonin stoikët. Pjesa më e mirë e njeriut është shpirti, që është i lirë dhe as nuk mund të përvetësohet, e as të huazohet e të robërohet. Stoikët e kultivuan idealin e të urtit, që është kozmopolit, qytetar i tërë botës, shtetit botëror ku të gjithë njerëzit janë të barabartë.

Morali stoik është heroik, me të nënkuptohet qëndrueshmëri, durueshmëri, në mënyrë të paepur. Sidomos kjo do të vijë në shprehje në kushtet e kalimit prej poliseve në dheshpotin skllavopronar heleniste, ku filozofia praktike u bë shumë tërheqëse për shtresat e ndryshme të shoqërisë.

2.11.1. Plotini (205-270)

Plotini u lind në Egjipt dhe ishte nxënës i Amonius Sukos në Aleksandri. Më vonë shkoi në Itali, ku në moshën 40 vjeçare u bë mësues shumë i popullarizuar i filozofisë në Romë. Perandori Galien i lejoi në gërmadhat e një qyteti në Kumpanjë të themelonte qytetin filozofik sipas modelit të shtetit të Platonit. Mirëpo njerëzit nga përcjellja e perandorit e penguan këtë ide dhe e pamundësuan themelimin e Platonopolisit. Vdiq në pasurinë e një nxënësi të tij në Kumpanjë, ndërsa nxënësi i tij Portiriu i mbledhi dhe i botoi 54 ligjërata e tij në 6 eneada.

Filozofia e Plotinit është një përtritje e veçantë dhe origjinale e platonizmit dhe në të gjejmë shumë elemente aristoteliane, stoike dhe mistike. Plotini është filozof me natyrë sublime dhe askete që trupi i duket si burgu i turpshëm dhe si mistik, që në ekstazë religjioze e sheh aktivitetin më të lartë gnosologjik. Ai konsideron se gjithçka ekzistuese del nga emanocioni i „njëshit”. Kjo „njëja” e „para”, kjo hyjni me këtë nuk humb, sikurse drita, asgjë nga ekzistenca e vet, që vazhdimisht emanon, hedh dritë në errësi. Por, megjithkëtë vetë shkëlqimi humb gjithnjë e më shumë intensitetin, sa më tepër largohet nga burimi i vet dhe duke kaluar nëpër sfera të ndryshme, në fund bëhet i erët, kundërti e keqe ndaj hyjnisë, pra bëhet materje.

Mbi çdo gjë është qenia e lartësuar, njëja, që njëherit është edhe e mira, por për të cilën në të vërtetë asgjë nuk mund të pohohet, nga se është mbi gjithçka të shqiptuar. Njëja është gjithçka, por asgjë e veçantë, ndërsa shkëlqimi i drejtpërdrejtë i tij është nus-i (mendja ose fryma), në të cilën tashmë ekziston të qenët dyfish të subjektit dhe të objektit, të menduarës dhe të përfytyruarës. Produkt i fymës është shpirti që përbën shkallën më të ulët mbishqisore dhe njëherazi lidhjen ndaj shqisores. Me gjithë kundërshtitë ndërmejt shqisores dhe mbishqisores, gjithçka që ekziston përbën një gradaci unike. Mandej edhe materja që është pol i kundërt i mbishqisores, gjithashtu edhe joqenie, nuk është përjashtuar nga kjo

kierarki, por është vetëm pikë përfundimtare e së njëjtës vijë të krijimit. Në të vërtetë, Politini kësajsoj e shndërroi dualizmin platonian në monizëm.

Te Politini edhe estetika bëhet pjesë përbërëse, integrale e një sistemi të mbyllur, ngase në të metafizika e së bukurës është e lidhur në mënyrë jokontradiktore në filozofimin mbi artin. Për Politinin arti nuk e imiton natyrën, por e plotëson natyrën me bukuri, atje ku vetë natyra është mece. Në artistikën çdo gjë ndijore tejkalohet për t'u ngritur mbi ekzistencën tonë materiale.

Teoria gnosologjike e Plotinit, metafizika, psikologjia, filozofia e religjionit dhe sidomos estetika janë plot me mendime lucide dhe frymëzuese, por edhe me fantazi mistike, me përbuzje ndaj materiales dhe me synime të errëta religjioze ekstaze, mandej edhe me pseudozgjedhje, që në tërësi paraqesin përparim historik dhe mendor në krahasim me sistemet e mëdha racionale të antikës. Filozofia e Plotinit shërbeu si bazë ideore për shumë synime iracionale dhe mistiko-romantike të mëvonshme.

PYETJE:

1. Kur u paraqit filozofia antike?
2. Cilët popull i njihet merita e sajimit të filozofisë antike, e cilit i njihet merita e vërejtjes së vlerës së saj?
3. Kur u lind shkolla e parë filozofike dhe cilët janë përfunduesit e saj?
4. Ç'është baza e botës sipas Pitagorës?
5. Si krijues i prozës filozofike nga themeluesi i dialëktikës, çfarë thotë Herakliti për krijimin e botës?
6. Çfarë kuptuan racionalistët e parë antikë lidhur me arsyen e njeriut?
7. Cili është themeluesi i shkollës së Eleasë?
8. Çfarë argumenton Parmenidi?
9. Numëroji disa apori të Zenonit!
10. Bëj një krahasim ndërmjet themeluesve të shkollës atomike dhe zhvillimit „atomik“ të botës bashkëkohore!
11. Cilët konsiderohen „iluministët“ e parë në historinë e filozofisë?
12. Si do ta formulonit „relativizmin“ e Protagorës?
13. Cili është virtyti më i lartë për Sokratin?
14. Për çfarë e akuzoi „demokracia athinase“ Sokratin?
15. Cilën nga idetë Platoni e vendosi në krye të hierarkisë së ideve?
16. Cili është ideali etik i Platoni?
17. Si i ndan dituritë ekzistuese Aristoteli?
18. Si e përkufizon filozofinë Aristoteli?
19. Si e zgjidhi Aristoteli raportin ndërmjet të përgjithshmes dhe të veçantës?
20. Ç'është e mira më e lartë për Aristotelin?
21. Në ç'derjim filloi të zhvillohet filozofia në periudhën heleniste?
22. Çfarë predikonin cinikët që të arrihet lumturia?
23. Cili ishte roli pozitiv i skepticizmit?
24. Çfarë ishte qëllimi kryesor i filozofisë epikuriane?
25. Çfarë duhet ta mësojë njeriu filozofia sipas stoikëve?
26. Thuaj me disa fjalë filozofinë e Plotinit, si ndërmjetëse e filozofisë antike dhe të krishterizmit!

*„Njëra nga dhuratat më të bukura, të cilën fati na e ka ruajtur prej lashtësisë,
padyshim, është vepra e Platonit“*

Hegeli

III. FILOZOFIA MESJETARE

Nocioni filozofik „mesjetar” nuk përputhet me atë historik „mesjeta” që përfshin kohën prej shkatërrimit të Perandorisë Romake në vitin 476 e deri në vitin 1453 me rënien e Stambollit nën sundimin turk. Shekullin e artë të zhvillimit shteti Romak e përjetoi nën sundimin e perandorit August, ndërmjet shek. I p. e. r dhe I të e. r. Pas vdekjes së tij, fuqia e Perandorisë filloi të dobësohet për arsye të tre faktoriëve: nën presionin e luftërave të brendshme klasore; pakënaqësisë së rajoneve ndaj shfrytëzimit të pamëshirshëm romak; dhe të luftërave të vazhdueshme me barbarët, që nga të gjitha anët futeshin dhe e shkatërronin shtetin.

Krishterizmi është religjion në të cilin çështja e botës, e të njohurit dhe e njeriut nuk zgjidhet teoritikisht, siç ndodhi deri atëherë në filozofi, por praktikisht, nëpërmjet dogmave, besimit dhe kultit. Ideologjia krishtere në historinë e vet të gjatë në një anë është paraqitur si doktrinë filozofike, e në anën tjetër kisha krishtere si fuqi shpirtërore e shoqërore ka ushtruar ndikim të rëndësishëm jo vetëm në drejtim të konsolidimit të mendimit filozofik, por edhe në gjithë krijimtarinë shpirtërore.

Fundi i shkatërrimit të shoqërisë skllavopronare do të përcillet me kriza të mëdha ekonomike-shoqërore. Popullata e këtyre „shoqërive” gjithnjë e më shumë do të bierë në pikëllim e gjendje të pashpresë për një jetë më të lumtur. Shpëtim e rrugëdalje do të kërkojë në mbështetje të çështjeve të fesë, besimit të shteteve „të lindjes” që kishin filluar atëherë të përhapen në Perandorinë Romake. Dominuan dy fetë, ajo e krishterizmit dhe ajo islame, që besimtarëve iu premtorin dhe iu „siguronin” jetë të lumtur jo në këtë botë, por në botën tjetër, me kusht që këtë botë ta kenë kaluar në varfëri, si kusht i pastrimit të shpirtit nga mëkatet e shumta që njeriu i bën në këtë jetë. Bota në të cilën jeta, sipas religjioneve të përmendura, është e lumtur vetëm për të këqinjët, pabesimtarët, të pasurit dhe të diturit pagan. Këtyre iu ndalohet pastrimi nga mëkatet, për pasojë i pret dënimi dhe ferri në botën tjetër, ndërsa shpëtimi dhe parajsja i pret të mirët dhe të varfërit, siç predikojnë krishterizmi, ashtu edhe islamizmi.

Për të dy religjionet Zoti është Një dhe se ky Një ka qenë dhe do të jetë parimi kryesor i çështjes së besimit. Zoti i dënon ata që bëjnë padrejt, që nuk e njohin këtë parim si çështje besimi. Besimi i krishterë është „zëdhënasi” kryesor i krejt kohës së mesme. Përmes kishës e organizimit kishtar mendohet se vetëm mëshira e pakufijshme e shpirtit të pastër e përsosin dhe e lartësojnë qenien e njeriut. Krishterizmi mendon se Krishti derisa ishte në Tokë i shërbente njeriut, me të ndante çdo gjë, të mirën e të keqen, ia ktheu njeriut „sytë” madje edhe kuptimin e jetës duke e pastruar nga mëkatet.

Vetë Jezu Krishti nuk shkroi asgjë, si Sokrati. Mësimet për doktrinën e „besimit të ri”, i mbajti me 12 apostujt, ndërsa me masat e gjera dhe me „besimtarët e rinj” ligjëratat i mbante me metodën e predikimit apogog. Nuk e ka njohur Sokratin, por mësimet e tij janë të mësuara në krejt doktrinën krishtere, si të ishin mësimet e Krishtit. Ose thënë ndryshe, krishterizmi u zhvillua në ato vende ku dominante mësimi sokratian, përkatësisht ai platonian.

3.1. LINDJA E KRISHTERIZMIT

Shteti hebraik me rënien nën pushtetin romak, prej vitit 37 p. e. r. ishte nën protektoratin e Romës, ndërsa prej vitit 44 e. r. nën sundimin e plotë romak. Popullata hebreike u soll buzë kufirit të shkatërrimit për shkak të shfrytëzimit të pamëshirshëm nga ana e pushtuesve. Vazhdimisht hidhej në kryengritje, që shuheshin në mënyrë mizore. Zemërimi dhe pikëllimi e përfshiu popullatën e cila këtë „pamundësi” të veten e përjetoi si dënim nga Zoti. Ajo, duke mos pasur kurrëfarë gjasash që në mënyrë praktike ta ndryshojë gjendjen në të mirë, njerëzit filluan shpresën ta mbështesin gjithnjë e më shumë në ndonjë intervenim prej ndonjë force mbinatyrore; në ardhjen e të dërguarit të Zotit, mesisë – shpëtimtarit. Ai do të duhej ta nxjerrë popullatën nga robëria politike dhe varfëria e shkatërrimit ekonomik e të krijojë gjendje parajsore në tokë. Entuziazmi pas mesiasë i përfshiu masat, bile shumë vetë u shpallën për të tillë, por të gjithë ata i tejkolonte Jezu Krishti, ndihmuesi.

Krishti fitoi shumë ithtarë ndër popullatën e varfër që e ka ndjekur në mënyrë fanatike. Predikoi tri vjet sipas Ungjive. U zu nga pushtetmbajtësit në Jerusalem, është gjykuar dhe dënuar duke u kryqëzuar në kryq. Tri ditë pas vdekjes së mundimshme ringjallet dhe është ngritur në qiell. Kjo ditë sot festohet si ditë e madhe të krishterët, pra si festa e Krishtit për nder të ringjalljes.

Krishterizmi u lind në Palestinë në shtetin e judejve ndërmjet hebrenjve dhe pastaj u bë religjioni botëror historik në Perëndim. Doktrina e krishterizmit mbështet në Bibël, Librin e Shenjtë. Ajo është vepër letrare tejet e ndërlikuar. Është shkruar nga autorë të ndryshëm dhe në periudha kohore të ndryshme. Bibla përbëhet prej dy pjesëve: Dhijatës së Vjetër që e pranon edhe religjionin hebreik dhe Dhijatës së Re, në të cilën janë dhënë rrëfime për jetën e Jezu Krishtit; në të është paraqitur mësimi i tij si dhe janë vënë themelet e organizimit kishtar.

Krishterizmi, duke predikuar vëllazërinë ndërmjet njerëzve, duke iu drejtuar masave të shtypura e të shfrytëzuara, mandej „të gjithë njerëzve me vullnet të mirë”, shpejt filloi të përhapet, së pari në Palestinë e prej vitit 314 e. s. me Ediktin e Milanos të perandorit Konstatin që fitoi tretman të barabartë me religjionet e tjera, edhe në mbarë Perandorinë Romake. Së shpejti i asgjësoi të gjitha besimet politesite paganike e vendosi monopol si ideologjik ashtu edhe religjioz. Komunitatet e krishtere filluan të përhapen nëpër të gjitha qendrat e Perandorisë Romake, veçanërisht në Romë. Kështu, krishterizmi filloi të rrezikojë religjionin shtetëror, poliset greke dhe tërë pushtetin laik, prandaj besimtarët krishterë në fillim janë ndjekur prej disa perandorëve dhe janë dënuar në mënyrë të tmerrshme.

Por, krishterizmi nga ana tjetër si „paraqitje historike” është kundër, jo vetëm religjionit greko-romak, por edhe shkencës e filozofisë greke, në përgjithësi kundër krejt kulturës antike. Si mësim iu imponua njerëzve të thjeshtë e të paarsimuar, prandaj në të shumtën e rasteve është shërbyer me fjalime figurative; me tregimenë të cilat në mënyrë alegorike është paraqitur besimi për Jezu Krishin, si Zot, njeri dhe shpirt i shenjtë, që paraqesin në njëfarë mënyre mistike, një hyjni unike, treshin e shenjtë.

Jezu Krishti është lindur në Palestinë, në mënyrë të pagabueshme prej virgjëreshës Mari. Pas pësimit, rringjalljes e ngritjes në qiell tek Ati – Zoti i tij, ai pas disa kohërash do të kthehet përsëri në tokë e në mesin e njerëzve, me tërë shkëlqimin e famën dhe do t’iu gjykojë të gjithëve, të gjallëve dhe të vdekurve si dhe do të krijojë mbretërinë e amshueshme të Zotit, duke krijuar gjendje parajsore për të drejtët dhe të mirët, ndërsa do t’i dënojë në ferr gabimtarët dhe të këqinjët e kësaj bote, sipas besimtarëve krishterë.

3.2. PATRISTIKA

Me përhapjen e krishterizmit, atë filluan ta pranojnë edhe shtresat e larta të shoqërisë. Nga këtu krishterizmi do të duhet të paraqitet me një bindshmëri dhe elaborim më të madh, në tjetrën anë atë e kërkon edhe lufta e vazhdueshme me religjionet dhe kulturën antike. Në përgjithësi u shtrua nevoja që të mbrohet krishterizmi, e më vonë edhe t’u kundërvihet edhe heretikëve, besimtarëve të gabuar, që në krishterizëm paraqitnin qëndrime të kundërta, përkundër pikëpamjes zyrtare të kishës krishtere, me çka prishej uniteti i saj. Paraqiten apologjentët (mbrojtësit) dhe etërit kishtarë (lat. *patres*), veprimtaria predikuese e të cilëve pat rëndësi tejet të madhe për formimin e ideologjisë së krishterë dhe për forcimin e saj në pikëpamje organizative e teorike. Disa nga apologjentët dhe etërit kishtarë kanë qenë vendosmërisht kundër filozofisë dhe shkencës greke. Tertulani, bie fjala, mendonte se dogmat e krishtera nuk duhet të arsyetohen racionalisht, por duhet të pranohen me besim. Ai thoshte, „besoj në atë që është absurde”. Patristika, në anën tjetër, theksonte se duhet të shfrytëzohet filozofia greke, për arsyetimin racional të dogmave të krishtera, me çka do të ishin të pranueshme edhe për të arsimuarit. Një mendim i këtillë ishte prezent në shkollën krishtere të Aleksandrisë, me përfaqësues Klementin dhe Origjenin.

Filozofia në botën e krishterë karakterizohet me atë që është dogmatike dhe apologjetike; detyra kryesore është që në mënyrë racionale t’i arsyetojë dogmat religjioze; është zhvilluar metoda skolastike (lat. *scola* – shkolla) e filozofimit, që duke u mbështetur në autoritetin e teksteve të Biblës e të etërve kishtarë i „argumenton pohimet e saj”. Kjo filozofi është shërbetore e teologjisë.

Zhvillimi i skolastikës ndahet në tri periudha: **skolastika e hershme** (shek. IX-XII), **kulminacioni i skolastikës** (shek. XIII) dhe **rënia e skolastikës** (shek. XIV-XV). Synimi që doktrina e krishterë të paraqitet si sistem shkencor u realizua me sukses në sistemin teologjiko-filozofik të Toma Akunit, të cilin kisha e shpalli të shenjtë.

Edhe pse kisha e luftonte mendimin e lirë, ajo nuk qe në gjendje ta shuajë krejtësisht. Përpunimi i logjikës në skolastikën e hershme e ballafaqoi filozofinë me çështjen e kuptimit

të nocioneve të përgjithshme. Miratimi i doktrinës së Aristotelit, në kulminacionin e mesjetës ndikoi në përpunimin sistematik të problemeve, ndërsa zhvillimi i shkencave të veçanta në skolastikën e vonshme shkaktoi ndarjen e teologjisë prej filozofisë, të fesë prej arsyes. Skolastikët më së shumti u morën me teorinë e të njohurit, logjikës dhe gnosologjisë.

Problemi kryesor i gnosologjisë mesjetare është raporti ndërmjet fesë dhe arsyes, teologjisë dhe filozofisë, autoritetit dhe shkencës. Përkatësisht, problemi se a mund të njihen e arsyetohen me anë të arsyes dogmat fetare apo në të duhet besuar edhe kur janë në kundërshtim me arsyen. Kjo ka pasur konsekuencat e veta të caktuara praktike: **dhënia përparësi fesë** që do të thotë të jesh në anën e pushtetit sovran, të kishës dhe të Papës dhe e kundërta, **dhënia përparësi arsyes** që do të thotë t'i japësh përparësi pushtetit profan. Në fillim mbisundoi formula racionaliste „besoj që të mund të kuptoj”. Por kur Pjer Abelari proklamoi se feja patjetër duhet të mbështetet në arsye e në shkencë, atëherë u pa se mund të mbërrihet deri te bindja se sistemi i doktrinafe fetare është joracional.

3.2.1. Aurelie Agustini (354-430)



Aurelie Agustini jetoi në kohën kur ishte vështirë të bëhej dallimi ndërmjet filozofisë dhe teologjisë dhe në të dy fushat ai ishte njëri nga më të mëdhenjtë. U lind në Afrikën e Veriut. Në rini kaloi një jetë të shthurur, por shpejt iu fut studimit të filozofisë nën ndikim e veprave të Ciceronit dhe traditës stoike. Papritmas në moshën 33-vjeçare konvertohet në krishterizëm, pas atyre vitesh studimi të filozofisë. Vetë pohonte se konvertimi i tij në krishterizëm kishte qenë i përgatitur nga vepra e Platonit përmes neoplatonistit Plotin.

Agustini nga mësues i retorikës u bë peshkop në qytetin e Hiponit, në veri të Afrikës dhe nga Romaku që digjet pas kënaqësve u bë i shenjtë i të kreshterëve.

Veprat e tij më të njohura janë: „*Qyteti i diellit*” (*De civitate Dei*) që është një përpjekje për përligjjen e krishterizmit nëpër shekuj dhe „*Rrëfimet*”, njëra nga tekstet më të shkëlqyeshme që ekzistojnë në filozofi, por që nuk ofron asnjë sistem, asnjë paraqitje sistematike të një dije.

Mendimi i Agustinit luhetet ndërmjet filozofisë antike dhe krishterizmit, ndërmjet filozofisë dhe fesë, pra ndërmjet filozofisë dhe teologjisë. Teoria e tij duhet të përputhet me një traditë të krishterizmit, asaj të zbulesës hyjnore. Filozofia e Agustinit si pasojë e konvertimit të tij fetar, kërkon më pak koherencë racionale, që është kusht i qartësisë dhe se sa më pak

është i sigurtë në kontinuitetin intelektual, aq më shumë mbështet në përvojën e përjetuar nga shpirti dhe mendja. Që nga kjo kohë, problemi i raportit ndërmjet arsyes dhe besimit shtrohet me një mprehtësi krejt të re, që përmbledh pohimin e një feje të dhënë nga Zoti, të një fjale hyjnore, të një doktrine që edhe pse shprehet me gjuhën njerëzore, edhe ajo drejtpërdrejt vjen nga Zoti.

Për Agustinin besimi i paraprin arsyes dhe arsyetimit. Më së pari besimi merret si zbulues, por gjithashtu edhe si kusht paraprak i të kuptuarit mendor të botës, për të cilën vetë ai ka nevojë dhe e kërkon për ta kuptuar vetveten, për ta kuptuar atë që beson. Agustini gjeti formulën e njohur „*cred ut intellektum*”, unë besoj megjithëse kuptoj, ose unë besoj, por dua të kuptoj, apo unë besoj për të kuptuar. Këtu edhe qëndron thelbi që karakterizon qëndrimin e besimtarit në lidhje me arsyen. Tek Agustini, pra, ideja udhërrëfyese është se besimi i paraprin të kuptuarit, por edhe se besimi e kërkon të kupturit „*fides duarens intellectionem*” dhe se besimi është kusht i domosdoshëm i të kuptuarit „*Unë besoj për të kuptuar*”, e kjo do të thotë se nuk mund të arrihet te thelbësorja, e vërteta vetëm me ndihmën e arsyes. Që arsyeja të arrijë atë që ajo e synon, më së pari duhet të ushqehet nga besimi. Pa besimin arsyeja nuk do ta arrinte qëllimin.

Për Agustinin Zoti, është „objekti” i parë që besimi i ndihmuar nga mendimi racioal përpiqet ta kuptojë. Për të folur për Zotin ne përdorim fjalët e gjuhës sonë njerëzore, por ne, në një farë mënyre, duhet të përkthejmë pandërprerë në një nivel tjetër. Kur flasim për Zotin gjuha jonë e kapërcen vetveten, e duke e kapërcyer vetveten ajo e kundërshton veten e saj. Në këtë mënyrë kontradiktorja bëhet shenjë e hyjnore. „*Unë besoj sepse është absurde*”, thotë Agustini, pra ai pranon se kontradiktorja mund të jetë shenjë e hyjnore.

Agustini pohon sipas Biblës „*Zoti e ka krijuar botën ex nihilo*”, duke u nisur nga asgjëja. Për herë të parë në mendimin perëndimor e gjejmë te krishterizmi idenë e krijimit duke u nisur nga asgjëja. Zoti ka ekzistuar „përpara” botës dhe në një kuptim që nuk e kuptojmë dot përpara kohës. Kështu, Zoti i është përjetshëm dhe se krijimi ndodhi vetëm sepse e dëshiroi Ai. Dëshira e Zotit, pra, e ka krijuar botën. Por të gjitha këto fjalë nuk kanë kuptim jashtë besimit. Këto kanë vetëm kuptim që u jep atyre besim.

Triniteti shënon tre persona në një person të vetëm hyjnor, pra, Ati, Biri dhe Shpirti i shenjtë. Me krishterizmin nuk ekziston vetëm historia e natyrës si histori e universit, as një vetëm një filozofi e njerëzimit si histori e popojve dhe e kulturave, por ekziston edhe një histori mbinatyrore, në të cilën vetë Zoti është qenie historike. Historia mbinatyrore fillon me krijimin e botës nga asgjë dhe se pastaj kthehet nga mëkati fillestar dhe jeta, si dhe nga vdekja e Krishtit në historinë e shpëtimit dhe përfundon po në të njëjtën kohë të Zotit. Sipas Agustinut triniteti mund ta luajë këtë rol vetëm poqese uniteti dhe vërtetësia e tij janë me të vërtetë pranishme. Në qoftë se njëra nga këta dy nuk është, krijimi i trinitetit humbet menjëherë. Domethënë, në mësimin për „trinitetin” flitet për tre persona në një dhe një në tre persona: pra, Ati është arsyeja hyjnore, qenia e Zotit, Biri është fjala, e vërteta, ngase e vërteta tingëllon nga çasti kur qenia flet dhe Shpirti i shenjtë është dashuria nëpërmjet së cilës Ati lindi të Birin, thotë Agustini.

Për Agustinin e kaluara nuk ekziston, e ardhmja nuk ekziston ende, e tanishmja nuk është veçse një limit abstrakt pikash, rrjedhimisht nuk ka kohë. Nga këtu, Zoti e krijoi botën

dhe kohën në të njëjtën kohë. Por ne si qenie njerëzore, jemi të detyruar të kërkojmë shpëtim në diçka që e tejkalon kohën, qoftë kjo kohë që na është dhënë, qoftë një kohë e „menduar”. Dhe, edhe diçka, nëse është përjetësia, koha nuk është, e nëse nuk është përjetësia, por aq më tepër është koha. Këtu qëndron edhe misteri i jetës sonë njerëzore, thotë Agustini.

Zoti i Agustinit është një Zot i gjallë, që nuk mund të përfytyrohet, të cilit ai i beson dhe që është më i thellë se sa ai vetë. Është vetë jeta e Zotit në përjetësi, që lind në përjetësi të qenurit në kohë. Në këtë mënyrë mendimi i Agustinit shënon një transformim krishter fetar të trashëgimisë filozofike greke dhe hyrje në epokën mesjetare, në të cilën ka pasur shumë lutje, asketizëm e hipokrizi, por edhe mendime e diskutime të frytshme e krijuese.

3.3. FILOZOFIA BIZANTINE

Për filozofinë dhe kulturën e Bizantit është karakteristikë e përgjithshme ajo se paraqet përzierjen e krishterizmit me shtetin dhe kulturën romake, ku ruhet pasuria kulturore e antikës, por edhe se Bizanti i krishter nuk „i friksohet” mençurisë pagane. E drejta romake në Bizant paraqet bazën e jetës juridike, ndërsa kultura greke bazën e arsimit. Mandej bizantinët më fetarë inspirohen prej filozofisë, letërsisë dhe historiografisë greke, por edhe kisha është shërbyer me nocionet e filozofisë greke për përpunimin e doktrinës së saj fetare, dogmatike. Në shpirtin bizantinas është prezent mallëngjimi për amshimin, për përsosshmërinë e bukurinë mbitokësore, të mirën dhe të vërtetën edhe atëherë kur janë të veshura me mistikë e „fantazi” religjioze, që në fund-fundit si të tilla paraqesin karakteristika të njeriut si të tillë.

Lufta e ashpër ndërmjet neoplatonizmit dhe mendimit krishter në Bizant fiton përpunim racional filozofik. Neoplatonizmi si drejtim filozofik, eklektik, përzierje e pitagorizmit, platonizmit e aristotelizmit në njërin anë dhe afrimi i krishterizmit në anën tjetër sillen në pajtim të plotë. Në përmbledhjen Pseudo Dionisi Aeropagat të shek. VI në mënyrë jo të rëndomtë bashkohen mendimet dogmatike të krishtera me neoplatonizmin. Në këtë shekull dallohen mendimtarët nga Gaza, si Ençi, Zaharie dhe Prokopie. Leonikis nga Konstatinopoli, fjala vjen, është shërbyer me logjikën formale të Aristotelit për ta interpretuar shpalljen. Si logjikën e Aristotelit edhe antologjinë e Platonit, ai i aplikon për zgjidhjen e problemit krimnologjik për natyrën e Krishtit. **Duhet theksuar se në Bizant nuk pati filozofi zyrtare.** Për shqyrtimin filozofik të qëndrimeve filozofike dhe ndërtimin e pikëpamjeve filozofike, disa i mbështesin mbi Aristotelin e disa mbi Platonin. Sistem i vetëm filozofik që mund të quket „orthodoks” ka qenë ai i Jani Damaskinit, prej Damaskut. Në vepërën e tij „*Burimi i njohjes*” përpiket të përfshijë tërë diturinë e atëhershme në sistemin e tij filozofik. Edhe Demaskini u shërbye me logjikën formale të Aristotelit. Sipas tij, besimi shkon para arsyes dhe se ndërmjet tyre nuk ka mospërputhje. Dialektika është shërbetore e teologjisë dhe është tejet e dobishme për mbështetjen e besimit orthodoks, si besim i vërtetë.

Në shekullin e IX në Perandorinë Bizantine përtërihet shkolla e Lartë e Konstantinopolit, (në të cilën u arsimuan edhe Kirili dhe Metodi). Katedrën për filozofi e udhëhoqi Fotie, me bibliotekën e tij të njohur. Ai ishte mendimtar i gjithanshëm që u mor me filozofi, teologji,

drejtësi, gramatikë, por edhe me shkencat e natyrës, si medicina etj. E tërhiqte filozofia si e tillë, pavarësisht prej teologjisë. Përparësi i ka dhënë Aristotelit në krahasim me Platonin.

Shkëndijat e para të renesanës disa shekuj më parë u paraqitën në Bizant se sa në perëndim. **Mihajl Pselit** (1018-1096), i cili është përfaqësuesi më i rëndësishëm i filizofisë Bizantine, për të është thënë se: „*me veprën e tij na e sjell ndër mend Volterin*”. Pseli është platonist dhe shpesh e shpreh dashurinë për filizofinë antike. Sipas Pselit, filizofia paraqet përgatitje për metafizikën, të cilën e mbështet mbi Platonin, Poltinin e Proklerin, neoplatonistë të dikushëm. Sipas tij, filizofët paganë janë të krishterë të pavetëdishëm. Pseli përpiqet ta kuptojë krishterizmin në dritën e filizofisë greke. Për të, me të vërtetë filizofia del nga Zoti, e shpreh vullnetin e Zotit, përkatësisht dashurinë dhe mençurinë e tij.

Perandoria Bizantine fillon prej vitit 330, kur perandori Konstantin e përurroi „Romën e re” Stambollin e sotëm dhe zgjati diçka më tepër se një mijë vjet, përkatësisht deri më 1453, me rënien e Kostantinopolit nën sundimin turk. Fuqia bizantine fillon të bjerë në shekujt XIV dhe XV, por në nivelin e kulturës e arrin kulminacionin. Përveç Stambollit, u zhvilluan edhe qendra të tjera si Pirea, Selaniku, etj.

Në këtë periudhë kohore mbetet i njohur Universiteti i Konstantinopolit në të cilin „nuk ka pasur asnjë gjurmë të vogël të mësimit teologjik”. Në të vërtetë mbizotëron platonizmi nën ndikimin e mësimave të Pselit, por interpretimi ekzistonte edhe për Aristotelin.

3.4. ILUMINISTËT E PARË SLLAVË

3.4.1. Kirili (824-869)

Vepra e vëllezërve Konstantin të Selanikut, të quajtur në murgj Kirili dhe Metodi, vëllai i tij më i vjetër, Kirili është me rëndësi ekskluzivisht të madhe për popullin maqedonas. Me të drejtë quhen apostuj sllavë, meqë misionin e tyre të krishterimit të sllavëve që ua imponoi perandori bizantin Mihali i III dhe patriku Fotie, e kryen me sukses. E krijuan alfabetin sllav „glagolikën”, kanë përkthyer në gjuhën e sllavëve maqedonas një varg librash të nevojshëm kishtar e për shërbime kishtare-meshën. Ata i vunë themelet e shkrim-leximit dhe të letërsisë sllave.

Kirili është shkolluar në Konstantinopol, në shkollën e dëgjuar për murgj, në krye të së cilës ishte Lav Matematicienti, ndërsa mbante ligjërata edhe Fotie. Më vonë Kirili është mësimdhënës i „shkollës së lartë”, ku ligjëronte filizofinë, nga këtu u quajt edhe filozof. Kirili ka bërë dy misione, te Saracenët dhe te Hazarët, ku kishte për detyrë ta mbrojë religjionin krishter nga islamizimi dhe hebraizimi. Pastaj i besohet misioni në Moravi te princi Rostislav. Kirili është ithtar i vedosur i orthodoksisë. Polemizon dhe lufton për t'i kthyer besimtarët e gabueshëm dhe heretikët në besimin e drejtë. Kirilit i takon definicioni i parë i filizofisë, në historinë e kulturës sllave. Për të, „*filizofia është të kuptuarit e punëve*

të Zotit dhe të njeriut, deri në cilin njeriu mos mund t'i ofrohet Zotit dhe se; me veprat e veta të fitojë pamjen dhe rastin e atij që e ka krijuar". Pjesa e parë e definicionit shihet se është teorik. Lënda e filozofisë përfshin problemet filozofike dhe teologjike, në kuptimin më të ngushtë të fjalës. Pjesa e dytë e definicionit ka të bëjë me problematikën etike, filozofinë praktike. Sipas Kirilit, ekziston një Zot, që është krijues i çdo gjëje, që është i dukshëm dhe i padukshëm. Zoti është i padukshëm, pasi është pa trup. Ai është i amshueshëm, i gjithëfuqishëm, tejet i mirë dhe tejet i mëshirshëm.



Ekzistojnë dy natyra në botën e vetme të Zotit, ajo shpirtërore dhe shqisore. Ajo që është e Zotit, hyjnorja ka natyrë shpirtërore. Por, Jezu Krishti ka dy natyra, trupore-njerëzore dhe shpirtërore-hyjnore. Prandaj është ndërmjet botës shpirtërore dhe trupore. Për botën tokësore, Kirili mendon se është shprehje e së keqës dhe e mëkatit. Po, njeriu përveç trupit që është gabimtar dhe i vdekshëm, ka shpirtin frymor prej Zotit. Së këndejmi, te njeriu kemi dy synime, në njërën anë atë të jetës gabimtare e të turpshme, e në anën tjetër, atë të jetës së amshuar. Me agjërim e lutje hyhet në lidhje me Zotin dhe mund të meritohet jeta e lumtur në parajsë. Me ardhjen e dytë të Jezu Krishtit në tokë, të vdekurit do të ringjallen, shpirti do të bashkohet me trupin, atëherë njerëzve do t'u gjykojë „gjyqi i tmershëm”, me ç'rast të drejtët dhe të mirët do të shkojnë në parajsë, ndërsa gabimtarët dhe të këqinjët në ferr.

Kirili vdiq në Moravi, si misionar.

3.4.2. Metodi (vdiq në vitin 885)

Edhe pse më i vjetër, është bashkëpunëtori më besnik i vëllait të tij Kirilit. Pas vdekjes së vëllait ai e vazhdoi veprën e tij. Ishte arqipeshkop i parë sllav. Metodi ka zhvilluar luftëra të vazhdueshme e të vështira me priftërinjtë gjermanë, deri në vdekjen e tij. Është përkthyes i Biblës. Përveç Makavenjtë, në gjuhën sllave përktheu edhe Nomakanomin, përmbledhjen e dispozitave për organizimin kishtar. Atij i mvishet edhe autorsia e aktit të parë juridik „Ligjet për gjykimin e njerëzve”. Metodi, bashkë me të vëllanë, është ndër iluministët e parë sllavë, në frymën e krishterizmit orthodox.

3.4.3. Klimenti i Ohrit (840-916)

Klimenti i Ohrit bashkëpunoi me Kirilin dhe Metodin për përgatitjen e misionit të tyre në Moravi, si dhe me rastin e krijimit të alfabetit të parë sllav, bashkëpunoi me rastin e përkthimit të librave të nevojshëm kishtarë në gjuhën sllave, bashkëpunoi edhe me rastin e veprimatrisë së mësuesve të vet, në mbrojtjen e misionit të tyre. Pas vdekjes së Metodit merr pjesë në „konfliktet” me klerikët gjermanë dhe idenë e përhapur ndër krishterizmin perëndimor (katolicizmin) se Shpirti i shenjtë ka rrjedhur edhe nga Zoti, Biri.

Sipas dogmës orthodoxe, e vendosur në kuvendin e Nikejës në vitin 325, Shpirti i shenjtë rrjedh vetëm nga Zoti, Atë. Lufta në këtë pikëpamje do të marrë hov më vonë dhe si rezultat i saj do të kemi se Shpirti i shenjtë rrjedh vetëm „prej Birit”. Kjo do të thotë se mohohet zyrtarisht nga Roma, që pastaj do të shpierë te shizma, ndarja e madhe e kishës, katolike prej asaj orthodoxe në vitin 1054.

Klimenti i Ohrit është pjesëmarrës në përpunimin e „Përdorueses së Sinait”, si dhe të dhjetra lutjeve të tjera, me çka paraqitet si autor i parë origjinal sllav. Këtu lutjet janë të dy llojeve, mësim dhe lavdrata. Përderisa lutjet janë përshtatur për popullin e thejshtë me qëllim që të mësojë, për fenë e vërtetë dhe t’i nxisë në sjelljen e drejtë morale, lavdrimet në anën tjetër janë si himne stilistike të stolisura bukur me pretendime poetike dhe shprehje artistike. Etika e Klimentit është ajo e krishterizmit: duhet të punohet ajo që është e mirë, për Zotin të bëhen vepra të mira, të mos u bëhet njerëzve të tjerë keq dhe të mos u kthehet për bërjen e të keqes me të keq, por me të mirë; të bëhesh i matur, të respektohen ligjet e Zotit dhe njeriut.

Klimenti është bërë i dëgjuar si themlues i „Universitetit” të parë maqedonas, shkollë nëpër të cilën kanë kaluar 3500 nxënës, të cilët u bënë predikues të krishterizmit në gjuhën sllave. Themeloi shkolla e manastire dhe si peshkop i parë maqedonas është themelues i organizimit kishtar maqedonas dhe i shenjtë i merituar i saj.



3.4.4. Toma Akuini (1225-1274)

Toma Akuini u lind në Itali. Është me prejardhje nga familjet e kontëve italianë dhe me gjithë rezistencën e kushërinjëve bëhet rregulltar dominikan. Teologjinë dhe filozofinë e mësoi në manstirin Monte Kasina, te dominikanët në Napoli dhe në Këln tek Alberti i Madh. Si mësimdhënës jashtëzakonisht i arsimor i teologjisë, veproi në Paris, pastaj në

Romë dhe në fund në Napoli. Vdiq në mansatin Fosanaova te Teraçini, në rrugë prej Napolit për në Lion. Janë të shumta veprat e tij, ndër më të veçuarat „*Përmbledhja teologjike*” (*Summa Theologica*) dhe „*Përmbledhja kundër të pafeve*” (*Summa contra Gentiles*).



Toma Akunil

Toma Akuini dha një enciklopedi të veçantë të teologjisë katolike dhe të filozofisë skolastike, pastaj një pasqyrë universale dhe sistematike të paraqitjes së pikëpamjeve mesjetare të kishës lidhur me çështjet e drejtësisë, të moralit, të shtetit, të ekonomisë e të marrëdhënieve sociale. Si përpjekje më e gjerë për t'ia përshtatur Aristotelin mësimin të kishës katolike, filozofia dhe teologjia e Toma Akunit bëhet shkalla më e lartë e mendimit skolastik mesjetar dhe themel i dogmës së krishterë deri në ditët tona. Sistematizuesi i madh i kohës së tij dhe njohës i mirë i traditës filozofike, ai e vazhdon mësimin e Albertit të Madh, duke luftuar si kundër mësimin të vjetër augustinian, ashtu edhe kundër tendencave materialiste të averositëve krishterë. Toma Akuini përpaket ta dallojë fenë prej diturisë, teologjinë prej filozofisë. Dhe, përderisa dituritë e para janë të vërteta, racionale të mendjes, të tjerat janë „të vërtetat e zbulimit” të „mbiarsyes”, por jo edhe të „kundërsyes”. Prandaj edhe të vërtetat teologjike mund të mbrohen me mendjen si jokontradiktore dhe të mundshme. Filozofia, ndërkaq, është në shërbim të teologjisë, „*ancilla theologiae*”, ngase njohjet e saj janë më të ulta se ato të teologjisë, përkatësisht, mendja e kufizuar njerëzore është më e ulët se mençuria e madhe hyjnore.

Lidhur me çështjen e universalive, Toma është realist në kuptim aristotelian të matur. E përgjithshmja në realitet është imanente e individuale dhe është e ndarë nga kjo vetëm me arsyen që obstrukton. Kuptimi ynë, ndërkaq, nuk është i shtrembër deri atëherë derisa të mos gjykojë se e përgjithshmja ekziston vetëm për vete, në mënyrë të veçantë. Përveç të përgjithshmes në gjërat dhe të përgjithshmes pas gjërave, ekziston edhe e përgjithshmja para gjërave, si ideja e frymës hyjnore. Të ekzistuarit e perëndisë, sipas Tomas, mund të vërtetohet, aposteriore, domethënë prej botës si vepër e perëndisë. Perëndia ekziston si formë e pastër jomatriale, si aktualitet i pastër, ajo është shkaku formal dhe shkaku final i botës.

Bota nuk ka ekzistuar amshueshëm, por ekzistenca e saj nga asgjëja është shkaktuar prej perëndisë me gjithë fuqinë e saj në çastin e caktuar kohor dhe në të cilin

ka filluar të ekzistojë edhe vetë koha. Se bota ka fillim, sipas Tomas, vërtet nuk mund të vërtetohet rigorozisht në mënyrë filozofike, por ky pohim është më i mundshëm se kundërpohimi i tij dhe bëhet i sigurtë vetëm nëpërmjet të zbuluarit. Materjes si potencë e caktuar dhe pasive i jep qenie reale forma.

Pavdekësia e shpirtit buron prej jomaterjalitetit të saj, thotë Toma Akuini, sepse forma e pastër nuk mund të zhduket as prej vetvetes e as me shkatërrimin e substratit material. Shpirti njerëzor, përkundër mësimit të Platonit, nuk ka ekzistuar para ekzistimit të vet tokësor, kështu që njohja nuk është të kujtuarit e ideve që i vëzhgon shpirti në paraekzistencë. Shpirti për më tepër, nuk posedon as ide të lindura. Të menduarit e tij supozon përfytyrimin ndijor dhe është i lidhur me figurën empirike, nga e cila intelekti aktiv i abstrakton format. Shumë elemente të senzualizmit dhe të racionalizmit gërshetohen kështu në teorinë e njohjes së Toma Akunit. Ndërkaq, të vërtetën ai e përkufizon si ngjashmëri e arsyes dhe e sendit dhe në bazë të kësaj ngjashmërie arsyeja, pra, edhe nuk i njeh vetëm përfytyrimet e veta, por nëpërmjet tyre edhe vetë sendet.

Mësimi etik i Toma Akunit është përpjekje e bashkimit të ideve të Platonit dhe disa temave aristoteliane me virtytet e krishtera siç janë feja, të shpresuarit dhe dashuria. Qëllimi i fundit i njeriut është lumturia. Lumturia konsiston në posedimin e të mirës më të lartë dhe kjo është të vëzhguarit e drejtpërdrejtë të perëndisë. Prandaj edhe lumturia e përsosur edhe e amshueshme mund të arrihet vetëm në jetën tjetër, pas vdekjes.

Me tezën se subjekti është faktori qenësishëm për caktimin e të bukurës, Toma Akuini anticipoi shumë estetika të mëvonshme subjektiviste. Në mësimin e tij për shtetin shihet qartë përcaktimi i tij shoqëror. Pranimi i pushtetit të Monarkut si vullnet të perëndisë, arsyetimi i dallimeve klasore, sipas së drejtës hyjnore dhe natyrore, vlerësimi i të nënshtuarit si virtyt më i lartë i shtetasve, etj, flet qartë se Toma, më shumë është i kthyer nga e kaluara e kohës së tij se sa nga e ardhmja e kohës sonë.

Toma Akuini bëri ndarjen e fushës së fesë dhe të teologjisë prej fushës së arsyes e filozofisë, e nga këtu filozofinë ia nënshtroi teologjisë; filozofia është vetëm përhapje e teologjisë, shkencës hyjnore. Don Skoti të gjitha të vërtetat fetare i proklamoi si të paargumentueshme, nga këtu ishte e mundur të përfundohej se doktrina kishtare ishte e palogjikshme në esencën e vet. Argumentet racionale të fesë, sipas Skotit, janë të rastësishme, ngase në dogmat fetare vetëm mund të besohet. Në këtë mënyrë teologjia de facto ka qenë e mposhtur, ndërsa filozofisë dhe shkencës iu hap rruga për studimin e lirë të natyrës.

Një ndër çështjet e rëndësishme të skolastikës është edhe raporti i nocioneve të gjinisë dhe llojit. Në fillim dominoi realizmi, që konsideronte se universalet ekzistojnë para sendeve, si ide që gjenden në arsytin hyjnor; ato janë të vetmet që ekzistojnë realisht, ndërsa sendet individuale ekzistojnë vetëm nëse marrin pjesë në të përgjithshmen (universalët). Një gjë është aq më reale, sa më e përgjithshme që të jetë. Realizmi mesjetar, në të vërtetë, është vazhdim i idealizmit të Platonit. Për këtë arsye, realizmi është shfrytëzuar për t'u argumentuar ekzistenca e hyjnisë: meqë Zoti është qenia më e përsosur dhe më e përgjithshme, pra, qenia absolute dhe meqë të përgjithshmes, asaj më të përgjithshmes, i përket realiteti i njëmendët, del se Zoti ekziston domosdo. Ky edhe është i ashtuquajti argumentim

ontologjik i ekzistencës së Zotit. **Nominalistët**, në anën tjetër, mendojnë se reale janë vetëm sendet individuale, ndërsa nocionet e përgjithshme (universalet) janë vetëm tinguj bosh, përkatësisht emra (lat. *nomia* – emër) dhe se nuk ekzistojnë realisht.

Realizmi ishte shumë i përshtatshëm për argumentimin e shumë tezave teologjike, por njëkohësisht çonte në panteizëm (Zoti, gjendet në të gjitha sendet e natyrës) dhe prandaj si i këthillë u hudh poshtë. Por kisha e hudhi poshtë edhe nominalizmin, që në fund të fundit çonte në materjalizëm. Realizmi i matur i është përmbajtur Aristotelit, pra mendimet e përgjithshme gjenden edhe në sendet individuale. Nominalizmi i matur thotë se e përgjithshmja gjendet edhe në mendjen e njeriut.

3.5. LINDJA E ISLAMIT

Në shekullin VII u paraqit islami (ar. përkushtim), fe e re me predikuesin, profetin Muhamed dhe librin e Shenjtë Kur'anin. Besimi islam, pas besimit të krishter, është ndër më të mëdhatë në botë. Muhamedi u lind nga fisi Kurejsh në prill të vitit 571 në Mekë prej një familjeje tregtarësh. Në moshën 25 vjeçare martohet me Hadixhen e vejë e cila ishte 40 vjeçare. Në Mekë atëbotë mbretëronte besimi politeist. Për çdo vit në muaj të Ramazanit (ar. muaji i agjërimit) Muhamedi shkonte në shpellën Hira i veçuar prej njerëzve dhe meditonte rreth Krijuesit të përgjithshëm. Në moshën dyzetvjeçare të viti 610, derisa ishte në shpellën Hira, të ditës së 27 të muajit Ramazan, papritmas i paraqitet engjulli (ar. *melek* – engjull) Xhibril e i tha disa ajete (ar. *azat* – simbol, shenjë), pohime të kaptinës së Kur'anit „El alak”, përkatësisht e urdhëron të lexojë e mësojë. Muhamedi i përgjigjet se nuk di të lexojë. Engjulli Xhibril e urdhëron..., për të tretën herë duke i thënë: „Lexo, mëso, duke përmendur emrin e Zotit, që e ka krijuar njeriun në mënyrë më të përsosur prej një pikë gjaku të ngjizur! Lexo, mëso, dhe njëhe Krijuesin tënd! Dije se Zoti yt është më i ndershmi, dhe më i mëshirshmi! Ai e ka mësuar njeriun që të përdorë lapsin dhe e ka mësuar atë edhe për ato që nuk i ka ditur”. Në besimin islam akti i leximit është qenie e përparimit. Leximi ka qenë, është e mbetet punë e shenjtë, kush di të lexojë, ai di për Zotin, për natyrën dhe për veten.

Derisa i shpallej Kur'ani (ar. *Kur'an* – Lexim), profeti Muhamed i flonte njerëzit në besim të drejtë, i këshillonte për vepra e sjellje të mira, i udhëzonte të mësojnë shkrim e lexim dhe ta shtojnë diturinë. E para i besoi gruaja Hatixheja, djaloshi i ri i xhaxhait Aliu, shërbetori i dikurshëm Zejdi dhe Ebu Bekiri, udhëheqës autoritativ në Mekë.

Në shtator të vitit 622 shpërngulet për në Medinë, ku do të vazhdojë predikimin; përveç çështjes së besimit parashtron edhe rregulla e dispozita tjera për organizimin e „bashkësisë” islame. Sa ishte në Meke, thelb kryesor i udhëzimeve të Kur'anit ishte besimi në Një të vetmin Zot, në ditën e kiametit (ar. *kijamat* – kataklizmë), në shpërblime e ndëshkime, në barazi ndërmjet njerëzve. Në vitin e dhjetë të mërgimit shkon në kohën e

haxhit (ar. *hagy* – ai që viziton vendet e shenjta) e kryen detyrën, i udhëzon muslimanët me ato këshilla të njohura si „*Haxhi lamtumurës dhe këshillat lamtumurëse*”. Kthehet në Medinë dhe vdes në moshën 63 vjeçare sipas kalendarit arab ose në moshën 61 vjeçare e disa muaj. Për dallim prej besimeve tjera që me besimtarët e vet silleshin rreth çështjeve të fatit, shpalljet e Zotit në Kur'an që i predikon profeti Muhamed ishin përplot me shpresa. Ai zgjidhjen e problemeve nuk e mbështete në gjasa e hipoteza, por në dije dhe fakte. **Zoti, pra, njeriut i fali të gjitha të mirat e, para së gjithash, arsyen dhe mendjen.** Për rrjedhojë Zoti di gjithcka, është çdokund, mëshirues, mëshirbërës e i plotfuqishëm. Padyshim, ndër pjesët më të bukura të Kur'anit është predikimi i formës „*vallë a nuk shikon, vallë a nuk vëren*”, pra, kjo do të thotë se vërejtja dhe qortimi janë akte të mëdha morale që njeriu të ndihet i qenësishëm dhe i kthyer nga vetvetja.

3.6. FILOZOFIA ARABE

Religjioni i posakrijuar është quajtur **Islam** (arab. – nështrim vullnetit të Zotit), ndërsa ithtarët e tij **muslimanë**, ata të cilët i gjunjëzohen vullnetit të Zotit. **Kur'ani**, libër i shenjtë i muslimanëve, paraqet përmbledhjen e dispozitave fetare, morale, politike dhe juridike, që sipas traditës Allahu ia ka shpallur Pejngamberit, të dërguarit të Tij, **Muhamedit**. Në një përmbledhje i ka mbledhur kalifi **Abu Bekir** që e përbën bazën e mësimit fetar dhe të drejtën islame, **sheriatin**. Kur'ani përmban 114 sure (kapituj), prej të cilave secila përbëhet prej më shumë ose më pak vargjesh, **ajetesh**. Është shkruar në gjuhën klasike arabe dhe paraqet një vepër të jashtëzakonshme artistike letrare. Mund të bëhesh anëtarë i besimit musliman, sipas besimit islam, nëse pranon se, *Allahu është një, ndërsa Muhamedi i dërguari i Tij*, pesë herë në ditë lutje, falje, agjërim në Ramazan, dhënia e zeqatit si dhe shkuarja në Mekë, haxhillëk. Brenda për brenda islamit është paraqitur nevoja e sqarimit të dogmave dhe arsyetimi i tyre duke u thirrur në autoritetin e Kur'anit. **Mutakalimët** ishin ithatër të shqyrtimit me gojë, por edhe arsyetimit logjik të dogmave fetare. **Mutazilitët** ishin për vullnet të pakufizuar, përkundër determinizimit të mutakalitëve. Përfaqësuesi më i dalluar i mutazilitëve ishte Al-ashri. Sipas tij asgjë nuk mund ta njohë Zotin, por besimi, vullneti i lirë nuk mund të jetë i kufizuar. Çdo gjë mbështetet në krijimin e drejtpërdrejtë të Zotit.

Arabët para islamit, në anën tjetër, nuk e njihnin filozofinë e as që tregonin ndonjë interesim për shkencat dhe manifestimet e tjera të kulturës, të cilat i njihnin dhe i patën arritur bashkëkohësit egjiptianë, grekë, babilonas, persianë dhe indianë. Filozofia kaloi tek arabët pas paraqitjes së islamit, kur tek ata kjo fe e re ngjalli një jetë të re dhe kur ua mundësoi kalimin nga shkalla e kufizuar fisnore brenda Gadishullit Arabik në horizontet e gjera të njerëzimit. Muslimanët formuan një shtet të madh që shtrihej në lindje, prej Kinës, e në perëndim deri te skaji i Spanjës, Andaluzisë. Të gjithë filozofët arabë predikonin islamin dhe flisnin të njëjtën gjuhë, arabishten. Muslimanët ishin falmurtarë të kulturës kozmopolite dhe dhjetë shekuj me radhë që nga themeli i studiuan artet e shkencat e ndryshme.

3.6.1. Al Kindi (795-873)

Al Kindi jetoi në Bursë e pastaj në Bagdad. Konsiderohet themelues i filozofisë arabe. Ishte erudit dhe shkroi vepra të llojeve të ndryshme shkencore, para së gjithash nga matematika, astronomia, medicina e shkencat tjera. Është aristotelian konsekuent, përktheu shumë studime të Aristotelit, mirëpo në doktrinën e tij filozofike janë të qarta edhe disa ndikime të neoplatonizmit. Në mënyrë të veçantë theksoi rëndësinë e matematikës për themelimin e të gjitha shkencave.

Al Kindi argumenton se filozofia dhe shpallja nuk janë në disharmoni, prandaj dallon shkencën e njeriut, në të cilën bën pjesë edhe filozofia dhe shkencën e Zotit e cila u zbulohet profetëve. Ndërmjet veti këto shkencat në mënyrë të përsosur pajtohen. Zoti e ka krijuar botën nga asgjëja. Sipas tij, ekzistojnë tri lloje njohjesh: të logjikës e matematikës, shkencave të natyrës dhe metafizikës.

3.6.2. Al Furabi (872-950)

Ebu Naser Al Furabi, është emri i tij i vërtetë. U lind në qytetin Basiq në krahinën e Furabit dhe jetoi gjatë. Është filozof islam me prejardhje turke. Vdiq në Damask. Furabi ka qenë shumë i zgjuar, me një temperament të butë e të qetë dhe i dhënë tepër pas filozofisë; ai kalonte një jetë si filozofët e parë grekë dhe nuk kishte lakmi në begatitë e kësaj jete; e vetmja lakmi e tij ishte filozofia; ai nuk kishte as pasuri, as shtëpi. Arabët e quanin „mësuesi i dytë”, duke pasur parasysh se, Aristoteli ishte mësuesi i parë.

Al Furabi është përpjekur ta „bashkojë” Aristotelin dhe Platonin. Nga i pari mori logjikën dhe kozmologjinë, ndërsa nga i dyti, mësimin për krijimin e botës, që shkon prej nga shumësia, prej të amshueshmes kah koha e ndryshueshme. Shpirti individual nuk është i pavdekshëm e nuk ka jetë pas varrit, – mendon ai.

Kur e pyetën se cili ishte më i mençur, ai apo Aristoteli, u përgjigj: „Po ta kisha arritur Aristotelin, do të bëhesha student më i madh i tij” dhe „e kam lexuar Fizikën e Aristotelit dyzë: herë dhe e shoh se kam nevojë ta përsëris”. Nxënësit dhe miqtë e lutën që t’i përkthente veprat e Aristotelit në gjuhën arabe. Një punë të tillë e bëri me sukses dhe të gjitha veprat e Aristotelit, që janë përkthyer në gjuhët evropiane, të reja e të vjetra, janë sipas sistemit që ua bëri këtyre Al Furabi.

3.6.3. Avicena (980-1037)

Avicena (Abu Ali ibn Sina) i lindur në afërsi të Buharesë, është filozof natyralist; politikan, poet dhe mjek i njohur në perëndim. Vepra kryesore e tij është „Mbi shërimin e shpirtit”. Është përfaqësues i aristotelizmit arab, mirëpo në disa vepra të veta më të vogla

është afër edhe me misticizmin, duke u përpjekur ta bashkojë neoplatonizmin me përfytyrimet fetare islame. Sipas Avicenës, bota materjale është e amshueshme, e krijuar prej askushit, mirëpo vetëm relativisht është e domosdoshme dhe i takon kategorisë së mundësisë. Kjo botë që ekziston në aspektin kohor në mënyrë të përvetshme, kushtëzohet nga Perëndia e amshueshme që ekziston jashtë kohës.

Shpirti i njeriut është i pavdekshëm, jo në kuptimin fizik, por në atë shpirtëror. Lidhur me çështjen e universaleve, Avicena është realist i matur, për të nocionet e përgjithshme ekzistojnë para sendeve, në sendet edhe pas sendeve. Mendja e Perëndisë, – konsideron Avicena, – u paraprin sendeve, ndërsa mendja njerëzore vjen pas tyre. Për Avicenën, parimi i individualizmit është materia, ndërsa parimi i të përgjithshmes është mendja. Njohja është e pamundur pa mendjen kozmike aktive, e cila është unike te të gjithë njerëzit. Por njohja gjithashtu është e pamundur pa njohjen shqisore.

Vepra e Avicenës, „*Enciklopedia e madhe filozofike*“, e cila me urdhërin e kalifit u dogj në Bagdad në vitin 1160, ndahet në logjikë, fizikë, matematikë dhe metafizikë. Kononi i tij u përdor disa shekuj nga mjekët e lindjes dhe perëndimit.



3.6.4. Averoesi (1126-1198)

Averoesi (Ibn Rozhdi), filozof arab, është nga Kordoba e Spanjës, i cili përveç filozofisë studioi dhe teologjinë, shkencat juridike dhe medicinën. Ka qenë gjyqtar në Sevilje dhe Kordobë, por edhe mjek oborri i sundimtarëve marokienë. Është njëri nga komentuesit më të njohur të Aristotelit. Thuhet se „*Aristoteli e shpregoi natyrën, ndërsa Averoesi Aristotelin*“. Ndonëse konsiderohej vetëm nxënës i Aristotelit, të cilit nuk i nevojiteshin kurrfarë korrigjimesh, por mbrojtja nga interpretimet e ndryshme disproporcionale, prapsëprap e interpretoi vetë në mënyrë origjinale, duke theksuar orientimin materialist.

Bota materjale nuk ka as fillim e as mbarim në kohë, mirëpo nga aspekti i hapsirës është e kufizuar. Lëvizja është e përhershme dhe e pandërprerë, gjithmonë e shkaktuar nga lëvizja e mëparshme. Ndërkaq, lëvizja i nevojitet substratit, ndërsa Averoesi konsideron se ky substrat i përhershëm edhe universal i lëvizjes është materia. Materia e parë as nuk është krijuar e as nuk zhduket. Format gjenden potencialisht në materje.

Me çështjen e raportit ndërmjet shkencës dhe teologjisë Averoesi është njëri nga themeluesit e mësimin për të vërtetat e dyfishta. Të vërtetat e shkencës (filozofisë) mbështeten në mendje, janë racionale, ndërsa të vërtetat e fesë (teologjisë) mbështeten në shpallje. Të

vërtetat religjioze janë për masat dhe janë të dhëna në formë alegorike, ndërsa të vërtetat filozofike janë të dhëna të formë të pastër, racionale dhe mendore. Ekziston një intelekt i përgjithshëm i tërë gjinisë njerëzore, i cili është i pavdekshëm. Shpirti intelektual shkatërrohet me shkatërrimin e trupit. Magjithatë, doktrinën e tij e kritikoi ashpër Universiteti i Parisit në vitin 1240 dhe papa Leoni në vitin 1519. Në oborrin mbretëror Al Mansura, njëherë pasi u lavdërua, ai u ndalua dhe u ndoq si heretizëm. Në përfundim, në suaza të krishterizmit patën një drejtim që quhet averoizëm, kundër të cilit u ngrit edhe Toma Akuini.

PYETJE:

1. Ç'nënkuptojmë me filozofinë mesjetare?
2. Kur dhe ku u lind krishterizmi?
3. Ç'nënkuptojmë me „patristikën“?
4. Si është raporti ndërmjet besimit dhe arsyes të Sh. Augustinit?
5. Ç'nënkuptojmë me bizantin dhe a patëm ndonjë filozofi zyrtare?
6. Cilët ishin iluministët e parë sllavë dhe cili ishte misioni i tyre?
7. Si është raporti ndërmjet filozofisë dhe fesë të Toma Akuini?
8. Në çka mbështet pavdekshmëria e shpirtit të Toma Akuini?
9. Kur u paraqit islamizmi dhe si ishte zgjidhja e problemeve në të?
10. Si është realcioni ndërmjet besimit islam dhe filozofisë islame?
11. Numëroi disa përfaqësues të filozofisë islame!

„Fillimi dhe mbarimi i çdo filozofie është liria”

Shelingu

IV. FILOZOFIA E KOHËS SË RE

4.1. RENESANSA

4.1.1. NDRYSHIMI I FRYMËS DHE KULTURA E RE

Filozofia e kohës së re filloi të marrë formën e vet në shekullin XV dhe shekullin XVI në Evropën Perëndimore. Në këtë kohë u zhvillua një kthesë jo vetëm në filozofi, por edhe në të gjitha fushat e krijimtarisë shpirtërore. Ndryshimet e reja në zhvillimin e gjithëmbarshtëm të shoqërisë pasqyrohen në frymën e re, ndërsa në superstrukturën shoqërore u vërejtën në kulturën e re. Kjo kulturë e re ishte rezultat i praqitjes së shtresave të reja, pikërisht shtresës së qytetarëve të pavarur. Kjo shtresë shoqërore u zhvillua shumë, saqë shumë qytete u bënë të lira, u pavarësuan prej sundimit të feudalëve. Në këtë drejtim u paraqitën qytetet e lira në Itali si Gjenova, Firenca, Venediku, Milano, Napoli etj. Këto zhvillime dhanë shkas që në artin figurativ dhe në letërsi të krijohen veprat e para me frymë të lirë. Vlen të përmendet Leonardo da Vinçi, Mikelanxhelo Bunaroti, Rafaello e Ticiani, shumë të tjerë, si piktorë e skulptorë, mëtej Dante Aligeri, Fraçesko Petrarka, Xhovani Bokaçio e të tjerë në letërsi. Të gjithë këta krijues të mëdhenj jetuan dhe krijuan në Itali në shekujt e parë të kohës së re. Veprat e tyre përshkohen me frymën e re të humanizmit (lat. *humanus* – njerëzor), e që nxirrnin në horizont kohën e Renesansës.

Renesansa (prej frengjishtes „*renaissance*” do të thotë rilindje, ripërtitje) ka qenë e pandarë prej humanizmit. Rilindet kultura antike greke. Zbulohen dhe mblidhen „përmendoret” e kulturës antike, njohja e të cilave është përjetuar si një kontakt me një botë madhështore ku ka mbretëruar e vërteta, e mira dhe e bukura. Humanizmi është frymë e re e njerëzimit, kur njeriu i kthehet njeriut, i kthehet tokës dhe gjërave njerëzore, duke i vënë ato në bazë të interesimit kulturor, pra shkencor-hulumtues, estetik-artistik dhe filozofik. Toka është fushë për ta studiuar njeriun e jo „luginë e lotëve”, e pastaj vjen qielli apo Zoti, si nocione toelgjiko-religjioze.

Thënë më drejtpërdrejtë, dilet prej prangave të skolastikës. Kështu, del në arenën e kulturës në prgjithësi filozofia e re, e cila zhvillohet krahas shkencave tjera shoqërore dhe atyre të natyrës. Në renesansë në këtë mënyrë triumfoi individualizmi dhe kozmopolitizmi, ngase njerëzit ndiheshin qytetarë të botës, e njeriu u bë qëllimi dhe vlera, fokusi i të gjitha përpjekjeve njerëzore.

4.2. SHKENCA E RENESANSËS

Shkencëtarët e renesansës sollën ndryshime thelbësore në botën e mendimit dhe kjo arritje erdhi si pasojë e futjes së një metode të re, në kërkim të njohjes. Përtrihet, pra, interesi për shkencat e natyrës si matematikës, fizikës, astronomisë, anatomisë, etj. Individualizmi dhe kozmopolizmi i njerëzve të kësaj kohe u reflektua edhe në pasionin e tyre që të zbulohen vende e dete të reja, deri atëherë të panjohura. Kristofor Kolombo në vitin 1492 zbuloi Amerikën, Vaska de Gama zbuloi rrugën për në Indi, duke shkuar rreth e përqark Kepit të Shpresës së Mirë, në të cilin zbulim rol vendimtar luajti busulla, Johan Getenbergu e zbuloi makinën e parë të shkrimit, zbulohet baroti, kurse në vitin 1590 u krijua mikroskopi i parë, ndërsa holandezi Tipersheu në vitin 1608 shpiku teleskopin, kurse Galileu ishte i pari që e vuri në përdorim. Më një fjalë, objekt i interesimit të njeriut bëhet natyra dhe ligjëshmëritë e saj, njeriu dhe trupi i tij, jeta shoqërore dhe argumentimi politik. Shkenca përfundimisht çlirohet prej prangave të mendimit teologjik nga varësia e shpalljes dhe autoritetit, por edhe prej përfytyrimeve dhe supozimeve fantastike për botën objektive dhe dukuritë e saj. Tani e tutje bota do të soditet esull, ashtu siç është.

Leonardo da Vinçi (1452-1519), edhe pse më i njohur si piktor, skulptor e arkitekt, ai ishte edhe inxhinier, mekanik, anatomist e matematicient, pastaj edhe filozof. Sipas tij, natyra është i vetmi objekt jo vetëm i artit dhe i shkencës, por edhe i filozofisë. Çdo gjë që është mbishqisore, është objekt i shkencave të rrejtshme, që përveç astrologjisë dhe alkimisë da Vinçi e numronte edhe teologjinë. Natyra mund të njihet përmes përvojës shqisore, ndërsa shënimet e përfituara prej saj, duhet të përpunohen matematikisht. Leonardo da Vinçi veçanërisht e çmoi matematikën, ngase thoshte „*çdo shkencë është për aq më e saktë, për aq sa më tepër të aplikohet matematika*” dhe se „*mekanika është parajsa e shkencave matematikore*”. Shkenca, sipas tij, duhet të mbështetet në të vërejturit dhe eksperimentin, ndërsa teoria të ndërtohet në mbështetje të matematikës. Dhe, vazhdonte ai: „*përvoja janë ushtarët, e teoria është komandanti*”. Da Vinçi ishte edhe novator dhe ndërtimtar i jashtëzakonshëm, që duke studiuar fluturimin e shpendëve synoi të ndërtojë makinën për të fluturuar, me të cilën do ta pushtonte botën. Shpiku parashutën dhe mjete të tjera luftarake.

Nikolla Koperniku (1473-1543), kanonik (gradë e priftit të lartë) i arsimuar, është astronom polak. Me veprën e tij „*Mbi rregullimin e trupave qiellorë*”, të vitit 1543, supozoi tezën se „*Dielli gjendet në qendër të botës dhe rreth tij në formë të rretheve, në formë të udhëtimeve rrethore lëvizin planetet*”. Te ky sistem heliocentrik Koperniku erdhi duke krahasuar shënimet për lëvizjen e trupave qiellorë në dy teoritë ekzistuese: teorinë gjeocentrike të Kllaudio Ptolomeut dhe atë heliocentrike. Koperniku vuri në dukje se kalkulimet për lëvizjen e trupave qiellorë janë shumë më të thjeshta nëse supozohet se Dielli gjendet në qendër të botës, se sa kjo të jetë Toka. Sipas Koprenikut, nëse supozohet se natyra vepron në mënyrë të rëndomtë, atëherë është më e racionale të supozohet se Toka e

vogël rrotullohet, ndërsa sfera e yjeve të palëvizshme ri në qetësi. Sistemi i Kopernikut për botën mohoi antropocentizmin, mbi të cilin kisha e mbështeste doktrinën e saj zyrtare. Kësisoj, ai shkatërroi pikëpamjen e vjetër për botën, në çka qëndron edhe rëndësia kryesore e teorisë së tij. Por, teoria e Kopernikut me që ishte e mbështetur në fizikën e vjetër, nuk kishte mundësi të argumentohet, por më tepër duke e pasur parasysh nivelin e atëhershëm të zhvillimit të shkencave. Vërtetimin e sitemit heliocentrik të botës do ta bëjë vetëm zhvillimi i mëvonshëm i të arriturave shkencore.

Johan Kepleri (1571-1630), i cili në bazë të shënimeve për lëvizjen e planetit Mars, parashitroi tri ligje, që mbajnë emrin e tij, për lëvizjen e planeteve dhe kur në bazë të këtyre ligjeve e parashikoi skatësisht datën e zënies së Diellit. Këtë zënie në vitin 1631 e vërejti Pjerë Gasendi. Vetëm me anë të ligjeve të Keplerit heliocentrizmi i Kopernikut u kuptua si sistem i vërtetë i fizikës për lëvizjen e planeteve. Kepleri si shkencëtar gjenial, mposhti paragjykimin që kishte zënë rrënjë që në kohën antike, se planetet lëvizin në formë të udhëtimeve rrethore ngaqë rrethi konsiderohej si figura më e përsosur gjeometrike. Kepleri njëkohësisht miratoi edhe shumë konstruksione astrologjike e mistike si të vërteta.

4.2.2. Galile Galileu dhe Nikola Makiaveli

Galile Galileu (1564-1642), është tericinët, fizikan, matematicinët dhe natyralist italian. Bëri një varg zbulimesh të jashtëzakonshme epokale: konstatoi ligjet e rënies së lirë, të pjerrët dhe horizontale; peshoren hidrostatike; konstrukttoi teleskopin; bëri një varg zbulimesh astronomike, etj. Në fushën teorike-filozofike ishte materjalisht mekanicist, armik i skolastikës spekulative dhe përfaqësues i teorisë për dy të vërtetat. Sipas tij, arsyeja nuk është kompetente të gjykojë për çështjet religjioze-teologjike, por gjithashtu edhe teologjia dhe skolastika janë shërpe për shpjegimin e natyrës e të botës. Konsideronte se natyra me anë të përvojës duhet „*studiuar ashtu siç është ajo përnjëmend*”. Luftoi në mënyrë kritike kundër autoritetit skolastik, verbalizmit dhe silogjistikës. Madhësia, forma, kuantumi i trupit dhe lëvizja e tyre që zhvillohet mekanikisht, janë elemente fundamentale të botës për Galileun. Lidhur me këtë pohoi se çdo gjë mund dhe duhet të reduktohet në të shprehurit preciz matematikor dhe kuantitativ.

E vërteta absolute mund të jetë vetëm ajo që mund të shprehet në mënyrë gjeometrike dhe aty ku merr fund mundësia e shpjegimit matematikor, përfundon edhe shkenca, ngelin vetëm „fjalët boshe”. Galileu thotë: „*Kurrë unë nuk do të kërkoj prej trupave të jashtëm çfarëdo tjetër pos madhësisë, fugurës, kuantitetit dhe lëvizjes së ngadalshme ose të shpejtë*”.

Galile Galileu është iluminist i madh, mizorisht i persekutuar deri në fund të jetës prej autoriteteve kishtarë dhe romake, shkenca e të cilit sipas pohimit të jezuitëve ishte „*më e tmershme edhe për kishën më shkatërrimtare se veprat e Luterit dhe Kalvinit*”. Ai paraqiste një hap përpara për themelimin e pikëpamjeve të reja, nga këtu ishte antiskolastik e për kërkime

empirike-shkencore për natyrën dhe për krijimin e premisave themelore për kërkim të lirë shkencor. Mekanika dhe matematika i zbulojnë fshehtësitë e natyrës, ose ligjet e saja mund të shprehën me formula matematikore. Me këtë hapi rrugën triumfale drejt zbulimeve të reja shkencore të fshehtësive të botës.

Nikolla Makiaveli (1469-1527), ishte politikan, teoricient i të drejtës dhe shtetit, historian e diplomat italian. Në vitin 1513 shkroi veprën e tij më të rëndësishme juridike-politike „*Sundimtari*”, në të cilën paraqiti botëkuptimet e tij për formën më të mirë të organizimit politik. Makiaveli u nis prej premisë se nuk ka dobi nga përshtirja e ndonjë tipi ideal të sundimitarit, për të cilin rrëfejnë religjionet, flasin filozofët utopistë e reformatorët shoqërorë, për rrjedhojë niset nga studimi i natyrës së njeriut që orvatet ta kuptojë pa paragjykim. Ai thotë se „*njeriu për nga natyra është i keq, egoist, i pamëshirshëm sidomos kur janë në pyetje interesat e tij*”. Sundimtari duhet të disponojë me pushtet të pakufizuar për të frenuar këtë natyrë dhe ta detyrojë të veprojë në harmoni me të mirën e shoqërisë. Në vendimet politike nuk duhet të udhëhiqemi nga kurrëfarë konsideratash morale. Në këtë mënyrë ai pastron llogaritë me filozofët para tij, se politika dhe etika janë në lidhje të ngushtë dhe të parën e nxirrin prej të dytës. Pastaj edhe diçka më shumë: sundimatri i mirë moralisht mund t’i bëjë të keqe të madhe shtetit. Në anën tjetër, sundimtari i pamëshirshëm dhe i ashpër, siç ka qenë Cezar Borxhia, i cili me sjelljet e tij ndaj kundërshtarëve është shërbyer me mjete tejet jomorale, si tradhëri, helm, dinakëri dhe krime të tjera, vetëm e vetëm që t’i shkatërrojë ata, për Makiavelin ka bërë mirë ngase me ato veprime e ka forcuar shtetin. Më vonë, tek ai do të vijë në shprehje, parimi famëkeq që ka shërbyer si arsytim i tiranëve për të arsytuar pushtetin e tyre se „*qëllimi i arsytet mjetet*”, që do të thotë se është e lejueshme të shërbelemi me të keqen, nëse ajo shpie nga qëllimi i mirë. Për të mirën e shtetit nuk ka të keqe para së cilës sundimtari duhet të ndalet.

Në luftërat e ashpra që sundonin në Itali, Makiaveli mendonte se mund t’u kundërvihet vetëm me forcë dhe pavarësisht prej mjeteve mund të arrihet çlirimi i vendit. Vetë thoshte: „*Konsideroj se është i luntur ai që në veprimet e tij udhëhiqet nga fryma e kohës, pra së këndejmi i paluntur është ai veprimet e të cilit nuk përputhen me kohën*”. Pohon se tiranin e krijon ose populli ose aristokracia, varësisht prej rastit që paraqitet. Ndërkaq ka ndryshim qenësor ndërmjet popullit dhe aristokratëve: „*Synimet e popullit janë shumë më të ndershme se synimet e aristokratëve, sepse këta duan ta shtypin popullin që të mos shtypet*”. Në këtë mënyrë duke hequr maskën e rreme të moralit dhe të mashtrimit, themeloi teorinë e parë civile të shtetit.

Në komeditë e tij të shkëlqyeshme „*Mandragola*” shfaqet si mjeshtër i të qeshurit dhe i moralit i cili i kundërvihet drejtpërdrejtë hipokrizisë priftërore dhe çdo hipokrizie „të madhërishtme”. Mbron të drejtën e argëtimit dhe të qeshurit të popullit, i cili është i kundërt me „fjalimin solemn dhe rigoroz” të moralistëve.

4.2.3. Xhordano Bruno (1548-1600)

Është filozof italian, i cili në manastirin dominikan në Napoli studioi filozofinë antike, arabe dhe skolastike, kurse nën ndikimin e Lukrecit dhe Kopernikut gradualisht formon botëkuptimin e vet materialist dhe panteist. Në moshën 27 vjeçare ik i akuzuar për herezi prej një manastiri romak dhe i fillon bredhjet e veta të pafat nëpër qytetet e Italisë së Veriut, Zvicrës, të Francës, të Çekisë dhe të Anglisë. Kthehet në atdhe, pas ftesës së aristokratit Mocenig, i cili edhe e denoncoi dhe më 23 V 1592 e burgosi inkuizicioni venecian, duke e akuzuar se po „rekomandon shkencë mbi pafundësinë e gjithësisë dhe mbi shumësinë e botërave”. Inkuizicioni romak e torturoi për shtatë vjet me radhë dhe në fund e dënoi me vdekje. Pas persekutimit, burgosjes dhe dënimit, Bruno nuk u dërmua dhe nuk dëshironte të pendohej. Kur së bashku me fjalinë e moçme „*Të veprohet me të botërisht dhe pa derdhur gjak*” që donte të thotë digjeni në turë drunjesh, inkuizicioni ia shqiptoi dënimin. Ai iu përgjigj guximshëm ndaj torturave: „*Ju këtë dënim po e shqiptoni me frikë më të madhe se sa unë që po e dëgjoj*”. U dogj në sheshin Campo di Fiori dhe ishte një nga krimet (e shumta) më të rënda që i ekzekutoi inkuizicioni katolik.



Xhordano Bruno

Xhordano Bruno shkroi poema e diskutime, ndërmjet tjerave dhe dialogun „*Për shkakun, fillimin e njeshin*”. E miratoi doktrinën astronomike të Kopernikut dhe në bazë të saj e zhvilloi doktrinën e vet për gjithësinë. Duke e pranuar parimisht teorinë e tij pohoi se kozmosi nuk mund të kufizohet në sistemin planetar të Diellit tonë, por është pafundësisht i madh. „*Të gjitha yjet e ngurta, sipas Brunos, janë Diej të rinj që kanë planetet e veta të banuara prej qenieve të gjalla*”. Natyrisht, kjo tezë nuk qe e vërtetuar shkencërisht, por ishte e anticipuar në mënyrë filozofike. Vetëm më vonë u argumentua dhe u verifikua shkencërisht. Aristoteli pohoi katër elemente prej të cilave përbëhen gjërat e Tokës, Bruno plotësonte se trupat qiellorë janë të përbërë edhe nga elementi i pestë – efiri. Për të bota është unike dhe e amshueshme dhe se Zoti është çdokund në natyrë. Kjo pikëpamje për nga forma panteiste në esencë është materialiste. Gjithësia si tërësi pasqyrohet në secilën pjesë të saj, ndërsa secila pjesë është një gjithësi e vogël në vete: makrokozmosi i përgjigjet mikrokozmosit. Pjesëzat deri në pakufi të vogla të gjithësisë Bruno i quajti *monada*, por edhe gjithësinë në tërësi e paraqiti si një monadë, ose monadë të monadave.

Në një varg veprash të tij, Bruno përpiqet të sintetizojë shumë elemente racionaliste dhe empiriste, kështu shpesh herë edhe arsyeja edhe shqisat për të janë kriter i njohjes. Megjithatë, shqisat janë më pak të përsosura, ngase nëpërmjet tyre njihet vetëm ana sipërfaqësore, ndërsa mendja futet në vetë esencën e sendeve. Një njohje luan rol edhe „*entuziazmi heroik*”, ëkstaza e ndjenjave. Në jetën shoqërore, sipas Brunos, bëhet luftë ndërmjet dritës dhe erësirës, paditurisë dhe diturisë. Duke iu falenderuar dorës, njeriu është

ngritur mbi të gjitha qeniet e gjalla. Bruno është filozof dhe shkencëtar tipik i renesansës, luftëtar i pakomprimis kundër mesjetës, adhures i natyrës, panteist i entuziazmuar dhe artist i fjalës; shpirt universal dhe optimist i dalluar, por më tepër luftëtar për lirinë e mendimit e të shpirtit, ndërsa jeta dhe vdekja e tij do të mbesin simbol i sakrificimit në luftë për të vërtetën.

4.3. SHKENCA NË KOHËN E RE

Derisa në kohën e renesansës Italia ishte qendra e filozofisë dhe e shkencës në Evropën Perëndimore, në kohën e re udhëheqjen shpirtërore e morën Holanda, Anglia e Franca, ndërsa kjo shpjegohet me rënien ekonomike të Italisë dhe ngritjen e vendeve të përmendura që gjendeshin në udhëkryqet kryesore të tregtisë botërore. Me kohën e re nënkuptojmë periudhën historike të popujve të Evropës që nuk është e përcaktuar saktësisht. Disa mendojnë se koha e re, fillon me rënien e Stambollit (1453); të tjerët për fillim marrin si ngjarje të rëndësishme renesansën, reformacionin etj. Koha e re në fakt shënon luftën e klasës borgjeze për të drejtat e saja politike dhe ekonomike, në suaza të feudalizmit. Në këtë kuptim, lajmëtar i kohës së re ka qenë shpërthimi i lëvizjes kundër hegjemonisë së katolicizmit nën udhëheqjen e Martin Luterit, kryengritjet fshatare të shekullit XVI dhe revolucionet borgjeze në Holandë, Angli dhe Francë. Në këtë periudhë kohore fillojnë të themelohen shtetet borgjeze, ndërsa shpirti njerëzor në përgjithësi dhe ai filozofik në veçanti përfundimisht çlirohen prej prangave të mesjetës. Fitohet e drejta e mendimit dhe e shprehjes së lirë, e bindjeve politike e fetare dhe në përgjithësi ajo që nënkuptohet me shprehjen, të drejtat dhe liritë qytetare. Por procesi i këtyre të drejtave është bërë në mënyrë graduale prej vendit në vend me intensitet të ndryshëm. Në botën perëndimore të drejtat dhe liritë themelore të njeriut u fituan më herët, kurse në disa vende të botës ai proces vazhdon edhe sot.

Në kohën e re çështje kryesore në filozofi dhe në shkencë ka qenë të përpunohet metoda e re për nevojat e zhvillimit shkencor dhe zbulimit të së vërtetës në të gjitha fushat e jetës e të natyrës, shoqërisë dhe mendimit njerëzor. Në kërkesën për konstituimin e metodës shkencore universale u skicuan dy rrugë: **empirizmi anglez** me metodën e vet induktive dhe **racionalizmi kartezian** me metodën e vet deduktive. Këto dy metoda themelore të punës kërkimore-shkencore, që janë zaten të lidhura ngushtë, sintetizohen në filozofinë klasike gjermane. Në formulimin dhe arsyetimin e metodës së re dhanë nxitje zbulimet e reja, me të cilat u rrit fuqia e njeriut në përvetësimin e natyrës dhe vënien e atyre zbulimeve, në shërbim të mirëqenies së njeriut. Shtresa e re e njerëzve të pasur kërkon që zbulime të këtilla të ketë më shumë, ndërsa filozofia të angazhohet në „shërbim” të tyre.

4.3.1. Frensis Bekoni (1561-1626)

Ndodhitë shoqërore, politike, kulturore e ekonomike botërore me bartjen prej bregdetit Mesdhe, që llogaritej për qendër të botës, në atë të bregdetit perëndimor të Oqeanit Atlantik, vendet e shtrira përgjatë gjatësisë së tij u bënë bartëse të ndodhive shoqërore e historike. Tani

e tutje (prej shekullit XVI e tutje), fuqi udhëheqëse ekonomike e politike u bë Anglia. Ajo i shtypi shtetet rivale dhe krijoi perandorinë e madhe koloniale në të cilën dielli kurrë nuk perëndonte. Përrjedhojë u krijua pasuri e madhe, deri atëherë e paparë. Në këto kushte lindi filozofia e kohës së re.

Frensis Bekoni është filozof anglez dhe krijues i parë i filozofisë së kohës së re, përtëritës i shkencave që ishin shkatërruar me shkatërrimin e botës antike. Studioi në Kembrixh. Në kohën e sundimit të Elizabetës e sidomos të Jakovit mori pozita të larta partiake e shtetërore (Lord Kancelor), mirëpo akuzohet për marrje ryshfeti (sipas mendimit të disave, ka qenë e reme dhe e koordinuar), dënohet me gjobë të lartë e burgim. Ndonëse për një kohë të shkurtër ai amnestohet, kurrë më nuk u mor me aktivitete partiake, por iu kushtua problemeve shkencore e filozofike. Bekoni e vërejti me kohë krejt pakuptimësinë dhe shterpërinë e skolastikës si dhe gjendjen jo të denjë të shkencave, e gjetur nën prangat e kësaj doktrine dogmatike. Për këto shkaqe u përpoq të bëjë restaurimin e madh të shkencave. Veprat e tij filozofike i emroi me këtë titull, pjesë përbërëse të së cilës ishin „*Mbi dinjitetin dhe zmadhimin e shkencave*”, ku angazhohet për bashkimin e filozofisë me njohuritë e natyrës, që ashtu të bashkuara të kontribuojnë, që në mënyrë sistematike të arrihet deri te zbulimet e reja e shpikjet teknike. Me këtë do të zmadhohet prodhimi dhe pasuria e popullit, ndërsa Organoni i ri do t'i kundërvihet Organonit (të vjetër) të Aristotelit, në të cilin rëndësi të dorës së parë i jepte metodës deduktive, kurse Bekoni ia kundërvente metodën induktive. Kjo do të thotë se Bekoni ishte i angazhuar për induksionin shkencor.



Frensis Bekoni

Për të pasur njohje të vërtetë, Bekoni thotë se njerëzit duhet të çlirohen prej paragjykimëve të ndryshme, thellësisht të rrënjësura dhe të përhapura në mendjen e njeriut nga skolastika. Ata i quajti idole (lajthitje) dhe dallon katër sish: 1. **Idolet e fisit**, janë veçoritë e llojit njerëzor, që ekzistojnë në vetë natyrën e njeriut; 2. **Idolet e shpellës**, që paraqiten te disa njerëz të veçantë; 3. **Idolet e tregut (sheshit)**, paraqiten në lidhjet ndërmjet njerëzve, më së shpeshti prej dykuptimisë së të folurit dhe 4. **Idolet e teatrit**, kur njerëzit besojnë se ajo që është në skenë është e vërtetë e jo lojë. Prej idoleve të teatrit më i shprehuri është ai i besimit në autoritet, para së gjithash në atë të Aristotelit. Vetëm pasi të çlirohet njeriu nga këto lajthitje, paragjykime e nëse mbështetet në përvojën dhe i hudh poshtë dituritë e reme, mund të merret me njohje të vërtetë.

Pra, pasi janë zbuluar lajthitjet, tani mund të ndërtohet metoda e re. Sipas Bekonot, objekt i studimit të filozofisë është studimi i natyrës, ndërsa vetë filozofia duhet të mbështetet

në shkencat e natyrës, posaçërisht në fizikën. Me ndihmën e të vërejturit, analizës e veçmas eksperimentit, duke shkuar prej të veçantës duhet të zbulohet ajo e përgjithshme – metoda e induksionit. Bekoni punoi shumë për induksionin shkencor, domethënë mbi mundësinë e nxjerrjes së ligjeve nëpërmjet vështimit të veçantë dhe serisë së rregullave të atij vështimi. Bekoni i kuptoi shumë mirë kufizimet e induksionit popullor me numrin e thjeshtë, ku nuk haset rasti i kontestimit. Bile ai ironizonte duke e quajtur metodën aristoteliane „përfundim induktiv” se të gjithë kuajt e një tufe janë të zinj, pa qenë të tillë, sepse të zinj të themi ishin vetëm 18 të parët. Nga këtu Bekoni porositi bërjen e tabelave (listave) si: **tabelën e prezencës** së një dukurie (p. sh. të ngrohtësisë: me rastin e zjarrit, nxehjes me rrezet e diellit, me rrezet e lëshuara nëpër thjerëz, etj); **tabelën e përvojës** (në të cilën, në rastet e ngjashme me atë të tabelës së mëparshme, nuk ka ngrohtësi: nga rrezet e Hënës dhe të yjeve etj); **tabelën e gradacionit** (krahimit), kur një dukuri paraqitet në masën më të madhe ose më të vogël (ngrohtësia me veprim intensiv etj).

Pas tabelave fillon procesi i induksionit, në të cilin bëhet pastrimi i rasteve që nuk janë prezente te dukuria e tillë. Në fund mbledhen faktet e tërë veprimit, domethënë i kushtohet vëmendje të përgjithshme, e cila nxirret prej të veçantës apo individuale. Në rastin konkret nxirret përfundimi se ku ka nxehtësi ka edhe lëvizje, shkaku i nxehtësisë është lëvizja. Sipas Bekonit, vetëm në fund mund të vëhet në përdorim metoda e deduksionit. Këtu edhe qëndron doktrina e filozofisë së kohës së re, të bëhet hulumtimi në natyrë për t'u zbuluar kauzaliteti, raporti i domosdoshëm ndërmjet shkakut dhe pasojës, me qëllim që shkencat të zhvillohet si veprim i pavarur njerëzor empiriko-shkencor. Dituritë e fituara në këtë mënyrë do të ishin forcë e vërtetë për ta sunduar natyrën dhe për të krijuar pasuri materjale, të cilat e bëjnë jetën e njeriut të denjë e të lumtur.

4.4. EMPIRIZMI: LOKU, BERKLI, HJUMI

Shkollat empirike, pavarësisht prej mënyrave të thjeshta, me të cilat dolën në dukje, ishin destinuar për ta ndryshuar kursin dhe interesat e filozofisë moderne. Përderisa qëllimi i Bekonit ishte „*një rindërtim i gjithë dijes njerëzore*”, Loku që ishte krijues i empirizmit britanik, e vuri theksin mbi objektiva më modeste, duke kërkuar që ashtu siç pastrohet toka, edhe ne t'i pastrojmë e t'i zhvendosim pak nga pak mbeturinat, që shtrihen në rrugën e njohjes. Qëllimi ynë i njohjes, thoshte Loku, është i kufizuar nga përvoja jonë. Më parë si Bekoni e Hobsi që ishin të bindur se njohja duhet të mbështetet mbi të vërejturit (vëzhgimin), andaj edhe do të quhen empiristë, por asnjëri prej tyre nuk bëri ndonjë vështim kritik të fuqive intelektuale të njeriut. Ata, megjithatë, pranuan se pamja e përgjithshme e njohurive rreth natyrës, që mendja është e aftë t'i prodhojë, vjen vetëm si rezultat i përdorimit të metodës së përgjithshme. Ngjashëm Dekarti supozoi se nuk ka problem të cilin mendja e njerëzve të mos e zgjidhë, nëse përdoret një metodë e duhur. Por, pikërisht ky ishte supozimi që Loku e ngriti në trajtimin e tij kritik, domethënë se mendja njerëzore ka aftësi për të zbuluar natyrën e vërtetë të universit. David Hjumi këtë kritikë e thelloi edhe më tutje, duke theksuar nëse mund të sigurohet një njohje e sigurt, e plotë e jo e pjesëshme. Duke i përdorur metodat e tyre

të ndryshme, në shqyrtimin e njohjes njerëzore, empiristët britanikë Loku, Berkli dhe Hjumi i ndryshuan jo vetëm paraardhësit e tyre (britanikë), por edhe racionalistët e kontinentit që e kishin filluar filozofinë moderne, mbështetur mbi një pamje optimiste të fuqive racionale të njeriut.

Në përgjithësi, përfaqësuesit e filozofisë empiriste mendojnë se përvoja është burim kryesor për njohjen njerëzore. Në anën tjetër, empirizmi nuk mund të reduktohet në senzualizëm, edhe përkundër afërsisë me të. Empirizmi e ka rehabilituar rolin e njeriut individ, aftësinë e tij që vetë të vijë te e vërteta dhe me këtë e ka ngritur dinjitetin e njeriut, për dallim nga shtypja e autoriteteve njerëzore e qiellore, në të cilën mbështetej njohja e mesjetës. Fuqia e përvojës, siguria dhe shpresa e saj zmadhohet me eksperimentin (lat. *experimentum* – përvojë). Eksperimenti është veprim i tillë që artificialisht i shkakton dukuritë e caktuara për t'ia nënshtruar gjurmimit, së këndejmi vjen në shprehje synimi që të forcohet fuqia e pranimiit shqisor me mjete artificiale si mikroskopi, teleskopi, etj. Domethënë, përvoja bëhet më e sigurt dhe përgjithësimi më i saktë, së këndejmi edhe roli i pazëvendësueshëm i eksperimentit në shkencë.

Në eksperimentin vijnë në shprehje edhe aftësitë tjera njohëse, si arsyeja e mendja, fantazia, ndjenjat e vullneti. Thuhet se empiristët më shumë shkruajnë për arsyen e njeriut se sa për përvojën. Por, për empiristët, burim i njohjes është përvoja, ajo është kriter i së vërtetës me çka kundërshtohet racionalizmi.

4.4.1. Xhon Loku (1632-1704)

Xhon Loku është filozof anglez i lindur në rrethinën e Bristolit. Është përfaqësues më i dalluar i empirizmit anglez. Studioi shkencat natyrore, medicinën dhe filozofinë e kohës së re. Në veprimtarinë filozofike të tij në mënyrë vendimtare ka ndikuar miqësia e tij me lordin Sheftsberi. Si sekretar personal dhe mjek i tij, Loku së bashku me të emigron në Francë e Holandë. Pas mbarimit të revolucionit të vitit 1688, kur Sheftsberi u kthye në Angli, me të u kthye edhe Loku, me ç'rast pas këtij kthimi zuri pozita të larta në shtetin anglez.

Veprat e tij kryesore janë: „*Letër mbi tolerancën*“, „*Dy trajtime për qeverinë civile*“, „*Mendime për edukatën*“ dhe „*Ese për arsyen e njeriut*“. Në të vërtetë revolucion i vitit 1688 paraqet një komprimis ndërmjet aristokracisë dhe borgjezisë që shoqëria angleze e zgjidhi në mënyrë paqësore, me çka u krijuan kushte për një prosperitet të brendshëm dhe ekspansion të jashtëm. Anglia do të bëhet shteti më i fuqishëm dhe më përparimtar i kohës, ndërsa Loku i shprehu interesat e klasës borgjeze që ishte në hov të zhvillimit të saj.



Xhon Loku

Loku është teoricient i parë i njohjes në kuptimin modern të fjalës i cili sistematikisht merret me origjinën, aftësinë, sigurinë, themelet dhe shkallët e njohjes. Disa e konsiderojnë themelues të teorisë së njohjes në përgjithësi. Duke u nisur nga premisa të caktuara të Dekartit, Loku konsideron se ne njëmend njohim me anë të „ideve”, me të cilat ai nënkupton, atë, „*që shpirti e percepton për vete ose që është drejtpërdrejtë objekt i të perceptuarit të mendimeve dhe arsyes*”. Idetë në arsyen tonë paraqesin atë që ekziston objektivisht në realitet, domethënë jashtë arsyes sonë. Ato nuk janë të lindura, por shumica burojnë nga përvoja. Loku lufton kundër të gjithë atyre teoricientëve (racionalistëve) të cilët në çfardo formë mbrojnë tezën mbi idetë e lindura. Mandej edhe teza e tij themelore (empiriste) se „*asgjë nuk ka në arsye që më parë nuk ka kaluar nëpër shqisa – Nihil est in intellectu quod antea non fuerit sensa*”, është e drejtuar para së gjithash kundër teorisë mbi idetë e lindura. Njeriu është qenie mendore dhe ajo me të cilën merret arsyeja (intelekti) i tij, në të menduar janë idetë, njëdhmish njerëzit në arsyen e tyre kanë ide të ndryshme, të cilat fitohen „nga përvoja”. Në përvojë mbështetet krejt dituria jonë, – thotë Loku. Me rastin e lindjes së ideve, arsyeja është si „*tabulae rasae*”, e ngjashme me „letën e bardhë të pashkruar”. **Burimi i parë** i njohjes është përvoja e jashtme, perceptimet e jashtme, të ashtuquajtura **senzacione**. **Burimi i dytë** është përvoja e brendshme, refleksioni, vërejtja, që ndonëse supozon vëzhgimet e jashtme, paraqet një burim të pavarur.

Xhon Loku dallon ide të thejshta dhe të përbëra. Idetë e thjeshta janë materiali i tërë diturisë sonë, të cilat arsyeja nuk mund t’i krijojë, as nuk mund t’i zhdukë. Idetë e thjeshta në fakt paraqesin kualitete të sendeve dhe dukurive. Loku gjithashtu dallon kualitete (cilësi) primare-objektive dhe sekondare-subjektive. Në kualitete primare bëjnë pjesë hapsira, forma, lëvizja, ndërsa në ato sekondare, ndijimet e ndryshme si të parit, të dëgjuarit, etj. Prej ideve të thjeshta fitohen idetë e ndërlikuara, domethënë me përsëritjen, bashkimin dhe krahasimin e ideve të thjeshta arsyeja i formon idetë e ndërlikuara. Idetë e ndërlikuara lindin, pra, me aktivitetin e arsyes, e cila me rastin e marrjes së ideve të thjeshta ishte pasive. Idetë e ndërlikuara janë substancat – „njeriu”; moduset janë fakte të substancave si, „bukuria” etj dhe raporti – „babai”. Për Xhon Lokun ekzistojnë vetëm sendet individuale, ai është në anën e nominalizmit, ndërsa të përgjithshmet – thotë ai – krijohet nga arsyeja. Esenca e sendeve individuale, ajo „bartëse” e ideve të thjeshta nuk mund t’i njihet. Loku bie këtu, në agnosticizëm. Bile as ideja e Zotit nuk është e lindur, – thotë ai, – dhe se te kjo ide ne arrijmë duke e vështruar rendin harmonik të natyrës.

Për t’i shënuar idetë, për vete, por edhe diçka më me rëndësi, që t’i bartim në shpirtin tonë, ne shërbehet me gjuhën e cila përbëhet prej fjalëve, që janë shenja të ndijimeve. Në këtë mënyrë Loku vjen deri te semantika (gr. *semeion* – shenjë), që e përcaktoi si „mësim për shenjat”. Loku bëri ndarjen e shkencave në fizikë, e cila „studion natyrën e sendeve siç janë vetë në vete, raportet dhe veprimin e tyre”; në etikë, „dega më e rëndësishme e praktikës”, që i kërkon, ato rregulla dhe kritere për veprimin e njeriut që çojnë nga lumturia; dhe semantika ose logjika e cila merret me studimin e natyrës së shenjave që i përdor shpirti për t’i kuptuar sendet ose për bartjen e diturisë te të tjerët. Loku me emrin e ri për logjikën do të emërtojë „logjikë dhe kritikë tjetër, prej atyre të cilat ishin të njohura më herët”, fjala është për skolastikën të cilën e konsideron të zbrazët, pa përmbajtje e kurrëfarë shkencë.

Në filozofinë politike Loku është themlues i liberalizmit i themeluar në mënyrë filozofike. Angazhohet për rregullimin racional të shoqërisë dhe për zgjidhjen e arsyeshme të problemeve individuale. Shteti është krijuar si rezultat i kontratës shoqërore, që ta mbrojë lirinë individuale, barazinë, pavarësinë dhe pronën private. Jeta, pasuria, shëndeti, pavarësia, liria e mendimit dhe besimit janë të drejta të patjetërsueshme të individit. Loku dallon gjendjen natyrore dhe qytetare të njeriut. Në gjendjen natyrore njerëzit janë „të gjithë të lirë, të barabartë dhe të pavarur”, e dinë ligjin moral me arsyen e tyre, që duhet t’i nënshtrohen për të jetuar në paqe. Por, ata nuk e dëgjojnë çdoherë arsyen e tyre, ngase duke disponuar me atë që e kanë fituar vetë, ndihen të rrezikuar se do t’u shkelet e drejta e pronësisë prej „njerëzve të prishur”. Në gjendjen natyrore, edhe pse lufta nuk është e domosdoshme, ajo çdoherë është e mundshme. Prandaj „lidhet marrëveshja” me sundimtarin, i cili është garant se do ta ruajë „të drejtën natyrore”. E nëse sundimtari e shkel këtë të drejtë, atëherë edhe shtetasit kanë të drejtë ta prishin marrëveshjen. Sovraniteti i takon popullit dhe ai ka të drejtë të çohet në revolucion kundër tiranëve. Loku angazhohet për monarki kushtetuese, pra për ndarjen e pushtetit në ligjdhënëse, ekzekutiv dhe federativ, që ka të bëjë me politikën e jashtme, ndërkombëtare. Individët lidhin kontratën dhe shteti është që t’u shërbejë qytetarëve dhe se shteti është kufizuar në kryerjen e qëllimeve të tij; ai nuk guxon të përziehet as në familje, as në çështjen e besimit. Shteti duhet ta mbrojë trupin dhe pasurinë e individit e jo shpirtin e tij. Me këtë doktrinë të tij socialo-politike ai është themlues i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe qytetarit. Doktrina politike liberale e Lokut hyn edhe në kushtetutën e parë, atë amerikane të vitit 1787 dhe në të mbështetet edhe kushtetuta britanike, si edhe ajo franceze e vitit 1871.

4.4.2. Xhorxh Berkli (1684-1753)

Është kritik dhe vijues i filozofisë së Lokut. Në Dublin studioi teologjinë dhe gjuhët klasike. Ka shëtitur nëpër Francë e Itali dhe një kohë ishte misionar në Amerikë, ndërsa më vonë dhe ipeshkv në atdheun e tij në Irlandë. Veprroi në mënyrë aktive si teolog dhe shkrimtar. Veprat e tij nga fusha e ekonomisë politike e bëjnë paraardhës të ekonomisë politike angleze të Smitit dhe Rikardos, ndërsa veprat e tij më të njohura janë: „Ese mbi teorinë e re të vizionit”, „Një traktat mbi parimet e njohjes njerëzore” dhe „Tri dialogje ndërmjet Hilasit dhe Filunasit”.

Berkli niset prej pikëpamjes së Lokut se e tërë dituria jonë vjen prej përvojës, ndërsa ajo na tregon se realisht ekzistojnë vetëm sendet individuale e jo edhe nocionet e përgjithshme. Bile nocionet e përgjithshme si materjā, hapsira, lëvizja as që mund të merren me mend, sepse me këto fjalë në shpirtin tonë çdoherë lidhen



Xhorxh Berkli

përfytyrimet konkrete individuale, në të cilat realizohet materja, lëvizja etj. Materja çdoherë ekziston ose si ujë e tokë, ose shtëpi e dru, etj, ndërsa askund nuk është e dhënë si materje në përgjithësi. Në këtë nivel pikëpamja e tij është pastër nominaliste. Ai e shmang me sukses ndarjen e kualiteteve të sendeve në primare dhe sekondare të Lokut, ngase këto kualitete pandashëm janë të lidhura ndërmjet veti. Sipas, tij, ekzistojnë vetëm ato gjësende që mund të vërehen, të shihen, të preken, të dëgjohen. **Prandaj trupat që i vërejmë janë vetëm shuma, ose kombinim i ndijimeve tona.** Një send, sipas Breklit, ekziston nëse ai mund të vërehet – perceptohet. Të jesh do të thotë të jesh i perceptuar – „*esse, est percipi*”. Para cilësive të sendeve që i vërejmë, nuk gjendet kurrfarë substrati, kurrëfarë baze, të cilën filozofët e quajnë materje. Njëmendësia materjale ekziston vetëm në të vërejturit dhe idetë tona, ndërsa për ekzistencën e saj jashtë subjektit, nuk kemi kurrëfarë argumenesh racionale. Një idealizëm të kështillë subjektiv ai ua propozon të gjithë „miqëve të diturisë, të paqes e të fesë”, sepse shpresonte se me mohimin e ekzistencës së materjes do ta mposhtë materjalizmin dhe pasojën e tij – ateizmin.

Ndërkohë, që Berkli e mohoi ekzistimin dhe argumentimin e substancës materiale dhe që sendet i reduktoi në kombinimin të ideve, iu imponua përfundimi se bota ekziston vetëm në subjektin që percepton, domethënë se ekziston vetëm *Uni mendijimet e idetë e tij*. Botëkuptimi i kështillë është i njohur si solipsizëm (lat. *solas* – vetë, *ipse* – i vetëm). Berkli që t’i shmanget këtij përfundimi dallon ide reale dhe të imagjinatës. Idetë e fundit i prodhon vetë subjekti sipas vullnetit të vet. Ndërkaq, idetë reale i prodhon një mendje që është më e fuqishme se mendjet individuale njerëzore, e kjo për të është Zoti. Idetë e imagjinatës janë të paqarta e të pacaktuara, kurse ato reale janë të qarta dhe të lidhura sipas një rendi konstant, që i quajmë ligje natyrore. Berkli, me ndihmën e një hipoteze për hyjnitë kalon prej idealizmit subjektiv në atë objektiv. Ai mohoi materjen, me qëllim që kontakti ndërmjet njeriut dhe Zotit të jetë i drejtpërdrejtë, me çka nënvizoi intencën teologjike të doktrinës filozofike të tij.

4.4.3. David Hjumi (1711-1776)

I lindur në Edinburg, nga prindërit skocezë, studioi shkencat juridike, por interesi për filozofi u formua dukshëm nën studimin e filozofëve klasikë. Veprat më të njohura të tij janë: „*Traktati mbi natyrën e njeriut*”, „*Ese politike dhe morale*”, „*Një studim në lidhje me të kuptuarit njerëzor*”, madje janë të njohura edhe: „*Parimet e moralit*”, „*Debate politike*” dhe „*Dialog për besimin natyror*”. Ai i shtron të njëjtat pyetje si edhe empiristët tjerë: si mund të realizohet njohja, çfarë njohim ne, kur njohim, ku janë kufijtë e njohjes, etj. Sipas empiristëve, i vetmi burim i njohjes është perceptimi ndijor, nga përvoja, ndeshja me të dhënë empirike.

Radikalisht e ka aplikuar botkuptimin empirik dhe e ka shpënë deri në skepticizëm. Loku pranoi substancën trupore dhe shpirtërore, si burim i përvojës së jashtme dhe të brendshme, mirëpo u hamend mbi mundësinë e njohjes së kufizuar të substancës. Berkli vendosmërisht e mohoi ekzistimin e substancës materjale. David Hjumi tani mohon çdo mundësi të njohjes metafizike, atë për të cilën përvoja hesht, pastaj edhe vetë mundësinë e njohjes: qoftë të substancës trupore ose të substancës shpirtërore.

Përgjithësisht, në mënyrë kritike Hjumi e shtron problemin e vlerës së njohjes. Të gjitha sendet e mendjes së njeriut i ndan në raporte të ideve dhe raporte të fakteve. Të parat i njohim intuitivisht ose demonstrativisht, pavarësisht prej përvojës (p. sh. teorema e Pitagorës). Raportet e fakteve nuk i njohim aq sigurt, e as që vërtetësia e tyre është aq e dukshme. Për më tepër disa kundërshti të fakteve lehtë mund t'i marrim me mend pa kurëfarë kundërtënie spese, „çka është, mund edhe të mos jetë” (P. sh. dielli nuk do të lindë nesër!).

Themel i të gjitha përfundimeve tona mbi faktet është parimi i shkakësisë, do të thotë supozimi se ekziston lidhja ndërmjet fakteve; se njëri është shkak, e tjetri pasojë (p. sh. qëndrimi në ndonjë vend të panjohur!). Me parimin e kauzalitetit (shkakësisë) ne e tejkalojmë, – thotë Hjumi, – kufizueshmërinë e asaj që na e ofrojnë shqisat dhe kujtesa jonë. Njohja e lidhjes kauzale, shkak-pasojë nuk mund të njihet me anë të konkludimit apriori – pavarësisht nga përvoja. Shkaku dhe pasoja janë të ndryshme, prandaj nuk mundemi ne, që prej shkakut thjesht, të nxjerrim pasojë. Nohja e lidhjes kauzale, gradualisht pason a posteriori, në të vërtetë prej përvojës; se disa dukuri gjithmonë janë të lidhura e prandaj mendojmë se njëra del prej tjetrës.

Bazë e përfundimit tonë mbi lidhjen kaluzale është zakoni ose shprehia që të presim, një rrjedhë të tillë të njëjtë të ngjarjeve siç e kemi përjetuar më parë shumë herë. Fjala është thejshhtë për asocioacionin e përjetimeve. Të gjitha nxjerrjet nga përvoja sipas kësaj, janë pasojë e zakonit e jo e konkludimeve.

Ne përjetojmë vetëm rrjedhën kohore të dukurive, përjetojmë se një dukuri vjen pas tjetrës, por nuk e përjetojmë mënyrën e rrjedhës e as domosdoshmërinë e saj. Nëse zakoni (adeti) dhe shprehia janë bazë e njohjes sonë mbi ndodhitë, atëherë është e përjashtuar çdo mundësi e njohjes mbi ndodhitë përgjithësisht të vlefshme dhe të domosdoshme apriori, të pavarura nga përvoja.

Qëndrimi përfundimtar i Hjumit është **agnostik dhe skeptik**. Nuk është e mundur njohja objektivisht e domosdoshme. Me tezën e tij mbi pamundësinë e njohjes objektive e të domosdoshme si dhe të lidhjes kauzale, të cilën ai e gjen vetëm në arsyetimin psikologjik, ndikoi në mënyrë të drejtëpërdrejtë të Kanti, filozof i idealizmit klasik gjerman.

4.4.4. Rene Dekarti (1596-1650)

Filozofia rrallë ndryshon drejtimet dhe metodat e saj në mënyrë rrënjësore, por ka periudha kur interesat dhe mprehtësia e problemeve e ndajnë atë në mënyrë të qartë nga e kaluara jo shumë e largët. I tillë ishte rasti i revolucionit në kontinent në shekullin XVII, krijues i të cilit ishte Rene Dekarti. Dekarti, Spinoza dhe Lajbnici vunë një ideal të ri për filozofinë. Të ndikuar prej suksesit të shkencës dhe veçmas të matematikës së asaj kohe, ata synonin të krijojnë një filozofi me saktësinë e matematikës. Vendosën të formulonin parime të qarta racionale, të cilat mund të organizoheshin në një sistem të vërtetash, prej të cilave mund të nxirrej informacioni i saktë për botën. Ata nënvizuan aftësinë racionale të mendjes që e konsideronin burim i së vërtetës rreth njeriut dhe botës. **Racionalizmi** (lat. *ratio* – arsye)

do të thotë drejtim në filozofi i cili llogarit se burimi i njohjes është arsyeja, e cila ka aftësi si ndonjë dritë natyrore që të na e japë të vërtetën pavarësisht nga përvoja ose vetëm deridiku e mbështetur mbi të dhënat e saj. Arsyeja është arbitër i vetëm, se ndonjë pohim është i vërtetë apo i rrejshëm, çdo gjë duhet të nxirret para gjyqit të saj. Me racionalizmin afirmohet liria e personalitetit, besimi në njeriun, në aftësinë e tij, duke u mbështetur në fuqitë e veta që të arrihet te e vërteta.



René Dekarti

René Dekarti, i quajtur rëndom „babë i filozofisë së kohës së re”, u lind në Turen. Është një nga mendimtarët më të mëdhenj racionalitë të të gjitha kohërave. Ishte nxënës në kolegjin Jezuit La Flesch, ku studioi matematikën, logjikën dhe filozofinë. Gjatë kësaj periudhe ai mbeti i impresionuar nga siguria dhe saktësia e matematikës, e cila nuk mund të krahasohej me filozofinë, mësimet e ndryshme të së cilës sillnin vetëm dyshime dhe debate. Udhëtoi kudo nëpër Evropë, „duke studiuar librin e madh të botës”, vendosi të qëndrojë në Holandë ku i shkroi të gjitha veprat kryesore të tij, përfshirë „Diskutim për metodën”, duke e shkruar frengjisht, e jo sipas traditës latinisht, mandej „Mendime për filozofinë e parë”, „Parimet e filozofisë” dhe „Pasioni i shpirtit”.

Më vonë shkoi në Suedi i ftuar prej mbretëreshës së arsimuar Kristina, e cila donte që Dekarti t’i japë mësimet në filozofi. Vdiq në Stokholm të Suedisë.

Prej të gjitha shkencave me të cilat u mor Dekarti më së tepërmi e obligoi matematikën, në të cilën krijoi një degë të re, gjeometrinë analitike (bashkoi gjeometrinë dhe algjebërën, duke i futur në matematikë madhësitë e ndryshueshme, variablat). Me anë të sistemit kordinant ai vuri në dukje se figurat gjeometrike mund të shprehen me anë të ekuacioneve algjebrike dhe anasjelltas, secili ekuacion algjebrik mund të shprehet në mënyrë gjeometrike. Në fizikë formuloi ligjin e ruajtjes së lëvizjes, që shërbeu si bazë në ligjin e ruajtjes së energjisë. Futu në qarkullim edhe konceptin e inercionit të lëvizjes dhe në këtë mënyrë caktoi qetësinë vetëm si moment i lëvizjes. Në optikë përcaktoi ligjin për thyerjen e dritës, ndërsa në biologji i ka zbuluar reflekset e kushtëzuara.

Në filozofinë e tij Dekarti nisat prej dyshimit metodik. Ai dyshon më së pari nëpër atë që e ka mësuar në libra, e nëpërmjet mësimëve të të tjerëve, ai dyshon për vetë përvojën ndijore (empirike). Mos vallë këto përvoja janë si ato që shohim në ëndrra dhe prej të cilave vetëm gabohemi vazhdimisht. Ai dyshon për gjithçka, nuk ka asgjë të sigurt. Përveç tjerash, ai kishte marrë parasysh se dyshimi metodik mund të mos e çojë në asnjë dije të sigurt, atëherë të pakën do të përfitojë një përvojë: përvojën që unë nuk mund të di asgjë sigurtë. Por, dija në të cilën arriti ai, nuk ishte kjo. Kishte diçka për të cilën ai mund të thoshte se është i sigurtë, që nuk gabon, kjo është: „unë dyshoj”. Por nuk mund të dyshohet që ka

një „unë” që dyshon. Dhe, këtu zë fill formula e njohur e Dekartit: „Unë dyshoj, unë mendoj, pra unë jam – *Cogito ergo sum*”. Fjala „ergo” nuk është pra një term deduktiv, që nxirret. Medimi nuk nxirret nga dyshimi dhe qenia nuk nxirret nga mendimi. Bëhet fjalë për një intuitë të shpejtë nga ana e shpirtit, për një të vërtetë të përpiktë. Në çastin kur subjekti e kap vetveten si „dyshimtar”, ai ndjehet se është mendimtar dhe si i tillë „ekzistues”. Domethënë, subjekti që mendon është i sigurtë për veten e tij. Por, për të mbetur në terrenin e sigurisë (të së vërtetës), atij i duhet të përpunojë nocione dhe arsyetime që nuk lejojnë asnjë gabim. Dekarti shtroi kërkesa për nocione të qarta dhe të dallueshme. Një nocion është i qartë atëherë kur ai është i përcaktuar në mënyrë të përkryer, domethënë i kufizuar qartë prej nocioneve të tjera dhe një nocion është i dallueshëm, atëherë kur gjatë kuptimit të tij, shpirti i shfaqet me një transparencë të përkryer. Qartësia ruan zonën periferike të nocionit, kurse dallimi atë që është në brendësi të tij.

Dekarti e pa mirë se nuk mund të kalohet nga vërtetësia (qartësia) e ekzistencës së subjektit që mendon tek ajo e ekzistencës së botës së jashtme. Këtu nuk ka asnjë urë kalimi. Përkundrazi, ai ka gjetur një rrugë që e çoi nga ekzistenca e subjektit që mendon tek ekzistenca e Zotit. Dekarti konstaton se ka në veten e tij idenë e Zotit, domethënë idenë e një qenieje absolutisht të përkryer. Por, ai vetë është një subjekt që dyshon, që përmban në natyrën e vet papërkthyeshmërinë e dyshimit. Duke qenë vetë i papërkryer, nuk mund të jetë ai vetë burim i idesë për një qenie të përkryer absolute. Përfytyrimi i një qenieje të përkryer duhet të ketë origjinën e vet, të paktën në një qenie po aq të përkryer, sa që është vetë ky përfytyrim, pra te Zoti. Sipas Dekartit, Zoti është njëkohësisht i përjetshëm, i palëvizshëm dhe i lirë.

Tanimë ne pamë që subjekti që mendon posedon dije të sigurt për veten e tij, si subjekt që mendon, por Dekarti nuk mund të sigurohej në mënyrë të drejtpërdrejtë për sigurinë e botës së jashtme. Prandaj iu desh të sugurohej me ndërmjetësimin e ekzistencës së Zotit. Pastaj, edhe diçka më tepër, falë vërtetësisë hyjnore, ai sigurohet edhe për vlerën e ideve të qarta dhe të dallueshme, para se të gjejë përvojën e sendeve. Nga këtu filozofia e Dekartit është në mënyrë të prerë dualiste. Çdo gjë që ekziston tek ai shndërrohet në dy realitete themelore, të pareduktueshme te njëri-tjetri: shtrirja (*res extensa*) dhe mendimi (*res cogitans*). Mendimi është aktiv, vihet vetvetiu në lëvizje.

Shtrirja (sendi) është pasiv, çdo lëvizje e saj përcillet nga jashtë. Nga ana tjetër, në fizikën e tij është materjalist mekanicist. Mendon se në bazën e botës fizike janë korpuskulat (trupat) të cilët i janë të nënshtruar forcave mekanike; ata i krijojnë të gjitha sendet dhe dukuritë. Edhe kafshët janë bërë në mënyrë natyrore, në të vërtetë ato janë makina të posaçme, ndërsa njeriu, përveç qenies trupore, është edhe qenie shpirtërore i pareduktueshëm në makinë.

Në kryeveprën e tij „*Diskutim për metodën*”, Dekarti na thotë se në çka qëndron metoda e re, me të cilën shkencë mund të arrijë rezultate për të mirën e njeriut. Ai, është i bindur se pa metodë të drejtë nuk ka çlirim prej skolastikës dhe nuk ka zhvillim të shpejtë të shkencave. Themeloi rregulla teorike për ta përcjellë më së miri mendimin e vet dhe thotë: të mos nisemi kurrë nga asgjë tjetër, veçse nga një e vërtetë e sigurtë; të analizohen të gjitha

elementet e mendimit deri në elementet më të thjeshta; të renditen këto elemente të thjeshta sipas një rendi gjithnjë e më kompleks, me qëllim që termat kompleks të jenë të kuptueshëm në mënyrë të qartë; dhe së fundi, të vërtetosh se e gjithë seria nuk ka asnjë zbrazëti dhe se rregulli i saj është i qartë dhe i plotë. Dekarti thotë se vetëm me këtë kusht mund të flitet për dije të vërtetë.

Dekarti në studimin e tij njëkohësisht hodhi poshtë paragjykimet mijëvjeçare, besimin në autoritet, në mistikë dhe gënjeshtër tjera duke ndërtuar një filozofi të besimit racional, me mundësi njohëse të njeriut, një filozofi optimiste të arsyes njerëzore.

4.4.5. Baruh De Spinoza (1632-1677)



Baruh De Spinoza

Është filozof holandez, me origjinë nga një familje hebreje që kishte ardhur nga Portugalia. U lind në Amsterdam dhe është njëri nga përfaqësuesit më të rëndësishëm të racionalizmit. Spinoza i ri i përkushtohet studimit të Biblës, Talmudit dhe filozofisë skolastike. Për shkak të qëndrimit të tij kritik e racional ndaj këtyre teksteve, shkakton zemërimin e ushëheqësve fetarë dhe të qarqeve teologjike në përgjithësi. Pas sugjerimeve të pasuksesshme që t'i kthehet fesë së etërve, u mallkua me anatemen më të rëndë dhe u përjashtua prej komunës hebreike: „Le të jetë mallkuar ditën dhe le të jetë mallkuar natën. Le të jetë mallkuar kur shtrihet dhe le të jetë mallkuar kur ngrihet. Le të jetë mallkuar kur niset dhe le të jetë mallkuar kur kthehet... Ju urdhërojmë që askush me të të mos komunikojë, as me gojë as me shkrim, askush të mos qëndrojë me të nën një kulm ose katër bërryla afër tij, askush të mos e lexojë veprën që e ka hartuar ai”.

Spinoza refuzoi ta braktisë qëndrimin e tij teorik dhe nuk pranoi ftesën për profesor në katedrën e filozofisë në Hajdelberg, duke siguruar ekzistencën me punë të mundimshme të grihjes së xhamave optikë dhe kështu i siguroi vetëvetes pavarësi intelektuale dhe morale. Vdiq i ri dhe në varfëri nga tuberkulozi, në kohën kur iu botuan vetëm dy vepra: „*Parimet e filozofisë së Rene Dekartit*”, në të cilën paraqiti në mënyrë specifike dhe të pavarur veprën e Dekartit dhe „*Traktatin teologjiko-politik*”, në të cilën për shkak të kritikës së ashpër dhe tezave liberale, e botoi anonimisht. Në veprën e tij kapitale dhe të botuar pas vdekjes së tij „*Etika e paraqitur sipas rendit gjeometrik*” – „*Ethika more geometrica demonstrata*”, që përmban pesë pjesë: Perëndinë: mbi natyrën dhe origjinën e shpirtit; mbi origjinën dhe natyrën e afekteve; mbi jolirinë e njeriut; mbi fuqinë gnosologjike ose mbi lirinë e njeriut. Spinoza synon

rigorozisht dhe në mënyrë racionaliste e „gjeometrike” ta nxjerrë tërë filozofinë e tij, nga numri i caktuar i përkufizimeve, i aksiomave, i thënieve dhe i vërtetimeve.

Ideja themelore e filozofisë së tij e shprehur në pjesën e parë të Etikës, është pohimi se ekziston vetëm një substancë e pafund, me të cilën nënkupton atë që vetvetiu ekziston dhe me ndihmën e së vërtetës kuptohet, domethënë ajo, nocionit të së cilës nuk i nevojitet nocioni i ndonjë gjëje tjetër, nga e cila doemos duhet të jetë formuar! Pra, ekzistenca e substancës është shkak i vetëvetes – *causa sui*. Si një ndër nocionet qendrore të filozofisë së Spinozës *cousa sui* përmban në vete refuzimin e secilit shkak të jashtëm, bile edhe të perëndisë si transcendencë e natyrës; mundëson tezën mbi vetmjaftueshmërinë dhe autonominë e natyrës si dhe të unitetit të botës. Perëndia ose natyra – *Deus sive natura*, nuk është jashtë ose mbi gjërat, por është në to, së këndejmi ajo është natyrë që krijon – *natura naturans*, e lidhur me të gjitha moduset e attributeve të perëndisë, domethënë me natyrën e krijuar – *natura naturata*.

Spinoza e quan atribut „atë që arsyeja e percepton në substancë, thujtje e përbën esencën e saj”. Nga atributet e shumta të substancës së pafundme, arsyeja jonë i njeh vetëm dy: shtrirjen dhe të menduarit. Gjërat e krijuara Spinoza i quan moduse, përkatësisht ai thotë: „Me *modus* kuptoj gjendjen e substancës ose atë që ekziston sipas diçkaje tjetër; me ndihmën e së cilës edhe kuptohet”. Moduset e attributeve janë gjendje të ndryshueshme dhe transitive të substancës, ose forma fenomenale të esencës së saj. Modifikimet më të rëndësishme të të menduarit janë arsyeja dhe vullneti, kurse modifikimet më të rëndësishme të shtrirjes (hapsirës) janë qetësia dhe lëvizja. Lëvizja është *modus* që ndërmjet moduseve tjera të substancës ka status special, ajo pra, është e përhershme. Nga kjo është e qartë se Spinoza si me hendek të pakalueshëm e ndan esencën prej dukurisë. Ndërkaq, vetëm me të kuptuarit e lëvizjes si veti themelore e materjes mund të tejkalohet kjo ndarje: asaj që krijon dhe që është e krijuar, të amshueshmes dhe kalimtares. Në anën tjetër, arsyeja nuk pranon kurrëfarë kundërthëniesi në mendim, ajo rreptësisht i respekton ligjet formalo-logjike. Nga këtu Spinoza mendon se moduset kanë të bëjnë me dukuritë, botën e dhënë shqisore, ndërsa atributet, ajo esencialja e botës, njihet me arsyen.

Të ndodhurit në botën materjale dhe shpirtërore, sipas Spinozës, është i determinuar rigorozisht, të gjitha dukuritë janë të lidhura në mënyrë kauzale (shkak-pasojë). Pra, çdo *modus* i të menduarit është i caktuar nga *modusi* tjetër i të menduarit, ndërsa *modusi* i shtrirjes nga *modusi* tjetër i shtrirjes. Ai përcaktohet për determinizmin, përkundër indeterminizmit mistik, në të cilin arsyetohet ekzistimi i çudive, krijimit prej asgjëje, etj. Duke e mohuar objektivitetin e rastësisë – ai për të rastit e llogarit atë dukuri, shkakun e së cilës ende nuk e kemi zbuluar. Spinoza bie në fatalizëm (nga lat. *fatum* – fat), doktrinë e determinizmit eskrem, domethënë parapërcaktueshmëri sipas fatit që me asgjë nuk mund të ndryshohet e edhe më pak të pengohet.

Për, Spinozën njeriu është një *modus*, unitet i trupit (shtrirjes) dhe shpirtit (mendimit) – attributeve të substancës. Së këndejmi, numri dhe rendi i ideve përputhet me numrin dhe rendin e sendeve. Në këtë përputhshmëri mbështetet mundësia që njohja të arrijë të vërtetën. Spinoza dallon tri lloje njohjesh. Në fillim është njohja ndijore (afektive), në të

cilën përzihen shqisorja dhe emocionalja; na jep pamje të turbullt për sendet dhe dukuritë individuale. Lloji i dytë i njohjes është ai i **mendimit racional**, ku përpunohet dija shkencore dhe lloji i tretë i njohjes është ai **intuitiv**, me të cilin venerohet esenca e substancës. Këtu e vërteta zbulohet pakusht, në krejt tërësinë e saj.

Te Spinoza kemi një pohim të njohur, që thotë se secili definicion është negacion – mohim. Sipas tij, definicioni jo vetëm që afirmon se çka është ndonjë nocion – që të hyjë në qarkun e tij, por të paturguarën, të nënkuptuarën – në të mohohet edhe çdo gjë tjetër, që nuk hyn në atë nocion. Nga këtu, në unitet kemi dy pohime kundërthënëse me çka vjen në shprehje mendimi dialektik, i cili nuk është karakteristik aq për Spinozën, por as për racionalizmin në përgjithësi. Qëllimi i fundit i Spinozës është të arrijë „dashurinë intelektuale ndaj Zotit” – *Amor dei intellectualis*. Njohjes së Zotit ai i jep një gjendje të pasionuar, por edhe të pastër emocionale. Në dashurinë intelektuale pasioni është synim i qetësuar, kjo dashuri është edhe e mira më e lartë. Në filozofinë e Spinozës përputhen antologjia, gnosologjia dhe etika. Me njohjen e Zotit, njeriu pastrohet prej pasioneve dhe vjen te liria. Për Spinozën Zoti është çdo herë i lirë, ngase vepron sipas domosdoshmërisë së tij. Ai lirinë e përkufizon si njohje të domosdoshmërisë.

Si çdo gjë tjetër në natyrë, ashtu edhe shteti dhe shoqëria i nënshtrohen domosdoshmërisë natyrore. Ai dallon **gjendje natyrore dhe qytetare** me rastin e justifikimit të teorive të tij shoqëro-politike. Në gjendjen natyrore e drejta e çdo individi sillet brenda kufijve të fuqisë së tij; në gjendjen natyrore nuk ka dallim ndërmjet të mirës dhe të keqes. Për këtë arsye ekzistenca e secilit është e rrezikuar. Për t’iu shmangur kësaj, njerëzit bashkohen dhe themelojnë shtetin, me qëllim që t’i mbrojnë të drejtat e veta për vetëmbrojtje. Spinoza thotë se paragjykimet nacionale dhe fetare i mbajnë njerëzit të nënshtuar; i përcaktojnë rrethimin e lirë të së mirës më të lartë të tyre – arsyes, krijojnë armiqësi reciproke dhe urrejtje, shkaktojnë luftëra dhe gjakderdhje. Shteti, sipas tij është rezultat i „kontratës shoqërore” dhe se „qëllimi i shtetit nuk është të sundojë as t’i mbajë njerëzit të frikësuar, por, përkundrazi, t’i çlirojë individët nga frika...” Forma më e mirë e organizimit shtetëror është **demokracia**, ajo është më e natyrshme, ngase njeriu të drejtat natyrore nuk i bart tek individi, por në tërë shoqërinë, individ i së cilës është edhe ai. **Demokracia më së miri i mbron të drejtat dhe liritë e njeriut**. Spinoza është teoricient i racionalizmit dhe demokracisë politike që së bashku duhet t’u sigurojnë qytetarëve mbrojtje prej tiranëve e prosperitet në rrethana ku mbretëron arsyeja.

4.5. ILUMINISTËT FRANCEZË

Iluminizmi është lëvizje shoqërore, shpirtërore, kulturore e mendore, përfaqësuesit e të cilit pohojnë se arsimimi, dituria, shkollimi, arsyeja etj, janë faktorë që mundësojnë heqjen e fatkeqësisë, e prapambeturisë, paragjykimeve e besytnive, abstrakzimit dhe të gjitha të këqijave të tjera dhe se sendërtojnë përparimin e shoqërive, mirëqenien e njeriut e

të njerëzimit në përgjithësi. U shfaq gjatë shekullit XVII-XVIII në vendet më të përparuara të Evropës si në Angli, Holandë, Francë, Gjermani e Itali, ndërsa më vonë edhe në vendet tjera. Iluminizmi kudo është kasnec i të resë përparimtare dhe luftëtar për marrëdhënie të reja shoqërore e kundër marrëdhënieve feudale konservative. U angazhua për barazi ndërmjet njerëzve, për lirinë e ndërgjegjes e të mendimit, ndërsa ishte në anën e natyralizmit e individualizmit si dhe liberalizmit, pra, „mbretërisë” të arsyes së shëndoshë njerëzore e të tolerancës fetare. Iluminizmi u angazhua që njeriun, si qenie e pajisur me arsye, ta bëjë mbizotërues të çdo gjëje.

Shkallën më të lartë të zhvillimit të vet, iluminizmi e arriti në shekullin XVIII në Francë. Burimet teorike të iluminizmit francez ishin skepticizmi i Mishell Montenjit dhe Pier Bejlit, deizmi dhe liberalizmi anglez, veçanërisht i Lokut, shkencat natyrore, sidomos fizika e Isak Njutnit si dhe parlamentarizmi anglez. Bredna për brenda iluminizmit francez u dalluan dy rryma: ajo deiste e Rusoit, Volterit, Dalambertit e Moniteskies dhe ajo materjaliste e Halbahut, Didros, Helveciasit, Lamtrisë, Kandiakut etj. Hiq dallimet e pikëpamjeve të tyre filozofike, iluministët francezë të gjithë u angazhuan rreth botimit të Enciklopedisë së famshme; në luftë kundër metafizikës së vjetër skolastike; hipokrizisë dhe ekskluzivitetit fetar si dhe kundër çdo autoriteti filozofik, politik, shtetëror, kulturor etj, i cili nuk ka mbështetje në arsyen e shëndoshë të njeriut. Iluministët francezë të gjithë u vërsulën kundër të „vërtetave të zbulesës” dhe ngulmonit që të gjitha idetë, kategoritë apo parimet (e mira, e bukura, e drejta, e vërteta, vlera, hyjnorja etj.) t’i shtrohen „provimit” para arsyes së shëndoshë të njeriut si i vetmi arbitër i mëvetësishëm e kompetent. Përndryshe, periudha e iluminizmit u quajt „shekulli i arsyes”, „shekulli i dritës” dhe „shekulli filozofik”. Emanuel Kanti do të thotë se: „iluminizmi është dalja e njeriut prej moshës jomadhore të tij, në të cilën është gjetur në fajin e tij”. Moshë jomadhore është paafërsia e njeriut që arsyen e vet ta përdorë pa ndihmën e tjetërkujt.

Iluminizmi beson se është e mjaftueshme të shkëlqejë drita e diturisë e njerëzit ta kuptojnë të vërtetën e çdo force të errët të së kaluarës, organizmin e padrejtë të shoqërisë, tiranët dhe të gjithë përfaqësuesit e regresit dhe paditurisë. Kjo lëvizje kontribuoi shumë në përhapjen e shkollimit dhe edukimit të masave. Ata besonin se secili është i aftë të vijë te e vërteta, ngase natyra e njeriut për të gjithë është e njëjtë. Sundimtarët e ligë e egoistë si dhe ligjet e padrejta i mbajnë njerëzit në padituri, e me këtë dhe të nënshtruar.

Iluminizmi është kohë kur shpallen të drejtat dhe liritë individuale të njeriut e qytetarit, për të cilat domosdo duhet të mbajnë llogari pushtetmbajtësit, qëllimi dhe detyra themelore e të cilëve mbetet që këto të drejta t’i sigurojnë dhe t’i mbrojnë. Ata e shpallën demokracinë, pushtetin e popullit, si diçka më e afërt me natyrën e njeriut. Idetë iluministe fituan afirmimin e tyre në „Deklaratën amerikane për të drejtat e njeriut”, e në „Deklaratën për pavarësi” të vitit 1776 si dhe në „Deklaratën franceze për të drejtat e njeriut e të qytetarit” të viti 1789. Iluministët proklamuan se të gjithë njerëzit janë të lindur të barabartë, e jeta dhe synimi drejt lumturisë janë të drejta që nuk mund të t’huasohen.

4.5.1. Volteri (1694-1778)



Volteri

Fransoa Mari Arue, me pseudonimin Volteri ishte shkrimtar, historian, publicist dhe filozof freng. Pasi kreu gjimnazin Jezuit, filloi të studiojë drejtësinë, mirëpo këtë së shpejti e braktisi. Te Volteri herët zhvillohet synimi për **marrëdhënie të papengueshme, të lira si dhe pikëpamje skeptike** për të gjitha autoritetet sunduese morale dhe religjioze. Për shkak të ofendimit të regjentit (sunduesit) Filip të Orleanit u burgos në Kështjellën e Bastiljes, ku jetoi një vit në mënyrë të vajtueshme. Derisa ishte në burg shkroi tragjedinë „*Edipi*” realizimi i parë i së cilës e bëri shumë të popullarizuar. U detyrua ta braktisë Francën duke shkuar në Angli ku u njoh me filozofinë e Lokut dhe Njutnit. Në Angli sidomos e entuziazmuan vendi i lartë në shoqëri që kishin artistët, filozofët dhe shkencëtarët. Kurrë nuk e harroi ceremoninë funerale solemne të Isak Njutnit dhe çdoherë përmente se si në Angli Loku e shumë të

tjerë kryenin funksione të rëndësishme shtetërore dhe gëzonin respekt të madh, ndërsa në Francë shkrimtarët jetonin nga „*mëshira e mjerueshme*” që e merrnin nga mbretërit dhe oborrtarët, kurse filozofët gati gjithnjë ishin nën „*mbikqyrje të policisë*”. Derisa qëndroi në Angli shkroi veprën e njohur filozofike „*Letrat filozofike mbi anglezët*”, të cilën parlamenti parisien e shpalli skandaloz, „*i cili skandalizon, i cili është në kundërshtim me religjionin... dhe me respektimin e pushtetit*”, dhe së këtëjmi urdhëroi të digjet publikisht. Volteri vetë shkroi shumë për gjuhën frënge dhe mburej me titullin „e shkrimtarit francez”.

Një kohë qëndroi edhe në oborrin mbretëror të mbretit gjerman Fridrih, por një miqësi e tillë shpejt u ftoh. Për shkak të sugurisë personale dhe mundësisë për të ikur, bleu pasuri në kufirin zviceran-francez ngase thoshte: „*Filozofët duhet të kenë dy strofka për t'u fshehur nga qentë që i ndjekin*”. Menjëherë pas kësaj shkroi kryeveprën e tij, e njëherit edhe të iluminizmit francez, romanin filozofik „*Kandidi*”, në të cilin në mënyrë antitetike i kundërvihet filozofisë optimiste të Lajbnicit, tallet me persiatjet hyjnore të Rusoit, mandej edhe me botkuptimet e veta të mëparshme optimiste. Ka shkruar edhe një varg studimesh historike dhe u paraqit edhe me shumë artikuj në Enciklopedi. Pastaj shkroi edhe veprat më të dalluara filozofike të tij, si „*Fjalori filozofik*” dhe „*Filozofi injorant*”. Kandorseu, për të do të shkruajë: „*sa herë që ndodh çfardo akti i fanatizmit dhe i kriminit kundër humanitetit, çnjerëzimit, Volteri menjëherë me zë të lartë i shpall në gjithë Evropën emrat e fajtorëve*”.

Volteri ka domethënie e një epoke, iluminizmi i shekullit XVIII nuk quhet pa arsye shekulli i Volterit. Ai e përqeshte në mënyrë cinike tërë Evropën, mbretërit kryelartë, klerikët kokëtrashë, filozofët që besonin se kjo botë është më e mira nga të gjitha botërat e mundshme, aristokratët që silleshin në mënyrë sikurse „*fshatarët arrijnë në botë me*

shalë në kuriz, kurse ata me mamuza në thembra", juristët e nderuar, predikuesit e kthimit në natyrë, pseudomjekët me titujt e akademikëve, por jo më pak edhe vetveten, me entuziazmet dhe absurditetet e tij rinore.

Volteri thotë se të gjitha njohuritë tona mbështeten në përvojë dhe se asgjë nuk ekziston pa shkaqe. Nuk ka kurrëfarë idesh të lindura, askush në botë nuk solli me vete nocionin e moralit, e as të drejtësisë e të perëndisë, thotë ai, për të vazhduar: „*Të gjithë njerëzit vijnë në botë me hundë dhe pesë gishta në dorë dhe askush prej tyre nuk vjen në botë me nocionin e perëndisë*". Herë-herë është i afërt edhe me tezat agnostike e pohon se kurrë nuk do të njohim se ç'është „fryma”, e gjithashtu edhe vetë fjala substancë, domethënë „*ajo që është përfund, na paralajmëron mjaft se ajo përfundi do të mbetet për ne gjithmonë e panjohur*". Volteri duke mbetur deist, në të vërtetë, është nën nivelin filozofik të bashkëkohësve të tij materialistë. Konsideronte se masës i nevojitet religjioni, sepse duke premtuar „jetën e andejshme” me shpërblime dhe ndëshkime, shtie frikë e cila të orienton në respektimin e rregullit. Me fjalë të tjerë edhe sikur ateizmi të ishte filozofikisht i arsyetueshëm, ai do të vlente vetëm për njerëzit „e arsimuar”, „më të mirët”, kurse masës i nevojitet religjioni. Ai do të thotë: „*Edhe sikur perëndia të mos ekzistonte, do të ishte mirë ta shpiknim*”, ngase në të kundërtën njerëzit e padishëm do të bëheshin kriminelë të ndryshëm. Llogaritet njëri nga krijuesit e filozofisë së historisë, sepse në histori, mendonte ai, vjen në shprehje përparimi shpirtëror i njerëzve. Prandaj në histori duhet të paraqiten të arriturat kulturore të popujve e jo të përshkruhen luftërat e jeta e sunduesve.

Rëndësia e Volterit si filozof e shkrimtar qëndron në luftën e tij të vazhdueshme për liri, arsye dhe drejtësi. Krejt veprimtaria e tij filozofike, letrare dhe ajo publike ishte e drejtuar në mposhtjen e gënjeshtërisë e të hipokrizisë që ishin grumbulluar në një shoqëri që ishte në agoni e sipër.

4.5.2. Zhan Zhak Ruso (1712-1778)

Rusoi u lind në Gjenevë dhe është njëri prej mendimtarëve francezë të shekullit XVIII që pat më së shumti ndikim. Pak ditë pasi kishte lindur, i vdes e ëma e i ati, një orëbërës, e la nën kujdesin e tezes, e cila edhe e rriti. Pas qëndrimit dy vjet në konvikt, për të cilin do të thoshte ai, në veprën e tij „*Rrëfimet*” se „*atje më mësuam të gjitha mbeturinat e panevojshme që ka fituar emri arsim*”. Prej andej, e tërhoqi përsëri tezja e tij dhe në moshën 12 vjeçare arsimin të tij formal i erdhi fundi.

Rusoi kaloi një jetë të paretshme duke bredhur e shëtitur nëpër vende të ndryshme të Evropës. Shkrimet dhe librat e tij të shkëlqyeshëm i sollën lavdi, por i shkaktuan edhe ndeshje të pareshtura me pushtetin, që ndikuan shumë keq në Rusoin, i cili për nga natyra ishte shumë i ndieshëm dhe idhnak. Për këtë arsye binte në konflikt me bashkëkohësit e tij, me të cilët, përndryshe, sa ishte i ri dhe kur gjendej në Paris, kishte shoqëri. Në jetën e tij të



Zhan Zhak Ruso

mëvonshme erdh e u bë i çuditshëm dhe histerik. Me ftesë të Hjumit qëndroi në Angli, por shumë shpejt u kthye në Francë. Kur i treguan se Volteri kishte vdekur, ai tha: „*Jetët tona ishin të lidhura ngushtë me njëri-tjetrin. Unë nuk do të jetoj shumë pas tij*”. Veprat kryesore të tij janë: „*Mbi origjinën e pabarazisë*”, „*Kontrata shoqërore*” dhe „*Emili ose mbi dashurinë*”.

Sipas Rusoit njeriu për nga natyra është i mirë dhe nuk ka bërë kurrëfarë mëkati që ka lindur, por atë e ka prishur qytetërimi dhe kultura. Gjithë përparimi i shkencës, artit e i teknikës si dhe i ekonomisë është humbje e njerëzisë burimore, i lumturisë së shëndoshë natyrore dhe i harmonisë jetësore. Sedra naive natyrore shndërrohet nën ndikimin e arsyes në egoizëm, kurse luksi, dobësia e karakterit dhe çoroditja e zakoneve janë pasojë e zhvillimit të artit. Shkencat dhe virtytet nuk mund të pajtohen, ngase të gjitha shkencat janë me origjinë të ulët: astronomia rrjedh nga bëstytia dhe astrologjia; retorika nga ambicja; gjeometria nga lakmia; fizika nga kureshtja, mandej edhe etika burimin e ka në mendjemadhësinë njerëzore.

Bujqësia dhe përpunimi i metaleve shkaktuan lindjen e pronës private, e cila e zhduk barazinë e dikurshme fillestare. Prona private i ndan njerëzit në të pasur dhe të varfër, kurse pushteti në të fuqishëm dhe të dobët. Rusoi thotë: „*I pari që mendoj për të thurur një copë tokë – thotë ai – kjo tokë është e imja*”, duke hasur në njerëz naivë, të cilët i besuan, ishte themelues i vërtetë i shoqërisë qytetare. Sa krime, vrasje dhe luftëra do të pengoheshin, prej sa e sa mjerimeve e trishtimeve do të kursehej gjinia njerëzore sikur ai që do të shkulte hurin dhe do ta mbulonte hendekun duke u bërë titull i afërmëve: „*Mos i besoni mashtruesit, do të ngatëroheni në goftë se e largoni mendësh se frytet u përkasin të gjithëve, kurse toka askujt*!”. Për këtë arsye kthimi në natyrë bëhet kërkesë imperative për shpëtimin e njeriut, mirëpo ky kthim nuk është në gjendjen fillestare, por tejkalim i saj në shoqërinë e re qytetare, e cila ruan atributet e qenësishme pozitive të gjendjes natyrore.

Duke ndryshuar shoqërinë e në radhë të parë shtetin, i cili në të ardhmen duhet të mbështetet në „kontratën shoqërore”, në shtetin e këtillë popullit i takon sovraniteti i plotë, i cili është i pandashëm dhe i patjetërsueshëm. Te Rusoi legjitimiteti i pushtetit nuk mbështetet në forcë (Hobsi), e as në ndarjen e pushtetit (Manteskie), por në sovranitetin e popullit. Ligjet që miratohen në këtë shtet, domodo janë shprehje e vullnetit të përgjithshëm popullor për liri dhe barazi. Ndërkaq, vullneti i përgjithshëm nuk është identik me vullnetin e të gjithëve, ai duhet të bëhet burim dhe themel i çdo të drejte. Kontrata shoqërore, thotë ai, ka zënë fill në bazë të nevojës që do të mbrohet liria dhe barazia që mbretëronte në gjendjen natyrore. Me teorinë e shtetit si „kontratë shoqërore” Rusoi e parashtroi kërkesën demokratike për krijimin e një republike të përgjithshme popullore. Mendonte se prona private duhet të jetë patjetër themel i shoqërisë. Prandaj është e nevojshme vetëm të barazohet prona private dhe në këtë mënyrë do të zhidhen kontradiktat ndërmjet të varfërve dhe të pasurve. Ai shtyllën e rregullimit të drejtë shoqëror e gjeti në pronën private, të mbështetur në pronën personale.

Rusoi porositi të kthehet prej botës së arsyes, egoizmit dhe të konvencave shoqërore, nga bota e natyrës dhe e ndjenjave. Natyra është baza e vërtetë e njerëzores, ndërsa kultura e civilizimi si produkte të shoqërisë janë nocion i saj. Ai porositi t'i kthehemi natyrës! Volteri me këtë rast do të tallet duke shkruar se „*njeriut i lind dëshira që të ecë këmbodorës kur lexon librin tuaj. Mirëpo, meqë e kam humbur këtë shprehje që më shumë se gjashtëdhjetë vjet, për fat të keq ndjej se nuk kam mundësi ta ftoj sërish*”.

Zgjidhjet e çështjeve filozofike të Rusoit janë nën nivelin e Enciklopedistëve të shekullit XVIII. Por, përkundër kësaj, teoria për shtetin i tejkalon bashkëkohësit e tij dhe dominoi

gati gjatë tërë periudhës revolucionare të historisë franceze. Në shumë vepra të tij zmadhohet roli i ndjenjave në llogari të arsyes, ndërsa botëkuptimet estetike dhe veprat letrare e inaguruan drejtimin letrar të njohur me emrin sentimentalizëm, i cili më vonë u shkri në romantizëm. Rusoi pranoi ekzistencën e materjes pasive dhe shpirtit aktiv, me çka tek ai vjen në shprehje deizmi. Shpirti i njeriut nuk është i kësaj bote, ai është i pavdekshëm, – thoshte Rusoi. Edhe vetë religjionin e konsideronte si të rrënjësor në njeriun, mandej të rrënjësor në ndjenjat e brendshme të tij, të cilat zhvillohen nga adaptimi ndaj natyrës. Si deist i llojit të vet ai hodhi poshtë si materjalizmin ashtu edhe ateizmin e materjalistëve francezë dhe në këtë mënyrë shkoj përpara kohës vetë, pra, ndikimet e tij të llojllojshme kanë depërtuar thellë në shekullin e XIX dhe u përhapën edhe jashtë kufijve të Francës.

4.6. ENCIKLOPEDISTËT

Në filozofi dhe në letërsi me fjalën „enciklopedistët” kuptojmë redaktorët dhe bashkëpunëtorët më të njohur të „Enciklopedisë” apo të fjalorit analitik të shkencave, të arteve dhe të zejeve që u botua në vitin 1751 e deri në vitin 1772. Prijës i enciklopedistëve ishte Deni Didro, redaktor i „Enciklopedisë”, të cilit më së shumti i ndihmoi Dalamberi. Enciklopedistët kanë qenë filozofë të njohur (Didro, Holboh, Helvecius), mendimtarë socialë (Monteske, Rusoi), shkencëtarë (Dalumberi, Tyrgoja), eseistë (Volteri) etj.

Ndikimi i tyre në formimin e opinionit publik mbështetej në autoritetin që kishin si mendimtarë, në trimërinë e vendosmërinë e tyre në luftë kundër botës obskurante feudale – vlen veçanërisht për Didroin. Enciklopedistët edhe vetë „Enciklopedia” kanë luajtur rol shumë të rëndësishëm në luftën kundër rendit feudal dhe institucioneve feudale, pastaj në shtjellimin e idologjisë qytetare (civile) franceze, por edhe më gjerë.

4.6.1. Lametri (1709-1751)

Zhylien Orfej de Lameti është filozof dhe mjek francez. Që në moshën e hershme mbrojti disa teza materjaliste duke u marrë me fizikë dhe medicinë, ndërsa më vonë mori edhe titullin e doktorit. Satirat dhe pamfletet e tij të guximshme e spirituoze në veprën „Mbi mendjen dhe të mençurit” ngjallën urretjen te qarqet klerikale ndaj botëkuptimit materjalist të tij. Kundër tij filluan persekutimet, publikisht digjen veprat e tij, ndërsa vetë ai ikën në Holandë. Vdiq në Berlin, duke rrefuzuar, si ateist i bindur, të rrëfëhet para vdekjes.

Duke u nisur prej disa elementeve të filozofisë së Dekartit dhe filozofisë empirike angleze, Lametri



Lametri

formuloi botkuptimin e tij filozofik mekaniko-materjalist. Përvoja dhe të vëzhguarit-padyshim vërtetojnë se në **gjithësi ekziston vetëm një substancë materjale**, e modifikuar në forma të ndryshme, e cila përveç shtrirjes, ka aftësi dhe të lëvizë vetë. Edhe trupi i njeriut nuk është asgjë tjetër veçse një mekanizëm i përbërë, i ngjashëm me mekanizmin e orës, me ndryshim se vetë kurdiset. Mësimin e Deakrtit mbi kafshët si makinë, Lametri e zbatoi edhe në njeriun, kështu që edhe të menduarit është cilësi e materjes së organizuar në mënyrë të lartë. Kryevepra e tij është „*Njeriu makinë*”.

Në tezat etike të tij është ithtar i hedonizmit ekstrem, përkatësisht pastrimit të egoizmit në bazë natyraliste. Legjislacioni dhe edukata, shteti dhe shoqëria do të duhej, – thotë Lametri, – të angazhohen në atë mënyrë që egoizmi të përdoret për mirëqenien e shoqërisë.

4.6.2. *Deni Didro (1713-1784)*

Është filozof dhe iluminist francez i cili duke rrefuzuar ofertën për t'u bërë prift, jetoi si boem letrar. I kërcënuar vazdimisht nga persekutimet, burgjet dhe nën mbikqyrjen rigoroze të policisë, Didro megjithatë filloi t'i bënte përgatitjet për botimin e veprës më të madhe të mendimit materjalist të iluminizmit francez, të „*Enciklopedisë së madhe*”.

Enciklopedia e parë dhe më e njohur franceze është e lidhur në mënyrë të pandashme me emrin e Deni Didros. Ai shkroi më shumë artikuj nga fusha e filozofisë, artit dhe zejeve dhe deri në fund mbeti redaktor i saj. Mandej, edhe kur të tjerët u frikësuan nga terrori dhe persekutimet, ai nuk u thye, por vetëm pas një lufte të vështirë botoi vëllimin e fundit. Enciklopedia, të cilës vulën themelore ia dha Didroja, është kryevepër e vërtetë e frymës ateiste dhe materjaliste franceze. Ajo dha impulse jashtëzakonisht të rëndësishme dhe frytëdhënëse për zhvillimin e mëtejshëm të kulturës evropiane. Në Enciklopedi njëmend është paraqitur „*pasqyra e përgjithshme e përpjekjes së mendjes njerëzore të të gjithë popujve dhe në të gjitha kohët*” dhe janë vërtetuar edhe elementet themelore ideore të shkrimtarit të shoqërisë së vjetër dhe është provuar nevoja imperative e depërtimit më të guximshëm në drejtim të njohjeve të reja mbi shoqërinë e ardhmërisë.

Didro nuk krijoi ndonjë sistem të rumbullakësuar filozofik dhe të nxjerrë në mënyrë konsekuente. Duke kaluar rrugën nga deisti tek ateisti, u bë një nga kritikët më konsekuentë të moralit religjioz. Sipas tij, materja është aktive, e përbërë nga thërmia shumë të imta, me bashkimin mekanik dhe ndarjen e të cilave çdo gjë ndodh në natyrë. Arsyeja dhe njohja mbështeten në ndieshmërinë e përgjithshme të botës materjale. Didro besonte se progresi i njerëzimit varet nga idetë që ndikojnë në zhvillimin e legjislacionit e që përcakton formën e sundimit të disa vendeve dhe epokave historike.

Sipas Didros, e bukura artistike është ajo që përshkruan vetë njëmendësinë natyrore, mandej në atë mënyrë duke treguar ligjin jetësor të brendshëm të fenomenit ose objektit. Vlerësimi estetik i figurës duhet të mbështetet mbi pesë elemente të qenësishme, siç janë: vizatimi, ngjyrat, hija dhe dritat, shprehja dhe kompozicioni. Didro ishte i pakompromis kundër të gjitha formave të tiranisë. Ai me shumë vepra të tij jeton edhe sot. E, klerikët edhe pas dyqind vjetësh të vdekjes së tij, nuk mund ta falin e të pajtohen me fjalët e ashpra e therëse që

ua drejtoi, ashtu që edhe në kohën tonë përpiqen ta ndalojnë realizimin e veprave letrare dhe përhapjen e ideve filozofike të tij.

4.6.3. Helveciusi (1715-1771)

Klod Adrien Helvecius është filozof dhe iluminist francez i cili ishte i preokupuar me çështjen e moralit dhe, të shoqërisë në përgjithësi. Së bashku me Didron, Holbahun dhe enciklopedistët e tjerë, në sallonin e famshëm të vet, zhvillonte debate për çështjet e atëhershme aktuale të filozofisë. Kryevepra e tij „*Mbi shpirtin*” u dogj publikisht, për shkak të karakterit materialist dhe antireligjioz.

Teza themelore e Helveciusit është se njeriu dhe të menduarit e tij është fryt i rrethit dhe së këndejmi kujdes të madh u kushton çështjeve të edukimit. Njeriu është vetëm ai çfarë e bën edukata. Atëherë kur edukata do të na mësojë t’i harmonizojmë interesat personale me atë shoqërore, do të zhduken krimet dhe padrejtësitë. Morali, – thotë Helveciusi, – është i ndryshueshëm dhe se thelbi i tij është filozofik, ndërsa imoraliteti nuk lind nga korrupsioni ose prej natyrës së keqe të njerëzve, por nga papërsosshmëria e legjislaturës.

Sipas Helveciusit, teoria e njohjes është e drejtuar në mënyrë senzualiste, krejt jeta shpirtërore e njeriut mbështet në shqisa. Sipas tij, pasionet janë burim i të gjitha veprimeve tona, ndërsa për natyrën e njeriut më adekuate është që ta evitojë çdo dhimbje dhe të arrijë kënaqësinë e lumturinë. Në anën tjetër, ai e hodhi poshtë mundësinë e ekzistimit të ideve të lindura. Kërkoj, si kusht i ndryshimit të njeriut dhe realizimit të lumturisë, ndryshimin e rendit shoqëror.

4.6.4. Dalamberi (1717-1783)

Zhan le Ron Dalamber është fizikan, matematikan dhe përmbi të gjitha filozof francez. Në moshën 23 vjeçare u pranua anëtar i Akademisë së Shkencave të Francës, për talentin e rrallë për matematikë. Ai i kushtohet shkencës dhe bëhet, siç thotë vetë „*skllav i lirisë së vet*”. Është pionier i shumë shkencave ekzakte të shekullit XVIII. Dalamberi është një nga bashkëpunëtorët më kryesorë dhe të përhershëm të „enciklopedisë” si dhe autor i vepërs së njohur „*Shqyrtime hyrëse në enciklopedi*”. Filozofia e Dalamberit përpiket të hedhë poshtë çdo metafizikë, duke iu drejtuar përvojës, si i vetmi burim adekuat i njohjes sonë. Ai thotë: „*Të gjitha dituritë tona të drejtpërdrejta reduktohen në atë që i marrim nëpërmjet shqisave, nga këtu ne për të gjitha idetë tona u detyrohemi ndijimeve*”. Detyra themelore e filozofisë, për të është, **zgjidhja e çështjeve gnosologjiko-teorike**. Gnosologjinë, këtë „*fizikë eksperimentale të shpirtit*” e konsideron **disiplinë kryesore filozofike**. Në „metodën e re” të tij, më vonë do të vijë në shprehje ognosticismi, orinetimi pozitivist-scientist. Parimi i kauzalitetit bëhet parimi suprem i metodës së tij antispekulative.

Filozofia, sipas tij, është shkencë për substancën ose parimet e përgjithshme të genies. Aplikimi i mendjes mbi sendet e veçanta mbështetet mbi faktet e përvojës. Shkenca lind si rezultat i shtimit të nevojave njerëzore, e kujdesit të njeriut për vetekzistencë. Dalamberi të gjitha dituritë i ndan në tri grupe që u përgjigjen tri aftësive të njeriut: kujtesës i përgjigjet historia, arsyes – filozofia, ndërsa imagjinatës – artet e bukura.

4.6.5. Pol Holbah (1723-1789)



Pol Holbah

Pol Ditril Frajer Holbah është filozof francez i cili u rrit në një familje të pasur aristokrate – pati edhe titullin e baronit. Në moshën 27 vjeçare arrin në Paris ku bëhet bashkëpunëtor i ngushtë i enciklopedistëve. Së shpejti saloni i tij shndërrohet në qendër për grumbullimin e filozofëve, ndërsa Holbahu ndërmjet tyre ishte kritiku më radikal dhe më i ashpër i feudalizmit, i krishterizmit, i teologjisë. Ai ishte ateisti më konsekuent dhe luftëtar i pakompromis kundër të gjitha formave të tiranisë e paragjyqimeve të ndryshme dhe krejt regjimit të vjetër. Veprat e tij u botuan me pseudonim dhe shkaktuan sulme të ashpra të kishës e të përfaqësuesve zyrtarë të Francës, prandaj u ndalua dhe u dogj kudo. Vepra kryesore e tij është „*Sistemi i natyrës*“, ndryshe e quajtur „*bibël e materjalizmit*“, u bë vepra më me influencë e iluminizmit. Në të është punuar në mënyrë sistematike teoria e të njohurit, ontologjia, etika sociale, politika, filozofia

e religjionit dhe antropologjia. Pjesa e parë merret me problemet e natyrës e ligjeve të saj, fuqisë e lumturisë njerëzore, ndërsa pjesa e dytë me kritikën e religjionit dhe të teologjisë.

Detyra e filozofisë është e përcaktuar prej qëllimeve praktike, pra për arritjen e lumturisë njerëzore. Ai thotë: „Njeriu është fatkeq ngase nuk e njeh natyrën“. Natyra si tërësi unike përbën në vete një sistem, ndërsa materja posedon një aktivitet vetiak të brendshëm. Materja dhe vetia themelore e saj – lëvizja, është themel i çdo gjëje ekzistuese. Lëvizja nuk është vetëm veti e materjes, por është thelbi i saj. Lëvizja shfaqet si kauzalitet i përgjithshëm, si zinxhir i pandërprerë i shkaqeve dhe pasojave. Çdo ndryshim i ndonjë trupi paraqet pasojën që rrjedh nga ndonjë shkak. Edhe pse tek ai gjenden elemente të dialektikës, në esencë ngel në nivelin e filozofisë mekaniko-materjaliste. Sipas Holbahut, vetëdija dhe arsyeja nuk janë gjë tjetër veçse materja e organizuar në formën më të lartë. Njeriu është qenie natyrore dhe pjesë e pandashme e saj.

Determinizmi absolut e çoi Holbahun në fatalizmin absolut, ose siç thotë ai, „Fatalizmi është rend i amshueshëm, i pandryshueshëm, i domosdoshëm në natyrë dhe shoqëri, lidhja e domosdoshme e shkakut me pasijat, sipas të cilit trupat e rëndë bien, materjet tërhiqen dhe dëbohen, njerëzit midis tyre duhen ose urrehen, bëhen të lumtur ose fatkeq”. Të gjitha ligjet mekanike, – thotë ai, – vlejnë edhe për njerëzit, e ajo që nuk përputhet me këto ligje, është anomali shoqërore dhe politike kundër së cilës duhet luftuar. Holbahu lufton kundër regjimit të vjetër e religjionit, kundër çdo despotizmi politik e shoqëror si dhe kundër çdo fanatizmi religjioz. Ai thotë se religjioni është grumbull i mashtrimeve më të mëdha njerëzore, sistem i iluzioneve shtrerpë që njeriut i pikturojnë jetën në botën tjetër dhe kështu e largojnë nga problemet e rëndësishme të jetës.

Filozofia e Holbahut, padyshim, është materializëm francez i formuar si sistem në mënyrë më konsekuente. Me gjithë të metat e tij, që dalin nga premisat mekanike-materialiste dhe deterministe, ajo është një hallkë progresive për zhvillimin e mendimit qytetar.

PYETJE:

1. Kur u paraqite „renesansa” dhe çfarë fryme paraqiste ajo?
2. Thuaj disa zbulime më të rëndësishme në „shkencën e renesansës” dhe përfaqësuesit më tipik të saj!
3. Çfarë thotë Galileu, për të vërtetën absolute në botën fizike?
4. Çfarë është njeriu për nga natyra e tij, sipas Nikolla Makjavelit?
5. Çfarë thotë për botën Xhordano Bruno dhe thuaj për fatin tragjik të tij?
6. Si është raporti i metodës dhe të vërtetës, në „kohën e re”?
7. Cilën „metodë” preferonte Frensis Bekoni në zbulimet shkencore?
8. Çfarë konsiderojnë me „burim të të njohurit” empiristët?
9. Çfarë thotë Xhon Loku për „rolin e përvojës” në njohjen tonë?
10. Ç’do të thotë të „ekzistojë një send” sipas Xhorxh Berklit?
11. Çfarë është qëndrimi përfundimtar i David Hjumit?
12. Pse Dekarti quhet „baba i filozofisë së kohës së re”?
13. Çfarë është „dyslumi i Dekartit”, për të ardhur tek e vërteta?
14. Ç’është „shkak i substancës” për Baruh de Sipinozën?
15. Si mund t’i ikim fatkeqësisë, prapambeturisë, paragjykimeve e bestytnive të ndryshme, sipas iluminizmit?
16. Në mënyrë cinike, çfarë përqeshte Volteri në Evropë në atë kohë?
17. Sipas Rusojit, „kultura dhe qytetërimi” a kontribuan në mirësinë e natyrës së njeriut?
18. Numëroji disa përfaqësues të „enciklopedistëve” francezë?

„Filozofi që të jetë i denjë respektit, duhet të predikojë me shembullin e vet”

F. Niçe

PROSVETNO DELO

V. FILOZOFIA BASHKOHORE

5.1. FILOZOFIA DHE SHKENCA NË SHOQËRINË BASHKOHORE

Bartës i mendimit filozofik të botës bashkohore gjithësesi është „idealizmi klasik gjerman” me përfaqësuesit: Kant, Fichte, Schelling e Hegel. Ai paraqet sintezën e të gjitha përpjekjeve të deriatëhershme filozofike e të kohës së re; **kulminacioni i kulturës së shoqërisë borgjeze** në përgjithësi dhe është udhërrëfim i tërë zhvillimit të mëvonshëm filozofik, pastaj i tillë ka mbetur deri në ditët tona.

Në histori ka qenë rast i rrallë që periudha e rënies politike të përputhet me periudhën e përparimit të madh shpirtëror siç ngjau me Gjermaninë e asaj kohe. Derisa Franca borgjeze e Napoleonit shkelte toka feudale gjermane, **arti dhe filozofia gjermane depërtonte në radhët e para të kulturës botërore**. Shkenca gjermane e asaj kohe vjen e bëhet e para në Evropë. Letërsia gjermane nëpërmjet shkrimtarëve të vet të mëdhenj siç janë Lessing, Herderi, Goethe, Schiller etj, zë vend të rëndësishëm në letërsinë botërore, e muzika gjermane me Haydnin, Mozartin e Beethovenin gjithashtu gjendet në krye të muzikës botërore. Ndërsa filozofia klasike gjermane me përfaqësuesit më tipik Kantin dhe Hegelin botës i solli aso begatie të mendimit filozofik çfarë zaten rrallë janë shënuar në një distancë kaq të shkurtër kohore. Filozofia atëherë, pra arriti zhvillimin më intensiv në historinë e saj të përgjithshme, në një periudhë relativisht të shkurtër. Për këtë **V. Vilelmbandi do të thotë**: prej „*Kritikës së mendjes pastër të Kantit 1781 e deri në vdekjen e Hegelit 1831 kaluan vetëm pasëdhjetë vjet, e kjo kohë do të mund të krahasohet vetëm me periudhën e lulzimit të madh të filozofisë greke me në krye Demokritin, Sokratin, Platonin e Aristotelin*”.

Përkundër **partikularizmit politik** në Gjermani, në anën tjetër në atë kohë, bëheshin përpjekje për **univerzalizëm shpirtëror**. Letërsia dhe filozofia me Goeten e Kantin në krye paraqiten dhe ndërtohen në bazë të të arriturave të mëdha shpirtërore të krejt historisë njerëzore. Filozofia i miratoi dhe i thelloi idetë e antikës, të renesansës dhe të iluminizmit. Ajo me anë të Hegelit edhe vetveten e kuptoi si rëzim, sistematizim të të gjithë atyre që mendja dhe shpirti njerëzor i ka krijuar deri atëherë. Domethënë paraqet sintezën e skolastikës dhe të racionalizmit-dogmatizmit si dhe të empirizmit-skepticizmit anglez. Ajo gjithashtu mësoi

prej shkencës natyrore e matematikës së Njutnit dhe prej analizave psikologjike të njohurit njerëzorë, që i vuri në pah shekulli i iluminizmit. Fjala vjen në Kantin ushtroi ndikim si teoria sentimentaliste e Rusoit ashtu edhe „teoria e religjionit natyror” (Spinoza). Filozofia moderne i parashikoi rrjedhat në përmasat botërore si synime më të larta dhe më përparimtare të kohës sonë në përgjithësi e që vlejnë në forma të modifikuara edhe sot e kësaj dite.

5.1.1. Emanuel Kanti (1724-1804)



Emanuel Kanti

Emanuel Kanti është lindur në Kenigzberg të Prusisë Lindore nga një familje zejtare. Prindërit e tij i takonin sektit fetar pietist. Atmosfera religjioze familjare ushtroi ndikim të dukshëm në botëkuptimin dhe karakterin e tij. Nuk lëviz kurrë nga vendlindja. Dukej sikur guximi i mendimit të tij i mjaftonte për të qetësuar te vetja çdo dëshirë për aventurë. Ishte nga ata njerëz, te të cilët e gjithë energjia, të gjitha përpjekjet bashkohen në një pikë, te vepra, e cila nuk lejon asnjë teprim; ishte nga ata njerëz që jetojnë për hir të punës së tyre dhe për punën e tyre. Jetoj në mënyrë të rëndomtë duke rregulluar kohën e punës dhe duke iu shmangur të gjitha intrigave të mundshme.

Studioi filozofinë, matematikën dhe shkencat natyrore. Zhvillimi i veprimtarisë filozofike te Kanti ndahet në dy periudha: parakritike dhe kritike.

Periudha parakritike. Në këtë periudhë Kanti filozofon për çështjen e historisë së kozmosit. Është plotësisht në terrenin e filozofisë natyrore të Njutnit dhe vetes i parashtron detyrë që zanafillën dhe zhvillimin e kozmosit ta shpjegojë vetëm me ndihmën e ligjeve mekanike. Vepra e tij më e rëndësishme e kësaj periudhe është „*Historia e përgjithshme e natyrës dhe teoria e qiellit*” në të cilën ka paraqitur teorinë e tij mbi prejardhjen e Sistemit diellor. Para Kantit këtë pyetje nuk e shtroi asnjë shkencëtar, ndërsa Njutni mendonte se trupat qiellorë e bashkë me ata edhe Sistemi diellor ekzistojnë amshueshëm, të krijuar nga krijuesi i amshueshëm – Zoti. Kanti nga kjo fushë studimi largoi teologjinë, duke shpjeguar me ligje natyrore të lindurit të Sistemit diellor. Ai thoshte: „*Ma jepni materjen dhe unë do t’ju tregoj se si prej saj ka zënë fill bota*”. Njësoj si Kanti, por pavarësisht prej tij, e paraqiti teorinë e vet edhe fizikanti francez Pjer Laplas. Në literaturë kjo njihet si „Teoria e Kant-Laplasit”. Laplasi iu përgjigj bile edhe Napoleonit, i cili e pyeti se ku e ka Zoti vendin në këtë teori, „*se nuk kishte nevojë për një hipotezë të tillë*”.

Periudhës parakritike i takon edhe vepra „*Shqyrtime mbi ndjenjën e së bukurës dhe të madhërishmes*”. Në këtë vepër Kanti dallon të madhërishmen dhe të bukurën. E madhërishmja, që objektivist përmban të lemeritshmen, bujaren dhe madhështoren, gjithmonë

duhet të jetë e madhe, ndërsa e bukura mund të jetë edhe e vogël. Vetitë e të madhërishtes inspirojnë nderimin, të bukurën dhe dashurinë, etj.

Periudha kritike. Kjo periudhë erdhi në shprehje në tri kritikë të tij të famshme: „*Kritika e mendjes pastër*“, „*Kritika e mendjes praktike*“ dhe „*Kritika e fuqisë së të krijuarit*“. Në këto vepra Kanti përpunoi filozofinë e tij të njohur si kritikizëm ose idelaizëm transcendental. U quajt e këfillë për shkak të metodës që përdori dhe rezultateve në të cilat i arriti. Me këto vepra kritike Kanti synoi që të tejkalojë kundërshtinë ndërmjet racionalizmit dhe empirizmit. Nga të kuptuarit dogmatik (filozofia e Lajbniv-Voltit), në fillim nën ndikimin e të cilit ishte, – e zgjoi David Hjumi. Kanti do të thotë: „*E pranoj botërisht se kujtimi për D. Hjumit ka qenë mu ajo që para shumë vitesh më ka zgjuar nga gjumi dogmatik dhe gjurmimeve të mia nga lëmia e filozofisë spekulative u ka dhënë krejtësisht drejtim tjetër*“. Mirëpo pajtimi me këtë filozof anglez nuk zgjati shumë. Ai nuk mund të pajtohet me skepticizmin e Hjumit meqë në themel të tij qëndronte botëkuptimi empirist, sipas të cilit, përvoja shqisore është burim kreativ i tërë diturisë. Skepticizmi i Hjumit nuk jepte mbështetjen e shkencave që në këtë kohë tregonin bindshmëri dhe siguri në pohimet e tyre, siç ishte rasti me Gjeometrinë e Euklidit dhe Fizikën e Njutnit. Filozofia e Kantit në të vërtetë paraqitet si përpjekje për t'i dhënë bazat filozofike të këtyre dy shkencave. Ai donte të dëshmojë në studimet e tij, se edhe filozofia është shkencë në lëndën dhe në tezat e së cilës askush nuk mund të dyshojë.

Kanti është përpjekur të zbulojë jo se çfarë gjendet në bazën e sendeve (botës), por të përcaktojë se çfarë është fuqia njohëse e njeriut, cilat janë burimet, mundësitë dhe kufijtë e asaj njohjeje. Tërë gjerësinë e problematikës filozofike e pëfshin në tri pyetje: çka mund të dijë, çka mund të bëjë dhe në çka mund të shpresojë, të cilat shkrihen në një pyetje të vetme: Çka është njeriu?. Risinë e pikëpamjeve të tij, të njohjes Kanti e quan kthesë kopernikiane. Në të vërtetë, ashtu si Koperniku që e ktheu pamjen tradicionale të botës: Tokën e palëvizshme nga qendra e botës e vuri në udhëtim rrethor rreth Diellit, ashtu edhe Kanti e ktheu raportin e subjektit dhe objektit. Objekti deri tani ka pasur rolin e qendrës së palëvizshme rreth të cilit qarkullonte subjekti, në synimin e tij që ta njohë objektin, të tillë siç është ai, pavarësisht nga subjekti. Në të vërtetë ndodh anasjelltas, sipas ti, sendi (objekti) drejtohet sipas vetive të forcave tona njohëse, objekti qarkullon rreth subjektit, jep dukuritë ashtu siç i kushtëzon subjekti me format e tij njohëse. Njeriu arrin në qendrën e procesit njohës. Ai është ligjdhënësi i natyrës, prandaj „*ne për sendet njohim apriori vetëm atë që vetë e vëmë në to*“.

Në teorinë e njohjes Kanti nisat nga analiza e gjykimeve që i llogarit për elemente të njohjes së njeriut. Në pajtim me traditën ai gjykimet i ndan në: **gjykime analitike dhe gjykime sintetike**. **Gjykimet analitike** janë ato të cilat predikati vetëm e zbulon përmbajtjen e subjektit, vetëm e analizon atë. Kur themi „*Trupi është hapësinor*“, predikati „*hapësinor*“ në mënyrë të domosdoshme i takon subjektit „*trupi*“, i cili pa vetinë hapësinore nuk mund të merret me mend. I ngjashëm është rasti edhe me gjykimin „*Begari është mashkull i pamartuar*“. Në nocionin „*begar*“ si subjekt, ne pas analizës së përmbajtjes së tij hetojmë se ai është „*mashkull*“ dhe „*i pamartuar*“, ndërsa predikati vetëm e zbulon atë dhe nuk shton asgjë të re ndaj subjektit. Në anën tjetër, **gjykimet sintetike**, të cilat në predikatin na tregojnë diçka të re për subjektin,

e zgjerojnë atë që mundëmi ta njohim me analizën e përmbajtjes së tij. Për shembull, sqaron Kanti, – kur themi: „*Trupi është i rëndë*“. Predikati „*i rëndë*“ nuk zbulohet me analizën e përmbajtjes së subjektit. Trupat nuk janë të rëndë në mënyrë të domosdoshme, mendon Kanti, prandaj me këtë predikat mësojmë diçka të re për subjektin ndaj të cilit është e mveshur vetia „*i rëndë*“ ose siç thotë ai, ajo është sintetizuar, i është bashkuar subjektit.

Ndërkaq, Kanti vërteton se **grykimet analitike janë të përgjithshme dhe të domosdoshme. Ato nuk mund të mos jenë të vërteta dhe se vërtetësia e tyre vërtetohet pavarësisht nga përvoja.** Por grykimet analitike nuk na tregojnë asgjë të re për botën, gjë që nuk është rast me grykimet e shkencës të cilat e zgjerojnë diturinë tonë për botën. Në anën tjetër, grykimet sintetike e zgjerojnë diturinë tonë për botën, por nuk janë të përgjithshme dhe të domosdoshme, ato janë të rastësishme – disa trupa janë të rëndë e disa të lehtë, ndonjë kullosë është e gjelbër e ndonjë e verdhë, etj. Mbi grykimet e këtilla nuk mund të ndërtohet shkenca. Kjo është edhe thelbi i kritikës së racionalizmit dhe empirizimit nga ana e tij. Prandaj Kanti përpiqet të gjejë grykime të tilla në njohjen tonë, të cilat do të jenë të përgjithshme dhe të domosdoshme dhe të cilat njëkohësisht do ta zgjerojnë njohjen tonë. Për këtë qëllim ai sjell edhe një ndarje të grykimeve: në apriori (të parapërvojës) dhe aposteriori (të përvojës). **Zakonisht llogaritet se grykimet analitike janë apriori, ndërsa ato sintetike aposteriori.** Ndërkaq, Kanti mendon se ekzistojnë *grykime sintetike apriori*. Kjo është, ajo e rëndësishmja tek ai, domethënë grykime të përgjithshme dhe të domosdoshme dhe që e zgjerojnë diturinë tonë. Dhe, se ekzistojnë grykime të këtilla dëshmojnë matematika dhe shkencat natyrore. Kanti nuk shtron problemet se a ekzistojnë grykimet sintetike apriori, por si janë ato të mundshme.

Forcat e ndijimit. Kanti thotë se çdo njohje fillon prej përvojës, por jo secila njohje gjendet në përvojë. Njohja paraqitet, në të vërtetë, kur diçka prej botës së jashtme vepron në organet tona shqisore. Atë diçka e quajmë send në vete, si rezultat i atij veprimi, fitojmë ndijime të ndryshme për të parit, të dëgjuarit etj. Por ndijimet nuk tregojnë asgjë për sendin në vete, nuk paraqesin asgjë objektive. Ndiijimet e shkaktuara nga sendi në vete, në shqisat tona paraqiten pa kurrëfarë rendi. Për të vënë rend ndaj ndijimeve duhet t'u bashkohen edhe krijimet apriori të fuqisë së pastër ndijore, e pastër në pavarësi prej sendit në vete. **Produkte të fuqisë së pastër ndijore janë hapsira dhe koha.** Hapsira dhe koha janë institucione të pastra dhe paraqesin kushte apriori të çdo përvoje të mundshme shqisore. Duke i falenderuar hapsirës dhe kohës ndijimet renditen njëri pranë tjetrit (hapsira) dhe njëri pas tjetrit (koha). Hapsira dhe koha te Kanti janë subjektivizuar në nivelin e gjinisë njerëzore, e jo në nivelin e individit të caktuar. Ato nuk u takojnë sendeve të botës së jashtme – sendit në vete. Ndaj tyre ne mashtrohemi, si i sëmuri prej të verdhës kur mendon se verdhësia është veti e sendeve të botës së jashtme. Pra, hapsira dhe koha janë krijime apriori subjektive të fuqisë së ndijimit, e jo veti e sendeve.

Vetëm hapsira në gjeometri dhe koha në aritmetikë mundësojnë që të bëhet sinteza e subjektit dhe predikatit e të fitohen grykime sintetike apriori, domethënë të përgjithshme dhe të domosdoshme, por edhe që e zgjerojnë diturinë tonë, në fushë të matematikës. Pohimi $7+5=12$ që për Lajbnicin ishte analitik, për Kantin është sintetik, 12 është numër çift

që tregon diçka më tepër se numrat 7 dhe 5 që janë numra tek. Ky pohim është edhe apriori, duke falenderuar sintezës e cila në të bën kohën si një pas një, shtimin e njësive prej 5 kah 7, ndërsa në pohimet e gjeometrisë luan rol hapsira. Kjo është filozofia e Kantit në matematikë. Ndërkaq, hapsira dhe koha nuk janë veti të vetë sendeve, por kushte tona subjektive të përjetimit të sendeve. Ne njohim vetëm dukuritë e sendeve, domethënë perceptimet që ato i prodhojnë në ne.

Fuqia e arsyes. Njohja, përveç fuqisë së ndijimit, disponon edhe me fuqinë e arsyes. Ajo është fuqi e tillë njohëse, e cila ajo që është pranuar prej fuqisë së pastër të ndijimit e formëson në dukuri (fenomen) – në njohje lëndore. Kjo bëhet me ndihmën e kategorive – nocioneve të përgjithshme, të cilat i prodhon fuqia njohëse e arsyes, e ato janë apriori, të pavaruara prej përvojës. Kanti në pajtim me ndarjen e gjykimeve, në logjikën e atëhershme formale, të cilës i jepte rëndësi të posaçme, bën klasifikimin e gjykimeve sipas kuantitetit: të përgjithshme, të veçanta dhe individuale; kualitetit: afirmative, negative dhe limitative; modalitetit: problematike, asertorike dhe apodiktike dhe relacionit: kategorike, hipotetike dhe disjunktive. Kanti mendon se me zbërthimin e këtyre gjykimeve mund të nxirren të gjitha kategoritë, pa të cilat nuk mund të ndërtohet asnjë dukuri (fenomen). Sipas gjykimeve të kuantitetit, Kanti dallon tri kategori: njëjës, shumës dhe gjithçka. Ose sipas kualitetit kemi kategori: afirmim, mohim dhe limitim, mandej të gjykimeve me lidhje afirmative dhe pridikat negativ, si fjala vjen „*shtaza është jo e arsyeshme*“. Në bazë të 12 gjykimeve ai nxori edhe 12 kategori, të të cilat gjashtë të fundit janë dinamike, për dallim nga gjashtë të parat që janë statike. Kanti do të nënvizojë se kategoritë pa të vërejturit janë boshe, ndërsa të vërejturit pa kategoritë është e verbër.

Me ndihmën e sintetizmit të ndijimeve me kategoritë, formohet rrjeti i çdo dukurie të objektit në njohjen tonë. Kështu sendet para neve dhe në botën objektive në përgjithësi si kjo tavolinë, karrige e mollë, etj, sipas Kantit, janë vetëm gërshetime tona: ato janë të përbëra nga ndijimet, me kushtet e saj apriori kohën dhe hapsirën dhe nga kategoritë, të cilat bëjnë sendin të jetë i dhënë, një aksidencë dhe substancë, i lidhur në raport të shkakut dhe pasojës, në veprim të ndërsjellë, i mundshëm, real dhe i domosdoshëm. Asgjë në këto nuk ekziston si send në vete.

Sendet në përvojën tonë janë vetëm dikuri që i krijojnë aftësia njohëse e njeriut, vetëdija në përgjithësi, siç thotë Kanti: *Njohja njerëzore, pra, është e kufizuar vetëm në njohjen e dukurive, prej këtu ontologjia si shkencë për ekzistencën si ekzistuese është e pamundshme*. Njohja buron kur sendi në vete i nxit shqisat tona që mund t'i njohim formimet dhe dukuritë matematikore, botën fenomenale që nuk mund të tejkalohet ngase has në kufirin e patejkalueshëm të sendit në vete, botës noamenale.

Fuqia e mendjes. Fuqia e mendjes është aftësi e cila edhe pse e di se është e pamundshme të tejkalohet kufiri i botës së fenomenit (dukurisë), ajo prapë kërkon kalimin e saj. Ndërkaq, bie në liuzione dialektike, me ç'rast mendja krijon idetë: shpirtin si bazë të dukurive psikike, kozmosin si gjithmbarshmëri të dukurive të botës dhe Zotin si shkak i parë. Idetë nuk hyjnë në përbërjen e njohjes së fenomenalitetit, thotë Kanti, por

janë idealet drejt të cilave synon njohja për të mos arritur kurrë. Në përvojë është dhënë lidhja shkak-pasojë, por edhe shkak i parë (Zoti) në të cilin ndalet renditja shkakore. Është e ngjashme edhe ideja për kozmosin, ajo kurdoherë shpie në antinomi; si bota ka fillim në hapsirë dhe kohë; bota është e pakufishme në hapsirë dhe pa fillim në kohë, sendet janë të ndashme në pakufi – ka pjesë të pandashme më tutje, atomet; në botë mbretëron determinizmi – në botë gjithçka është e indetëruar; ekziston shkak i parë, Zoti, – nuk ekziston shkak i parë. Edhe metafizikat e veçanta nuk mund të formohen si shkencë (psikologjia racionale), pasi argumentet për ekzistimin e shpirtit si substrat i dukurive psikike janë në të vërtetë paralogjizma (përfundim i gabuar, me pahir); ideja për botën përfundon në antinomit, që paraqet vdekjen për çdo shkencë, ndërsa ideja për Zotin argumentohet me sofizma (përfundim i gabuar qëllimisht). Metafizika e Kantit në këtë mënyrë tregohet rënimtare, ajo rënon çdo shkencë.

Ndërkaq, idetë nëse nuk mund të argumentohen, kjo nuk do të thotë se edhe duhet të hudhen poshtë. Pastaj edhe diçka më shumë, idetë janë të domosdoshme për rregullimin e sjelljes praktike të njerëzve, si qenie morale. Kanti thotë se në këtë botë njerëzit e mirë kalojnë keq dhe nëse nuk është besimi në pavdekshmërinë e shpirtit dhe në ekzistencën e Zotit, i cili në botën tjetër do të ndajë shpërblime dhe dënime, morali kurrsesi nuk do të ishte i mundshëm, ndërsa pa moral, – thotë ai, – nuk do të mund të ekzistonte çfardo qoftë bashkësi.

Etika. Filozofia e Kantit, përveç se është kritike (në teorinë e njohjes), ajo është edhe filozofi praktike (etikë). Në etikën e tij ai bën dallim të prerë ndërmjet njeriut si qenie fizike, që rigorozisht u nënshtrohet ligjeve të natyrës dhe njeriut si qenie morale që vepron sipas vullnetit të vet të lirë. Me këtë njeriu dallohet në mënyrë esenciale prej qenieve të tjera natyrore. Në lëmin e moralit kemi punë jo me atë që është patjetër, por duhet; jo me ligjet që vlejnë përgjithësisht dhe domosdoshëm, por me urdhëra, imperative, që duhet, por nuk është patjetër të plotësohen. Kanti dallon imperativ hipotetik, që udhëzon në çfardo veprimi të mirë nëse është mjet për arritjen e diçkaje tjetër dhe imperativin kategorik, që udhëzon në çfardo veprimi i cili në vete është i mirë.

Kriterin e jetës morale Kanti nuk e kërkon në përvojë, por e nxjerr prej mendjes praktike. Parimi i veprimit tonë praktik është vullneti i mirë i pastër (i kulluar). „Askund në botë, – thotë Kanti, – nuk mund të merret me mend asgjë që pa kurrëfarë kushtëzimesh mund të merret si i mirë, përveç vullnetit të mirë”. Vullneti i mirë i pastër nuk është i motivuar as me lumturinë, as me dobinë, as me kënaqësinë shpirtërore. Etika e Kantit i dha vullnetit karakterin e autonomisë, që vetvetes i jep fuqinë e ligjit. Vepër morale është vetëm ajo që bëhet sipas ligjit moral, i cili e detyron dhe e përcakton praktikën. Morali është vetëm ajo që bëhet nga detyra, që e kërkon ligji moral. Ligjin më të lartë moral e ka përkufizuar si imperativ kategorik që thotë: „Vepron në atë mënyrë që maksima e vullnetit tënd të mund të vlejë gjithmonë si parim i një legjislacioni të përgjithshëm”.

Forca e imperativit kategorik është apriorë që tregon çdo vullnet individual me anë të kërkesës për një vlerë të përgjithshme. Ky qëndrim nuk vjen nga jashtë, as nga perëndia e as nga ligjet pozitive. Ligji suprem mbi moralin mund të përkufizohet edhe kështu: „Vepron

ashtu që njerëzit në personalitetin tënd dhe në personalitetin e çdo njeriu tjetër ta përdorin gjithëmonë si qëllim, ndërsa kurrë si mjet". Po për të qenë njeriu person duhet të jetë medoemos i lirë. Liria është kushti dhe kërkesa kryesore e moralit. Lirisë nuk mund t'i gjendet vend në lëmin e teorisë së pastër, të diturisë, por Kanti i ka gjetur vend në veprimtarinë praktike, ku ajo medoemos të mendohet „për shkak të përdorimit praktik”.

Estetika. Mendja teorike dhe ajo praktike në sistemin filozofik të Kantit mbeten të ndara, atëherë u paraqit nevoja që të kërkohet pika e unitetit të tyre. Ai këtë e vuri në pah në kritikën e fuqisë së të gjykuarit. Në gjykimet tona të ndjenjave, pra, në gjykimet për të bukurën sintetizohet senzualiteti dhe arsyeja, mendja teorike dhe ajo praktike, domosdoshmëria e natyrës dhe liria e vullnetit. Kjo është e mundur pasi që në veprat e artit, të bukurit zë fill në bazë të lojës së imagjinatës dhe arsyes. Vetë të bukurit është ajo që me formën e vet, pa kurrëfarë interesi u pëlqen të gjithëve.

Emanuel Kanti me tërë energjinë dhe vullnetin e tij të pathyeshëm ka synuar të gjitha enigmat „e qiellit me yje mbi ne” dhe „ligjit moral në ne”, të zbulojë së paku, një pjesë të atyre fshehtësive, duke na afruar një hap kah e vërteta mbi botën dhe njeriun. Mendonte se duhet të krijohet gjendja e paqes së amshueshme ndërmjet të gjitha shteteve, ndërsa që të mund të institucionalizohet dhe të ruhet paqja duhet të zhvillohet tregtia dhe komunikimi ndërkombëtar në dobi të ndërsjelltë të shteteve të ndryshme. Kanti është humanist i madh duke e zmadhuar lirinë e njeriut dhe autonominë shpirtërore të tij, fuqinë e tij krijuese deri në atë masë, sa e ka ngritur në nivel të ligjit të përgjithshëm natyror.

5.1.2. Hegeli (1770-1831)

Georg Vilhem Fridrih Hegeli është filozof gjerman, me origjinë prej një familjeje të vjetër protestane. U lind në Shtutgart të Gjermanisë. Në Tübingen studioi teologjinë dhe filozofinë. Ishte mik i Helderinit dhe Shelingut. Në Bern dhe Frankfurt punoi si mësues shtëpiak, ndërsa në fund të vitit 1801 u rehabilitua profesor në Jenë. Këtu së bashku me Shelingun botoi „Revistën kritike filozofike”. Në vitin 1807 botohet një nga veprat, më vonë, më të njohura të literaturës filozofike botërore „Fenomenologjia e frymës”. Pas kësaj Hegeli bëhet redaktor i gazetave, ndërsa më 1808 edhe drejtor i gjimnazit në Nuremberg, ku shkroi veprën e tij të njohur „Shkenca e logjikës”. Së shpejti emërohet profesor i filozofisë në Hajdelberg ku shkroi „Enciklopedinë e shkencave filozofike”. Në vitin 1818 ftohet në Berlin, ku ndër të tjera shkroi edhe „Veçoritë themelore të filozofisë së të drejtës”. Vdiq në Berlin, siç thuhet, nga kolera.



Hegeli

Filozofia e Hegelit paraqet një sistem logjik mendor aq të gjithanshëm, të thellë dhe në vetvete konsekuent, sa për nga gjithanshmëria sistematike dhe konsekuencat mendore, në historinë e filozofisë nuk ka pothuajse as paraardhës e as trashëgimtar. Hegeli i jep shumë rëndësi sistematizimit, nga se konsideronte se filozofia pa sistem nuk mund të ketë në vete asgjë shkencore, objektive dhe të domosdoshme, me çka konsideronte se një mendim i tillë josistematik, pra i rastësishëm dhe subjektiv do të ishte joobligues, do të kishte karakter kalimtar, gjendjen e realitetit do ta paraqiste çfarë është në një moment të caktuar, për ne dhe për opinionin tonë e jo si është „*për vete dhe në vetvete*”.

Hegeli ka krijuar sistemin e tij monumental të idealizmit objektiv. Ai me metodën dialektike është shërbyer në mënyrë sovranë, ashtu që ai që dëshiron të shërbehet me këtë mjet të patejkalueshëm për hulumtimin shkencor duhet ta studiojë mirë veprën e tij. Ai niset nga absolutja që tek ai paraqet unitetin e shumësisë së momenteve të veta, që në të janë përmbajtur në gjendje të pazhvilluar. Absolutja është e papërcaktuar dhe paraqet idenë që është unike dhe në vete. Ajo medoemos të diferencohet, ta paraqesë shumësinë e përcaktimeve të saja duke i kaluar nëpër fazat e ndërlikuara të zhvillimit dialektik. Absolutja do të kalojë tri faza dialektike, e ato janë: ideja në vete, në të cilën është paraqitur zhvillimi parabolik i absolute; ideja jashtë vetes, ku ideja t'huajsohet prej vetvetes dhe idesë në vete dhe për vetvete ose shpirti, ku ideja kthehet ndaj vetvetes dhe bëhet e vetëdijshme për vetveten. Fazën e parë të zhvillimit të idesë e studion logjika, të dytën filozofia e natyrës dhe të tretën filozofia e shpirtit.

Logjika. Logjika e Hegelit paraqet zhvillimin e idesë absolute në mënyrë absolute, para natyrës dhe shpirtit njerëzor; ajo paraqet skeletin ideal edhe të natyrës edhe të shpirtit. Në mendjen njerëzore përputhen: të menduarit dhe qenia, e kjo përputhje (e të menduarit dhe qenies) përbën bazën e krejt sistemit hegelian, veçmas të logjikës. Prandaj, logjika nuk është vetëm shkencë për ligjet e të menduarit, por edhe për ligjet e qenies. Hegeli thotë: „*çdo gjë që është mendore është e njëmendët, ndërsa çdo gjë që është e njëmendët është mendore*”. Ky është botëkuptimi panlogjik (gr. *pan*-krejt, *logos*-mendje) i Hegelit, sipas të cilit të njohësh do të thotë të ndjekësh logjikën e vetë sendeve. Ajo që ngjet subjektivisht në procesin logjik të të menduarit, domosdo i përgjigjet gjithmonë procesit objektiv të sendeve në qenie. Me fjalë të tjera, përmbajtja dhe forma nuk mund të ndahen. Sipas tij, logjika nuk mund të jetë më shkencë për lidhjen e mendimeve dhe për rregullat e kësaj lidhjeje pa marrë parasysh përmbajtjen, siç vepronte dhe mendonte logjika tradicionale. Përkundrazi, logjika patjetër të jetë me përmbajtje, sepse format mendore janë çdoherë të mbushura me përmbajtje. Nga këtu, ligjet e logjikës janë njëkohësisht edhe ligjet e sendeve. Hegeli, pra, „*e hamendi në mënyrë gjeniale dialektikën e sendeve nëpërmjet dialektikës së idëve*”.

Me fjalë të tjera, një e njëjta mendje dominon edhe me qenien edhe me të menduarit; në ndjenjën e njeriut zbulohet struktura e vërtetë objektive e qenies. Prandaj, filozofia e Hegelit është idealizëm objektiv, përkatësisht idealizëm absolut, ngaqë mendja është absolute. Të menduarit racional është forma më e lartë edhe e vërteta e të njohurit të njëmendësisë, ndërsa tërë njëmendësia është sendërtim i mendjes.

Fazën e parë të zhvillimit të idesë absolute Hegeli na e paraqet në logjikë, ku çdo gjë fillon me nocionin më të zbrazët *qenien*. Për këtë mund të vërtetohet vetëm ekzistenca e zhveshur dhe asgjë më shumë. **Qenia** si e këtillë, në të vërtetë është **asgjë**. **Qenia dhe asgjëja, thotë ai**, janë identike, por njëkohësisht edhe të ndryshme, ngase **qenia nuk është asgjë, por diçka e caktuar**. Në këtë mënyrë te kundërthënia e qenies: **teza-antiteza**, prej të cilës kundërthënie rrugëdalje kërkohet në krijimin e **sintezës**. Ajo që është në procesin e të krijuarit është qenia dhe asgjëja, kalimi prej njëres në tjetrën; prej joqenies në qenie dhe anasjelltas. Hegeli do të thotë: „*askund, as në qiell e as në tokë nuk ka asgjë që në vetvete të mos përmbajë edhe njërën edhe tjetrën, qenien dhe mosqenien*“. Për të vazhduar, në botë çdo gjë është në proces: lindje dhe zhdukje.

Nga triada parësore zhvillohen tjerat: **sinteza e arritur**, bëhet **tezë për një triadë të nivelit më të lartë**, e pas saj do të paraqitet triada e re e nivelit edhe më të lartë. Në këtë mënyrë fitohen tërësi gjithnjë e më të ndërlikuara dialektike. Triada themelore në të cilën zërthehet ideja në vete, është **qenia - esenca - nocioni**. Në suaza të qenies triada e përfshirë është **kualitet - kuantitet - masë**. Domethënë, këtu zhvillohet doktrina për kalimin e kualitetit në kuantitet dhe anasjelltas, për masën si për thyerjen kufitare në të cilën ndryshimet kuantitative nuk e tejkalojnë kualitetin e caktuar, ndërsa, porsa kalohet masa e kuantitetit, jep kualitet të ri.

Në kërkesën për esencën e shkencës së logjikës, Hegeli e shtron analizën e thellë dialektike nëpërmjet kategorive. Ai kështu e shtron raportin e **dukurisë dhe esencës, tërësisë dhe pjesëve, formës dhe përmbajtjes si dhe tejkallimin e ligjeve të logjikës formale me ligjet e dialektikës**. Por kjo analizë nuk është gjithmonë e suksesshme, sepse ai ishte larg nga të kuptuarit bashkëkohor të logjikës formale. Nga esenca pastaj ai kalon në teorinë e tij për nocionin, si sintezë dialektike e qenies dhe esencës. Në këtë pjesë shqyrtohen format tradicionale të logjikës: **nocioni, gjykimi dhe konkludimi**, ku edhe mbàron zhvillimi i idesë në vete.

Filozofia e natyrës. Në filozofinë e natyrës, ideja në vete si nocion që më plotësisht i ka zhvilluar përcaktimet e veta, kalon në idenë jashtë vetes, pra bëhet e huaj për vetveten, **t'huajsohet në natyrë**. Këtë kalim të idesë në vete në ide jashtë vetes Hegeli e shikon si degradim të idesë që megjithatë është e pashmangshme për të ardhur te shkalla më e lartë e zhvillimit të saj. Për natyrën ai flet me nënçmim, ngase në natyrë ndryshimet zhvillohen në hapësirë dhe „*në atë asgjë s'ka pasur të re nën kupën qiellore, ngase nuk kishte kohë dhe zhvillim në kohë*“. Duke i kaluar fazat: **mekanizëm - kimizëm - organizëm**, do të thotë prapë triadë dialektike, me triadë të shumëllojta më të ulta, më në fund ideja e t'huajtuar i kthehet vetvetes, por tanimë ajo nuk është vetëm ide në vete, por edhe për vete. Ideja, pra, e cila ka ardhur te vetëdija për veten përkatësisht te vet-vetëdija. Këtë ide në vete dhe për vete Hegeli e quan edhe *shpirt*.

Filozofia e shpirtit. Në filozofinë e shpirtit Hegeli e prezntoi qëndrimin e tij pikënisës se të njohurit e **njëmendësisë** është i mundshëm në të menduarit e rëndomtë të njeriut. Ai, këtu vuri në pah se cilat shkallë duhet t'i kalojë vetëdija e rëndomtë, që të mund të ngritet në nivelin e refleksionit filozofik. Prandaj kjo „vetëdije historike“ paraqet zhvillimin e

domosdoshëm dialektik të të menduarit përmes nocionit duke filluar prej **vetëdijes objektive**, **nëpër ndërgjegje e deri te mendja**. Ai, këtu në tokë paraqet zhvillimin e historisë konkrete shoqërore të njerëzisë. Vetëdija individuale në rrugën e saj logjike shkon nëpër të njëjtën rrugë, por të shkurtër, nëpër të cilën kalon edhe vetëdija kolektive e njerëzisë në rrugën e saj historike. Në fenomenologjinë e shpirtit përfshihen këto shkallë të pohimeve filozofike hegeliane: *shpirti subjektiv, shpirti objektiv dhe fryma absolute*.

Shpirti subjektiv. Me idenë në vete edhe për vete të shpirtit, Hegeli nënkupton **jetën shpirtërore të njeriut**. Njeriu në ekzistimin e tij fizik merret si anë e jashtme e shpirtit dhe luan rol të pazëvendësueshëm, e sipas kësaj është i padenjë që të përmendet në filozofi. Shpirti nuk është vetëm ide në vete, pra ai jo vetëm që ekziston, por edhe është për vete, domethënë ai është i vetëdijshëm për ekzistimin e tij. Rruga e ndërlikuar nëpër të cilën kalon zhvillimi i shpirtit, gjithashtu zhvillohet në mënyrë triadike. Së pari shpirti është ai që vjen në shprehje te njeriu i veçantë, në vetëdijen individuale të tij - ky është *shpirti subjektiv*.

Mandej prej këtij si tezë, kalohet në **shpirtin objektiv** si antitezë, ku shpirti paraqitet si vetëdije kolektive e bashkësisë, edhe atë si: jurisprudencë, moral dhe histori botërore. Ai këtu paraqet filozofinë e drejtësisë, etikën dhe filozofinë e historisë. Në moralitet nënkuptohet përparimi i lirisë në familje, shoqërinë qytetare dhe shtetin. Në filozofinë e historisë Hegeli shqyrton forcat lëvizëse të historisë që e çojnë shoqërinë përpara dhe të përsoset. Me fjalë të tjera, filozofia e historisë e shqyrton zhvillimin e shoqërisë si proces ligjor, objektiv, i pavarur nga dëshira subjektive e njerëzore, nga synimet dhe qëllimet e tyre. Edhe këtu vjen në shprehje idealizmi objektiv i tij. Sipas Hegelit, **fuqia lëvizëse e historisë është shpirti botëror**, që paraqitet si shpirt popullor i bashkësive të caktuara, që duke i falenderuar paraqitjes së saj janë ngritur në nivelin e popujve historikë.

Në zhvillimin historik rol qenësor luan përparimi i vetëdijes për lirinë e njerëzve. Historia fillon me **popujt e lindjes**, të cilët krijuan perandori që shpejt u rrënuan. Në dhesportitë e Lindjes një person është i lirë, përkundër të gjithë të tjerëve që janë të nënshtruar. Mandej në skenën historike paraqiten Greqia dhe Roma, ku më tepër njerëz janë të lirë, dhe së fundi paraqitet bota krishtere evropiane, në të cilën paraqitet vetëdija se të gjithë njerëzit janë të lirë. Në suaza të kësaj teorie të procesit historik Hegeli konstaton se edhe parakushtet materiale luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin shoqërorë. Ai, thotë: „*dinakria e mendjes*” i shfrytëzon pasionet dhe interesat e njerëzve për qëllimet e tyre.

Shpirti objektiv. Ideja absolute, pasi që ka kaluar fazën e saj abstrakte të zhvillimit në logjikë si dhe pasi është t’huajsuar në natyrë, përfundimisht i kthehet vetvetes. Në këtë shkallë të zhvillimit të idesë absolute zhduken të gjitha ndryshimet ndërmjet asaj që është shqisore dhe asaj që është racionale, të së jashtmes dhe të së brendshmes, të asaj që është teorike dhe të asaj që është praktike, ngase shpirti në objektet e botës së jashtme e zbulon vetëveten, ashtu që ajo tashmë e paraqet lirinë e plotë dhe të vërtetën absolute. Shpirti absolut paraqitet si perceptcion, pasqyrim dhe nocion. Në realitet, Hegeli këtu shqyrton estetikën, filozofinë e religjionit dhe historinë e filozofisë.

Filozofia e artit paraqet zhvillimin historik të artit dhe me anë të tij i shpjegon të gjitha drejtimet, format dhe stilet e krijimtarisë artistike. Sipas Hegelit, të bukurit artistik apo ideali, është **dukuria shqisore e idesë**: në veprën artistike forma shqisore dhe përmbajtja shpirtërore përbëjnë një unitet të përsosur. Fazat themelore të zhvillimit të artit janë: arti oriental-simboli, në të ideja mezi merret me mend, sepse forma nuk arrin ta përvetësojë përmbajtjen; arti helen-klasik, në të gërshetohen në mënyrë më intime forma dhe përmbajtja, ideja dhe dukuria, dhe unitetin e këtyre të dyjave e paraqet **arti romantik** i popujve krishtero-gjerman, në të cilin forma dhe subjekti e përvetësojnë objektivitetin dhe përmbajtjen. Me këtë Hegeli, arriti të jepë sintezën e krejt filozofisë së deriatëhershme për artin dhe të bukurën. Së këndejmi veprimtaria artistike e njeriut, është vetëm formë specifike e veprimtarisë shoqërore me anë të së cilës njeriu e pëvetëson natyrën dhe e sendërton esencën e vet njerëzore.

Forma tjetër e shpirtit absolut është religjioni, në të cilin të njohurit e idesë absolute është dhënë në **formë të përfytyrimit**. Vetë rangimi i religjionit si formë më **autentike** e shfaqjes së idesë absolute prej asaj filozofike tregon mjaft. Ai ka vërtetuar se dogmat e krishterizmit si forma më e lartë e religjionit janë gjithashtu të vërteta, si dhe të vërtetat e filozofisë, vetëm se ato janë në formë të përfytyrimeve. Hegeli atyre dogmave u jep domethënie simbolike dhe i shpjegon filozofikisht. Sipas tij, Zoti është aspekt ideor i botës, por njëkohësisht identik me atë; bota paraqet vetëm formën e tij konkrete. Zoti nuk është qenie e veçantë, por ana ideore e botës, e cila duke u vetërealizuar, vjen te vetëdija për vetveten në njeriun.

Shpirti absolut. Shpirti absolut **e njeh vetveten** përfundimisht në filozofi. Kjo vetëdije e plotë e shpirtit absolut është dhënë në mendime - nocion. Sikurse esencën e artit dhe të religjionit që e kërkon në zhvillimin historik të tyre, poashtu edhe filozofinë e ka shqyrtuar historikisht. Hegeli vë në dukje jo vetëm faktin se si sistemet filozofike vijnë njëri pas tjetrit, **por sprovon ta kuptojë mënyrën se si dalin njëri prej tjetrit**. Radhitja historike dhe logjike e nocioneve filozofike i përgjigjen njëra tjetrës, ashtu që sistemi i fundit filozofik - e ky sipas tij është sistemi i tij filozofik - i përmban në vete të gjitha ato momente që kanë qenë të vërteta në sistemet e mëparshme filozofike, prandaj edhe paraqet të vërtetën e plotë. Por, tendenca e tij, që të ndërtojë një sistem filozofik të mbyllur e çoi deri te mohimi i zhvillimit të mëtejshëm të filozofisë. Më mirëpo, përpara metodës së tij dialektike, asgjë nuk është definitive dhe e përsosur. Prandaj, kjo kundërthënie themelore në filozofinë e tij ishte qenësore në mes sistemit të tij dhe metodës dialektike dhe paraqet - sërish në mënyrë dialektike - kushtin për zhvillimin e mëtutjeshëm të filozofisë.

Për në fund. Ernes Bllahu do të thotë: „Hegeli e mohoi ardhmërinë, por asnjëherë ardhmëria nuk do ta mohojë Hegelin”. Karakteristikat themelore të filozofisë së tij janë: panlogjizmi, uniteti i sistemit, enciklopedishmëria dhe metoda dialektike - momenti heraklitian, ideja e historishmërisë dhe fuqia e të menduarit mohues. Ndërsa kategoria e tij e l'huajsimit bëhet gati një nga nocionet themelore të filozofisë së mëvonshme.

Të menduarit dialektik është mohim i të dhënës së drejtpërdrejtë. Kthesa konceptuale si dialogje të frymës me vetveten i përgjigjen të menduarit dialektik, të së vërtetës mendore të botës. Në panlogjizmin hegelian nuk ka vend të vërtetë rezistenca, pengesa, vështirësitë reale.

Sistemi filozofik i Hegelit është i plotë, i mbaruar dhe përfundimtar. Kjo është prirja e tij, ndaj sistematizimit dhe *dhuna* e mundshme mbi faktet.

Racionalizmi e tejthekson sferën racionale dhe për të mirën e tërësisë e sistematicitetit e lë pasdore komponentën e vullnetit, intuitën, e *aktivën* dhe përgjithësisht atë iracionale në jetën e njeriut. Synimi është tërësia, ndërsa të veçantat janë vetëm mjete në shërbim të „shkathësisë së mendjes” të historisë botërore. Në ligjëshmërinë gjithëpërfshirëse të botës dhe domosdoshmërisë së ndodhive historike humbet individi si individua me përjetimet e veta karakteristike dhe të papërsëritshme të botës, përvojën jetësore dhe fatin jetësor, me synimet dhe vështirësitë e tij, interesat dhe pasionet, vuajtjet dhe shpresat. Gjithë përvoja historike e zhvillimit të filozofisë pas Hegelit në shekullin XVIII dhe XIX pa mëdyshje tregon se është e paqëndrueshme lënia e tillë pasdore e sferës intime dhe iracionale të jetës.

5.2. VOLUNTARIZMI

Voluntarizmi është pikëpamja sipas së cilës vullneti është parësor dhe si i tillë mbizotëron në të gjitha sferat: në të qenët, në të njohurit, në të vlerësuarit e botës, në të besuarit dhe në të vepruarit e njeriut e shoqërisë. Voluntarizmi e absolutizon dhe e hipostozon vullnetin si qenie apo-sferë e parë dhe vepruese. Çdo gjë në natyrë, shoqëri dhe jetën shpirtërore është e determinuar në bazë të vullnetit dhe ajo është shfaqje e caktuar e tij.

Voluntarizmi është pikëpamje e kundërt me racionalizmin, intelektualizmin dhe sentimentalizmin. Duke e absolutizuar vullnetin, dashjen e dëshirën voluntarizmi shpie në përfundim të gabuar se në natyrë, në jetën shoqërore dhe shpirtërore nuk ekzistojnë kurrëfarë ligjshmëri tjera, përveç ligjshmërive të vullnetit. Themelues i voluntarizmit është Artur Shopenhaueri, filozofia e të cilit në esencë është doktrinë për vullnetin.

5.2.1. Artur Shopenhauer (1788-1860)

Artur Shopenhaueri shkencat natyrore dhe filozofinë i studioi në Gtingen dhe në Berlin, kurse në vitin 1813 u promovua në Jenë me tezën e doktoraturës „*Mbi rrënjën e katërfisht të parimit të shkakut të mjaftueshëm*”. Në vitin 1820 emërohet docent privat në Berlin, mirëpo i penguar për të përparuar më tej në universitet, shpërngulet në Frankfurt, ku mbetet mësues privat deri në fund të jetës.

Duke e kundërshtuar zhvillimin postkantian të filozofisë gjermane Shopenhaueri sulmon me temperament vazhduesit e Kantit, të cilët e „shtrembëruan doktrinën e filozofit të madh nga Kenigsbergu”. Ai e sulmon sidomos Hegelin „sharllatanin e neveritshëm”, e autorin e „filozofisë së pakuptueshme vishi-vashi”, mësimi i të cilit „tash plot 20 vjet paraqet fjalën e fundit të filozofisë së katedrave”, e na kujton „llomotitjen në çmendiri”. Shopenhaueri përpiqet ta kthejë filozofinë në „problemet burimore”, të cilat i inauguroi Kanti dhe me voluntarizmin specifik synoi ta zgjidhë enigmën e „sendit në vete”. Ai do të thotë, në fillim të kryeveprës së tij, „*Bota si vullnet dhe përfytyrim*”: „Bota është përfytyrim

i im, asnjë e vërtetë tjetër nuk është aq e sigurtë dhe e pamohueshme", duke e parashtruar kështu qartë, në themelin e filozofisë së tij, tezën e vjetër subjektive idealiste të filozofisë. Bota ndërkaq, nuk është fikcion i thjeshtë, ngase lidhja reciproke e përfytyrimeve sipas ligjit të kauzalitetit e **ndan jetën nga ëndrra e iluzioni**, ndërsa themeli i përbashkët i rendit të përfytyrimeve është parimi i shkakut. Pra, Shopenhaueri **pranon vetëm shkakun i cili vlen vetëm për përfytyrimet, e jo edhe për nocionet**, siç mendonte Kanti. Ai, shkakun e lidh me hapësirën, si një pranë tjetrit dhe kohën, si një pas tjetrit. Bile ai do të thotë, „parimi i shkakut është ligji më i rëndësishëm i forcës sonë të njohjes dhe i objektivitetit". Sipas Shopenhauerit, bota është e përfytyrueshme vetëm prej jashta. Të arrihet te brendësia e botës, te „sendi në vete", nuk është e mjaftueshëm vetëm përfytyrimi, **por është i nevojshëm edhe vullneti**. Ndërmjet vullnetit si akt njerëzor dhe vullnetit si vepër i trurit nuk ekziston dallim. Ai është një i njëjtë, njëherë i shqyrtuar nga shqisa e brendshme, ndërsa herën tjetër nga jashtë.

Vullneti është ajo qenësorja te njeriu, ajo që te njeriu është „sendi në vete", ndërsa së këndejmi vullneti është „esenca" e „botës në vete". Vullneti është baza e çdo gjëje që paraqitet, ai çdo gjë e përshkon dhe në çdo gjë derdhet: në natyrë jo të gjallë, në botën e gjallë dhe te njeriu. Nga këtu, vullneti që në asgjë nuk mbështetet, vullneti i verbër për jetë thërmohet në një varg „objektivizimash" nga të cilat secila synon të sundojë, prandaj e kemi „luftën e të gjithëve kundër të gjithëve" e cila është e pandërprerë. Mirëpo, objektivizmat e vullnetit ekzistojnë edhe si tërësi e radhitur në mënyrë hierarkike e që pasqyrojnë hierarkinë e ideve, të kuptuar në mënyrë platoniane. Shprehja më e plotë e vullnetit fiton në njeriun. Dallimi i vullneteve mbështetet në dallimin e vetëdijes. Njeriu dallohet me shprehjen më të lartë të vetëdijes - mendjen. Vullneti i pamotivuar, i mposhtur, i pakundërshtueshëm, ai është instikt i verbër, synim i cili përbirohet nëpër të gjitha pengesat për të ardhur në shprehje. Së këndejmi edhe egoizmi i pakufizuar i njeriut, i cili duke e njohur vetveten me krejt vullnetin e tij për jetë, ndërsa duke i pasur parasysh edhe individuat e tjerë si përfytyrime të veta, me asgjë nuk mund ta pengojë egoizmin e vet, por gjithashtu, atë nuk mund ta bëjë as shteti. Prandaj, të mposhturit e egoizmit deri diku është i mundur vetëm në lëmin e moralit dhe artit.

Në këtë botë të vuajtjeve, në këtë botë të pakënaqësisë së përhershme e vetmja detyrë e menduar e artit është të bëhet ngushëllues, të bëhet „paliativ" i dhembjes botërore, të na lirojë nga shkaqet e të gjitha të këqijave dhe mendimeve, të na lirojë nga vullneti. Në gjendjen e lumtur të kontemplacionit artistik njeriu harron vetveten, „*vullneti hesht dhe me këtë zhduk individualitetin dhe të gjitha mundësitë e dhembjes*". Njeriu bëhet diç që nuk është, dhe në këtë harresë ideale ideja artistike e tejkalon mjerimin e përditshëm. E bukur është çdo gjë që shpreh idenë, kurse arti më shumë se çdo gjë tjetër e „*ndan idenë nga elementet e rastësishme të realitetit*". Arti është vepër e gjeniut, përsërit idetë e amshumeshme që kuptohen nëpërmjet kontemplacionit të pastër, dhe kjo është ajo e qenësishmja e të gjitha fenomeneve të botës. Në këtë shpëtim të njeriut në njeri, vend të lartë sidomos zë muzika, ngase ajo nuk është si artet tjera, vetëm pasqyrimi i idesë, për më tepër ajo është pasqyrim i vetë vullnetit, objektivacioni i drejtëpërdrejtë i saj.

Në etikë Shopenhaueri nga supozimet e tij themelore nxjerr përfundimin tejet pesimist. E keqja është tejet qenësore për njeriun. Vuajtja e vazhdueshme e përcjell atë. Sa më shumë

jemi të dijshtëm e të vetëdijshtëm aq më shumë vuajmë ose sa më shumë dijmë aq më shumë pësojmë. Në fund, gjashtë ditë kemi mjerim, të shtatën mërzi. Dhe kjo botë është më e keqja nga të gjitha botët e mundshme dhe sikur të ishte edhe vetëm pak më e keqe, nuk do të mund të ekzistonte fare. Ndërkaq, edhe kënaqësia është dhembje, por më pak e shprehur. Njeriu është bile edhe më i keq se kafsha, e për Shopenhauerin madje ofendim është që të quhemi njeri. Andaj ai do të porositë heqjen dorë nga vullneti për jetë. Vetëm njohja e tërësisë dhe thelbit të gjërave e qetëson vullnetin dhe të shpie në askezë, në mposhtjen e instikteve egoiste dhe të shpëton në „hiçin relativ” - nirvanen budiste. Me fjalë të tjera, Shopenhaueri përfundon në abstenim prej jetës duke mos lënë pasardhës.

Shopenhaueri është mendimtar me një stil të shkëlqyeshëm i cili përvetësoi një numër të madh lexuesish, madje pothuajse u bë edhe modern. Me tezat e tij ndikoi në kulturën e shekullit njëzet, veçmas në Vagnerin etj, ndërsa me voluntarizmin dhe iracionalizmin e tij edhe në zhvillimin e filozofisë së shekullit nëntëmbëdhjetë dhe njëzet.

5.3. POZITIVIZMI

5.3.1. Ogis Konti (1798-1857)

Ogis Konti është filozof, sociolog dhe matematikan francez. Ligjëroi mekanikën dhe matematikën në Shkollën politeknike të Parisit, mirëpo për shkak të sulmit kundër akademikëve, të cilët, sipas tij bënë „një politikë shkencore të turpshme” dhe botimit të „Kursit të filozofisë pozitive” (1830-1842) humbi vendin e punës. Gjatë jetës shpesh nuk kishte kurrëfarë të ardhurash dhe e siguronte ekzistencën në saje të ndihmës që i jepnin ithëtarët e tij.

Në përgjithësi, Konti konsiderohet themelues i pozitivizmit. Me moton e njohur „*Savoir pour prévoir, prévoir pour prevenir*” (të dish të parashikosh, të dish të qeverisësh), Konti u përpoq të themelonte shkencën pozitive të tij, me të cilën u kundërvijë të gjitha spekulimeve idealiste dhe metafizike. Objekt i njohjes së vërtetë mund të jenë vetëm faktet, ajo që është e dhënë, që është pozitive. Mund të njihen jo vetëm raportet ndërmjet fenomeneve, por edhe thelbi i tyre, ndërsa objekt i njohjes nuk mund të jetë as çështja mbi shkaqet e para e as ajo mbi qëllimet e fundit. Por për parashikimin e fenomeneve të ardhshme, sipas tij, nuk është e nevojshme asgjë tjetër përveç njohjes së raporteve, domethënë të ligjeve, ndërmjet vetë fenomeneve. Andaj edhe është e mjaftueshme dituria për të parashikuar ardhmërinë. Çdo gjë tjetër përveç njohjes së fakteve, çdo spekulim teologjik ose filozofik hidhet poshtë radikalisht. Kjo shkallë **pozitive e shkencës është shkalla e tretë më e lartë**, koha e pjekurisë së shkencës, në të cilën gjithçka zbulohet nëpërmjet vëzhgimit dhe eksperimentit.

Para kësaj shkalle ekzistojnë dy më të ulëta: teologjike dhe metafizike. Shkalla e fëmijërisë së diturisë, shkalla e saj teologjike, të gjitha fenomenet i shpjegon me anën e qenieve hyjnore kulminante. **Shkalla metafizike** që identifikohet me rininë, i ka zëvendësuar qeniet hyjnore me nocionet, siç janë nocionet e natyrës, të forcës jetësore e tjera, dhe pastaj këto

nocione kuptohen si thelb i vetë gjërave. Në shkallën metafizike, e cila në themel është vetëm një modifikim i zakonshëm i së parës, forcat mbinatyrore zëvendësohen nga forcat abstrakte. Ligji i tri shkallëve, ndërkaq nuk e përjashton as faktin se në fusha të caktuara të diturisë ekzistojnë në të njëjtën kohë tri shkallët. **Konti lidhur me këtë bile as nuk e mohon tezën se religjioni dhe spekulimet metafizike medoemos kanë kontributin e tyre për zhvillimin e njerëzimit; këto kanë ndërtuar shkallët mbi të cilat ngrihet tempulli i diturisë së sotme.** Mirëpo për shkak të falenderimit që u shprehim si forca historike nuk mund të nxirren obligimet shpirtërore për të sotmen. **Pozitivizmi** përpiqet të shpjegojë përse kohët që kaluan me shpejtësi të madhe, u detyruan të mendojnë ashtu siç vepruan. Duke i klasifikuar shkencat, Konti caktoi gjashtë fusha themelore: matematikën, astronominë, fizikën, kiminë, biologjinë dhe sociologjinë.

Shumë autorë konsiderojnë se Konti është themelues i sociologjisë bashkëkohore. Sociologjia sipas tij, ende nuk është në shkallën e tretë pozitive të zhvillimit, mirëpo detyra themelore e shkencës bashkëkohore është që ta shpjerë matanë spekulimeve metafizike, në studimin pozitiv të fakteve. Përparimi i shoqërisë, sipas Kontit, është evolucioni, brenda të cilit në realitet nuk ka transformime të qenësishme revolucionare, kurse të gjitha fenomenet duhet studiuar sipas „koekzistencës dhe suksesionit” të tyre, nëpërmjet krahasimit empirik, duke mos hulumtuar disa shkaqe esenciale të cilat i krijojnë dhe i mundësojnë këto ndryshime. Të gjitha fenomenet politike dhe ekonomike mund të kenë ndikim të njëmend në përparimin e shoqërisë në qoftë se me këto nuk lidhet edhe transformimi moral i individit. Në këtë drejtim Konti konsideron se **një nga detyrat e politikës së vërtetë është që egoizmin ta zëvendësojë me altruizëm.** Konti e redukton psikologjinë në realitetin në biologji dhe sociologji.

Edhe vetë filozofia si filozofi është absurditet, – thotë Konti. Ajo mund të jetë vetëm sistem ose unitet i disa shkencave, të cilat bazohen në unitetin e metodës shkencore. Prandaj, meqë ekziston një metodë unike me të gjitha shkencat, e ajo metoda sociologjike që është identike me ato natyrore-shkencore. Sociologjia ndahet në statike, sociale dhe në dinamike. E para studion varësinë reciproke të fenomeneve sociale, harmoninë dhe ekuilibrin e tyre, ndërsa e dyta ligjet e zhvillimit dhe të përparimit të tyre. Përkundra pushtetit kishtar, i cili u përgjigjet shkallëve të mëparshme të zhvillimit të shoqërisë, Konti kërkon që në shoqëritë bashkëkohore, industriale pushteti t’u jepet filozofëve pozitivistë, sepse ai atëherë do të ishte i mbrojtur nga kualitetet morale dhe shkencore të bartësve të tyre, e me këtë autoritative për të gjithë qytetarët.

Nga perceptimet e jashtme ne krijojmë të njohurit tonë të njeriut, kurse nga ndjenjat krijojmë moralitet, por gjithmonë me pjesëmarrjen e intelegjencës. Të moralshmen është e drejta ta quajmë të lindur si dhe produkt të zhvillimit. Ne që nga fillimi jemi qenie morale, mirëpo njeri të moralshëm duhet ta bëjmë edhe veten; prirje morale kanë edhe kafshët, mirëpo moraliteti është vepër e njeriut dhe e historisë. Edhe **arti për Kontin është fakt ose kontekst i fakteve** dhe si i tillë, i barabartë me veprimtaritë tjera njerëzore që janë të varura, para së gjithash, nga situata e përgjithshme shoqërore. Arti ndihmon edhe si mjet për krijimin e shoqërisë së përsosur, ndërsa aftësia e tij gjendet ndërmjet aftësive intelektuale dhe morale dhe kështu mund të ndihmojnë në shndërrimin e njohjes në veprimtari. Ndërkaq, përgjithësisht studimi i artit kërkon gjithashtu objektivitet dhe arsyetim të qetë, çfarë e kërkon për shembull astronomia.

Nga fundi i jetës, si duket edhe nën ndikimin e disa krizave personale, Konti bëhet ithëtar i një religjioni „sentimental” pa përëndinë, në të cilin arsyeja duhet t’i nënshtrohet zemrës. Religjioni i „qenies së madhe” të madhërishtme është një religjion i një humaniteti të tillë i cili për priftërinjtë emëron filozofët, për dogma të vërtetat shkencore, kurse për vlera themelore dashurinë, rendin dhe përparimin.

I gjithë pozicioni filozofik pozitivist i Kontit, i cili dëshiron të zhdukë çdo metafizikë, vuan, de facto (në të vërtetë), nga horizonti metafizik veti i tij: nga idhujtaria e fakteve, që do të thotë vetëm pajtim „pozitiv” me ekzistuesen dhe që në vend të spekulimit metafizik tradicional fut një mistikë të re të scientizimit dhe një „katekizëm me papë të ri dhe me stërgjyshër të rinj në vend të të vjetërve”. Pavarësisht nga meritat e padyshimta të Ogis Kontit, sidomos lidhur me sprovimet shkencore të themelimit të sociologjisë si shkencë, kufizimi themelor i tij qëndron në faktin që nuk i ka parasysh ato primesa mbi të cilat themelohet krejt ndërtesa pozitiviste e tij, dhe të cilën pikërisht për këtë shkak edhe nuk e merr parasysh, sepse kjo nuk do të ishte në përputhje me orientimin „pozitivist” kah faktet dhe me mospërfshirjen e përgjithshme të çdo spekulimi filozofik.

5.4. EKONOMIA LIBERALISTE

5.4.1. Adam Smiti (1721-1790)

Filozofia e liberalizmit është shprehje ideore e interesave dhe synimeve të borgjezisë kundër ideologjisë dhe ineteresave të klerit dhe feudalëve konservatorë. Derisa religjioni, që ishte shtylla ideologjike e feudalizmit dhe obskurantizmit të tij, mbështetej në „bulesën”, në karakterin kinse hyjnor të shtetit etj, liberalizmi si botëkuptim insistonte në arsyen, mendjen, individualizmin, lirinë dhe të drejtën e njeriut që si i barabartë me të tjerët të veprojë sipas mendjes dhe interesave të veta. Sa i përket fesë liberalizmi mbështetej mbi pikëpamjet e reformationit përkundër katolicizmit, mbi bindjen e lirë përkundër ortodoksisë. Çdo fe, sipas liberalizmit, është e barabartë me të tjerat dhe e lirë: asnjë fe nuk mund të ketë përparësi ndaj fesë tjetër. Liberalizmi insistonte në lirinë e individit që ta zgjedhë ose fare mos ta zgjedhë ndonjë religjion, në tolerancën fetare etj. Shteti dhe shkenca nuk duhet të jenë të varura prej fesë.

Në fushën e politikës, liberalizmi e madhëronte rendin qytetar si një rend natyror, përkatësisht rend që i përgjigjet natyrës dhe arsyes së njeriut. Shteti duhet t’i kufizojë sa më pak nismat, të drejtat, mendimet, interesat e njerëzve. Ai duhet të garantojë dhe të mbrojë të drejtën e pronës, të bindjeve politike e fetare, të fjalës dhe të mendimit e të tubimit të lirë etj.

Adam Smiti është ekonomist dhe përfaqësues më i dalluar i ekonomisë politike angleze të shekullit XVIII. Ishte profesor i logjikës dhe etikës në Glosan. Së bashku me David Rikardon është themelues i ekonomisë politike moderne. Në kryeveprën e tij etike „*Teoria e ndjenjave morale*” përshkruan fenomenin e moralit duke u përpjekur të ngelë në suazë „të fakteve reale”. Refuzon teorinë egoiste duke konsideruar se mëshira, që e ndjejnë te fatëkeqësitë e njerëzve të tjerë, na përfshin aq shumë sa që fatëkeqësinë e përjetojmë sikur të na kishte ndodhur neve. Vlera e një ndjenje mund të caktohet vetëm në bazë të veprimit që del nga kjo, ndërsa qëllimi themelor i tërë krijimtarisë pozitive është lumturia e njeriut. Në këtë vështrim Smiti konsideron se duhet vënë në harmoni pikëpamjet e të ashtuquajturës *përshtatshmëri*; domethënë të pajtimit me gjendjen faktike të përvojës morale, dhe dobia sikurse edhe mendja dhe ndjenjat. Por Smitit i duket e pamundshme se miratimi moral mund të jetë ndonjë e të njëjtit lloj si ajo me të cilën e vëzhgojmë godinën e ndërtuar mirë.

Gjykimin moral, pra nuk mund ta udhëheqë dobia ose dëmi, suksesi ose mospërshtatshmëria, por përshtatshmëria ose mospërshtatshmëria e ndjenjave tona me ndjenjat e atij që vepron ose vuan në mënyrë të caktuar. Simpatia njëmend është rrënjësore në natyrën e njeriut, por përveç kësaj edhe hakmarrja, si veprim kundër krimit të bërë është, gjithashtu, një nga bazat më të rëndësishme shpirtërore të jetës morale.

Adam Smiti në veprën e tij „*Hulumtimi i natyrës dhe i shkakut të pasurisë së popullit*” (1776) i vuri bazat e atij drejtimi në ekonominë politike i cili është i njohur me emrin „shkolla klasike”. Si ideolog i borgjezisë argumenton se zhvillimi i lirë i borgjezë është garancia më e mirë për sendërtimin e interesave të të gjithë anëtarëve të shoqërisë. Duke studiuar format dhe ligjet e prodhimit e të këmbimit borgjez, ekonomistët qytetarë erdhën deri te ligjet e formës, historikisht të caktuara të veprimtarisë ekonomike, duke i formuluar ligjet natyrore të shoqërisë, që i përgjigjen natyrës së njeriut. Smiti mendonte se mënyra e prodhimit borgjez, këmbimit dhe shpërndarjes është forma që më në fund u gjet, e jetës ekonomike të njerëzve. Ai u nis prej përfundimeve të verifikuara shkencërisht, të ekonomisë politike klasike, veçanërisht prej të ashtuquajturës teorie pagesës së vlerës së punës. Në të vërtetë, Smiti vërteton se puna ishte i vetmi burim i pasurisë, përkatësisht se vlera e ndonjë malli caktohet me sasinë e punës së nevojshme për prodhimin e tij. Supozohej se puna paguhet sipas vlerës së saj të plotë, domethënë se punëtori në formë të pagesë e merr kundërvlerën e plotë të punës së tij, ndërsa profiti krijohet si rezultat i formave ekzistuese të mënyrës borgjeze të prodhimit dhe këmbimit.

Adam Smiti ishte kundër ndërhyrjes së shtetit në çështjet ekonomike. Motoja e liberalizmit ekonomik ishte „*laissez faire, laissez passer*” - lëre të bëhet, lëre të ngjajë ajo që ngjan. Çështja e asortimentit, e mënyrës së prodhimit, e sasisë së mallit të prodhuar, të distribuimit, të çmimeve duhet të jetë jo e shtetit, por e individit. Interesat e njerëzve veprojnë në pajtim me ligjshmëritë shoqërore dhe janë të pagabueshëm sikurse ligjet e natyrës. Në mes interesave të individit dhe interesave të shoqërisë ekziston një harmoni e prestabilizuar dhe ato nuk mund të vijnë në konflikt njëri me tjetrin.

5.5. LIBERALIZMI

5.5.1. Xhon Stjuart Mill (1806-1873)

Xhon Stjuart Mill është filozof dhe ekonomist anglez. Është bir i Xhemsit. Ishte edhe anëtarë i Dhomës së ulët të parlamentit Britanik. Si ekonomist, Milli është qytetar liberal dhe eklektik që dëshiron kompromis me punëtorët me qëllim të ruajtjes së mënyrës borgjeze të prodhimit.

Në bazë të parimit të psikologjisë asociative realizoi analizën e njohjes, sidomos të veprimit induktiv. Sipas Millit, konkluzioni nuk zhvillohet përtej të përgjithshmes nga e veçanta, prandaj ai mohoi vlerën e konkludimit deduktiv, i cili, sipas tij, ose mbështetet në gabimin „*petitio principii*” – *parimi gjurmues*, ose është tautologji e zakonshme. Ky veprim, konsideron ai, nuk e zgjeron assesi njohjen tonë, sepse edhe vetë vlefshmëria e premisë së përgjithshme, që më parë supozon vlershmërinë e konkluzionit. Kështu në silogjizmin e njohur „*Të gjithë njerëzit janë të vdekshëm, Sokrati është njeri, Sokrati është i vdekshëm*”, premisa e parë dhe e dytë mund të jenë të sakta vetëm atëherë nëse që më parë dimë se konkluzioni është i vërtetë. Prandaj veprimi deduktiv silogjistik është „*cirkulus*” - qarkullimi, më i rëndomtë.

Duke konsideruar induksionin si të vetmin veprim të saktë, pohoi se në natyrë ekziston njëlloj, e cila mund të sigurojë se ajo që ka ndodhur në të kaluarën dhe në të sotmen do të ndodhë gjithashtu edhe në të ardhmen. Për Millin edhe qëndrimet matematike janë të përgjithshme nga përvoja, ndërsa problematiken logjike e shpjegoi pikërisht në mënyrë psikologjike. Duke i kushtuar kujdes të veçantë induksionit, vëretoi katër lloje të metodës induktive, përkatësisht të konkludimit induktiv: metoda e përputhjes, metoda e ndryshimit, metoda e variacioneve paralele dhe metoda e mbetjes.

Me pikëpamjet etike Milli është i afërt, sidomos në fillim, me utilitarizmin e Xheremi Bentamit (1748-1832) dhe në këtë fushë kishte ndikim të jashtëzakonshëm. **Kënaqësia** është e vetmja gjë e dëshirueshme, dhe nëse një njeri pa kushte shkon drejt kënaqësive të veta, atëherë nuk ka kurrëfarë kuptimi t'i flitet se ai duhet të bëjë diçka tjetër. Njëkohësisht, Milli ishte i bindur se çështjet vërtet të mëdha, jetike të së kaluarës etike, gjenden në fushën shoqërore dhe se normat edhe vlerësimit nuk mund të zhvillohen vetëm nga individ. Ai mohon premisat e shkollës etike inventive, kurse parimi i lumturisë, të jesh sa më i lirë nga dhembja dhe sa më i pasur në gëzime, është mendimi drejtues i përcaktimit të tij të vlerës. **Moraliteti, pra, është grumbull normash të sjelljes njerëzore me plotësimin e së cilës do të mund të realizohet ndjenja e lumturisë në dimensionin më të gjerë.**

Demokracia është forma më e mirë e qeverisjes, mendon Milli. Në esenë e tij „*Për lirinë*”, ai shkroi për disa rreziqe të trashëguara nga forma demokratike e qeverisjes. Ai paralajmëronte se vullneti i popullit shumë shpesh është vullnet i shumicës, dhe kjo bën plotësisht të mundur që shumica ta shtypë pakicën. Përveç kësaj, në demokraci ekziston tirania e opinioneve, një rezik po aq i madh sa edhe shtypja. **Bile edhe në demokraci është e nevojshme të vendosen roje kundër forcave që duan t'ua mohojnë njerëzve lirinë e**

tyre duke vendosur kufizime në veprimet e qeverisë. Milli mbrojti të drejtën që të ndërhyjë në lirinë e veprimit të kujtdo tjetër, nëse është në vetëmbrojtje. Si i vetmi qëllim, për të cilin fuqia mund të ushtrohet në mënyrë të drejtë mbi çdo shtetas të një komuniteti të qytetaruar, kundër dëshirës së tij, është ta parandalojë dëmin që ai ua sjell të tjerëve. Por asnjë qeveri nuk është mirë të ndërhyjë mbi subjektet e veta: kur veprimet mund të kryhen më mirë nga personat privat; kur megjithëse qeveria mund të kryejë veprimet më mirë se sa individit privat, është e dëshirueshme nga individët ta bëjë atë për zhvillimin dhe arsimimin e tyre; kur ka rrezik të ushtrohet forcë e tepërt e panevojshme nga qeveria. Argumentimi i Millit për lirinë ishte më tej një argument për individualizmin. Ai kishte një pakënaqësi të thellë për shtetin totalitar, edhe përkundër asaj se shumë herë e pa shfaqjen e tij të vështirë.

Ndodh shpesh që në emër të së mirës, – mendonte Milli, – shteti lëviz në zonat e lirisë së njeriut. Ajo, që ai tha për lirinë, pati një shprehje të veçantë në shekullin XX, e cila ka për dëshmi shkëlqen, që qeveria bëri mbi veprimet dhe mendimet e njerëzve kudo në botë.

5.6. KRITIKA SOCIALE

Gjatë shekujve XVI dhe XVII u paraqitën shumë vepra, subjekti i të cilave ishte utopia (greqisht *u-jo* dhe *topos*-vend) ajo që nuk ekziston, ajo që nuk gjendet askundi si „Utopia” e Tomas Morit, „Atlantida e re” e Frensis Bekonit, „Qyteti i Diellit” i Tomazo Kampanjellës. Edhe gjatë shekujve XVIII dhe XIX shumë autorë u paraqitën me veprat e tyre, temë themelore e të cilave ishte utopia, si Haringtoni me veprën „Komonvellti i Oqeanisë”, Etien Kabe me „Rruga për në Ikari”, Viliem Moris me „Lajme nga askundi” etj. Utopia është një fenomen i gjithëmbarshtëm njerëzor dhe bërë sipas Bllohut edhe „humanizmi ka lëshuar shtat brendapërbrenda utopisë”. Në anën tjetër edhe socializmi si një rend shoqëror, i mbështetur në barazinë e njerëzve, u paraqit në veprat e socializmit utopist si të Tomas Morit, Sharl Furies, Robert Ovenit, Etjen Kabes etj.

5.6.1. Anri Klod de Sen Simon (1760-1825)

Është teoriciet francez i shoqërisë. Mori pjesë në luftën çlirimtare në Amerikë. Në kohën e revolucionit francez hoqi dorë nga titulli aristokrat. Sikurse edhe disa utopistë tjerë, në eksperimentet e ndryshme edhe në punët ekonomike ngeli pa pasuri, kështu që nga fundi i jetës e mbanin miqtë. Së bashku me Sharl Furien dhe Robert Ovenin është një nga utopistët socialist më të mëdhenj.

Ideja themelore e Sen Simonit është që shoqëria do të duhej të çlirohej nga shtresat joproduktive, nga parazitët dhe nga djeranët - ushtarët, aristokratët, burokratët, që shtresat prodhuese si punëtorët, fshtarët, tregtarët, por edhe fabrikantët dhe borgjezët ta marrin administrimin e gjithë shoqërisë. Të parët përbëjnë partinë nacionale, kurse të dytët partinë antinacionale, prandaj është e domosdoshme kthesa në të cilën të dytët do ta marrin pushtetin dhe do t'i zbrapsin parazitët. Në këtë shoqëri në vend të luftës klasore dhe të përdorimit të

forcës duhet realizuar bashkëpunimi klasor dhe njerëzit do të duhet ta kuptojnë se janë vllazër me anën e religjionit plotësisht të reformuar „të krishterizmit të ri”. Reformat e tij, Sen Simoni, mendon t’i realizojë në mënyrë që shkencëtarit t’i caktohet detyra që të bëjë planin shkencor „të makinës shoqërore” të re në bashkëpunim me industrialistët. Këtyre reformave u bashkohet artisti, i cili kujdeset për shpirtin dhe të cilin duhet përfutur për planet e reja, në mënyrë që fitimi i shkathtësisë së tij të vihet në shërbim të çështjeve të dobishme. Ai do t’i plotësojë zemrat për një rregullim më të drejtë dhe të lumtur. Në vitet e fundit të jetës Sen Simoni shkroi se do të duhet ndaluar çdo krijimtari artistike derisa të mos ndryshojë shoqëria dhe të mos ndërtohet ndërtesa e bashkësisë së re.

5.6.2. *Sharl Furie (1772-1873)*

Është socialist francez. Në konceptimet e tij sociale niset nga ideja se çdo njeri përmban në vete synim për jetë të përbashkët. Predikoi që shoqëria e ardhshme, tek e cila mund të arrijmë me anë të arsimit dhe bindjes, do të duhej të përbëhej nga një varg bashkësisë „falangash” që do të përfshinin rreth 150 njerëz. Ato do të jetonin së bashku në ndërtesa të mëdha duke u marrë kryesisht me bujqësi. Mirëpo, derisa ekziston prona private, njerëzit midis tyre do të urrehen e do të jenë armiq. Prandaj, zhdukja e pronës private do të jetë premisë e parë e shoqërisë së harmonishme. E rëndësishme është edhe kritika e tij drejtuar marrëdhënieve bashkëshortore dhe seksuale të shoqërisë së kohës së tij. Ai i pari e tha mendimin se shikalla e emancipimit të grave është masë e sigurt e emancipimit të përgjithshëm. Që civilizimi të dalë prej mjerimit dhe të lundërojë në ishullin e lumturisë, nevojitet që më parë t’i njohë ligjet të cilat dominojnë në shoqërinë njerëzore, ndërsa mandej marrëdhëniet njerëzore të rregullohen në përputhje me këto ligje. Epshet, – thotë ai, – janë lëvizësit themelorë të të vepruarit të njeriut. Mirëpo, që të mos shndërrohet në vese nevojitet që të sigurohet rregullimi i tillë shoqëror, në të cilin loja e lirë e epsheve njerëzore do të ketë si pasojë harmoninë dhe lumturinë e përgjithshme.

Furie në mënyrë negative e vlerëson qytetërimin e deritashëm dhe filozofinë që e përcejell. Sipas tij, filozofët ankohen se si natyra nuk po i lejon t’i njohë ligjet e saja. Mirëpo, mashtrimi i filozofëve konsiston në faktin se përkundër shkencave të veçanta, dëshirojnë t’i imponojnë natyrës ligjet e veta.

5.6.3. *Robert Oveni (1771-1758)*

Është socialist dhe teoricient anglez. Autodidakt, i cili në sajë të talentit të tij bëhet fabrikant i suksesshëm dhe i pasur. Mirëpo, për propagandimin e ideve sociale të tij dhe për eksperimentet e tij harxhoi tërë pasurinë e vet. Oveni beson se rendi i ri shoqëror mund të sendërtohet duke bindur klasën punëtore, dhe së këndejmi hedh poshtë çdo ide për dhunë. Ai konsideron se prona private së bashku me makinën dhe religjionin, është burimi themelor i të gjitha fatëkeqësive shoqërore. Njëkohësisht pohoi se makina ka zënë

vendin e punës, ndërsa *laissez faire* (lëre të bëhet) nuk i dha klasës punëtore mjetet përkatëse për ta penguar forcën e makinës. Duke u përjekur për realizimin e koncepcioneve të tij, ai si pronar i fabrikës bënte reforma: shkurtoi ditën e punës, ndërtoi banesa për punëtorët dhe hapi shkolla për fëmijët e punëtorëve.

Oveni qe humanist dhe filantrop, entuziast përparimtar dhe vizionar, për ithtarët e të cilit në vitin 1827 për herë të parë u përdor emërtimi „socialist”. Prej teorive të tij paradoksale, u friksua edhe Xhejms Milli, i cili anticipoi disa parime të shoqërisë komuniste. Oveni më kot shpreh edhe me besim naiv, u përpoq të sendërtonte idetë e tij. Të gjitha realizimet e tij të koncepcioneve ideale, për shembull kolonitë komuniste në Amerikë, banka për këmbimin në bazë të vlerësimit të vlerës së parave të shpenzuara për punimin e produkteve, etj - shkatërohen në kushtet e pazhvilluara ekonomike e sociale dhe për shkak të ligjësiave të përgjithshme prodhuese të rrethit borgjez. Por, megjithëkëtë, në fund të jetës së tij Oveni mund të thoshte me krenari: „Jo Zotëri, jeta ime nuk ishte e padobishme. Proklamova të vërtetën e mëdha, e pse bota nuk i provoi për shkak se nuk i kuptoi. A mund ta dënoj për këtë shkak? - Jo, unë shkoj para kohës sime”.

5.7. ANARKISTËT

Anarkizmi është lëvizje politike dhe pikëpamje sociale, e cila, në emër të lirisë dhe autonomisë së individit, angazhohet për heqjen e çfardo forme të organizimit shoqëror, për përmbysjen e shtetit, qeverisë dhe çfardo forme të organizimit politik. Shteti dhe organet shtetërore, organizatat dhe organizimi politik në përgjithësi janë forma dhe mjete, me ndihmën e të cilave pengohet liria dhe çenohet autonomia e njeriut si individ. Paraqitja dhe përhapja e anarkizmit përkon me shekullin XIX, veçanërisht me gjysmën e parë të tij.

Themelues i ideor i anarkizmit konsiderohet anglezi Viliem Goldvin me veprën „*Studime në lidhje me drejtësinë politike dhe influencën e saj në moralin dhe lumturinë*”. Goldvini mendon se njeriu është i aftë ta kuptojë natyrën, shoqërinë dhe vetveten, prandaj atij nuk i nevojitet kurrfarë tutele, si shteti, pushteti, qeveria, organizatat politike etj. Përfaqësues më të njohur të anarkizmit janë Maks Shtirneri me veprën „*I vetmi dhe prona e tij*”, Zhosef Pradoni me „*Ç’është prona*”, Mihail Bokanini me veprën „*Zoti dhe shteti*”, etj. Mihail Bokanini, kundërshtar i freptë i Karl Marksit, në Internacionalen e Parë, ishte kundër çdo shteti, pushteti, diktature, madje edhe kundër diktaturës së proletariatit. Ai thoshte, çdo pushtet korrupton, degjeneron e kufizon lirinë dhe autonominë e individit. Revolucionin, domethënë përmbysjen e shtetit dhe heqjen e eksploatimit nuk mund ta bëjnë turmat, por individët e zgjedhur, të organizuar në grupe të vogla. Kundër anarkistëve ishin marksistët. Sipas tyre, anarkizmi është teori e gabueshme dhe një praktikë utopike e terroriste, e cila e kompromiton kauzën e revolucionit socialist. Mirëpo, në praktikën politike e shoqërore, që u ndërtua mbi pikëpamjet e Stalinit e të stalinistëve, u manifestua një formë e posaçme e anarkizmit dhe anarkistëve, si marksizmi shtetëror, voluntarizmi, arbitrarizmi i shtetit dhe i partisë.

5.7.1. Marksizmi dhe markistët

Karl Marks u lind në Trir të krahinës Renane të Gjermanisë, në një familje të arsimuar juristësh çifutë, i cili pasi kreu gjimnazin studioi drejtësinë. Mirëpo, merret edhe me filozofi, ekonomi, histori dhe art. Vdiq dhe u varros në Londër në vitin 1883. Marks u doktorua me tezën „Ndryshimi ndërmjet filozofisë së natyrës së Demokritit dhe filozofisë së natyrës së Epikurit”. Bashkohet me helgelianët e rinj, ndërsa pas kryerjes së studimeve bëhet kryeredaktor i „Gazeta Renane”, të cilën qeveria prusiane së shpejti e ndalon. Pas kësaj në Paris nxjerr „Vjetarët gjermano-francez”. Në takimin e dytë me Engelsin në Paris në vitin 1844, pasi takimi i parë nuk i ofroi, arrin me të disa teza të përbashkëta. Kështu, puna e tyre e mëtejshme teorike dhe praktike është e lidhur ngushtë, ndonëse sigurisht ndërmjet tyre ekzistojnë edhe dallime të caktuara, jo vetëm nga aspekti formal dhe trajtimi i problemeve, por edhe nga trajtimi i disa çështjeve filozofike. Në këtë drejtim vetë Engelsi theksoi gjithmonë se Marksit i takon merita themelore për formimin e botëkuptimit të tyre. Shpesh i persekutuar, duke jetuar në skamje materiale, duke qëndruar më shumë në mërgim se sa në atdhe, Marks aktivisht merr pjesë në formimin e organizatave të para punëtore. Ai ishte udhëheqës idoeor i Internacionales së Parë (1864-1876). Krijimtaria filozofike e Marksit përfshin veprat: „Kritika e filozofisë së të drejtës shtetërore të Hegelit”, „Rreth kritikës së filozofisë hegeliane të së drejtës”, „Dorëshkrimet ekonomika-filozofike”; Tezat mbi Foerbahun dhe „Ideologjia Gjermane”, „Manifesti i Partisë Komuniste”, etj, së bashku me Engelsin. Mandej veprat: „Mjerimi i filozofisë”, „Puna me menditje dhe kapitali”, „Bazat e kritikës së ekonomisë politike”, si dhe kryevepra e tij „Kapitali, kritika e ekonomisë politike”.

Përkundër doktrinave të ndryshme idealiste, Marks thekson nevojën e analizës së marrëdhënieve shoqërore; nevojën e kritikës radikale të kundërtënieve fundamentale të shoqërisë, në mënyrë që të kuptohen komponentët themelorë të superstrukturës shpirtërore të epokës së caktuar. Ai në shumë vepra të tij e thekson këtë nevojë reale, mbi të cilën ngrihet superstruktura juridike, politike, filozofike, morale etj. Ndërkaq, në këtë rast duhet pasur parasysh se në histori, „për nga qenësia jonë si qenie”, mund të jemi sipas Marksit, qenie e lirë kur: „njeriu nuk riprodhohet sipas ndonjëfarë përcaktueshmërie, por prodhon totalitetin e vet, pa kërkuar çfarëdo që është bërë, por që ai të jetë në lëvizjen absolute të ekzistimit”. Ky dimension i historizmit, pra, nuk është qenësisht i përcaktuar me atë që ka qenë ose me atë që është, por me atë që ende nuk është por ekzistojnë premiset historike të bëhet.

Mendimi i Marksit, paraqitet në kushtet historike të diferencimit gjithënjë e më të madh të shoqërisë, në vendet e Evropës Perëndimore; në kushtet e kundërtënieve themelore ndërmjet punës dhe kapitalit „e cila bren dhe mohon vetë strukturalitetin e shtrëzimit të sistemit”, i cili është „i dënuar që në perspektivën historike të zëvendësohet” që nga themeli me marrëdhënie të reja. Në këtë periudhë vendimtare, kur proletariati paraqitet në mënyrë të organizuar në skenën botërore, mendimi i Marksit paraqitet si „orientim idoeor”, që kërkon transformimin e botës.

Opusi filozofik i Marksit në mënyrë të caktuar është drejtuar në të përmbysurit e traditës filozofike idealiste gjermane. Pika kulminante e kësaj filozofie ishte Hegeli, i cili në suaza të sistemit të tij racional dhe panlogjik shtroi tezën fundamentale që e goditi esencën e mistikës dhe të iracionales. Me këtë rast ai do të thotë: „*çdo gjë reale është e arsyeshme dhe çdo gjë e arsyeshme është reale*”. Marksi duke e pranuar këtë qëndrim edhe më qartë se të gjithë nxënësit e Hegelit, duke e kuptuar aftësinë e mendimit filozofik hegelian, në të njëjtën kohë ai kishte mundësi që ndaj kësaj ta orientojë çështjen e kritikës radikale të tij. **Kritika e Marksit nuk përmban vetëm mohimin e filozofisë së Hegelit, por është përpjekje e tejkalimit të krejt pozicionit filozofik të deriatëhershëm, si i njëanshëm dhe ekskluzivisht filozofik: në të nuk është realizuar në një mendësi, pajtimi i idesë dhe i njëmendësisë, logosit dhe i relalitetit, intelektit dhe ekzistencës, ose vetëm idealisht, vetëm në filozofi si filozofi.** Përkundër kësaj, Marksi përqëndrohet në përfshirjen aktive të njeriut në botën reale, si dhe në ndërprerjen e mendimit pasiv e iluzionist mbi këtë botë. Prandaj, përkundër vetë pajtimit ideal të mendjes e të njëmendësisë, Marksi edhe i shkroi Tezat e njohura të tij mbi Foerbahun, ku thotë: „*Filozofët nuk kanë bërë tjetër veçse e kanë shpjeguar botën në mënyrë të ndryshme, por puna është që të ndryshohet ajo*”! E vërteta e njeriut është, pra, e vërteta e të ekzistuarit historik të tij, e jetës faktike të tij, e ekzistencës së njëmendët të tij. Në themelet e saj dialektike e cila inkludon në vete, por edhe mohon, si idealizmin e shkollës gjermane, ashtu edhe materializmin mekanik, mandej edhe çdo materializëm tjetër dhe në themelet e të ashtuquajturit natyralizëm-humanizëm, **Marksi ndërton „anticipimin” e ri të shoqërisë. Proletariati, sipas tij, me heqjen e marrëdhënieve klasore, nuk krijon vetëm formacion të ri të shoqërisë, në të cilën bëhet klasë sunduese, por krijon premiset për zhdukjen e të gjitha klasave në përgjithësi, kështu edhe të vetvetes.**

Prej tezës fundamentale të Marksit mbi praktikën si mbi ndryshimin e vetëdijshëm njerëzor të botës, rrjedh edhe pikëpamja se vetëm të menduarit është formë e qenies. Nuk ka, pra, dallim të qenësishëm ndërmjet qenies dhe të menduarit, sepse me këtë do të bëhej e pamundshme praktika njerëzore në thelbin e saj, në të cilin përmbahet premisa e ndryshimit si teorik ashtu edhe praktik të botës. Për Marks, „*diskutimi mbi karakterin real ose joreal të mendimit, që izolohet nga praktika, është një çështje thjesht skolasitike*”.

Si njohës i jashtëzakonshëm i filozofisë bashkëkohore, si njohës i traditës filozofike, Marksi propozon zgjidhje të reja origjinale për të shtruar çështje të reja filozofike. Sipas tij, natyra nuk është dhënë vetëm në ndonjë formë të përgjithshme e abstrakte, por me anën e një morie të pafund të formave të veçanta materiale, të mundësive të materies. Gjithashtu materia nuk mund të jetë absolutisht identike me asnjë formë konkrete të veten, sepse çdo formë e ekzistimit të saj është vetëm shkallë kohore kalimtare, fazë e caktuar e ndryshimit të saj „të amshueshëm”. Njohja e njeriut, sipas Marksit, zhvillohet proporcionalisht me shkallën e zotërimit të historisë dhe të natyrës nga ai, e nuk është rezultat i të vëzhguarit pasiv. Dhe meqë ky proces në themel është i pafund, i pafund është edhe zhvillimi i njohjes njerëzore.

Mendimi i Marksit në tërësinë e problematikës së trajtuar është tejkalim i filozofisë së vjetër, të ekonomisë politike, të sociologjisë, të historiografisë dhe në përgjithësi të horizontit shkencor si shkencë; mendimi i tij nuk është shpjegim parcial i problemeve të njeriut dhe të botës, nga aspekti ekskluziv i cilësdo shkencë ose ideologji të veçantë. Pikëpamja e Marksit, është e lidhur me pikëpamjen mbi botën dhe njeriun, ndërsa qëllimi përfundimtar i përpjekjeve teorike dhe i synimeve praktike është **ndryshimi qenësor i marrëdhënieve ndërmjet njerëzve**. Marksi mbron të drejtat reale, të njëmendëta dhe jo vetëm të drejtat formale të lirisë kauzale, që janë të determinuara nga shkaqet heteronome, qofshin hyjnore ose natyrore.

Orientimi filozofik i Marksit për njeriun është „humanizëm real” që është i dukshëm në krejt opusin krijues të tij, e jo vetëm në punimet e hershme të tij. Pra, edhe në „Kapital” e punime tjera është i dukshëm ky orientim i tij. Atje ku ekonomistët e shkollës klasike (Smiti dhe Rikardo) shohin vetëm raporte ndërmjet sendeve, Marksi zbulon raportet ndërmjet njerëzve. Prandaj edhe mbivlera mbështetet tek ai, në shfrytëzimin e fuqisë punuese të njerëzve, e jo në shfrytëzimin e makinave, të tokës, etj.

Në praktikën vepruese të njeriut Marksi gjeti atë medium që mundëson, realizon edhe vërteton unitetin parësor të njeriut e botës dhe që tejkalon çdo relacion të ndarë subjekt-objekt. Njohja e njerëzve për të nuk është rezultat i ndonjë të vëzhguari të thjeshtë njerëzor, të ndonjë pasqyrimi, të realitetit dhe të natyrës. Ndryshimi praktik i botës në aktivitetin e saj gnosologjik është i pakufizuar dhe i hapur, dhe nuk është ndonjë nënshtrim i realitetit çfarë është ai, edhe „pasqyrimi” i saj. Pra, Marksi nuk e pranoi teorinë e pasqyritit në njohjen njerëzore.

Sipas Marksit, prodhimet vetiake të njeriut në botë që e parcializojnë personalitetin e tij, sundojnë mbi të. Kështu, marrëdhëniet midis njerëzve marrin formën si të ishin raporte midis sendeve. T’huajsimi i rezultatave të aktivitetit prodhues të njeriut mbështetet mu në t’huajsimin e vetë aktivitetit punues, të veprimtarisë punuese; në t’huajsimin e prodhimit njerëzor. Njeriu i bën të huaja (t’huajson) rezultatet e punës së vet, mu për arsye se t’huajson veprimtarinë punuese të vet, kështu që ajo si veprimtari i bëhet e huaj dhe në të nuk afirmohet, por mohohet, nuk çlirohet, por nënshtrohet. Prandaj, njeriu ndihet në vete, kur është jashtë kësaj veprimtarie dhe jashtë vetes, i huaj për vete kur është në të. Kështu edhe puna e tij bëhet punë e dhunshme, ajo nuk është plotësim i një nevojë qenësisht njerëzore, por mjet për t’u plotësuar nevojat jashtë tij. Marksi do të thotë se „njeriu punëtor ndihet vetëperues vetëm në funksionet shtazarake të tij, në ushqim, pije dhe të lindurit, më shumë në banesë, e stoli tjera, ndërsa në funksionet e tij njerëzore, domethënë në punë, e ndien veten si kafshë. Shtazorja bëhet njerëzore, ndërsa njerëzorja bëhet shtazore!”.

Format e ndryshme të t’huajimit si religjioni e ideologji të tjera, janë karakteristikë për një botë në të cilën njeriu është skllav i forcave të cilat i ka krijuar vetë njeriu; dhe nën të cilat e ndien veten të vogël, të pafuqishëm, – thotë Marksi. Kritika e një vetëdije të tillë të t’huajuar, para së gjithash, është kritikë e botës, e cila e lind dhe ka nevojë për një vetëdije të tillë të t’huajuar.

Megjithatë, filozofia e Marksit, nuk mund të reduktohet në disa „karakteristika” si u përpoq këtë ta bënte Stalini, e shumë vazhdues të tij.

Marksistët. Pasardhësit dhe mendimtarët e parë, të cilët u përpoqën ta kuptojnë dhe ta shpjegojnë filozofinë e Marksit ishin: në Gjermani **Josif Diogeni** (1828-1888), një autodidakt që pretendonte të filozofojë në frymën e filozofisë së Marksit; në Francë **Pol Lafargu** (1842-1911), i cili luajti rol të ngjashëm; në Itali **Antonio Labriolla** (1843-1904) i cili Marksit e zbuloi si hegelianist. Përhapja e filozofisë së Marksit në frymën e pastrimit nga dialektika, më karakteristikë ishte në Gjermani dhe Austri duke filluar me **August Babelin** dhe **Edvard Bershtajni** e deri te **Karl Kautski**, **Maks Adleri** dhe **Oto Boueri**. Këta përfaqësues vepruan asisoi që doktrina e Marksit të adaptohet me interesat dhe synimet e social-demokracisë. **Roza Luksemburgu** (1870-1919) ishte e para e cila e kritikoi social-demokracinë.

Në Rusi u paraqit **Gjorgji V. Plehanovi** (1856-1918) si kritik i tendencës neokantiste në filozofinë e Marksit. **Vlladimir Iliç Lenin** (1870-1924), shkoi shumë më larg se Plehanovi. Ai vërtetoi se filozofia e Marksit rrjedh nga materializmi dhe dialektika dhe është mundësi e vërtetë e ndërtimit të socializmit në botë. Në Rusi, përkaj Leninit u dallua edhe **Nikolla Buharini** (1888-1938), i cili thoshte se **materializmi historik** është metoda më e përgjithshme e të gjitha shkencave shoqërore. Ndërsa **J. V. Stalini** (1879-1953), në mënyrë vendimtare ndikoi në ardhmërinë e filozofisë së Marksit; pastaj ndikimi i tij ndihet edhe sot në formë të recidivit të „filozofisë socialiste”. Stalini dëshironte të bëhej ideologu i vetëm dhe i pacënueshëm, mendimet e të cilit nuk mund të kundërshtoheshin. Filozofinë e reduktojë në disa kategori të përgjithshme me anë të të cilave çdo gjë mund të shpjegohet, sikur te krishterët që çdo gjë mund ta shpjegojë Bibla.

Dogamtizmi stalinist gjatë disa dekadash i bëri të pamundshme të gjitha synimet, që filozofia e Marksit të zhvillohet në mënyrë krijuese. Për një kohë bukur të gjatë mbetën pak të njohura veprat që u krijuan jashtë suazave dhe kufijve të ideologjisë staliniste. Vepra të tilla janë ato të filozofit hungarez, **Gjergj Llukaçit** dhe filozofit gjerman **Ernest Bllohu**. **Gjergj Llukaçi** (1885-1971), e ndërtoi botëkuptimin e vet filozofik në frymën e të arriturave të filozofisë klasike gjermane, prej Kantit deri te Hegeli, pastaj veçmas nën ndikimin e drejtëpërdrejtë të Hegelit dhe Marksit. Mandej në formimin e tij mendor ndikoi edhe filozofi gjerman **Maks Veberi**. Kryeverpa e tij është „*Historia dhe vetëdija klasore*”, në të cilën u shpreh për zhvillimin e materializmit historik, që do të thotë se duhet t’i kushtohet kujdes historisë dhe dialektikës, në mënyrë që të kuptohen ngjarjet historike botërore. **Ernest Bllohu** (1885-1977) vuri në qendër të filozofisë së tij frymën e filozofisë së Marksit përmes dialektikës dhe humanizmit. Sipas Bllohut, ekzistenca e njeriut ka strukturë kohore. Nga fakti se njeriu është i hapur ndaj ardhmërisë, si qenie e qëllimshme dhe e lirë, ai esencialisht gjithmonë jeton me shpresë dhe duke pritur. Por, shpresa si parim themelor i ekzistencës nuk çon drejt optimizmit naiv, i cili nuk është asgjë tjetër veçse iluzionizëm i cekët. Për Bllohun, historia nuk është vetëm e kaluar, as nuk është vetëm e tanishme. Ajo, gjithashtu, është edhe ardhmëri. Parimi i shpresës, pra, është esenca e filozofisë së Bllohut.

5.7.2. Fridrih Niçe (1844-1900)



Fridrih Niçe

Fridrih Vilhem Niçe u lind në Rosken, provincën e Saksonisë të Gjermanisë. Studioi teologjinë, të cilën së shpejti e braktisi, filozofinë klasike dhe kështu në Greqinë parasokratiane dioniziane gjeti frymëzimet dhe modelet e para. Marrja me muzikë e shpie në miqësi me Vagnerin. Më vonë i dëshpëruar me faktin se Vagneri ishte „më shumë dramaturgjik dhe shumë pak muzikant” ndërpreu çdo marrëdhënie me të. Në Bazel në vitin 1869 u ftua për profesor. Veprat më të rëndësishme të Niçes janë: „*Kështu fliste Zaratustra*”, „*Përtej së mirës dhe të keqes*”, „*Vullneti për fuqi*” etj.

Zhvillimi mendor dhe futja në botën e vizioneve vetanake e vetmon gjithnjë e më shumë Niçen, ashtu që shumë simpati të mëparshme personale dhe filozofike, si atë të Shopenhauerit, plotësisht i braktis. Për disa vjet do të merret me studimin e pro-

blemeve natyrore-shkencore dhe përveç veprave filozofike eminente, të shkruara me një gjuhë jashtëzakonisht të bukur gjermane, shkruan edhe vjersha. Pas smundjes së rëndë vdes me një mendje plotësisht të erësuar. Veprat e tij i botoi, madje edhe i klasifikoi disa letra duke i shtuar pjesë motra e tij ambicioze dhe me orientim racist Elizabet Fërster-Niçe.

Niçe e zhvilloi filozofinë e tij kryesisht në formë aforistike dhe në mënyrë „josistematike”. Edhe përkundër kësaj tek ai mund të theksohen qartë disa tema dhe preokupime themelore filozofike, si: vdekja e perëndisë, vullneti për fuqi dhe kthimi i përhershëm i të njëjtës.

Vdekja e perëndisë është pasojë e raportit të tij negativ ndaj sferës së nevojave; ndaj moralit tradicional dhe metafizikës platoniane. Vdekja e perëndisë është fundi i realitetit historik, „në të cilin bota është bërë përrallë”, kurse njeriu i t’luajësuar në atë të përtejmen dhe me këtë demaskohet ajo idealja, e larta, e pastërta, moralja, mbinjerëzorja si „njerëzore dhe tepër njerëzore”. Historia botërore më nuk është gjuhë e hyjnisë, por është vënë mbi vetveten, dhe me këtë është vënë në pyetje edhe mendimi krishter mbi njëhershëmërinë e të ndodhurit njerëzor, si përparim i vazhdueshëm ndaj qëllimeve të fundit. Me vdekjen e perëndisë, mohohet teza se e vërteta e njëmendët e njeriut është fryma, e jo trupi. Trupi, ndërkaq, nuk mendohet si organizëm fiziologjik, por si kundërparim është transmunduar spirituale si simptom dhe simbol i sjelljes ndijore-mendore të njeriut, njëmendësia e tij autentike njerëzore „fizike”. Fryma, përkundër kësaj, është vetëm, „armë dhe lodër” e trupit të tillë, ndonëse shpesh mendon se është zotërues absolut i tij. Andaj, „perëndia ka vdekur që të mund të sundojë njeriun”, ndërsa këtë sundim e mundëson shkalla e lartë e vullnetit për fuqi.

Vullneti për fuqi është pasoja e drejtpërdrejtë dhe e parë e vdekjes së perëndisë. Sepse para perëndisë, si para abstraksionit më të lartë, të gjithë janë barazuar, meqë janë njësoj të vegjël dhe nuk posedojnë vullnetin për fuqi. Zaratustra ua predikon të gjithëve vdekjen e perëndisë, në mënyrë që te të gjithë ta zbulojë fuqinë e fshehur, ndonëse të gjithë, e sidomos

të pafuqishmit, nuk dëshirojnë ta dëgjojnë. Veçohen të pafuqishmit, masa, „kopeja”, e cila dëshiron ta udhëheqin mëtej të tjerët; e cila kërkon barinj të rinj. **Atëherë del papritmas mbinjeriu; njeriu që zotëron vullnetin e tij për fuqi.** Vullneti për fuqi triumfon në parimin e pabarazisë, kur „pabarazia bërtet për barazinë, pikërisht për shkak të pafuqisë”. Jeta dhe vdekja, natyra, njohja, rregullimet shoqërore, pikëpamjet ideore, pozita e njeriut, vlerësimet, filozofia me të gjitha disiplinat e saj, **nuk janë gjë tjetër veçse manifestime të maskuara ose të harruara të vullnetit për fuqi.** Vullneti për fuqi, megjithatë, mbetet gjithmonë në horizontin e qenies, dhe nuk është parim themelor i filozofisë së Niçes. Vullneti për fuqi shfaqet në kohë, e që njëkohësisht është edhe kufiri i tij i qenësishëm, sepse ai mund të dojë vetëm atëherë kur dashja e tij përparon nga e kaluara në të ardhmen. Vullneti për fuqi nuk mund ta ndryshojë të kaluarën. Ta bësh të mundur këtë, „të duash mbresa” të vullnetit për fuqi, nuk është vetëm dashje në ndonjë drejtim tjetër, por **dashje për kthesë të tërësisë së strukturës kohore,** që dashja e së kaluarës të bëhet identike me dashjen e ardhmërisë. Është e mundur këtë ta arrijmë vetëm nëse në kozmos sundon kthimi i përhershëm i së njëjtës dhe kështu kjo kategori fundamentale është pasojë e tezës e vullnetit për fuqi.

Kthimi i përhershëm i së njëjtës e mohon frymën e hakmarrjes. Ky është mendimi „**më i lartë dhe më i vështirë**” i Niçes, i cili si „enigmë” nuk mund të vërtetohet në mënyrë empirike e as të hudhet. Fjala është për **strukturën e re të kohës, e cila së kaluarës i jep një aspekt të hapur ndaj ardhmërisë, ndërsa ardhmërisë fortësinë, realitetin e së kaluarës.** Vetëm me kthimin e përhershëm të së njëjtës mund të rënohet koncepti teologjik e i krishter i botës, të tregohet se si nuk ka qëllim përfundimtar të cilin e synojmë, përëndi së cilës i flijojmë gjithçka. Njëkohësisht, vullneti për fuqi mund të manifestohet vetëm kështu në formën e tij të vërtetë, sepse **vetëm njeriu më i fuqishëm, e jo njeriu i dobët, i cili frikësohet prej kthimit të amshueshëm, mund t’i qëndrojë këtij mësimi.**

Mendimi i Niçes vetëm në dukje aforistike dhe josistematike, paraqitet vetëm kështu - në lidhshmërinë e brendshme të menduar, të vdekjes së përëndisë, të vullnetit për fuqi dhe të kthimit të përhershëm të së njëjtës për brenda koherent dhe i menduar. Kthimi i përhershëm i së njëjtës është kulmi i krejt ndërtesës filozofike të Niçes, që del nga dy motive fundamentale të të menduarit të tij: **vdekjes së përëndisë dhe vullnetit për fuqi.** Mirëpo, në kontekstin historik ky mendim është njëkohësisht kufi i qëndrueshëm i të menduarit të tij, i cili mohon perspektivën e njëmendët njerëzore dhe pamundëson kthesën historike në botën e re.

Çështjet mbi artin e Niçes janë çështje të artistit autentik mbi kuptimin dhe perspektivën e jetës vetiake. Niçe nuk merret me estetikë si „disiplinë” filozofike, ndërsa krejt opusi i tij është në anën tjetër të poezisë dhe të menduarit, kur këto nocione kuptohen tradicionalisht si polaritet i artit dhe i filozofisë. Të ashtuquajtura vepra filozofike, si për shembull „**Vullneti për fuqi**”, gjithashtu janë poetike sikur se është „*Zaratustra*” refleksive. Arti për ta, nxjerrë fuqinë e vet nga fuqia transformuese e entuziazmit dhe e dashurisë, prej vetë jetës, ndërsa çfarido mirësie, fryme, nderi a vërtetësie nuk ndikojnë në imagjinacionin krijues e artistik. Prandaj, „**arti është më i vlefshëm se e vërteta**”. Bota apoloniane, bota e formave, e masës, e harmonisë, – sipas Niçes, – mund të shfaqet vetëm në bazë dionisiane, e cila në qenie është pa kohë dhe e pakufijshme, e cila nuk mund të shkatërrohet dhe e cila gjithmonë shfaqet sërish. Ajo dionisiana është burim i përhershëm i krijimtarisë, themel i të ekzistuarit, bazë e thellë e pashpjegueshme e botës. Ajo, apoloniana, mundëson të shfaqet, të shprehet, të marrë fuqinë e saj.

Antiteza e apolonianes dhe dionisianes është gjithnjë e pranishme në krejt veprën e Niçes. Mirëpo, kredoja e tij jetësore dhe artistike është me karakter dionisian dhe forca filozofike e Niçes nuk qëndron në racionalitetin, në deduksion dhe në logjikë, por në krijimtarinë burimore të papenguar artistike, e cila e mundëson edhe vetë jetën. Edhe krijimi më i vogël, për të, gjithmonë është më i vlefshëm se sa të folurit për të krijuarën.

Filozofia e Niçes në tërësi, padyshim, është shprehje e kohës së errët të provokimeve pushtuese dhe i realitetit të vrazhdët në kthesën e shekullit. **Jeta e përditshme është muzgu i të gjitha normave dhe i vlerave etike.** Mirëpo, në këtë akoma fshihen të gjithë moralistët, filozofët dhe politikanët si edhe prijësit e ushtrisë. Niçe rivlerëson të gjitha vlerat morale, por pakënaqësia e tij nuk i kalon kufijtë e protestës verbale të zbukurimit moral, të situatës ekzistuese amorale. Ai nuk beson në mundësinë e ekzistencës së një shoqërie në të cilën të gjithë njerëzit do të kenë mundësi t'i zhvillojnë aftësitë krijuese. Sipas tij, ekziston vetëm një numër i vogël shpirtërash të fuqishëm, që janë të aftë të ngriten gjerë në nivelin e jetës krijuese. Niçe nuk nxjerr në shesh kuptimin për mundësitë e vërteta historike për t'i tejkaluar format ekzistuese të t'huajsimi të njeriut, ai nuk i sheh rrugët dhe mënyrat e vërteta përmes të cilave njeriu do ta realizonte lirinë e vet.

5.7.3. Soren Kierkegard (1813-1855)

Filozofia e Soren Kierkegardit është një nga burimet më të rëndësishme të filozofisë bashkohore, veçmas të filozofisë së ekzistencializmit. U lind në Kopenhagë, ku jetoi deri në fund të jetës së vet. Studioi filozofinë dhe teologjinë. Bëri një jetë të vetmuar. Për një vit në Berlin i dëgjoji ligjëratat e Shelingut. Me t'u kthyer në atdhe e filloi konfliktin me kishën dhe dogmatizmin teologjik. E sulmoi ashpër klerin, ndërsa revolucionin e vitit 1848 e përjetoi si tragjedi, duke kërkuar shpëtim në krishterizmin e reformuar. Shkroi një numër të konsiderueshëm të veprave, prej të cilave janë: „Ose-ose“, „Frika dhe tmerri“, „Nocioni i frikës“, „Shkallët në rrugën e jetës“, „Smundja për vdekje“, etj.

Sa qe gjallë nuk iu njoh merita, u bë i njohur vetëm pas vdekjes, ndërsa në shekujt e mëvonshëm mendimi i tij krijon pasardhës të entuziazmuar e do të ndikojë në rrjedhat e filozofisë dhe letërsisë (ushtroi ndikim te Jaspersi, Kafka etj). Kierkegardi e kritikoi filozofinë e Hegelit të frymës absolute, për arsye se në këtë sistem filozofik nuk ka vend për individin, për personalitetin njerëzor, për arsye se kjo është filozofi në të cilën realiteti është i caktuar në atë mënyrë sa që në të ajo që është individuale, ekzistenciale, ekziston vetëm si formë e çastit, e të shfaqurit të asaj që është e përgjithshme dhe e domosdoshme. Për Kierkegardin **problemi themelor i filozofisë është problemi i njeriut si individ.** Njeriu ekziston, para së gjithash, si person individual i cili ka vetëdijen, i cili i përket vetvetes dhe vetëm në këtë raport ndaj vetvetes vendoset edhe në marrëdhëniet ndaj botës në përgjithësi.

Përkundër Hegelit, për Kierkegardin **individit është gjithçka.** Të gjitha marrëdhëniet tjera të realitetit ai i nxjerr prej vetëdijes njerëzore, prej raportit të njeriut ndaj vetvetes. Ekzistenca e individit të vetëdijshëm njerëzor është esenca e kuptimit të realitetit të gjithëmbarshtëm. Kuptimi i këtij realiteti është i dhënë vetëm në përpjekjet e ekzistencës për ta ndërtuar vetëveten. Për Kierkegardin ekzistenca është qenie e zgjuar, qenie e cila

kujdeset për kuptimin e botës, që e ndërton kuptimin e realitetit. Ekzistenca është qenie individuale, subjektive, që nuk mund të përsëritet. Kurrfarë e vërtete objektive nuk ekziston jashtë kësaj qenieje. E vërteta mbi botën nuk është e vërteta mbi argumentet e pavarura prej njeriut individ. E vërteta krijohet në vetë procesin e formimit të individit. E vërteta nuk është dituri, por vepër, nuk është vetëdije për objektin, por „rrëfim”. E vërteta është e dhënë në përpjekjen për ekzistencë, për ta formuar kuptimin e të qenies së vet. Ekzistenca është qenie e zgjuar dhe qenie e brengës. Nga përpjekja e saj për ta formuar veten varet kuprimi i botës. Për këtë arsye, e vërteta mbi kuptimin e botës nuk mund të jetë e përgjithshme dhe racionale. E vërteta mbi realitetin nuk zbulohet si e vërtetë mbi botën jashtë ekzistencës, por komunikohet me përmbajtje të brendshme të vetëdijes së individit. Kjo është gjuhë me të cilën nuk shprehen kurrfarë të vërtetash të përgjithshme, e vërteta mund të njihet vetëm nëse përmes porosive dhe qëndrimeve të ekzistencës zbulohet përjetimi i saj i papërsëritur, personal ndaj botës.

Metoda dialektike është ajo e komunikimit të së vërtetës ekzistenciale; e cila vetëm në raport ndaj vetes mund të njihet. Me këtë të vërtetë zbulohet paradoksi i ekzistencës njerëzore. Individi jeton në dilema të përhershme të asaj ose-ose. Sintezë të këtyre kontradiktave nuk ka. Njeriu, thotë Kierkegardi, është qenie e cila jeton në paradokse të përhershme; në alternative të cilat nuk mund t'i tejkalojë. Njeriu është qenie paradoksale, ai është qenie e caktuar për të vdekur, qenie e frikës, e vuajtjeve dhe e brengës. **Paradoksi themelor: jeta e caktuar për të vdekur nuk mund të tejkalohet. Po, si mundet njeriu të mbetet gjallë, duke qenë i vetëdijshëm për jetën e vet kalimtare, për atë se është e caktuar për të vdekur. Kjo, thotë Kierkegardi, është e mundur vetëm në aktin e besimit e jo të diturisë.**

Besimi lind prej nevojës për t'i zgjidhur dilemat dhe paradokset, për t'u bërë zgjidhja ndërmjet alternativave në kundërtëni të përgjithshme racionale të jetës. Dituritë racionale nuk na japin mundësi t'u qëndrojmë paradokseve të jetës. **Për këtë arsye njeriu duhet patjetër të besojë.** Prandaj, kërkimi i kuptimit të qenies personale është i mundur vetëm si kërkim për perëndinë. Perëndia është çdoherë si absolut personal. Kierkegardi është kritik i besimit zyrtar të krishterë, e i krishterizmit si fe e institucionalizuar. Feja nuk mund të jetë në formë të të vërtetave të përgjithshme zyrtare, e as nuk mund të jetë e institucionalizuar. Feja e vërtetë është e dhënë në përpjekjen e çdo individit që të besojë dhe në këtë mënyrë t'u bëjë ballë paradokseve të jetës.

Sipas Kierkegardit, jeta kalon nëpër tri shkallë themelore, ndërsa zhvillimi ndërmjet tyre është hope-hope, e jo gradual. Shkalla e parë është estetike, jeta e imagjinatës, e lojës gjithmonë të përsëritur - ideali i Don Zhuanit. Shkalla e dytë është etike, njëmendësia e cila herën e parë ishte në ide, tani përsëritet në akt - ideali i Sokratit; dhe shkalla e tretë, ajo më e larta, është ajo religjioze - ideali i krishtit. Jeta këtu vihet në raport ndaj absolutes, heq dorë nga subjektiviteti i vet, e mohon veten dhe bëhet i panatyrshëm. Kalimi në absolut është plot vuajtje e dhimbje dhe paraqet ndryshimin e krejt jetës.

Kierkegardi preferon ekzistimin e njeriut që është i predestinuar, i orientuar dhe i sëmurë për vdekje, që është plot frikë e ankth, plot brengë për ekzistencën e vet, i painteresuar për njëmendësinë, praktikën, diturinë dhe autonominë morale. Duke lëvizur në këtë botë të tmerrshme, ekzistenca njerëzore e predestinuar, e kufizuar dhe nga brenga e ngarkuar, jeton në

suazat e paradoksit dhe të hyjnore, të kundërshtive të kohores dhe të amshueshmes, jetës dhe vdekjes. Kjo ekzistencë është individuale dhe së këndejmi shpëtimi i individit, e jo ndonjë njerëzim absolut, në këtë botë është i vetmi imperativ i njëmendët, e vetmja kërkesë e arsyeshme.

Nga vepra e Kierkegardit „*Ose-ose*”, por edhe nga vepra „*Frika dhe drithma*”, si dhe nga „*Ditarët*” e tij, shihet qartë çfarë vendi qendror zë loja. Ai, ndërkaq, nuk bën ndonjë lojë me ndonjë ose me diçka të jashtëm, tjetrën, por, para së gjithash, me vetveten dhe mundësitë ekzistenciale të veta. Loja si lojë afirmohet në ekzistencialen, pra në vetë lojën, e jo në teori mbi lojën, „llomotitjen” mbi lojën.

Filozofia e Kierkegardit, e kundërt me çdo ndikim racional, e njëanshme në theksimin e personalitetit të papërsëritshëm dhe në mohimin e çdo gjëje të përgjithshme shoqërore e individuale, e errësuar prej ndjenjës intime, e ngjyrosur me religjiozitet të thellë, megjithatë ishte në një mënyrë të caktuar edhe kthesë rrënjësore prej sistemeve idealiste të filozofisë klasike gjermane. Duke jetuar me filozofinë e tij si rrallë ndonjë filozof tjetër dhe jo duke speculuar brenda kontraksioneve të pajetë, Kierkegardi me veprat e tij në mënyrë të jashtëzakonshme filozofike e letrare dhe poetike la dokument tronditës të pakënaqësisë spontane, të një natyre senzibile, mendore dhe tragjike kundër botës, kundër përditëshmërisë së qetë, por edhe kundër skematikës së përgjithshme të flohtë, pa ndjenja, të sistemeve të mëdha idealiste.

PYETJE:

1. Kush është „bartës i mendimit filozofik” në botën bashkëkohore?
2. Çfëra „kthese filozofike” bëri Emanuel Kanti?
3. Pse quhet „kritike” periudha e dytë e krijimtarisë filozofike të Kantit?
4. Në çfarë drejtimi Hegeli e zhvilloi „idealizmin filozofik”?
5. A mund të thoni „trijadën” e zhvillimit dialektik të Hegelit?
6. Si do ta kishit përcaktuar filozofinë e Artur Shopenhauerit?
7. Si themelues i pozitivizmit, Ogis Konti çfarë thotë për sociologjinë?
8. Interesat e kujt i shpreh dhe i mbrojnë filozofia e liberalizmit?
9. Cilët janë përfaqësuesit më të njohur të liberalizmit?
10. Numëroji përfaqësuesit e „kritikës sociale”!
11. Çfarë është esenca e anarkizmit?
12. Cilat janë format e t’huajsimi (alienimit) sipas filozofisë marksiste?
13. A mund t’i numëroni disa përfaqësues të filozofisë marksiste pas Marksit?
14. Cilat janë tri temat bosht të filozofisë së Fridrih Niçes?
15. Për çfarë e kritikon Soren Kierkegardi filozofinë e Hegelit?

„Hegeli e mohoi arsyshmërinë, por asnjë ardhmëri nuk do ta harrojë Hegelin”

E. Billohu

VI. FILOZOFIA E SHEKULLIT XX

Shkenca në shekullin XX ka arritur rezultate kolosale. Në të gjitha disiplinat shkencore si në matematikë, fizikë, biologji, etnografi, sociologji, psikologji etj, u grumbullua material i tillë faktografik, në bazë të të cilit u parashtruan shumë teori. Por, në momentin kur shkenca moderne po arrinte lartësitë më të mëdha të të arriturave të saj, filozofë të guximshëm vunë në pikëpyetje hipotezat themelore të mënyrës shkencore të të menduarit. Ata, në të vërtetë, nuk mohanin që metoda shkencore i kishte mundur njeriut një kontroll më të madhe mbi natyrën, e për këtë arsye ajo ishte një ndërmarrje mjaft e suksesshme. Por çështja filozofike ishte nëse realiteti, natyra bazë e të gjitha gjërave, ishte ashtu siç mendonte shkenca, për më tepër se mendimi shkencor i shekullit XX, pohonte se natyra përbëhet prej objekteve materiale të vendosura në hapësirë. Mendohej se materia është lëndë themelore e pandashme, nga e cila formohen të gjitha sendet. Modeli sipas të cilit mendohej përmbajtja dhe veprimi i natyrës, ishte ai i mekanikës. Të gjitha sendet e veçanta në natyrë mendoheshin si pjesë të një mekanizmi të madh. Kjo nënkuptonte që pas njëfarë kohe, veprimi i çdo pjese mund të përshkruhej me saktësi matematikore, pasi objektet materiale lëvizin në hapësirë në përputhje me rregulla ose ligje të sakta, pra si pjesë të një mekanizmi gjërat lidheshin njëra me tjetrën me një vijueshmëri të pandërprerë shkaku dhe pasoje. Edhe natyra njerëzore vështrohej nga këto aspekte materiale mekanike. Ashtu si pjesë e një makine kozmike të organizuar mjaft mirë, edhe njerëzit nuk mendoheshin „të lirë”, në zotërim të lirisë së vullnetit.

Në fillim të shekullit XX duke u mahmitur me përparimin e shkencave natyrore, si drejtim në filozofi paraqitet neopozitivizmi dhe materializmi vullgar. Por, do të paraqiten edhe synime që të përtrihen „filozofitë” e filozofëve të mëdhenj të së kaluarës prej epigoneve (ithtarëve) të tyre në formë të neokantizmit, neohegelianizmit, neoatomizmit, neofiteizmit, etj. Ndërsa nën ndikimin e darvinizmit paraqitet vitalizmi e pragmatizmi. Në shekullin XX ndikim do të ushtrojë edhe fenomenologjia, ekzistencializmi etj.

6.1. PRAGMATIZMI

Pragmatizmi është drejtim filozofik që u shfaq nga fundi i shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, së pari në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e më vonë edhe në Angli e vende tjera të Evropës Perëndimore. Sipas pragmatizmit, kriteri kryesor dhe i vetmi i të vërtetës, kuptimisë dhe vlerës së gjykimeve, përfundimeve, pikëpamjeve, teorive, bindjeve etj, është **dobishmëria e tyre, përkatësisht vetia e tyre që në praktikë, në jetën e përditshme të tregohen dhe verifikohen si të dobishme**. Fjalën „pragmatizëm” i pari e krijoi dhe e përdori mendimtari i njohur amerikan Çarls Sendër Prisi.

6.1.1. Çarls Sendër Pirs (1839-1914)

Është filozof amerikan. Ishte profesor në Baltimor, në Kembrixh dhe Boston. Është themelues i pragmatizmit amerikan, të cilin e interpreton si vazhdimësi të filozofisë së Kantit dhe të empirizimit të Hjumit. Në punimin e tij „*Si t'i bëjmë të qarta idetë tona*”, thotë se e vërteta e nocioneve qëndron në rëndësinë e tyre për përvojën dhe dobia e tyre për veprimtarinë njerëzore. Për të arritur qartësim në mendimet tona për objektet, sipas Pirsit, duhet shqyrtuar çfarë pasojash të mundshme praktike mund të nënkuptojë ky objekt. Mirëpo, realisht nuk ekzistojnë vetëm objektet e veçanta, por as raportet e përgjithshme, nuk ekzistojnë ngjarjet aktuale, por as mundësitë e tyre. Sipas Pirsit, ekzistojnë tri kategori themelore që e mundësojnë formimin e metafizikës shkencore, e këto janë: *kualiteti* (spontaniteti), *reaksionet* (aktualiteti) dhe *përfytyrimi* (mundësia). Pirs gjithashtu është i njohur edhe si logjicent që kontrobuoi në zhvillimin e logjikës simbolike.

6.1.2. Vilhem Xhensi (1841-1910)

Vilhem Xhensi është filozof dhe psikolog amerikan, i cili prej vitit 1872 profesor në universitetin e Harvardit ku ligjëroi fiziologjinë, anatominë komparative dhe psikologjinë fiziologjike. Në vitin 1876 themeloi laboratorin e parë psikologjik. Më vonë fillon të merret me filozofi duke udhëtuar në shumë vende të Evropës Perëndimore e duke u bërë anëtar i shumë akademive si i akademisë së Berlinit, Romës, Parisit etj.

Xhensi në përgjithësi konsiderohet themelues i pragmatizmit ose i „empirizmit radikal”, sipas të cilit kriter themelor i njohjes është vlera praktike e saj, dobia e saj. Shqyrtimet metafizike të zhvilluara në mënyrë të vjetër janë absurde dhe nuk rezultojnë zgjidhje të cilat do të kishin rezultate praktike. Prandaj në këto mosmarrëveshje, në të vërtetë, të dy palët mund të flasin të vërtetën, por gjithashtu mund të thuhet se asnjëra palë nuk ka të drejtë. „Metoda pragmatike në radhë të parë, është metodë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve metafizike, të cilat përndryshe do të çonin në pafundësi. Metoda pragmatike në këto raste përpiqet të shpjegojë secilën pikëpamje duke tërhequr pasojat e tyre respektive praktike”.

Për Xhemsin e vërteta në përgjithësi mund të jetë vetëm mjet ndihmës i të menduarit tonë, që përdoret në disa përvoja, por kjo pikërisht për këtë shkak nuk mund t'u përgjigjet medoemos përvojave tjera dhe t'i kënaqë njësoj. Andaj edhe është e vërtetë „*ajo që si besim u tregua se është e mirë*”.

Pragmatizmi i Vilhem Xhemsit paraqitet si pajtues i metafizikave dhe antimetafizikave, i iracionalistëve dhe racionalistëve, i materialistëve dhe idealistëve. Mirëpo, përpjekjet e „pajtimit” nuk i shpien ato te sinteza, por as te të mbledhurit eklektik, por te të lëvizurit nga vendi i problematikës në një dimension krejtësisht të ri, në sferën e praktikës, të suksesshmes, të dobishmes.

Në ontologji Xhemi është pluralist, duke konsideruar se realiteti është të krijuarit gjithnjë të ri, kështu që uniteti i qenies, përkatësisht i njohjes, si e supozon monizmi, nuk mund të jepet, por vetëm të sajohet si qëllim i fundit. Pasuria, ndërkas e gjithënjëmendësisë, që shprehet në lloje të ndryshme të përvojës, nuk mund të shpjegohet as në mënyrë moniste e as në mënyrë dualiste. Monizmi është smundje e lindur e filozofëve të cilët nuk synojnë, si mendojnë të vërtetën, por unitetin me çdo kusht, sistemin. Për këtë arsye Xhemi konsideronte se janë joreale problemet e metafizikës gjermane, ndërsa hegelianizmin e karakterizoi si smundje ngjitëse.

Empirist radikal në gnosologji, Xhemi në të njëjtën kohë pohon se të perceptuarit është i pandarë nga të menduarit. Në psikologji mbrohet tezën se jeta psikike është rrjedhë e pandërprerë e vetëdijes, ndërsa përjetimet e veçanta në të janë izolatorë artificialë. U mor gjithashtu edhe me kujtesën, ndjenjat dhe proceset tjera psikike, ndërsa kujdes të veçantë i kushtoi përjetimit religjioz.


Në formimin e krejt ideologjisë dhe të filozofisë së pragmatizmit ndikoi padyshim edhe mentaliteti afarist amerikan, i suksesit dhe i dobisë. Me gjithë rolin pasiv të saj filozofia e Xhemsit me kuptimin pluralist të tij dhe në të vërtetë me kuptimin ogonistik të së vërtetës dhe të botës si dhe me relativizimin e nocioneve në praktikën e thjeshtë, në realitet përpigjet të mohojë jo vetëm mundësitë e ekzisitimit të filozofisë, por edhe ekzisitimit të vetë botës dhe të vërtetës objektive.

6.2. INTUITIVIZMI

Intuitivizmi është drejtim i filozofisë bashkohore, sipas të cilit intuita është burim kryesor dhe i vetmi i njohjes së vërtetë dhe më të thellë. Sipas intuitivizmit, intuita është fuqi e posaçme njohëse, e cila jo vetëm që ndryshon prej arsyes, mendjes, intelektit, por njëherit është edhe e kundërta me të. Përderisa intelektit dhe shqisat kanë të bëjnë me materien, natyrën, botën inorganike që është një shkallë e ulët, primitive, e vrazhdët e realitetit, intuita ka të bëjë me realitetin e vërtetë, të njëmendët dhe më të thellë: jetë, gjallërim „evolucionit krijues” si proces i parreshtur i ndryshimeve, të lëvizjes, të zhvillimit, të krijimit të së resë. Intuitivizmi kundron se jeta e gjallë, bota organike përgjithësisht nuk mund të kuptohet

me anë të intelektit; jeta organike dhe shpirtërorja mund të kuptohen vetëm me anë të intuitës dhe në bazë të përjetimit të drejtëpërdrejtë. Përfaqësues më të njohur të intuitivizmit janë: Henri Bergson, Edmond Huserli, Vilhem Dilltaj, Benedete Kroçe, Xhon Muri, etj.

6.2.1. Henri Bergson



Henri Bergson

Henri Bergson është filozof francez, i cili pas studimit të filozofisë, shtatë vjet shërbeu si profesor në provincë. Në vitin 1900 bëhet profesor në „College de France” në Paris, ndërsa porej vitit 1914 është anëtar i Akademisë franceze të shkencave. Ishte jashtëzakonisht i popullarizuar në Francë për shkak të stilit spirituoze e elegant me plot metafora dhe paradokse, si dhe për shkak të origjinalitetit të tezave filozofike. Kështu, emri i tij u bë shpejt i njohur në botë, ndërsa në vitin 1927 mori çmimin Nobel. Veprat kryesore të Bergsonit janë, „Provë mbi faktet e vetëdijes të dhëna drejtëpërdrejtë”, „Materia dhe memoria”, „Mbi të qeshurit”, „Evolucioni krijues”, „Dy barime të moralit dhe të fesë”, etj.

E gjithë filozofia, sipas Bergsonit, mbështetet në dallim esencial ndërmjet të menduarit konceptual (logjik) dhe intuitës. Zhvillimi i vetëdijës, thotë ai, ka ecur në dy drejtime divergjente: në njërin anë, në drejtim të vetëdijës konceptuale (logjike) e në tjetrën

anë, të intuitës. Mendimi logjik nuk mund të depërtojë deri në esencën e jetës, nuk mund ta njohë natyrën e vërtetë të jetës. Këtë mund ta bëjë vetëm vetëdija intuitive, e cila ndodhet në esencën e artit. Objekt i të njohurit, i vetëdijes logjike e racionale, sipas Bergsonit, është ajo tashmë e cila përsëritet pandërprerë, por kurrë nuk është e dhënë në formë të rrjedhës kohore. Ky veprim i të menduarit çdoherë është moment i ndalur i kohës, kjo është vetëm materia jo e gjallë, materia e cila nuk zhvillohet.

Sipas Bergsonit, intelekt i është aftësuar vetëm për atë që është artificiale dhe e vdekur. Së këndejmi intelekt i pëson disfatë dhe zhgënjën sa herë që synon ta njohë jetën e gjallë „evolucionin krijues”, si diçka që kurrë nuk do të përsëritet. Konceptet logjike janë të kurdisura sipas modelit të botës së vdekur materiale, sipas trupave të ngurtë, prandaj janë krejtësisht të papërshtatshme për hulumtimin, njohjen dhe shpjegimin e jetës si realitet më i thellë. „Intelekti, – thotë Bergsoni, – karakterizohet me një moskuptim natyror të jetës”. Përderisa intelekt i hulumton të gjitha sendet në mënyrë mekanike, instikti vepron, si të thuash, në mënyrë organike. Intuita është ajo që shpie drejt në brendinë, esencën e jetës. Aftësia e intuitës për ta kuptuar jetën, atë që është prore dinamike dhe asnjëherë një e njëjtë,

pason nga lidhja e saj me instiktin, i cili është i shkrirë sipas kallëpit të jetës. Prandaj, sipas Bergsonit, filozofimi shënon përpjekjet që me anë të intuitës të depërtohet në brendinë e objektit, ngase vetëdija intuitive është të njohurit që i përket rrjedhës kohore, vazhdimësisë, kontinuitetit. Realiteti inorganik, material, është sitem i gjërave dhe i fenomeneve të diskontinuara. Jeta është kontinuitet, proces i përhershëm, krijim i pandërprerë. Në materien inorganike çdo gjë mund të parashihet, ngase aty nuk ka zhvillim. Në jetë nuk mund të parashihet asgjë, në të dominon origjinaliteti dhe invencioni absolut.

Vetëdija racionale, intelegjenca, është e zhvilluar në marrëdhënien praktike të njeriut ndaj materies inorganike. Qëllimi themelor i intelegjencës është që të përgatisë aksionin tonë të orientuar nga sendet, nga objektet e natyrës së vdekur. Intelegjenca është aftësi që për një situatë të dhënë t'i parashihë pasojat e përshtatshme dhe të papërshtatshme, të cilat mund të rrjedhin prej tyre. Me rastin e këtij parashikimi intelegjenca nxjerr prej situatës së dhënë atë që është e ngjashme me të njohurën, sepse parimi i veprimatrisë së saj është: „*e njëjta prodhon të njëjtën*”. Vetëm në bazë të këtij parimi është i mundshëm zhvillimi i aftësisë për të parashikuar. Për intelegjencën ekziston vetëm realiteti i përsëritjes, kjo i ndan tërësitë organike në pjesët përbërëse dhe kërkon në to atë që është uniforme, atë që përsëritet. Nga këtu, edhe shkencat synojnë të njëtën gjë, të zbatojnë „metodën kinematografike”, t'i zbërthejnë tërësitë organike për të dominuar mbi pjesët. Në anën tjetër, „zgjatja”, koha, jeta janë krejt diçka, krejtësisht të ndryshme prej sistemit të sendeve dhe raporteve në botën e vdekur. Jeta, thotë Bergsoni, nuk zhvillohet sipas kurrëfarë programi të caktuar më parë. Nëse ky program ekziston, koha bëhet përsëri e tepërt, sepse atje ku çdo gjë që më parë është e planifikuar nuk ka krijime dhe inovacione. Nocioni i qëllimit ekziston vetëm në kuadrin e veprimit praktik, i cili është i drejtuar nga objektet e vdekura. Parimi i kauzalitetit - ku në bazë të përsëritjes parashikohet e ardhshnja, dhe parimi i qëllimshmërisë - ku ndërtohen plane për manipulim me objektet inorganike, nuk depërtojnë deri tek esenca e asaj që ndodh me të vërtetë. Vetë intelegjenca së cilës i shërbejnë këto parime, ka rëndësi të madhe praktike, por të njohurit e esencës së ndodhive, ajo medoemos duhet t'ia lëshojë vendin intuitës. Ndërkaq, intelegjenca dhe intuita në dallim të evolucionit të njeriut kanë qenë të dhëna së bashku në instiktet fillestare njerëzore, ndërsa më vonë janë ndarë definitivisht.

Vetëdija intuitive mbështetet në instikt, intuita është „instikt i vetëdijshëm”. Intuita na çon drejt brendisë së jetës, atë nuk e intereson bota e sendeve dhe qëllimet praktike. Forma më e shprehur për intuitën është arti. Përmes artit flet vetë esenca e jetës. Filozofia e cila synon ta njohë këtë esencë të jetës patjetër duhet të mbështetet në intuitë. Duke e kundërshtuar pozitivizmin, sipas të cilit shkenca është i vetmi kriter i të vërtetës, Bergsoni formuloi pikëpamjen karakteristike iracionaliste gnosologjike. Në kohën derisa jetoj ky mendimtar francez, filozofia e tij pati jehonë dhe ndikim të madh në Francë, e mandej edhe më gjerë. Pas Luftës së Dytë Botërore ky mendim bie në fund për t'u zhdukur plotësisht duke u zëvendësuar me ekzistencializmin dhe drejtime tjera në filozofinë bashkohore.

6.3. FROJDI DHE FROJDIZMI

6.3.1. Zigmund Frojd (1856-1939)



Zigmund Frojd

Zigmund Frojd, psikolog dhe psikiatër austriak, është themelues i psikoanalizës. Ishte profesor në Vjenë, ndërsa me ardhjen e fashistëve në pushtet u detyrua të emigrojë. Teoria e tij mbi jetën psikike ndikoi jo vetëm në zhvillimin e psikologjisë, por me modifikime të ndryshme dhe korrekture të shumta është e pranishme edhe në disa teza filozofike deri në kohën tonë, ndonëse vetë Frojdi refuzon vendosmërisht që t'i atribuohet çfarëdo intence filozofike konceptcionit të tij „natyror-shkencor”. Veprat më të rëndësishme të tij janë: *„Psikologjia e jetës së përditshme”, „Hyrje në psikoanalizë”, „Interpretimi i ëndërrave”,* etj.

Nocioni i nënvetëdijes është kategori fundamentale e psikoanalizës së tij. Duke konsideruar se themeli i krejt jetës është në sferën e cila është krijuar duke ndrydhur instiktin, para së gjithash atë libidinoz, në sferën e nënvetëdijes ai pohon se pikërisht

kjo sferë qenësisht përcakton të gjitha aktet tona të vetëdijshme. Të ndrydhurit (zbrapsja), mosplotësimi i kënaqësisë së plotë të instikteve seksuale rezulton me neuroza të ndryshme, ekecese patologjike, gabime në shkrim dhe në të folur, etj. Zbulimi i sferës së nënvetëdijshme, që i takon Frojdit, paraqet një zbulim jashtëzakonisht të rëndësishëm, relevant, sidomos për shpjegimin më të thellë të disa fenomeneve jo vetëm psikike, por edhe të përgjithshme kulturore.

Me zbrapsjen e instiktin libidinoz në të vërtetë nuk krijohen medoemos neurozat: në manifestimet e sublimuara të instiktin të paplotësuar shfaqet për shembull arti. Artisti kryesisht për shkak të nevojave të fuqishme instiktive është i paaftë të gjendet në realitetin praktik, prandaj i drejtohet botës së imagjinuar dhe në të gjen kompensimin për plotësimin e drejtpërdrejtë të dëshirave të veta. Nga kjo botë fiktive e artit nuk është larg shpeshherë rruga deri te neurozat. Mirëpo, artisti me anën e mekanizmit mbrojtës, domethënë me anën e aftësive të sublimimit, ndonëse ka pësuar disfatë në jetë dhe e ndien veten të vetmuar, prapëseprap gjen ngushëllim në faktin se u ofron ngushëllim joartistëve. Ndërkaq, bukuria në vetëvetë nuk u takon qëllimeve të drejtpërdrejta të artistit: për të pikërisht janë të rëndësishme problemet jetësore; bukuria i shërben vetëm si armë për mbrojtje dhe për lehtësimin e vështirësive. Neurotikët nuk e kanë këtë armë, kështu që u bëhet e pamundur rruga në realitet.

Në ëndërrat si dhe në religjionet e mitet manifestohet gjithashtu bota e dëshirave të perealizueshme, të zbrapsura. Gjithë simbolika që krijohet pikërisht për shkak të censurës dhe të pamundësisë që të shfaqen drejtpërdrejt impulset libidinoze, këta censorë nuk flejnë as në kohën e ëndërrave, mund të kuptohen duke i reduktuar në format e veta të pacenzuruara.

Shpjegimet e ëndrrave zbulojnë dëshirat dhe qëllimet sekrete, mandej edhe atëherë kur iluzorisht duket se janë të karakterit të kundërt.

Impulsi themelor dhe thelbi i gjithë mësimave të Frojdit si dhe një varg veprash teorike të jashtëzakonshme të tij qëndrojnë në synimin e tij që sa më shumë të eliminohet cenzura e përhershme, e cila pengon të shprehurit e lirë të impulsive, që këto të depërtojnë pa pengesa në pjesët e errëta, burgjet e tyre, që të shprehet në mënyrë autentike njeriu i vërtetë, burimor e jo i rremë e hipokrit; që në asociacionin e drejtpërdrejtë të zbulohen gjurmët e veprimtarisë jonjerëzore të njeriut.

Prandaj metoda fundamentale e shërimit psikoanalitik qëndron në faktin që, duke i bërë të vetëdijshme elementet e ndryshme të nënvetëdijes që shfaqet te pacienti, shpesh për shembull edhe në mënyrë simbolike në ëndrra të zbulohen shkaqet e vërteta të neurozave me anën e asociacioneve të lira dhe nëpërmjet bisedave.

Teoria e tij mbi egon, mbi kompleksin e Idipit, mbi ëndrrat, mbi shkaqet e ndryshme të perversioneve, mbi krijimin dhe përjetimin e artit, shpjegimi i tij i totemit dhe i tabusë, si dhe një sërë e tërë tezash mbi strukturën psikike dhe sociale të popujve primitivë, patën, e në masë të konsiderueshme kanë edhe sot, ndikim jashtëzakonisht të madh në shumë vazhdues dhe popullarizues të psikoanalizës në gjithë botën, dhe në fusha të ndryshme shkencore, prej psikologjisë, psikiatrisë e deri te sociologjia, estetika dhe filozofia e kulturës. Ndërkaq, sot njëkohësisht provohet edhe një sërë e tërë e njëanshmërive dhe i tezave joshkencore, të ndara dhe të pavërtetuara dhe i teprimeve plauzibile me të cilat, duke e reduktuar krejt jetën në elementet e instikteve libidinoze, janë të pasura veprat e Frojdit.

Në studimet e mëtutjeshme shpjegimin e tij të psikologjisë individuale Frojdi e zgjeroi edhe në psikologjinë e masave dhe të kulturës. Frojdi mendon se **civilizimi** mund të përcaktohet si „*shumë e aktiviteteve dhe vlerave të dobishme për njeriun, për t'u nënshtruar toka në shërbim të tij dhe të mbrohet kundër forcave të natyrës*”. Njeriu në këtë mënyrë tenton të bëhet i ngjashëm me Zotin, por megjithatë është i pafatshëm. Kjo vjen nga fakti se civilizimi kërkon heqjen dorë prej instikteve. Kjo dorëheqje e imponuar nga kultura (civilizimi) i përcakton marrëdhëniet sociale. Në këtë mënyrë civilizimi është në mënyrë të domosdoshme represiv, ndërsa restriksioni i jetës seksuale është i pashmangshëm. Civilizimi, thotë Frojdi, e pengon edhe agresivitetin, prandaj me këtë duket se është e pamundshme të krijohet lumturia, se duke e dënuar njeriun që t'i nënshtrohet parimit të realitetit, ai e bën të palumtur dhe së këndejmi „jokomoditetet e kulturës” janë të pashmangshme. Frojdi në krijimin e mëvonshëm të tij, te njeriu gjen arenën e dy instikteve njësoj të fuqishme: erosin dhe tanatosin, instiktin për jetë dhe instikti për vdekje, instiktin për ndërtim dhe instiktin për asgjësim.

6.3.2. Frojdzimi

Pas paraqitjes së veprës së Frojdit, përkatësisht psikoanalizës së tij, veprimtaria psikoanalitike si teori dhe praktikë filloi të përhapet, sidomos në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ajo filloi të përhapet në formë të psikologjisë, filozofisë, etikës e estetikës etj, si doktrinë e tij bashkohore e cila paraqet modifikimin dhe zhvillimin e mëtejshëm në kushte të reja të parimeve të psikoanalizës klasike të Zigmund Frojdit. Për ndryshim prej Frojdit, pra, psikoanalizës klasike, e cila theksonte në mënyrë të tepruar dhe të njëanshme atë që

është e bashkëlindur në jetën psikike të njeriut, për shmebull komplekset e ndryshme psikike, të pavetëdijshmes në përgjithësi dhe të motiveve seksuale „libidos” në veçanti në formimin e formësimit e karakterit, moralit, orientimit vlerësues, të qëndrimeve, sjelljeve të njeriut etj. Pasardhësit e Frojdit, duke e pranuar vlerën e të gjitha këtyre, ngulmonin në rolin shumë të rëndësishëm të marrëdhënieve shoqërore, ndërpersonale dhe të përjetimeve të njeriut në moshën fëmijërore. Ata e refuzojnë tezën e psikoanalizës klasike të Frojdit mbi ndarjen e krejt fuqisë motivuese të njeriut në dy motive: në eros dhe tanatos, në motivin për jetë e dashuri dhe në atë për vdekje e zhdukje. Pasardhësit e Frojdit angazhohen rreth çështjeve të moralit të njeriut, çështjeve se si duhet të jetojë e veprojë njeriu, çështje që këto Frojdi i nënçmoi. Pasardhësit e Frojdit janë mendimtarë me orientime të ndryshme filozofike të filozofisë bashkohore, si marksizmi, strukturalizmi, ekzistencializmi dhe psikologjizmi me psikologët Henri Shtik Saliven, Koren Hanri, etj.

Alfred Adleri (1870-1937) ishte gjithashtu një personalitet i madh në fushën e psikoanalizës, por me kalimin e kohës u nda nga pikëpamjet e Frojdit. Sipas Adlerit, nuk është seksualiteti faktori përcaktues, por instikti i fuqisë, tendenca për të qenë i vlefshëm, nevoja për të plotësuar një ndjenjë të turbullt, inferioriteti me të cilin ndeshet çdo qenie njerëzore.

Karl Gustav Jungu (1875-1961) ushtroi ndikim të jashtëzakonshëm në kritikën letrare, ashtu si edhe mbi imagjinatën krijuese, mbi kërkimet në fushën kulturore dhe, në një mënyrë të përgjithshme, mbi artin e kohës sonë. Sipas tij, ekziston një pavetëdije kolektive ku ndodhen arketipat e përbashkët, modelet themelore të sjelljes. Bëhet kështu e mundur të zhvillohet një psikoanalizë e kulturave të ndryshme: jo ajo e individëve, por e kulturave.

6.4. METODA FENOMENOLOGJIKE

6.4.1. Edmund Huserli (1859-1938)



Edmund Huserli

Fenomenologjia është shkencë për format dhe përmbajtjet ideale të aktivitetit të vetëdijshëm njerëzor. Themelues i fenomenologjisë, si një nga drejtimet e filozofisë bashkohore, është Edmund Huserli, autor i veprave të njohura si „*Hulumtime logjike*”, „*Idetë lidhur me një fenomenologji të pastër dhe fincedentale*”, etj, të cilat ushtroan ndikim të madh jo vetëm në lëmin e filozofisë e të shkencave, por edhe në mbarë kulturën e Evropës e më gjerë.

Huserli u lind në gjysmën e dytë të shekullit XIX, në Mohern, në një familje tregtarësh çifutë në Gjermani. Studioi astronomi, matematikë e fizikë, por mbi të gjitha ai interesohej për logjikë. Filozofi Frans Brentano ushtroi mbi të një ndikim të fuqishëm; ai përpunoi në një mënyrë vendimtare disa nga problemet e shtruar prej Huserlit, që më vonë kontribuan shumë për përpunimin e asaj që së shpejti do të merrte emrin fenomenologji. Huserli ishte

profesor në Göttingen dhe në vitin 1916 në Freiburg, atje ku Martin Hajdegeri kohë pas kohe u bë kolegë i tij. Në vitin 1933 Hitleri e mori pushtetin. Ai i ndaloi çifutët të frekuentonin ndërtesat universitare dhe bibliotekat. Në kohën kur Huserli u ndodh i përjashtuar nga Biblioteka e Universitetit, Hajdegeri u bë rektor i emruar nga pushteti i ri. Bile mu në kohën kur Hajdegeri, kolegu dhe ish nxënësi i tij, që i detyrohej shumë, ishte rektor, Huserli u përjashtua nga profesoriati. Falë disa ndërhyrjeve në mbrojtje të tij, më vonë gjërat ecën pak më mirë për të. Kurrë nuk u largua nga Gjermania, përkundrazi ndërmori më tepër se çdoherë tjetër një përpjekje për të mbrojtur „racionalizmin” ashtu siç e kuptonte ai, kundër tendencave iracionaliste që shpërthyen gjatë sundimit hitlerian derisa arriti të sundojë skenën filozofike. Vdiq në prag të Luftës së Dytë Botërore. Që në të gjallë të tij Huserli pa përhapjen e gjerë të fenomenologjisë, kësaj shkolle të cilën e krijoi vetë ai. Nga fundi i jetës provoi një ndjenjë të thellë vetmie dhe moskuptimi prej mjedisit që e rrethonte. Por ajo që ishte më e dhembshme për të, ishte ndarja përherë e më e thellë ndërmjet tij dhe Hajdegerit.

Huserli në filozofinë e tij fenomenologjike synon të përgjigjet në marrëdhënien ndërmjet ndërgjegjes dhe botës, prandaj do të fillojë luftën e tij e do të mbrohet prej tri drejtimeve: 1. **Ai u hodh kundër psikologjisë e introspeksionit.** Në asnjë mënyrë ai nuk dëshiron të ngatërrohet me ato që pretendojnë t'i gjejnë themelet e sigurisë në përshkrimin e gjendjeve të brendshme të ndërgjegjes. Huserli mendonte se gjendjet psikike, që ne mund t'i vëzhgojmë, me anë të introspeksionit, janë për ne objekte, po aq sa edhe objektet e botës së jashtme; këto janë objekte psikike, por megjithatë janë objekte. Huserli, pra, nuk dëshiron të ketë të bëjë me një subjektivizëm të ndërgjegjes, përkatësisht me psikologjinë. 2. **Ai, pastaj hudhet kundër Dekartit,** edhe pse kishte admirimi të madh për të. Përkundrazi, Huserli mendon: atë që mendimi e mendon në mënyrë origjinale nuk jemi ne që e ndërtojmë, ne, thotë ai, duhet të kënaqemi duke e përshkruar. 3. Në fund Huserli, **hudhet kundër Kantit e kantizmit,** pikërisht për të mos u lejuar elementëve të errët të arrijnë të errësojnë procesin e drejtëpërdrejtë të përjetimit, ngase Huserli dëshiron të krijojë filozofinë e vërtetë.

Sipas Edmund Huserlit, objekt i analizës dhe i kërkimeve fenomenologjike janë sendet e kulluara, esenca ideale, e jo kurse si vetë sendet, raportet apo proceset reale empirike, me studimin e të cilave duhet të merren shkencat e veçanta. Ithëtarët e fenomenologjisë, e para së gjithash vetë Huserli, insistojnë që vetë sendet, faktet, dukuritë ndijore të shumëllojshme të „futen në kllapa” përkatësisht abstraktohen, dukjet e tyre të drejtëpërdrejta empirike - reduksioni idetik me mendimet e mëparshme për atributet e gjësendeve - reduktimi fenomenologjik dhe të mos merren parasysh ato të dhëna që nuk janë objekte, përkatësisht koreleat i vetëdijes - reduksioni transcendent. Sipas mendimit të tij, filozofia si shkencë e saktë duhet t'u kthehet sendeve si të tilla, përkatësisht esencave të tyre të kulluara. Deri tek ato esenca të kulluara mund të arrihet me anë të ideacionit, përkatësisht shikimit të drejtëpërdrejtë në esencë. Huserli ishte i mendimit se mund të vihen bazat e shëndosha kritike jo vetëm të mendimit shkencor, por, për më tepër, edhe të mbarë kulturës në përgjithësi.

Huserli konsideron se në vetëdijën e kulluar ekzistojnë shtresa të ndryshme të përjetimit intencional si vlerësimi, të njohurit, dashuria e tjera, kështu që në formë speciale të reduksionit në të ashtuquajturin reduksion transcendent zbulohet edhe esenca e përjetimeve të

kulluara. Përveç problemit të analizës së mendimit dhe fushës së mendimit, Huserli i analizoi edhe strukturat korelate të tyre dhe kështu **fenomenologjia paraqet, përveç esencës dhe formave të përgjithshme të lidhjes së vetëdijes teorike, edhe vetë strukturat analitike të sferës transcendente, domethënë të sferës intersubjektive të ekzistimit.** Ajo në të ashtuquajturat „ontologji rajonale” zbulon fusha të ndryshme të qenies nga sendi i vdekur nëpër sferën animale deri te sfera shpirtërore dhe frymore.

Përveç etikës, estetika është ajo fushë në të cilën shfaqen zbulimet më të shumta të fenomenologjisë. Në këto suaza Huserli prej pozitës së vet të përgjithshme filozofike kërkoi që përkundër psikologjizmit, të studiohet esenca e veprës artistike në përgjithësinë e kulluar dhe të zbulohet apriori materiali i artit në ontologjinë përkatëse rajonale.

Fenomenologjia e Huserlit ka ushtruar ndikim të madh, veçanërisht në katër dekadat e para të shekullit XX. Nën ndikim e fenomenologjisë ishte në fillim edhe ekzistencialisti i njohur **Martin Hajdger**; themeluesi i antropologjisë filozofike **Maks Sheleri**, i cili e aplikoi metodën fenomenologjike në lëmin e vlerave dhe kulturës në përgjithësi; **Roman Ingardeni** e zbatoi me sukses fenomenologjinë e Huserlit në fushën e artit, ndërsa përfaqësuesi i vitalizmit **Hans Drishi** këtë e bëri në fushën e biologjisë etj.

6.4.2. *Bertrand Rasell (1872-1970)*

Bertrand Raselli është filozof anglez. Matematikën dhe filozofinë i studioi në Kembrixh, ndërsa prej vitit 1910 deri më vitin 1916 ka qenë ligjërues në të njëjtin universitet. Në kohën e Luftës së Parë Botërore u burgos për shkak të refuzimit të shërbimit ushtarak, me ç'rast humbi vendin e përhershëm të punës, mirëpo së shpejti u bë shumë i popullarizuar për shkak të tezave të guximshme e progresive për çështjet e ndryshme shkencore, sociale e politike. Si mysafir ligjëroi në Universitetin e Oksfordit, të Pekinit, të Çikagos dhe të Los-Anxhelosit. Në vitin 1950 fitoi shpërblimin Nobel për letërsi. Politikisht ishte i afërt me krahun e majtë të partisë laburiste dhe kundërshtar konsekuent i armatimit dhe të „çmendurisë së luftës së ftohtë”, ishte edhe kryetar i gjyqit për vërtetimin e krimeve të luftës në Vietnam. Veprat kryesore të Rasellit janë: „*Historia e filozofisë së perëndimit*”, „*Parimet e matematikës*”, „*Problemet e filozofisë*”, etj.

Sipas Rasellit, misioni i filozofit qëndron, para së gjithash, në luftë për të vërtetën. Nëse profesioni i shërben për diçka tjetër dhe jo për kërkimin e paanshëm të së vërtetës, ai bën tradhëti, për të cilën moralisht është përgjegjës. Ndërkaq, e vërteta duhet të jetë shikencërisht e bazuar, larg të gjitha paragjyqimeve, pa intolerancë, ekzakte dhe jopersonale, sepse vetëm kështu do të mundësojë simpatinë edhe mirëkuptimin ndërmjet njerëzve. „*Në konfliktin e ashpër të fanatizmit, fuqia e vogël e cila vepron në drejtim të unitetit është shkenca...*”, duke e trajtuar filozofinë, sipas fjalëve të tij, „nëpërmjet metafizikës”. Raselli shtron tezën se të gjitha aksiomat matematike mund të reduktohen në parime logjike. Kërkesa e tij e sakësisë metodike që i kundërvihet „konfuzionit të fanatizmit” dhe „i privuar nga synimet lokale dhe sentimentale” e shpuri te realizmi skeptik dhe nën ndikimin e Peanos dhe të Freges, „me gjithë natyrën epokale

të zbulimeve të veta Frege mbeti fare i paafirmuar derisa unë nuk i kushtova këtij kujdes në vitin 1903", zhvilloi një filozofi specifike të matematikës në kuadrin e së cilës ndërtoi sidomos logjikën matematike. Përmjes kësaj rruge të analizës logjike, sipas Rasellit, mund të arrihet e njëjta shkallë e sigurisë të cilën e posedon matematika e pastër.

Në gnosisologji, të cilën e fillon me kritikën e pragmatizmit dhe me aprovimin e teorisë specifike të së vërtetës si korrespondencë, Raselli më vonë dallon njohjet **me anën e njohurive të drejtpërdrejta dhe njohje me anë të përshkrimit**. Në kuadrin „e filozofisë së atomizmit logjik” të tij, ndikoi te Ludvig Vitsenshtaini, por edhe ai ndikoi mbi Rasellin. Raselli paraqet pohimin se **substancia, materia dhe vetë sendi i veçantë nuk janë realitete, por konstruksione logjike**. Sipas tij, bota përbëhet nga „parakonstruksioni” neutral, që nuk është material e as spiritual. Në një varg veprash Raselli merret edhe me të ashtuquajturën gjuhë ideale, e cila sipas strukturës së saj, do të ishte shumë e ngjashme me strukturën e fakteve që shënon. Struktura e kësaj gjuhe të përfytyruar ideale është e tillë, që ajo vërtet është e përdorshme në jetën e përditshme, por mund të bëhet armë e cila do të zhvillojë mjaft logjikën dhe shkencën në përgjithësi.

Problemet etike dhe problemet e vlerës, sipas Rasellit, ndonëse janë pjesë përbërëse e filozofisë, duhen veçuar prej trajtimit shkencor: metodat shkencore, – thotë ai, – të lënë në rrugë kur është fjala në radhë të parë për ndijimet. Shkenca gjithashtu nuk mund të vërtetojë, për shembull, se jeta ka kuptim, se është mynxyrë të kënaqesh me brutalitet e të tjera. Prandaj edhe **filozofinë e natyrës**, e cila ka të bëjë me atë që është, duhet dalluar prej **filozofisë së vlerës**, sipas së cilës, ne, krijuesit e vlerës, jemi „mbretër” dhe kështu degradojmë mbretërinë tonë vetiake nëse i nënshtrohemi natyrës.

Duke pasur qëndrim kritik ndaj kulturës dhe jetës shoqërore, të botës bashkohore të qytetëruar, Raselli konsideron se prona private dhe shteti janë bërë në botën moderne rrezik për shoqërinë. Të gjitha „fuqitë kulturore”, si shteti, kisha dhe edukimi, dështuan **lidhur me zgjidhjen e problemeve themelore sociale dhe nuk qenë të afta të analizonë absurditetin e luftës**. Ateist dhe pacifist i bindur, i cili subjektivisht nuk pranon „kurrfarë ligjësisht në histori”, Raselli shkroi në formë të paradokseve spirituoze dhe të ironive të guximshme në punimet e veta publicistike të angazhuara dhe pa paragjykime, në mënyrë optimiste e racionaliste e orientoi mendimin e tij, shpesh edhe me luftë praktike për një mënyrë më njerëzore të jetës, që supozon edhe „zvogëlimin permanent të fanatizmit dhe shtimin e aftësive të simpatisë dhe të kuptimit reciprok”. Ndërkaq, krahasimet dhe vlerësimet e tij kulturore historike e sidomos filozofiko-historike, në të cilat e akuzon Marks, herë-herë tregojnë të meta të caktuara të të pamenduarit filozofik, mandej edhe elemente të cilat, për shkak të synimit të spiritualitetit dhe popullaritetit kufizohen me vullgarizime si krahasimet e tij të Marksit me shpëtuesin, Partinë Komuniste me Kishën, proletariatin me popullin e zgjedhur, revolucionin me arritjen e mbretërisë qiellore etj.

Mirëpo, të gjitha këto, nuk mund ta mohojnë jo vetëm vlerën e disa konkluzioneve mendore lucide të tij, por as rolin shoqëror jashtëzakonisht pozitiv të këtij bardi të filozofisë angleze, e cila u shpreh në angazhimin humanist të tij kundër të gjitha formave të dehumanizimit dhe degradimit të njeriut e të bashkësisë njerëzore, kundër të cilave me pasion luftoi deri në fund të jetës.

6.5. NEOPOZITIVIZMI

Neopozitivizmi është rrymë shumështrësore e filozofisë bashkohore, e cila paraqet rringjalljen, aktualizimin, riafirmimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të tërë traditës pozitiviste. Në formimin e neopozitivizmit me rëndësi vendimtare kanë qenë pikëpamjet e Bertrand Rasellit dhe Ludvig Vitgenshtainit. Tipari esencial i neopozitivizmit është refuzimi „i metafizikës”, përkatësisht i filozofisë si gjoja pseudoshkencë dhe i çështjeve „metafizike”, përkatësisht çështjeve filozofike si gjoja çështje të paçështje „pseudoprobleme”, të cilat si të tilla, fare nuk e zgjerojnë diturinë tonë të njëmendët. Qëndrimi i këtillë i neopozitivizmit ndaj filozofisë tradicionale mbështetet në supozimin skeptik, agnostik dhe „metafizik”, se për realitetin e jashtëm material në përgjithësi si „materia”, „koha”, „hapsira”, „gjësendet në vetëvete” etj, dhe për jetën shpirtërore në përgjithësi si „vetëdija”, „fryma”, „shpirti”, „ideja” etj, nuk mund të dijmë me siguri asgjë dhe si rrjedhojë logjike e kësaj, nuk mund të themi asgjë që do të kishte kuptim e domethënie, kurse „për atë që nuk mund të thuhet asgjë duhet patjetër të heshtet”, thotë Vitgenshtaini, korifeu i neopozitivizmit.

Konceptet dhe gjykimet si koncepte e gjykime „metafizike”, sikurse edhe gjykimet etiko-morale, estetiko-artistike, sociologjike etj, si gjykime vlerësuese, nuk mund të kenë mbështetje dhe karakter shkencor, ngase nuk kanë korelat njëmendësor gjeigjës, dhe si të tillë, nuk mund të verifikohen në mënyrë empirike, përkatësisht në bazë dhe me anë të përvojës. Pra, ajo që nuk mund të verifikohet, ajo që nuk i përballon parimit të verifikimit nuk mund të jetë as shkencore, e as e vërtetë. Së këndejmi, sipas neopozitivizmit, filozofia mund të ekzistojë dhe të jetë e dobishme vetëm si filozofi shkencore, si logjikë e shkencës, si analizë logjike e gjuhës, detyrë e së cilës do të ishte sigurimi, saktësimi logjik i domethënies, kuptimit të koncepteve, kategorive etj, të shkencave të veçanta, „pozitiviste”. Themelues të neopozitivizmit konsiderohen po ata filozofë e shkencëtarë, të cilët në vitin 1929 e themeluan „Rrethin e Vjenës” me Moris Shlikun, Rudolf Karnapin dhe Oto Nojratin në krye. „Rrethi i Vjenës” angazhohej për një „botëkuptim shkencor”, i cili do të jetë diç i ri, revolucionar e antimetafizik.

Influenca e neopozitivizmit ishte e madhe. Së shpejti u paraqitën nuanca e rryma të reja brednapërbrënda neopozitivizmit, siç janë: „Shkolla e Varashavës” dhe „e Lëvovit” me K. Ajdukoviçin në krye, drejtim pozitivist pragmatik me P. V. Brixhmen e Ç. Morisin etj. Pastaj u paraqitë filozofia e analizës gjuhësore linguistike me Xh. Mur, Xh. Ostin, Xh. Rajl etj; filozofia linguistike e A. Zh. Ajerit dhe K. Poperit etj. Herë-herë neopozitivizmi, natyrisht e gjeti shprehjen e vet edhe në fusha tjera shkencore e teorike, si në sociologji, etikë etj.

Etika neopozitiviste është antintektualiste, intuitiviste dhe emativiste. Gjykimet morale nuk mund të jenë të vërteta ose të rrejshme, ngase nuk mund të verifikohen në mënyrë empirike, përkatësisht me anë të përvojës. Si të tilla konceptet dhe gjykimet morale nuk mund të kenë domethënie objektive shkencore. „Filozofia etike qëndron në konstatimin se konceptet morale janë pseudokoncepte dhe se nuk mund t’i nënshtrohen analizës”, thotë I. Ayer. Morali është çështje subjektive dhe vlerësore. „Secili ka të drejtë ta shtjellojë imperativin e vet moral dhe të kërkojë që të gjithë njerëzit e tjerë të veprojnë në ujdi me këtë imperativ”, thotë Hans Rojenbahu. Neopozitivistët e ndryshëm si S. Tulmin, R. Hear, A. Mantefiore, E. Hejken etj, janë për zëvendësimin e etikës si „metafizikë” e moralit me një metafizikë, e cila do të merrej

me hulumtimin e çështjes së domethënies së gjykimeve të përveçme morale dhe të logjikës së gjuhës morale në përgjithësi, mendojnë ithtarët e Shkollës së analizës linguistike të moralit.

6.5.1. Ludvig Vitgenshtain (1889-1951)

Gjatë jetës së furishme, sipas fjalëve të tij, jetës „së çuditshme” të tij, ndërroi shpesh profesionet dhe u mor me fusha të ndryshme të dijes, si matematikë, muzikë, pedagogji, medicinë, arkitekturë e disa herë braktisi studimet e filozofisë. Por, prej profesioneve të shumta, kënaqësi të vërtetë i jepte vetëm filozofia. Thonë se njëherë iu drejtua B. Rasellit dhe e pyeti: „Ju lutem a mund të më thoni a jam idiot total apo nuk jam... Nëse jam idiot total, do të bëhem aeronaut, por nëse nuk jam do të bëhem filozof”. Raselli, mësuesi i tij, i cili më vonë u konsiderua edhe nxënës i tij, e këshilloi të mos bëhet aeronaut. Ishte edhe profesor në Kembrixh dhe pa marrë parasysh numrin relativisht të vogël të veprave - për të gjallë botoi vetëm „*Traktatin logjik-filozofik*” dhe dy artikuj më të shkurtër, gjithsej 100 faqe, Vitgenshtaini është një ndër filozofët më me influencë të shekullit njëzet. Te Vitgenshtaini, me më pak ose me më shumë të drejtë, mbështeten filozofët e shkollës logjike-pozitiviste si dhe mendimtarët nga e ashtuquajtura filozofi e gjuhës së zakonshme. Ky drejtim mbështetet në veprën e tij, që u botua pas vdekjes së tij, „*Kërkimet filozofike*”.

Për të pohuar ndonjë fjali në përgjithësi, ndonjë fakt, sipas Vitgenshtainit, duhet të ekzistojnë diçka e përbashkët në strukturën e fjalisë dhe në strukturën e fakteve. Kjo, e përbashkët, ndërkaq në realitet nuk mund të shprehët. Vitgenshtaini krejt kuptimin e traktatit të vet original dhe të njohur e redukton në këto fjalë: „Ajo që përgjithësisht mund të thuhet, mund të thuhet qartë; kurse për atë që nuk mund të flitet, për këtë duhet të heshtim”. Ai konsideron se ky libër duhet të caktojë „kufirin e të menduarit, ose më saktësisht - jo të menduarit, për të shprehurit e mendimeve: sepse për ta caktuar kufirin e të menduarit, do të duhej të mundnim të mendojmë të dy anët e këtij kufiri (do të duhej, pra, të mund të mendojmë atë që nuk mund të mendohet)”. „Për këtë shkak, përfundon Vitgenshtaini, kufiri mund të caktohet, vetëm në gjuhë, dhe ajo që qëndron në anën tjetër të kufirit, do të jetë thjeshtë absurditet”. Filozofia e „Traktatit” të Vitgenshtainit është filozofi e të-pashprehëshmes, që përdor, „atomizmin logjik si mjet ndihmës të vetin”, – do të thotë Gojo Petroviq.

„Traktati” i Vitgenshtainit përbëhet prej shtatë tezave kryesore të shprehura me fjali të shkurtëra, një varg vërejtjesh në lidhje me tezat kryesore, vërejtje pranë vërejtjeve dhe vërejtjet e pranë vërejtjeve, për vërejtjet ai konkludoi në mënyrë skeptike se realisht nuk mund të flitet në formë mediative për problemet e vërteta filozofike.

Qëllimi i filozofisë, sipas Vitgenshtainit, është të sqaruarit logjik të mendimeve, mirëpo filozofia nuk është teori, por, para së gjithash, aktivitet. Rezultat i veprës filozofike nuk janë disa „qëndrime filozofike”, por t’i bëjë të qarta qëndrimet, që „rigorosisht t’i caktojë kufijtë e mendimeve të cilat, përndryshe janë të thuash të turbullta dhe të errësuar”. Bota përbëhet prej fakteve. Thënë saktësisht, faktet nuk mund të përkufizohen, por ajo që mendojmë mund ta shpjegojmë, nëse themi se faktet janë diçka që i bëjnë qëndrimet e vërteta ose të rreme. Filozofia, pra, jo vetëm që duhet ta kufizojë atë që mund të mendohet ndaj asaj që nuk

mundet, por këtë kufizim duhet ta kryejë brenda, domethënë me anën e asaj që mund të mendohet. Filozofia, do të ketë kuptimin e të pashprehurës, duke paraqitur qartë të shprehurën. Metoda e saktë e filozofisë, në realitet, do të ishte kjo: „*të mos thuhet asgjë, por ajo që mund të thuhet, pra qëndrimet e shkencave natyrore – pra, diçka që nuk ka kurrëfarë lidhje me filozofinë...!*” Duke përfunduar „Traktatin” me tezën e shtatë do të thotë: „*Për atë që nuk mund të flitet, për atë duhet të heshtim*”. Duke i shpallur të gjitha qëndrimet të cilat nuk janë tautologji të thjeshta ose qëndrime empirike „të pashprehshme” Vitgenshtaini, pra, nuk deshi të identifikonte të pashprehshmen me të paekzistuarën. Për më tepër ai të prezantuarit e të pashprehurës e konsideronte detyrë fundamentale filozofike, kurse filozofinë në përgjithësi aktivitet që duhet të tregojë, atë që në formë të qëndrimeve natyraliste dhe logjike nuk mund të shprehet.

6.6. EKZISTENCIALIZMI

Ekzistencializmi është drejtim i filozofisë bashkohore, sipas të cilit çështje madhore dhe themelore e filozofisë është çështja e ekzistencës si mënyrë e posaçme, specifike e të qenësuarit të njeriut, si „realitet njerëzor”. Ekzistencializmi paraqet në rend të parë, dhe para së gjithash mënyrën e filozofimit. Qëllimi esencjal i filozofisë, sipas ekzistencializmit, është që njeriu t’ia tregojë njeriun në atë mënyrë që ai në të ta njohë të vetëvetën. Mirëpo, ekzistojnë dy lloje filozofish. Te disa nga filozofët është e dukshme përpjekja që ta nxjerrin sheshit strukturën e përgjithshme të krejt asaj që është, që qenëson; nëse fare arrijmë deri te njeriu, atëherë kjo nodh krejtësisht në fund të hulumtimeve të tyre të kujdesshme. Këta filozofë i qasen njeriut përmes pikëpamjeve abstrakte për Zotin, qenien, botën, shoqërinë, përmjes ligjeve apo jetës. Sipas tyre, njeriu është pika përfundimtare, ose nëse doni, pika në të cilën mbyllet një sistem.

Përkundrazi, disa filozofë të tjerë nuk prajnë së rebeluari kundër një metode të tillë, tmerësisht të tërthorët. Filozofët e tillë vërsulen direkt në njeriun. „Pikërisht duke dashur që ta qëllojnë mishin e gjallë të „qenësuarit të tij”, ata tentojnë që nga erësira e gjendjes së tij, ta nxjerrin të vërtetën, e cila do t’i përgjigjej drejtpërdrejtë mallit tonë më të thellë... Atë që në mënyrë mjaft të përgjithësuar e quajmë ekzistencializëm, ka të bëjë me mënyrën me fjalë të të filozofuarit. Pra, në mënyrë mjaft të përgjithësuar „ekzistencializëm do të quajmë çdo filozofi e cila vërsulet drejtpërdrejtë në ekzistencën e njeriut me qëllim që ta nxjerrë në dritë, por *in vivo*, enigmën, të cilën njeriu ia paraqet vetëvetes”.

Themelues i ekzistencializmit është Sorens Kirkegardi, ndërsa përfaqësues më të njohur të tij janë Martin Hajdegeri, Karl Jospes, Zhan Pol Satri, Gabriel Marseli, Nikolla Abanjonë, ndërsa në fushën e letërsisë vlen të përmenden Alber Kami, Simon de Bovuar, Miguel Anamuno etj.

Pa marrë parasysh dallimet që ekzistojnë ndërmjet ekzistencialistëve dhe ekzistencializmave, karakteristikë e përbashkët e tërë kësaj filozofie është reagimi ndaj ekzistencializmit, pikëpamjeve sipas të cilave kryesore është esenca e cila i paraprin ekzistencës; absolutizmi i ekzistencës si realitet njerëzor, si monopol dhe „privilegj” vetëm i

njeriut, reagimi ndaj iluminizmit dhe racionalizmit, në përgjithësi edhe kundër atij të Hegelit në veçanti; pikënisja nga individ e jo nga shoqëria, njerëzimi etj. Disa mendimtarë janë të mendimit se filozofia që ka si pikënisje ekzistencën, mund të ndahet në: a) filozofia e ekzistencës në kuptimin e ngushtë me Karl Jaspersin në krye dhe të tjerë si Martin Buberi, F. Rozencfajgu, G. Marseli, pastaj letërarët F. Kafka, Rilke etj. b) filozofia ekzistenciale apo antologjia ekzistenciale e M. Hajdegerit në krye dhe c) ekzistencializmi me Zhan Pol Sartrin në krye. Sipas kësaj ndarjeje, ekzistencializmi është, thënë në mënyrë kondicionale, një variant, variant francez i filozofisë së ekzistencës, në kuptimin e gjerë të fjalës.

6.6.1. Zhan Pol Sartri (1905-1980)

Fama dhe popullariteti i Sartrit rritet hovshëm pas Luftës së Dytë Botërore. Më vonë do të jetë një nga filozofët dhe shkrimtarët më të rëndësishëm të letërsisë bashkohore franceze.

Nën ndikimin e caktuar të Kierkegorit, Huserlit dhe të Hajdegerit, Sartri formon konceptcionin vetiak ekzistencialist për botën dhe jetën, në të cilën në fazat e ndryshme të krijimtarisë së tij gërshetohen shumë tendenca filozofike të kohës. I angazhuar në jetën shoqërore e në disa aksione politike - Vietnami, ngjarjet hungareze, lufta algjeriane për çlirim e tjera, Sartri si shkrimtar veprat më të mira i shkroi në fushën e romanit „Neveria”, „Rrugët e lirisë”, dramat: „Miza”, „Me dyer të mbyllura”, „Lavirja e ndershme”, „Duart e ndyta”, „Djalli dhe perëndia tjetër” etj. Derisa veprimtaria e tij letrare mund të konsiderohet si arritje më e lartë e krijimtarisë letrare bashkohore në botë, tezat filozofike të tij nga ndonjëherë janë të ngarkuara me ndikime dhe rrymime kontradiktore.



Zhan Pol Sartri

Vetë nocioni i ekzistencës te Sartri është kuptuar dhe përcaktuar në kuptimin e kundërvënies tradicionale të ekzistencës dhe të esencës. Brenda kësaj antiteze Sartri thekson se **ekzistenca e njeriut i paraprin esencës së tij**: „Njeriu së pari ekziston, gjendet, shfaqet në botë dhe pastaj përcaktohet”. Protagonisti në romanin e tij „Neveria” njeh ekzistencën në rastin e frymëzimit, të vizionit të pastër, duke medituuar për rrënjën e një druri të cilin e vëzhgonte. Edhe drama „Me dyer të mbyllura” mirë e ilustron pikëpamjen ekzistencialiste për fatin e njeriut: në ferr, pa djall dhe zjarr, që është një dhomë e thjeshtë pa dritare dhe në të cilën tri qenie janë të dënuara të jetojnë amshimin e vet, tregon në mënyrë më plauzibile se ç’është në të vërtetë ferri njerëzor: „ferr janë të tjerët”. Liria tjetër, në të vërtetë, më çmon sipas vullnetit të saj, kështu që liria e tjetrit, në thelb, është mohim i lirisë sime dhe reciprokisht: edhe ta shikosh tjetrin do të thotë të bësh prej tij objekt. „Tjetri, kjo është vdekja e fshehur e mundësive të mia nëse unë e përjetoj këtë vdekje si të fshehur në mes të botës”.

Është ateist i bindur, që thotë se „nëse ekziston perëndia, atëherë nuk ekziston njeriu, njëri tjetrin e përjashtojnë”. Në shumë teza të tij filozofike i hapur ndaj lëvizjeve ideore bashkohëse, Sartri veçoi problemin e lirisë. Sipas tij, **njeriu është i dënuar të jetë i lirë**. Për më tepër, njeriu edhe „është liria”. Duke mos u lidhur për perëndinë, për të vërtetën ose qenien e dhënë, ai i braktisi plotësisht, realizon nëpërmjet aktivitetit të tij kuptimin e qenies së vet: „ai është ajo që vetë nga vetja me punën e vet e bën”. Në kryeveprën e tij filozofike „**Qenia dhe hiçi**” përpiqet t’i japë idesë së lirisë edhe kuptimin e caktuar shoqëror, si dhe përmbajtjen konkrete dhe historike. **Njeriu pa tutorin hyjnor, është krejtësisht i vetëm, mirëpo, pikërisht liria e tij është kuptimi i ekzistencës së tij**. Jeta do të jetë vetëm ajo që njeriu prej saj e bën: pikëllim ose gëzim, kuptim ose pakuptimësi, kjo varte vetëm nga ai. Prandaj dhe vetëm për këtë shkak duhet dhe mund të jemi përgjegjës, e kjo do të thotë edhe të përcaktuar, të angazhuar. Që liria të mos mbetet shprazëti, duhet ta plotësojmë me aktivitet shoqëror në përputhje me lëvizjet historike progresive.

Vepra „**Qenia dhe hiçi**” është, para së gjithash, përpjekje e Sartrit për themelimin e antologjisë. Ekzistojnë dy lloje të qenies: qenia në vetvete dhe qenia për vete. E derisa qenia në vetvete përbën tërë qenien përveç njeriut, **qenia për vete është të ekzistuarit e njeriut**. Mënyra e të ekzistuarit nëpërmjet këtyre dy llojeve të qenies është e ndryshme: qenia në vetvete është e thjeshtë, ajo materialja, masivja, e rënda, nivelizuesja „veshtullorja”, kurse qenia për vete vetveten e konstituon duke iu kundërvënë qenies në vetvete, si vetëdije në botën dhe bota vetëm.

Në „Qenia dhe hiçi” është i qartë, njëkohësisht, kalimi nga ontologjia në etikë. **Zbulimi i hiçit shënon burimin e vlerës: kjo është mungesë**. Njeriu e sheh veten si mungesë dhe vlerat gufojnë nga qëllimi themelor i tij, të cilin dëshiron ta realizojë me sintezën e vetëdijes dhe të qenies. Prandaj njeriu edhe dëshiron t’i japë vetes ekzistencën absolute, në të cilën mungesa do të ishte përjashtuar: andaj dëshiron, në thelb, të bëhet perëndi.

Këtë qëllim të tij e zbulon psikoanaliza ekzistenciale, e cila në të njëjtën kohë e bind njeriun se vetëm ai është qenie përmes së cilës ekzistojnë vlerat. Për këtë vepër më vonë, Sartri shkroi, „*Qenia dhe hiçi, caktun përvojën e brendshme, e cila nuk ka kurrëfarë lidhjeje me përvojën e jashtme, për mua mikroborgjezinë e atëhershme, përvoja e cila në një moment të caktuar u bë katastrofale*”.

Sartri është mendimtar bashkohor, penda e jashtëzakonshme e të cilit dominon shumë kohë në literaturën evropiane. Konsekuent ndaj disa angazhimeve të veta, refuzoi të pranonte shpërblimin Nobel, që disa e komentuan si pozë e cila Sartrit të popullarizuar duhet t’i sjellë popullaritet edhe më të gjerë. Mirëpo, cilësitë e tij të romansierit, të shkrimtarit të dramave dhe të eseistit, asnjë njeri serioz nuk mund t’i mohojë.

6.6.2. Karl Poperi

Karl Poperi është filozof anglez me origjinë austriake. Prej vitit 1945 është profesor i logjikës në Londër. Veprat kryesore të Poperit janë: „*Logjika e parashikimeve*”, „*Shoqëria e hapur dhe armiqët e saj*”, „*Varfëria e historicizmit*”, „*Parashikimet dhe mohimet*”, dhe „*Shkenca objektive*”.

Është ithtar i pozicionit specifik neopozitivist me elemente të racionalizmit kritik. Poperi dallon tri „botët”, edhe atë: **botën fizikale-materien; botën përjetuese-vetëdijen dhe botën e ideve, të teorive, të mendimeve si realitet objektiv.** Njëkohësisht Poperi e hedh poshtë mohimin e metafizikës si diçka që shpreh qëndrime absurde, si dhe kriterin e verifikimit. Në vend të verifikimit ai përpiket ta justifikojë kriterin e përgënjeshtimit, përkatësisht ta vërtetojë dëshminë e përgjithshme, por mund ta përgënjeshtrojë, prandaj është e nevojshme të gjurmohen vazhdimisht rastet negative përgënjeshtuese.

Poperi i kritikon si esencializmin e filozofisë së shkencës, ashtu edhe teoritë e ndryshme konvencionaliste dhe instrumentaliste të pozitivistëve klasikë dhe doktrinarë bashkohës. **Përparimi i njohes njerëzore mund të vërtetohet në kuptimin e mohimit të mitit dhe të shëndërrimit të tij në shkencë.** Dituria e kësaj shkence përparon me metodën e eksperimentit dhe të gabimeve, të supozimeve dhe të përgënjeshtimit të tyre. Mu për këtë shkak ai mohon edhe metodën indiktive dhe e zëvendëson me deduksion.

Si filozof i shoqërisë dhe kulturës bashkohore, kritikon ashpër krejt filozofinë sociale dhe mënyrën matematike të të vëzhguarit të shkencave historike. Nga pozitat e tendencave socialo-liberaliste dhe qytetare, si përfaqësues i tezes mbi „shoqërinë e hapur”, i kundërshton drejtëpërdrejt të gjithë „utopizmat e majtë” dhe përpjekjet revolucionare të ndryshimit të botës ose, siç thotë ai, „përpjekja që të rregullohet qielli në tokë prodhon gjithmonë ferr”. Karl Poperi Hegelin dhe Marksini kritikon pa kurrëfarë thellimi dhe kuptimi, siç thotë ai, si „profetë të remë”.

6.7. KIBERNETIKA

6.7.1. Norbert Vineri (1894-1964)

Shkathtësia e drejtimit, e timonimit në përgjithësi quhet **kibernetikë.** Ajo është shkencë ose metoda mbi parimet e përgjithshme të drejtimit, të rregullimit dhe të programimit të proceseve të çdo lloji, domethënë të proceseve brenda përbrenda makinave, organizmave të gjallë, organizmave shoqërorë. Fjalën kibernetikë i pari e përdori filozofi antik grek i njohur, Platoni. Ai, „kibernetikën” e përkufizoi si **shkencë mbi parimet dhe mënyrën e drejtimit të shoqërisë.** Fjala „kibernetikë”, kështu u kuptua më se dy mijë e treqind vjet. Në vitin 1948 është e lidhur ngushtë me daljen e veprës së matematikanit, Norbert Vinerit.

Norbert Vineri. Në bazë të arritjeve të shumta dhe të rëndësishme në lëmin e shkencave natyrore, matematike dhe teknike, veçanërisht të logjikës matematike, teorisë së alogaritmave, teorisë së probabilitetit, të fiziologjisë së veprimtarisë nervore etj, Vineri e themeloi kibernetikën si **shkencë mbi esencën dhe lëvizjen.** Ai, pra, kibernetikën e konsideron si shkencë për qarkullimin dhe përpunimin e informatave dhe, si rrjedhojë, shkencë për mundësinë e drejtimit brendapërbrenda sistemeve të ndërlikuara e dinamike. Në veprën e tij „*Kibernetika ose drejtimi dhe lidhja në botën organike dhe në makina*”, thotë se kibernetika mund të përkufizohet

edhe si shkencë për parimet e përgjithshme të vetorganizimit dhe të drejtimit të makinave, e para së gjithash, të makinave me drejtues rrugullator elektronik. Sipas kibernetikës, drejtimi i sistemeve është i mundur në saje të qarkullimit dhe përpunimit të informacioneve.

Qarkullimi i informacioneve është i dukshëm, me anë të komandave dhe sinjaleve, informacioni dërgohet prej dhënësit në marrësin e informacioneve, kurse nga ky i fundit arrijnë informacione retroaktive. Sistemet kibernetike ndahen në sisteme të mbyllura apo të izoluara, ku informacionet këmbehen vetëm në mes objekteve të një sistemi të caktuar dhe në sisteme të hapura, ku informacionet këmbehen jo vetëm në mes objekteve të një sistemi, por edhe në mes të sistemeve e nënsistemeve të ndryshme. Si shkencë mbi parimet e dhënie-marrjes dhe të përpunimit të informacioneve, mbi drejtimin e sistemeve dinamike, kibernetika ka rëndësi të madhe jo vetëm aplikative në teknikë, në teknologji, por edhe në ekonomi, në prodhimtari, komunikacion etj.

6.7.2. Erih Fromi (1900-1980)

Erih Fromi është filozof gjerman, i cili më vonë u vendos në Meksikë. Studioi psikologjinë dhe sociologjinë, ndërsa në Berlin specializoi psikoanalizën. I takoi rrethit të njohur të mendimtarëve të grumbulluar rreth „Revistës për kërkime sociale”, të cilës në atë kohë i takonin edhe Herbert Markuze, Maks Horkajmeri e të tjerë. Nga Gjermania emigroi pas ardhjes në pushtet të nacistëve. Shumë vjet me radhë ligjëroi në universitete të ndryshme të Amerikës psikologjinë sociale dhe pastaj ishte ligjërues në katedrën e psikologjisë në „Nju-Jork Universitet” dhe në katedrën e psikoanalizës në Universitetin Nacional të Meksikës në Meksiko Siti.

Fromi padyshim është një nga mendimtarët më të rëndësishëm bashkohorë. Ai studioi një sërë problemesh aktuale të botës bashkohore duke ngjallur dhe duke përhapur orientimin humanist, të cilin e zbatoi në radhë të parë brenda temave të qenësishme sociologjike dhe psikologjike. Në një varg veprash, brenda të cilave vend kryesor kanë trilogjitë: „*Ikja nga liria*”, „*Njeriu për vete*”, dhe „*Shoqëria e shëndoshë*”, Fromi i paraqet konceptet e veta themelore teorike, në të cilat, përveç disa interpretimeve kritike të disa qëndrimeve të Frojdit, i cili një kohë dukshëm ndikoi tek ai, përpiket t’i japë kuptim gjendjes së njeriut bashkohor.

Në veprën „*Ikje nga liria*” Fromi analizoi disa elemente fundamentale të vetë t’huajsimit njerëzor që manifestohet në ikje nga liria dhe të cilat bëhen thelb i qenësishëm i strukturës së karakterit të anëtarëve të grupit të caktuar shoqëror që u zhvillua si rezultat i mënyrës së jetës që është e përbashkët për tërë atë grup. Në këtë vepër Fromi, ndër të tjera, në mënyrë të jashtëzakonshme i paraqet disa komponenta fundamentale sociale, psikologjike dhe ideologjike që ishin vendimtare për krijimin e teorisë dhe praktikës së racizmit. „*Ndryshe me fuqinë kënaqen në radhë të parë prijësit, masat assesi nuk janë të privuara nga kënaqësia sadiste..., vetë këto masa mësojnë të kënaqen me fuqinë mbi kombet tjera dhe që forca lëvizëse e tyre bëhet pasioni për ta sunduar botën*”, - do të thotë Fromi.

Në librin „*Njeriu për vete*” Fromi duke theksuar tiparet themelore të karaktereve të vetë t’huajsimi „*joproduktiv njerëzor, në mënyrë sistematike paraqet edhe pikëpamjen e tij mbi natyrën njerëzore*”, dhe „*dijeninë mbi natyrën e jetës*”, si edhe në përgjithësi mbi problemet filozofike të njeriut, duke e shtruar çështjen mbi perspektivën e shoqërisë njerëzore, duke fiksuar dilemën mbi shpresën ose mungesën e shpresës, mbi të mirën ose të keqen, mbi fundin ose fillimin, ai tregoi se si koha jonë është e ngarkuar prej mundësive: „*Vendimi mbështet në njeriun. Ai mbështetet në aftësinë e tij që veten, jetën dhe lumturinë e tij ta kuptojë seriozisht, në dëshirën e tij që do të ballafaqohet me problemin moral, të vetin dhe të shoqërisë së vet. Ai mbështet në guximin e tij të bëhet i imi dhe për vete*”! Fromi këtu flet konkretisht për rrënjët e luftës për socializmin.

Për kritikën në mënyrë konsekuente ndaj shoqërisë bashkohore Fromi formuloi konceptin vetiak krijues dhe humanist për njeriun, në nivelin që pak kush arriti nga intelektualët bashkohorë. Sipas tij, situata njerëzore vërtet është produkt i caktuar i evoluimit të natyreshëm, njeriu është edhe pjesa e natyrës, por njëkohësisht ai transcendon këtë natyrë, ngase është i përcaktuar nga vetëdija e vetevetes, të njerëzimit. Kjo përçarje dhe ndarje ndërmjet natyrës dhe arsyes është shkak dhe burim i kundërthënieve të shumta, por edhe i dinamizmit të vazhdueshëm të ekzistencës njerëzore: i dëbuar dhe i shtrënguar nga forcat dhe nga „fuqitë mbinjerëzore”, njeriu nuk mund të qëndrojë pasiv, por sërish gjithmonë përpiqet të gjejë kuptimin e koezistencës së vet në gërshetimin e thellë të qenies së vet në natyrë, me shoqërinë e në fund edhe me vetëveten. Harmonia e parë gjithsesi nuk është më e mundur, sepse më në fund njeriu duhet të dallohet prej gjendjes shtazore primitive. Mirëpo, uniteti i ri mund të arrihet edhe në bazë të formimit të personalitetit autentik të pavarur, jo autoritar dhe të forcave specifike njerëzore; produktivitetit, arsyes dhe dashurisë.

Në veprën „*Anatomia e destruktivitetit njerëzor*”, përveç qërimit kritik të hesapeve me shumë teori të agresionit, Fromi na dha disa portrete jashtëzakonisht të pikturuara njerëzore, të cilat në shekullin tonë ishin bartësit kryesorë të formave malinje të agresionit: Stalinizmi, si rast klinik i sadizmit joseksual; Himlerit si rast klinik të sadizmit anal stivues; dhe të Hitlerit si rast klinik të nekrofilisë.

Në veprën „*Të kesh ose të jesh*” Fromi, ndër të tjera, provoi disa cilësi që duhet ta karakterizojnë njeriun e ri, struktura e karakterit të të cilit duhet të jetë e ndërtuar ashtu që të jetë i gatshëm të heqë dorë nga të gjitha format e pasurisë, për shkak që të mund të jetë plotësisht. Prandaj shoqëria e re që nxit krijimin e njeriut të ri; duhet ta zhvillojë tek ai ndjenjën e identitetit dhe të besimit të bazuar në besnikërinë, në atë që dikush është, në nevojën e raportit, të dashurisë, të interesit, të solidaritetit me botën rreth vetes dhe jo në dëshirën për pasuri, posedim, sundim të botës dhe robërim ndaj pasurive vetiake.

Fromi i cili shpesh konsiderohet krijuesi të ashtuquajturës „psikoanalizë humaniste”, në disa vepra të tij është ndoshta filozofikisht më pak relevant, kështu që disa shtrojnë pyetjen sa dhe a i ka kontribuar ai thellimit të konceptioneve filozofike. Ndërkaq, është e sigurtë se mendimi i tij, i gjallë dhe aktual, orientimi i tij fisnik, humanist e i angazhuar janë kontribut i madh, sidomos në fushën e psikologjisë dhe sociologjisë.

6.8. BIOETIKA DHE EKOLOGJIA

Emri i „bioetikës” është fryt i çështjeve të shumta të shkencës bashkëkohore, veçmas biologjisë, gjenetikës dhe medicinës si dhe synimeve të shumëfishta e të mundimshme që në pyetjet e tyre të gjenden përgjigje të kënaqshme. **Bioetika përfshin shkencat për jetën dhe shëndetin, për gjendjen e mjedisit njerëzor, duke synuar të gjejë masë ekuivalente të sjelljes së njerëzve në ato fusha.** Bioetika, pra, ka të bëjë me fushën e mjedisit njerëzor, për kushtet e jetës, në mënyrë simbolike dhe të njëmendët t’u hapë rrugë atyre që do t’u japin përparësi të veçnatë shëndetit dhe jetës.

Takimi i njeriut me natyrën, me mjedisin e tij jetësor, veçmas me gjithësinë në historinë e afërt pak ka paraqitur rrezik për mjedisin, ndërsa më tepër paraqiste rrezik për vetë njeriun. Sipas fuqisë dhe prirjes së tij, njeriu nuk ka mund të rehatohet në përputhje dhe ekuilibër me natyrën. Për më tepër ai u desht të luftojë për më shumë hapësirë për ekzistencën e vet. Njeriu instiktivisht, por edhe me plan, pak nga pak e shfrytëzoi, madje edhe e rriti fuqinë e tij, që më lehtë dhe më mirë të jetojë. Me të drejtë duke u shërbyer me gjenialitetin e vet e zhvilloi teknologjinë që t’ia përmirësojë vetes kushtet e jetës.

Duke mos i konsideruar as të mjaftueshme e as mjaft të vlefshme resurset burimore të natyrës, njeriu krijoi lloje të reja, hibride të reja, krijoi komponente të reja kimike me të cilat në mënyrë jo të natyrshme do ta rrisë frytshmërinë. Por, edhe duke ndotur tokën, ajrin dhe ujin, ndërtoi shumë qytete dhe mjedise industriale me përmasa jonjerëzore. Kjo ngjan sikur të jetë: çdoherë më pak qëllim i njeriut, ndërsa çdoherë më shumë përparim, përkatësisht zhvillim. Ndërmarrshmëritë e njeriut zënë vend me prodhimet ose mbeturinat, rezervat të paparashikueshme dhe të pakthyeshme të tokës, si dhe rrezikojnë jo vetëm llojet e jetërave të veçanta, por edhe vetë kushtet e jetës njerëzore. Kjo do të sjellë deri te gjendja e padëshirueshme e cila do të thotë: sa më shumë që do të rritet standardi, njeriu bëhet më i rrezikuar si dhe bota rreth tij.

Pas shpërthimit të ozonit, tragjedisë së Çernobilit, e të tjerave që dihen e nuk dihen, pastaj atyre të cilat ende kërcënojnë, njeriu është i ndier ngushtë, ai kërkon shpëtim prej ambientit të rrezikuar, e kërkon që të ikë prej kësaj bote. Megjithatë, për fat të keq të tij, ai është i ballafaquar me faktin, „për fatkeqësinë e botës” dhe se „si është i vogël kur duhet të ikë”. Pra, për çdo ditë rritet vetëdija se njeriu nuk ka tjetër vendstrehim, përveç këtij të vetmin; se kjo tokë është anije e vetme dhe e përbashkët e jona, në të cilën të gjithë lundrojmë. Në këtë tokë ende do të „luhet” ardhmëria e njeriut dhe njerëzimit.

Ndërgjegjja e njeriut dhe përgjegjësia e tij para botës, gjeneratave të ardhshme, Zotit sundues suprem të gjithëçkaje që është krijuar, shtrohet pyetja a mund të kultivohet mjedisi i tij, bota e tij e jashtme, nëse tanimë më parë është kultivuar bota e tij e brendshme, në formë të zbrapsjes së epsheve, racionalizmit të dëshirave të pangishme e nevojave të ndryshme shpirtërore të tij. Për gjendjen e tanishme të rrezikimit e kërcënimit të përgjithshëm jemi të gjithë përgjegjës, dikush më shumë e dikush më pak, bile para kësaj askush nuk mund të mbetet indiferent.

Disiplina e re shkencore, **ekologjia**, synon të përgjigjet në pyetjet e shumta dhe sfiduese, me të cilat sot ballafaqohemi në mjedisin tonë. Në njërën anë, ajo studion ligjet biologjike që

kushtëzojnë raportet me qeniet e gjalla si dhe raportet ndërmjet vetë atyre, pastaj edhe raportin ndaj ambientit, e në anën tjetër vëmendje të posaçme i kushtohet sjelljes së njeriut në suaza të natyrës, do të thotë mjedisit jetësor, duke vlerësuar sjelljen e tij në dritën dhe vlerësimeve etiko-morale. Tri ngjyrat e jetës janë: bimët që sajojnë ngjyrën e gjelbër, botën e mjedisit të shëndoshë jetësor; ngjyra e verdhë, bota e dritës dhe ngjyra e kaltër, bota e dritës së freskët që buron nga thellësia e oqeanëve dhe arrin deri te lartësitë qiellore, që është në gjendje ta kuptojë vetëm shpirti njerëzor.

Gjendja e mjedisit jetësor sot është çdoherë e më shumë në qendër të vëmendjes, jo vetëm të kërkimeve shkencore, por edhe më gjerë. Ngadalë krijohet vetëdija se ekzistenca e tokës, e njeriut dhe jetës tjetër të gjallë, seriozisht është sjellë në pikëpyetje dhe se ka ardhur koha kur do të duhet të pyetet për të gjithë atë që ndërmeir në mënyrë jo të menduar mirë e në dëm të vetes e të natyrës.

Vetëdija për ekologjinë shpie te synimi që të rrezikuarit e mjedisit jetësor të locohet në sistemin e vlerave, më konkret në ndryshimin e tyre, në kulturën e të jetuarit, në politikë, në rregullativën ekonomike, krejt me qëllim që të prekë të rrënjët e ndryshimit të mundshëm në drejtim pozitiv. Raporti ndaj mjedisit jetësor nënkupton jo vetëm dije të specializuara, por edhe të kthjellurit e thellë në vetëdije, e cila në vete ndërton sistemin e vlerave për qëndrim të drejtë ndaj natyrës, që i ndihmuar me rregullativë juridike e institucione të shtetit, lëvizja e zhvilluar ekologjike dhe arsimimi solid ekologjik mund të rezultojë në raport aktiv në mbrojtje të mjedisit jetësor.

Lënda e ekologjisë në vete përfshin më shumë disiplina shkencore si: sociologjinë, ekonominë, politikën, etikën, por edhe pyetje që dalin prej jetës së përditshme, e për të cilat nuk mund të thuhet se janë pjesë vetëm e një fushe ose disipline. Por, për ne është e rëndësishme që të kuptohet se qëndrimi ndaj mbrojtjes së mjedisit jetësor nuk nënkupton vështirim të ngushtë, të kufizuar ose specialistikë, por synim që të formohet pikëpamje për botën ku komponenta ekologjike do të ketë vend qëndror në përcaktimin e komponenteve tjera në jetën e njeriut.

6.9. POSTMODERNIZMI

Teoria postmoderne u zhvillua në dekadat e fundit të shekullit XX. Mësë pari ky koncept u përdor që t'i përshkruajë ndryshimet në fushën e artit dhe të arkitekturës. Për herë të parë u përdor në ShBA. Duke i theksuar ndryshimet në dansin modern e në arkitekturë në vitin 1949, ndërsa më vonë u stabilizua edhe në përdorimin masiv, sidomos pas gjysmës së dytë të viteve të shtatëdhjeta, përkatësisht prej viteve të shtatëdhjeta e këndeje, postmodernizmi filloi të përhapet edhe në Evropë.

Intelektualët, e posaçërisht teoriciontët letrarë e filozofët shpesh do të flasin për postmodernizmin si shumë e ideve teorike që tani kanë shprehje në fushën e politikës, letërsisë, artit, kulturës masive etj. Disa bile postmodernizmin e shohin si nusprodukt të fuqive ekonomike e sociale që kanë pak lidhje me teoritë intelektuale dhe filozofike të shekullit XX. Faktorët udhëheqës të postmodernizmit janë: hegjemonizmi deklinues i ekonomisë në Evropë dhe Amerikën e Veriut; pastaj demokratizimi i arsimit; efektet prej

mediave masive dominuese; rënia e kontinuitetit të religjionit dhe besimet e përgjithshme të teorive ekonomike totalitare dhe zëvendësimi i tyre me format eklektike të socializmit kapitalizmit.

Postmodernizmi sot është bërë term shtëpiak prezent në kontributet dhe shkrimet serike të TV-emisioneve të panumërta, në revistat akademike më serioze, të cilat gati pa përjashtim publikojnë numra specialë kushtuar postmodernizmit, pastaj dalin edhe një sërë librash të shtëpive të ndryshme botuese, në të cilat fjala postmodernizëm zë vend të dukshëm në kryetitujt e tyre. Pra, profilerimi i këtij formimi dhe temës që përfshin, shpiejnë deri tek ajo që të ikë kritikshmëria në natyrën e kompetenshmërisë së veprave të caktuara, me përjashtim të asaj që u bë literaturë themelore e kësaj fushe.

Postmodernizmi definohet si formë për teoretizim të shoqërisë dhe si periudhë e veçantë e meadimit shoqëror. Teoria postmoderne e shoqërisë karakterizohet me ndarje të teorisë prej koncepteve të sistemeve të mëdha që nënkuptojnë shoqërinë si totalitet: preokupimi intensiv me krizën e legjitimitetit dhe përvojën karakteristike për sistemin e kulturës botërore të botës bashkohore të kompjuterizuar dhe dinamikës së mas-mediave, ndërsa segment i rëndësishëm në këtë teori është korpusi i teorive fenomenologjike, strukturaliste, poststrukturaliste e kriticistike të Deridas, Adornës, Merlo-Puntit, Horkhajmerit, Markuzes etj.

6.9.1. Maks Horkhajmeri (1895-1978)

Horkhajmeri i kundërvihet në mënyrë kritike si pozitivizmit e metodologjisë së tij shkencore, ashtu edhe çdo spekulimi metafizik. Në fushën „e kërkimeve sociale”, kjo kishte kuptimin e qërimit të hesapeve me çdo konstruksion shoqëror a priori si dhe me përshkrimin e verbër të fakteve, kështu që lidhja e ngushtë e problematizimit teorik dhe e kërkimeve konkrete ishte ai parim themelor organizativ i institutit, veprimtarisë dhe punës, i cili tek ai dha rezultate të frytshme. Horkhajmeri ishte sidomos polemik ndaj të gjitha tendencave pozitiviste e shkencore në dukje neutrale, duke provuar falsitetin e tezës mbi zemërgjerësinë dhe papërcaktueshmërinë ideologjike të shkencës sidomos në shekullin tonë. Për Horkhajmerin „kuptimi i krizës së shkencës varet prej teorisë së drejtë të situatës shoqërore bashkohore”.

6.9.2. Herbert Markuze (1898-1979)

Në veprën e tij „*Mendja dhe revolucioni*” u kushton kujdes të veçantë atyre forcave historike të cilat mohojnë dhe kalojnë ekzistencën. Bën analizën e veprës së Hegelit si vepër e filozofit i cili thekson se të menduarit në thelb është mohim i dhënies së drejtëpërdrejtë. Duke e rehabilituar Hegelin, Markuze tregoi aktualitetin e mendimit të tij si „tejkallim i rendit ekzistues”. Diagnoza e tij e tendencave bashkohore totalitare, pavarësisht prej disa toneve të zymta, shpesh është shumë subtile dhe intelektualisht e theksuar si pasqyrë reale.

Markuze do të thotë se racionaliteti teknologjik është bërë racionalitet politik dhe me këtë realitet i forcës totalitare. Teknologjia dhe në përgjithësi racionaliteti shkencor mbi të

cilën bazohet, nuk janë nocione vlerësuese neutrale, por karakterizohen nga instrumentaliteti, nga të menduarit johuman të burokracisë dhe forcave manipulative. Në këtë drejtim, thotë ai, **demokracia shfaqet si sistem më etik i dominimit.**

6.9.3. Teodor Adorna (1903-1969)

Përveç shqyrtimit të problematikës kulturore e historike, gnosologjike e teorike si dhe sociologjike, Adorna merret edhe me letërsi, muzikë dhe estetikë të përgjithshme. Flet për të meta të ndryshme në të cilat has arti në përgjithësi, e sidomos muzika në botën bashkohore. Thotë se te publiku pakësohet aftësia e të dëgjuarit; modalitetet stilistike i përcakton burokracia politike; muzika më e re, format tingëlluese të të cilave marrin vlerën e tyre në raport me format tradicionale, shpesh jeton në ambientin e autonomisë dhe lirisë së re.

6.9.4. Jorgen Hofermas (1929)

Ndër të tjera, mbrohet tezën se **filozofia në shkencë është ruajtur si kritikë. Prandaj, teoria mbi shoqërinë e cila shtrun kërkesën për vetërefleksion, nuk mund të mohojë filozofinë.** Me fjalë të tjera, nëse shkenca mbi njeriun është kritikë materiale e njohjes, atëherë filozofia e cila si teori e kulluar e teorisë së njohjes është privuar nga përmbajtja e tërësishme, sërisht merr në mënyrë indirekte trajtimin e vet të çështjeve materiale.

6.9.5. Zhak Derida (1930)

Profesor në Paris, i cili u përpoq që nëpërmjet projektit të gramatikologjisë e jo semiologjisë, e cila vetëm deshifron shenjat duke gjurmuar ndonjë shenjë definitive, të themelonte filozofinë e të shkruarit dhe të ashtuquajturin „ndryshim”. Të mendosh mbylljen e përfytyrimit, do të thotë, – sipas Deridës, – të mendosh në mënyrë tragjike, jo si përfytyrim të fatit, por si fat të përfytyrimit, domosdoshmërinë e saj të paarsyeshme dhe të pafund.

6.10. FILOZOFIA NË MAQEDONI

6.10.1. Sami Krosi (1936)

U lind në vitin 1936 në fshatin Rashçe, afër Shkupit. Studimet i vazhdoi në fakultetin filozofik, në degën e filozofisë së artit. Studioi edhe drejtësinë dhe magjistroi në shkencat juridike-administrative.

Në fillim filloi të merret me poezi e pastaj edhe me prozë, të përshkruara me elemente të filozofisë, në përgjithësi, dhe filozofisë së jetës, në veçanti. Më vonë filloi të botojë edhe romane, përmbledhje tregimesh, kritika letrare, shikuar në aspektin filozofik. Më e gjerë

është vepra e tij kushtuar poetit të madh, Lazgush Poradecit, me titullin „*Filozofia e jetës në poezinë e Lazgush Poradecit*“. Në të janë zgjeruar dhe thelluar studimet e tij për këtë poet që i ka bërë dhe botuar më herët nëpër revistat që dilnin atëherë në gjuhën shqipe, siç ishte „*Jehona*“ e Shkupit, „*Koha*“ e Podgoricës, „*Doruntina*“ e Kumanovës. Pikëpmajet e tij mbi jetën janë shprehur duke e analizuar dhe komentuar veprën e Lazgushit, se jeta duhet vazhduar me të gjitha vështirësitë që paraqiten. E thekson idenë e Lazgushit se njeriu duhet të jetë „durim-plotë“, se duhet qëndruar ashti siç kanë qëndruar të parët tanë, gjyshërit dhe stërgjyshërit. Për të qenë njeriu i fortë dhe i denjë për t'i dalë krahë popullit të vet, në veçanti, dhe njerëzimit, në përgjithësi, duhet të jetë parimor, duhet ta respektojë rendin dhe ligjin, të jetë si Sokrati, të cilin e merr Lazgushi si shembull në një vjershë të tij.

Ky respektim i rendit dhe i ligjit u është nevojitur çdoherë njerëzve, sidomos bashkëkombëtarëve të poetit, por të profesorit të filozofisë që e bëri shkrimin më të mirë për filozofinë e Lazgushit.

Në këtë libër Sami Krosi vuri në dukje se Lazgushi ka qenë edhe kritik i shquar i rendit shoqëror, për ç'arsye e shkroi edhe poemën e gjatë „*Ekskursioni teologjik i Sokratit*“. U shpreh se njeriu nuk duhet t'i shkelë të tjerët për të mbrojtur interesat e veta personale. Vepra e tij mban titullin „*Mëkatet filozofike dhe shkencore të Rexhep Qosjes së ri*“. Kur të lexohet ky libër formohet bindja se njeriu, sado që në jetë të jetë i mllëfësuar në armiqtë e tij, duhet të ketë parasysh dinjitetin e përgjithshëm njerëzor më tepër sesa e kanë bërë ata, kundër tij.

6.10.2. Jonçe Josifovski (1920)

U lind me 20 janar të vitit 1920. Shkollën për mësues e mbaroi në Jagodinë. Diplomoi filozofinë, si student i parë në Fakultetin Filozofik të Shkupit. Prej vitit 1957 e deri në pension në vitin 1984 i fitoi të gjithë titujt shkencorë të nevojshëm për punëtor universitar në Fakultetin Filozofik të Shkupit. Në veprimtarinë e tij dyzetyjeçare, si profesor, ka shkruar rreth dyqind punime shkencore. Është njëri ndër autorët e parë të abetares maqedonase, pastaj të tekseteve të para universitare si të „*Logjikës*“ (1970), „*Historisë së Logjikës*“ (1976), ndërsa shkroi edhe lubrin e parë filozofik për shkollat e mesme *Filozofia*. Ka botuar studime, broshura pothuaja nga të gjitha disiplinat filozofike. Po i numrojmë disa prej tyre: „*Neopozitivizmi*“, „*Semantika e semantikës filozofike*“, „*Kuptimi dhe moskuptimi i logjikës formale*“. Jonçe Josifovski u mor edhe me problemet e përgjithshme të filozofisë marksiste dhe të historisë së filozofisë si dhe me problemet estetike në mënyrë të veçantë.

6.10.3. Mitko Ilievski (1924 – 1993)

U lind në Bllatec të Vinicës. Studioi filozofinë në Beograd e Shkup. Punoi si mësimdhënës i filozofisë duke ligjëruar Logjikën dialektike. Veprat më të njohura të tij janë: „*Definicioni në mësimdhënie*“, „*Socializmi është humanizëm*“, e tjera, ndërsa në doracakun

„Logjika” (1976), që e shkruan së bashku me Jonçe Josifovskin, e përpunon problemin e metodologjisë.

Mendimi filozofik i Mitko Ilievskit është pjesë përbërëse e historisë së filozofisë në Maqedoni. Si një ndër të parët në veprimtarinë filozofike të pasluftës në Maqedoni, për katër dekada me radhë shënoi veprimtari të frytshme dhe të gjithanshme në lëmin e arsimit, shkencës e kulturës në Maqedoni.

Filozofia çdo herë synon të përgjigjet në pyetjet më të përgjithshme dhe ndoshta më të rëndësishme për njeriun. Pra, ndërmjet mendimtarëve që treguan kontinuitet dhe konsekuentshmëri në zhvillimin e pikëpamjeve dhe qëndrimeve të veta gjithsesi është edhe Mitko Ilievski. Për të filozofia si botëkuptim për botën, si krijim shpirtëror, është „udhëheqje me aksionin praktik, ngase ajo gjatë tërë ekzistimit të saj ka pasur funksion të caktuar shoqëror”. Për Ilievskin filozofi si qenie individuale e me cilësi të caktuara morale, psikike e intelektuale „është i interesuar për një botëkuptim të drejtë për botën”.

„Ajo që ekziston çdo herë është individi, abstrakja nuk ekziston”

S. Kierkegard

PYETJE:

1. Numëroji disa drejtime filozofike në filozofinë bashkëkohore?
2. Ku lindi pragmatizmi dhe ç'është kriteri i së vërtetës sipas tij?
3. Thujai përfaqësuesit e pragmatizmit?
4. Ç'është kriteri i së vërtetës sipas intuitivizmit?
5. Në çka mbështetet e gjithë filozofia e Henri Bergsonit?
6. Në çka e mbështeti Freudi psikoanalizën e tij?
7. Çfarë paraqet „froidizmi” dhe thujaj ndonjë përfaqësues të tij?
8. Ç'është „fenomenologjia” dhe kush është themeluesi i saj?
9. Ku qëndron „misioni i filozofisë” sipas Bertrand Rasellit?
10. Ç'është „neopozitivizmi” dhe me çka e „shndërroi” filozofinë?
11. Ç'është qëllimi i filozofisë sipas Ludvig Vitgenshtajnit dhe si e përkufizoi atë?
12. Çfarë konsideron „çështje madhore” në filozofinë e ekzistencializmit?
13. Çfarë është relacioni i „esencës” dhe „ekzistencës” te Zhan Pol Sarti?
14. Si përfaqësues më i njohur i „shoqërisë së hapur” çfarë ideologjie kritikon Karl Poperi?
15. Ç'është kibernetika dhe kush është themeluesi i saj?
16. Si themelues i „psikoanalizës humaniste” Erih Fromi në zhvillimin e cilave disiplina shkencore veçmas kontribuoi?
17. Ç'përshlin bioetika, e çfarë synon ekologjia?
18. Kur dhe ku filloi të zhvillohet postmodernizmi dhe thujaj disa përfaqësues të tij?
19. Në ç'drejtim zhvillohet filozofia në Maqedoni dhe a mund të thonë ndonjë përfaqësues të saj?

„Të kuptosh do të thotë të ndryshosh, vetëvetes t'i kundërvihesh”

Zh. P. Sartër

absolute – e pakushtëzuar, e pakufizuar, e përsosur
adekuate – në pajtim, në përputhshmëri, që është e barabart me diçka tjetër

afeksjon – shqetësim, ngacmim

agnosticismi – doktrinë filozofike e cila mohon mundësinë e njohjes së plotë - sukses

aksidenci – rastësi, rastësisht, veçori joqenësore

aksiologji – e dinjitetshme, disiplinë filozofike mbi vlerat

aktuale – bashkohore, vendimtare në momentin e tashëm, e vërtetë

alienca – t'huajzim, humbje e qenies vetiake, shiko te Hegeli – 89

antinimi – kundërtënie e të dy kundërtezave që duken njësoj të vërteta

abitezë – tezë e kundërt (vërtetim); mohim i tezës

antropologji – disiplinë filozofike mbi njeriun

antropomorfizëm – dhënia e vetive njerëzore sendeve, natyrës dhe hyjnive

apercepcion – të kuptuarit, percepcion i vetëdijshëm, vrojtim i përfshirë në përmbajtjen e deritashme të vetëdijes; parafytyrim aktiv, i vetëdijshëm

apologji – mbrohem, arsyetohem – mbrojtje; shiko te Sokrati – 25

aposterior – ajo që është pastaj (përvojës), në bazë të përvojës, shiko te Hjumi 66

apriori – ajo që është përpara, që është në vete, e pavarur nga përvoja; shiko Hjumini – 66 dhe Kanti – 84

askezë – stil i jetës të jetë i matur; dorëheqje nga çdo kënaqësi

ataraksi – pamundshmëri, qetësi shpirtërore të të urtëve si ideal të kohës heleniste

ateizëm – mohim i ekzistimit të Zotit, pahyjësi, pafe

atribut – veti e qenësishme, e domosdoshme e ndonjë sendi

autarki – i vetëmjaftueshëm, i privuar nga nevojat, të jesh mjaft për vetëveten ka qenë ideal i sinikëve dhe stikëve

autonomi – rregull, rend, ligj – vetëpërcaktim, vetëligjvënje, pavarësi, vetëqeverisje

deduksion – nxjerrje nga e përgjithshme nga e veçanta dhe individualja; pasim i domosdoshëm i gjykimit

nga gjykimet e tjera

deizëm – mësim se Zoti është krijues mendtor i botës që nuk kujdeset për njëdhën e mëtutjeslme të botës, sepse ajo zhvillohet sipas ligjeve të natyrës; deizmi është i kundërt me teizmin

determinizëm – mësim mbi shkakësinë e gjithëmbarshme; caktueshmëri e dukurive dhe e të gjitha ndodhjeve në botë

dialektikë – për të bërë bisedime, diskutime në bazë të pyetjeve dhe përgjigjeve; te Hegeli dhe Marksii dialektika është ligjësi e përgjithshme e të gjitha ndodhjeve dhe metoda e përgjithshme e njohjes

diskursive – e nxjerrë me analizim mendtor; procesi i suksesit logjik me të cilin gradualisht, hap pas hapi, arrihet deri te njohja

dituri – rezultat i njohjes

dogmë – qëndrim themelor i besimit; pohim i cili llogaritet i panjësueshëm dhe i pakshkelshëm

dogmatizëm – mendim jokritik; thirrje në mësim të martë jokritik

doksë – mendim i pabazuar, i pasigurt

dualizëm – mësim i cili çdo gjë që është vihet në dy parime të pavarura dhe të ndryshme

egoizëm – egositi, vetëdashje

egzakte – e saktë, adekuate

ekzistencë – ekzistencë, për dallim nga e qenësuar ekzistenca do të thotë se diçka është

eklekticismi – drejtim filozofik që merr elemente nga përbërjet e ndryshme filozofike

ekstazë – mahnitje, dalje jashtë vetes

emanaci – të buruarit, të shëndriturit

empirizëm – pikëpamje njohëse teorike që mendon se përvoja është burim i krejt diturisë sonë

entelehi – ajo që është e formësuar plotësisht sipas qëllimit; realizim qëllimor

epikureizëm – qëllimi i jetës është kënaqësia dhe qetësia shpirtërore

eristikë – zhdërvjelltësi për të diskutuar me kundërshtime, shkathtësi për t'u zënë e cila madje edhe me përdorimin e dykuptimshëm të fjalëve „argumenton“ tezën e vet

eros – dashuri, mahnitje dashurore, synim filozofik për njohjen

esencë – qenie

estetikë – filozofia e të bukurës dhe filozofia e artit, hulumton qenien, kushtet dhe kriteret e krijimit, përjetimit dhe të gjykuarit për të bukurën, respektivisht artit

etatizëm – bashkëpunim mbisundues i shtetit në të gjitha format e jetës shoqërore, shtetëformuesi

etikë – adet, zakon – filozofia e moralit, disiplina që studion prejardhjen, motivet, normat dhe qëllimet e të vepruarit moral dhe të gjykuarit moral

etikë sociale – etika që në plan të parë vë aspektin social të marrëdhënieve morale

etos – shenjë e veçorive njerëzore morale; përmbajtje e vlerësimeve dhe veprimeve morale

eudaimonizëm – doktrinë mbi fatin ose lumturinë si qëllim i veprimeve njerëzore

e vërtetë – sipas teorisë së adekuacionit ose korrespondencës e vërteta caktohet si veti e gjykimit, që qëndron në „harmonizimin e mendimeve dhe sendeve”

evidencë – nxjerrje në dritë, e dukshme, e qartë, qartësi, evidentitet

fatalizëm – fat, ndodhje, kob, gjykim – bindje se ndohja në botë dhe të vepruarit njerëzor është i përcaktuar më parë

fenomen – dukuri

fenomenologji – shkencë mbi fenomenet

filozofemë – tezë e caktuar filozofike, respektivisht doktrinë filozofike

filozofi – pikëpmaje mbi botën dhe jetën

filozofi praktike – pjesë e filozofisë që si lëmë të veten e ka të vepruarit e njeriut, njerëzor

fizis – natyrë, tërësia e çdo gjëje që është

gnosologji – njohje, teori e njohjes

hedonizëm – mësim sipas së cilit kënaqësia e rastit trupor është e mira më e lartë, motivi masë dhe qëllim i të vepruarit

heteronomi – rregullim, rend, ligj, varësi nga ligji të cilin ndonjë tjetër e ka vënë; varësi e legjislaturës që rrjedh prejndokujt ose diçkajit tjetër e jo nga vetëvetja, e kundërta është autonomia

hilozoizëm – mësim se materia është burim i krejt jetës

ideal – pamje, qëllim, mendim udhëheqës

idealizëm – njëra nga dy konceptet themelore ontologjike; mëson se qenësia e çdo gjëje është ideja. Fjala idealizëm ka edhe rëndësinë e vet etike; ideali duhet të udhëheqë me të gjitha veprimet tona, e jo

interesi material

ide të lindura – nacionet dhe parimet që shpirti njerëzor mund vetë t'i zhvillojë, pa ndihmën e përvojës imanente – ai që mbetet brenda, e kundërta është transcendentë

indeterminizëm – teori mbi lirinë absolute të vullnetit; në fizikën bashkëkohore indetermimizim do të thotë të kuptuarit se proceset interatomike nuk janë të caktuara kauzalisht, respektivisht se në të njëjtën kohë një grimcë nuk mund t'i caktohet shpejtësia, madhësia dhe pozita

induksion – veprim i nxjerrjes nga individualja dhe e veçanta të përgjithshmen

inteligibile – koshiençë, mendje, të menduarit, të konceptuarit – mbishqisor, i kapshëm vetëm me koshiençën

intuicion – të shqyrtuarit, të pasurit para syve; pamje e drejtpërdrejtë me sy

iracionalizëm – si e kundërta e racionalizmit, respektivisht intelektualizmit në përgjithësi udhëzon në burime iracionale dhe pranime të gjithëçkahut

katarzë – pastrim, fisnim

kauzalitet – sendi i cili është para gjykimit, shkaktësi, raport i shkakut dhe rrjedhojës

koicidencë – të takuarit, njëkohësi

komunizëm – koncepton i rendit shoqëror në të cilin është mbisudnuar prona private, ndarja e punës në punë fizike dhe mendore dhe vendosja e barazisë së njerëzve

koncepton – kuptuarja, marrja me mend; vënia e tezave themelore, marrja me mend, plani i ndonjë vepre

konsekuencë – ajo që përcjell, që vjen pas, që pason e është e varur nga e përparshmja, rezultati, rrjedhoja, konsekuenca

kontigjencë – rastësi, mundësi

koshiençë – në historinë e filozofisë raporti mes koshiençës dhe mendjes është caktuar në mënyrë të ndryshme. Kanti mendon se koshienca është forcë më e ngushtë njohëse, ndërsa mendja është forcë më e gjerë dhe më e lartë, që në vetë, përveç ndiesisë, përfshin edhe koshiençën dhe krijimin e ideve

ratio – mendje, shkak

kriticizëm – koncepton filozofik i Kantit

kritikë – akti i gjykimit, në kuptimin e ngushtë paraqitjeje vërejtjeve; dënim

kuantitet – sasi, të sasisë, madhësi

legalitet – ligjësi

liri – pavarësi nga dhuna, vetëpërcaktim; liria është parim themelor në sferën shpirtërore të njeriut

logjikë – mendje, të menduarit, të gjykuarit – disiplinë filozofike mbi format e mendimit të vlefshëm dhe metoda e njohjes

logjistikë – shkathtësi e llogaritjes; logjika bashkohore matematikore

logos – fjala, fjalmimi, e vërteta, rendi, nocioni, mësimi, ligji, veprimi, argumentimi, fjala e Zotit

maksimë – më i madhi, më i larti, më i vlefshmi; fjalë e urtë; parim që njeriu i përmbahet në jetë

materie – send, lëndë, ndërtim, burim, origjinë, përmbajtje, realitet objektiv që ekziston pavarësisht nga objekti që e njohim

materializëm – njëra nga të dyja koncepcionet ontologjike; mëson se qenia është primare, ndërsa vetëdija sekondare

mekanicizëm – pikëpamje që të gjitha dukuritë dhe të gjitha ndodhitë i interpreton me ligjet makenaike

mendje – grumbull i të gjitha forcave njohëse ose madje edhe forcave shpirtërore në përgjithësi

metafizikë – disiplinë filozofike themelore; doktrinë mbi burimet e para dhe shkaqet e para të qenies; mësim mbi të vërtetën; dituri mbi atë që është në atë anë të fizikës

mistikë – pikëpamje që mëson se ajo absoluteja, e kufishmja, mbinatyrtorja, hyjnorja, nuk mund të njihet as racionalisht, por vetëm ashtu që mistiku të hyjë në raport të drejtëpërdrejtë me atë absoluten, që me atë drejtëpërdrejt të bashkohet në ndijat, aktin e dashurisë

mīt – legjendë, tregim fantastik figurativ mbi lindjen e botës, perënditë dhe njerëzit

modus – mënyrë, mënyra konkrete e panjes së qenies

monizëm – njëra nga zgjidhjet ontologjike themelore; mëson se qenia është një; çdo gjë që është në bazën e vet është unike; një është parimi i gjithëçkajut; një substancë

moral – shumë e rregullave dhe zakoneve të cilat përcaktojnë marrëdhëniet e ndërsjella të njerëzve në ndonjë shoqëri

nativizëm – mësim mbi ekzistimin e ideve të lindura, përfytyrimeve, nocioneve, qoftë si përmbajtje të gatshme, qoftë si dispozicion

natyrë – gjithëmbarësi e krejt çka është

nominalizëm – mësim ose nocion i përgjithshëm, emër i përbashkët për më shumë sende individuale, të cilat vetëm ato ekzistojnë si diçka reale dhe të ndara, kurse nocionet e përgjithshme në vetë nuk janë asgjë reale

noumenim – send për vetë

njohje – veprimtari me të cilën zbulojmë të vërtetën; rezultat i asaj veprimtarie është dituria

njohuri – shumë e të gjitha dukurive metodikisht të fituara dhe sistematikisht të renditura mbi çdo lëmë

ontologji – disiplinë filozofike mbi qenien si qenie, studion pra problemin e qenësisë

opinion – mendim i pasigurtë, i pathemeltë

panlogjizëm – mësim se logosi është baza e botës dhe i të gjitha ndodhive në të

panteizëm – mësim se Zoti në botë është immanent, se Zoti dhe bota janë të njëjtë, respektivisht se krejt është Zot

pasqyrim – të vërejturit, percepcion, vëzhgim

patristikë – mësim i atërve kishtarë

perfeksionizëm – drejtim etik që mëson se qëllimi i fundit është veprimi moral i përsosjes dhe përsosmërisë

pesimizëm – mësim se në botë ka më shumë keq se sa mirë; ose madje kjo botë është më e keqe se të gjitha botërat e mundësime

përvojë – shumë e të gjitha njohjeve të mbështetura në përjetimet e drejtëpërdrejta

pluralizëm – mësim se bota përbëhet prej shumë elementeve të para, relativisht të pavarura, baza ose substanca

poisis – poezi, është bërje në vepër

potencë – forcë, mundësi

pozitivizëm – drejtim filozofik që shtron kërkesë se njohja mbetet te faktet pozitive dhe përshkrimi i tyre d.m.th. kufizohet me atë që është e mundur të kontrollohet me anë të përvojës. Pozitivizmi për atë me pabesim e hedh çdo metafizikë, prandaj çdo vlerë i jep vetëm diturisë, respektivisht gjithë njohjen e redukton në zbulimin njohësor të ligjësisë mes dukurive

pragmatizëm – drejtim i afërt me pozitivizmin; u përmbahet baminive dhe konkretës, por më së pari mban llogari për dobinë pragmatike të adonjë teorie mbi vlerën e saj në të gatshme; gjykimet tona nuk janë tjetër gjë por rregulla për të vepruar, prandaj kanë kuptim dhe vlerë vetëm nëse ka pasoja praktike

praksë – të vepruarit, akti, për Marks-in praksa është kategori themelore filozofike dhe përcaktim esencial i njeriut; njeriu në të vërtetë është qenie e praksës

predestinim – përcaktim prej më përpara; mësim se Zoti parapërcakton gjithçka që është dhe çka do të bëhet, ashtu që njerëzit me vendimin e perëndisë janë

disa për t'u shpëtuar, kyse të tjerët të parapërcaktuar për shkatërrim. Me të vepruarit e tij njeriu nuk do të kishte mundur të ndikojë në shpëtimin ose shkatërrimin e vet. Problemi i predestinacionit është pyetje e ndieshme brenda filozofisë së krishterë. Kisha katolike nuk pranon predestinimin, ndërsa në kishën protestane ajo është e vetmja tezë qenësore

qenie – ajo që është, që ekziston, ekzistuesja, krej që në njëfarë mënyre „është”, pa e marrë parasysh atë se a qenëson realisht ose idealisht

qenësi – ajo sipas së cilës diçka është ajo që është; natyrë e përlshme, e vërtetë e ndonjë sendi; ajo e përgjithshmja që e tejkalon individualen

qenësor – është ajo sipas së cilës është çdo gjë që është. Qenësori u dhuron qenieve të qenurit e tyre (esencë e qenieve), qenësori i bën qeniet

racionalizëm – drejtim i njohjes që mëson se baza e vërtetë e njohjes është koshienca ose mendja

ratio – mendje, shkaku – konceptin njohës i cili pohon se realiteti ekziston pavarësisht nga vetëdija; realizmi mesjetar pohon se e përgjithshmja ekziston realisht më përpara dhe pavarësisht nga sendet individuale

realitet – gjithëmbarsë e gjithçkalut që ekziston, që është realisht

religion – besim në Zotin, respektim i Zotit dhe Zotërave, të besuarit në jetën e pasvarrit

scientizëm – teori që në plan të parë si kriter themelor të çdo gjëje e vë njohurinë shkencore

senzualizëm – drejtim i njohjes që si empirizmi ekstrem gjithë njohjen e bazon në ndiesi, shqisa

skepsë – dyshim, skepticizëm

skepskë metodike – dyshim si rrugë e tejklimit të dyshimit

skepticizëm – botëkuptim i cili secilës tezë i kundërvihet njësoj e vëllshme, kundërteza, e kështu të mos jetë e mundshme arritja deri te njohja objektive skolastike – filozofi mesjetarë, parimisht e nënshtuar teologjisë

socializëm – konceptin i rendit shoqëror në të cilin njerëzit e prodhimit janë në pronën shoqërore, në të cilin nuk ka robërim, ndërsa devizë themelore është: prej secilit sipas mundësive të tij, secili sipas punës së tij

sofistikë – mësim i sofistëve; nxjerrje me qëllim të konkludimeve, sofizma

solipcizëm – pikëpamje njohëse teorike që pohon se ekziston vetëm uni; ekziston vetëm vetëdija për përjetimet e veta dhe asgjë jashtë saj

stoicizëm – mësimi i stoikëve sipas të cilëve virtyti qëndron në të imposhturit e afekteve dhe të vetëkënaqësisë

subjekt – që është vënë nën diçka

substancë – ajo që rri në themelin e sendeve, bartës i të gjitha vetive

shkak – që vetëm duket e nuk është ashtu, i kundërvihet të vërtetës së qenies

shkencë – mësim, doktrinë, ajo që diçka mëson. Në atë kuptim shkenca nuk është njësoj si edhe dituria. Me shkencën emërtojmë tërësinë e rezultateve të disa diturive individuale kur ato rezultate lidhen me një qëllim të përbashkët në aplikimin praktik

shkencë ekzakte – dituri të cilat janë pohime të matshme dhe mund të kontrollohen

tabula rasa – e zbrazët, pllakë e pashkruar

teizëm – besim në Zot i cili krijon botën, drejton me atë dhe gjendet jashtë botës

telelogji – mësim mbi qëllimet, mbi qëllimshmërinë në botë

teologji – mësim mbi Zotin

teori – të hulumtuarit mendor, kërkim i shkaqeve, kërkim i të vërtetës, njohje e pastër

teori e njohjes – disiplinë filozofike që shqyrton çështjen e origjinës, burimit, vëllimit dhe objektit të njohjes dhe problemit të së vërtetës

të bërit – ndryshimi, të paraqiturit, të ndodhurit, të zhvilluarit në kuptimin më të përgjithshëm

të pasqyruarit – „venerim”, burimor, i drejtpërdrejtë i formave ndijore ose logjike dhe qenësore. Pasqyrimi i kundërvihet procesit të njohjes logjike

tjetërsim – humbje e qenësisë së vet

totalitet – gjithëmbarsë

trascendencion – kalim në atë anë, kalim i kufirit të përvojës

transcendental – kusht i cili e mendëson përvojën, forma të vetëdijes sonë

transcendent – që kalon kufijtë e përvojës

transcendentim – kritikë që ndonjë mësim e hedh poshtë më ndonjë pikëpamje tjetër

universalitet – nocione të përgjithshme

vetëdije – vetëdije në vetëveten

vitalizëm – mësim që jetën e shpjegon duke u thimur në forcën e veçantë jetësore

voluntarizëm – mësim apo doktrinë që vullnetit i jep përparësi mbi koshiencën

zakon – adet, etikë, moral

LITERATURA

1. A.G. Boungarten - I. Kant *Pagëzimi i estetikës*, C.P. Shkodër, 2001
2. Bosnjak Branko: *Uvod u filozofskom mishljenje i rjeenik*, Naprijed - Zagreb, 1989
3. Berlin, Isajiah: *Idetë filozofike të shekullit XX*, Onufri - Tiranë, 1996
4. Cekiq, Miodrag: *Pasqyra e historisë së filozofisë*, Prishtinë, 1983
5. Dida, dr. Ali: *Pasqyra e historisë së filozofisë së kohës së re*, Prishtinë, 1983
6. Dedie, Zhylia: *Fjalori i filozofisë*, ShBE, Tiranë, 1994
7. Ekrem, dr. Murtezai: *Filozofia për vitet IV gjimnaz*, Libri shkollor, Prishtinë, 2003
8. Ekrem, dr. Murtezai: *Bazat e filozofisë marksiste*, Prishtinë, 1986
9. Ekrem, dr. Murtezai: *Hyrje në filozofi*, Prishtinë, 1984
10. Ekrem, dr. Murtezai: *Fjalori i filozofisë*, Prishtinë, 1995
11. El-Ehvani, Almet Fuat: *Filozofia islame*, BIM, Shkup, 2002
12. From, Erih: *Psikoanaliza dhe feja*, Plejada, Tiranë, 2002
13. From, Erih: *Njeriu për veten*, Titanë, 2003
14. From, Erih: *Psikoanaliza e dashurisë*, Plejada, Tiranë, 2000
15. Gërliq, Danko: *Leksikon i filozofëve*, Rilindja, Prishtinë 1986
16. Garodi, Rozhe: *Mendimi i Hegelit*, Rilindja, Prishtinë, 1983
17. Hersh, Zhani: *Habia filozofike*, Dituria, Tiranë 1995
18. Hegel, Georg Vilhem Fridrih: *Aristoteli*, Driton, Tiranë, 2003
19. Josifovski, Jonçe: *Filozofia për vitin IV gjimnaz*, Prosvetno dello, Shkup, 1994
20. Jaspers, Karl: *Svetska istorije filozofija*, Novi Sad, 1992
21. Kalin, Boris: *Povjest filozofije*, Shkolska knjiga, Zagreb, 1988
22. Koraç, Velko: *Historia e filozofisë*, Prishtinë, 1973
23. Kirkegard, Soren: *Koncepti i ankthit*, Plejada, Tiranë, 2002
24. Kis, Janus: *Filozofia politike bashkëkohore*, Onufri, Tiranë, 1997
25. Kullashi, Muhamedin: *Filozofema*, Rilindja, Prishtinë, 1981
26. Kullashi, Muhamedin: *Kah metafizika*, Rilindja, Prishtinë, 1985
27. Kullashi, Muhamedin: *Vetëpërkufizimi i njeriut*, Rilindja, Prishtinë, 1987
28. Luzha, Murtezai: *Shqyrtime filozofike*, Rilindja, Prishtinë, 1981
29. Metaj, Kadri: *Teoria estetike e Gjergj Lluçit*, Rilindja, Prishtinë, 1989
30. Niçe, Fridrih: *Filozofia*, Apolonia, Tiranë, 2001
31. Niçe, Fridrih: *Për tej së mirës dhe së keqes*, Plejada, Tiranë, 2003
32. Niçe, Fridrih: *Kështu fliste Zaratusta*, Rilindja, Prishtinë, 1982
33. Presheva, dr. Avni: *Filozofia e gjuhës*, Prishtinë, 1998
34. Presheva, dr. Avni: *Prej gjuhës në gjuhë*, Hanover, 2005
35. Poper, Karl: *Mjerimi i historicizmit*, Onufri, Tiranë, 1996
36. Pejović, Danilo: *Francuska prosvetiteljska filozofija*, MH, Zagreb, 1997
37. Petrović, Gajo: *Sovremena filozofija*, Shkolska knjiga, Zagreb, 1997
38. Petrinjović, Branislav: *Istorija novje filozofije*, NOLIT, Beograd, 1982
39. Sinani, Gjergj: *Hyrje në filozofinë e historisë*, SHBLU, Tiranë, 1999
40. Scruton, Roger: *Historia e shkurtër e filozofisë moderne*, Besa, Tiranë, 200
41. Stumpf, Samuel Enoch: *Filozofia, historia, problemet*, Toena, Tiranë, 2002
42. Simonovska, Suzana: *Mitko Ilievski*, Shkup, 1995
43. Vitgenshtajn, Ludvig: *Hulumtime filozofike*, Toena, Tiranë, 2002
44. Vitgenshtajn, Ludvig: *Traktati logjiko-filozofik*, Prishtinë, 2000

PËRMBAJTJA

I. NJOHURI HYRËSE PËR FILOZOFINË	3
1.1. Ç'është filozofia - lënda e filozofisë	3
1.2. Lënda e filozofisë	4
1.3. Problemet dhe disiplinat e filozofisë	5
1.4. Nacionet themelore të filozofisë	5
1.5. Drejtimet dhe disiplinat e filozofisë	6
1.6. Historia e filozofisë	8
II. FILOZOFIA ANTIKE	9
2.1. Lindja e filozofisë antike	9
2.2. Antika – themel dhe shtyllë e civilizimeve dhe kulturës evropiane e botërore	10
2.3. Filozofët e parë	11
2.3.1. Shkolla e Miletit	11
2.3.2. Talesi	12
2.3.3. Anaksimandri	12
2.3.4. Anaksimeni	13
2.3.5. Pitagora	13
2.4. Kundërthëniet filozofike	15
2.4.1. Herakliti dhe shkolla e Elesë	15
2.4.2. Herakliti	16
2.5. Eleasit	17
2.5.1. Ksenofoni	17
2.5.2. Parmenidi	17
2.5.3. Zenoni	18
2.6. Atomistët antikë	19
2.6.1. Leokipi	20
2.6.2. Demokriti	20
2.7. Sofistët	22
2.7.1. Protagora	23
2.7.2. Gjorgjiu	24
2.7.3. Trasimarku	24
2.7.4. Sokrati	24
2.7.5. Platoni	27
2.7.6. Aristoteli	29
2.8. Filozofia heleniste	33
2.9. Cinikët	34
2.10. Skepticizmi	34
2.10.1. Epikuri	35
2.11. Stoicizmi	36
2.11.1. Plotini	37

III. FILOZOFIA MESJETARE	39
3.1. Lindja e krishterizmit	40
3.2. Patristika	41
3.2.1. <i>Aurelie Augustini</i>	42
3.3. Filozofia bizantine	44
3.4. Iluministët e parë sllavë	45
3.4.1. <i>Kirili</i>	45
3.4.2. <i>Metodi</i>	46
3.4.3. <i>Klimenti i Ohrit</i>	47
3.4.4. <i>Toma Akuini</i>	47
3.5. Lindja e Islamit	50
3.6. Filozofia arabe	51
3.6.1. <i>Al Kindi</i>	52
3.6.2. <i>Al Furabi</i>	52
3.6.3. <i>Avicena</i>	52
3.6.4. <i>Averoesi</i>	53
IV. FILOZOFIA E KOHËS SË RE	55
4.1. Renesansa	55
4.1.1. <i>Ndryshimi i frymës dhe kultura e re</i>	55
4.2. Shkenca e renesansës	56
4.2.1. <i>Galile Galileu dhe Nikolla Makiaveli</i>	57
4.2.2. <i>Xhordano Bruno</i>	59
4.3. Shkenca në kohën e re	60
4.3.1. <i>Frensis Bekoni</i>	60
4.4. Empirizmi	62
4.4.1. <i>Xhon Loku</i>	63
4.4.2. <i>Xhorxh Berkli</i>	65
4.4.3. <i>David Hjumi</i>	66
4.4.4. <i>Rene Dekarti</i>	67
4.4.5. <i>Baruh De Spinoza</i>	70
4.5. Iluministët francezë	72
4.5.1. <i>Volteri</i>	74
4.5.2. <i>Zhan Zhak Ruso</i>	75
4.6. Enciklopedistët	77
4.6.1. <i>Lametri</i>	77
4.6.2. <i>Deni Didro</i>	78
4.6.3. <i>Helveciusi</i>	79
4.6.4. <i>Dalamberi</i>	79
4.6.5. <i>Pol Holbah</i>	80
V. FILOZOFIA BASHKEKOHORE	83
5.1. Filozofia dhe shkenca në shoqërinë bashkëkohore	83
5.1.1. <i>Emanuel Kanti</i>	84
5.1.2. <i>Hegeli</i>	89
5.2. Voluntarizmi	94

5.2.1. Artur Shopenhaueri	94
5.3. Pozitivizmi	96
5.3.1. Ogis Konti	96
5.4. Ekonomia liberaliste	98
5.4.1. Adam Smiti	98
5.5. Liberalizmi	100
5.5.1. Xhon Stjuart Mill	100
5.6. Kritika Sociale	101
5.6.1. Anri Klod de Sen Simon	101
5.6.2. Sharl Furie	102
5.6.3. Robert Oveni	102
5.7. Anarkistët	103
5.7.1. Marksi dhe marksistët	104
5.7.2. Fridrih Niçe	108
5.7.3. Soren Kierkegardi	110

VI. FILOZOFIA E SHEKÛLLIT XX 113

6.1. Pragmatizmi	114
6.1.1. Çarls Sedër Pirs	114
6.1.2. Vilhem Xhemi	114
6.2. Intuitivizmi	115
6.2.1. Henri Bergson	116
6.3. Frojdi dhe frojdizmi	118
6.3.1. Zigmund Frojd	118
6.4. Metoda fenomenologjike	120
6.4.1. Edmund Huserli	120
6.4.2. Bertrand Raselli	122
6.5. Neopozitivizmi	124
6.5.1. Ludvig Vitgenshtajn	125
6.6. Ekzistencializmi	126
6.6.1. Zhan Pol Sartri	127
6.6.2. Karl Poperi	128
6.7. Kibernetika	129
6.7.1. Norbert Vineri	129
6.7.2. Erih Froim	130
6.8. Biotika dhe ekologjia	132
6.9. Postmodernizmi	133
6.9.1. Maks Horkajmeri	134
6.9.2. Herbert Markuze	134
6.9.3. Teodor Adorna	135
6.9.4. Jorgen Hobermas	135
6.9.5. Zhak Derida	135
6.10. Filozofia në Maqedoni	135
6.10.1. Sami Krosi	135
6.10.2. Jonçe Josifovski	136
6.10.3. Mitko Ilievski	136

Акционерско друштво за издавање учебници и наставни средства
ПРОСВЕТНО ДЕЛО - Скопје, ул. „Димитрие Чуповски“ бр. 15 * За
издавачот: м-р Павле Петров, генерален директор * Главен уредник:
Весна Дукоска * Бајрам Селмани: ФИЛОЗОФИЈА за IV година на
реформираното гимназиско образование * Лектор-коректор: Рефаил
Сулејмани * Технички уредник и корица: Миодраг Алексовски
* Ракописот е предаден во печат во август 2018 година. Печатењето е
завршено во септември 2018 година. Обем: 148 страници. Формат:
20 X 25,5 ст. Книгата е отпечатена во печатницата „Коста Абраш“
-АД Охрид.

Shoqata aksionare e botimit të teksteve dhe të mjeteve mësimore
PROSVETNO DELLO-Shkup, Rr. „Dimitrie Çupovski“ nr. 15. Gradski
xid * Përbotuesin: Mr. Pavle Petrov, drejtor gjeneral * Kryeredaktor:
Vesna Dukoska * Dr. Bajram Selmani: FILOZOFIA për vitin IV të
gjimnazit të reformuar * Lektor- korrektor: Refail Sulejmani * Redaktor
telcnile dhe kopertinën: Miodrag Aleksovski * Dorëshkrimi u dorëzua
në shtyp në gusht 2018. Libri doli nga shtypi në shtator 2018. Madhësia:
148 faqe. Formati: 20 X 25,5 cm. Libri u shtyp në shtypshkronjën „Kosta
Abrash“- Ohër.

CIP - Каталогизacija vo publikacija
Народна и универзитетска библиотека „Св. Климент
Охридски“, Скопје

811.18(075.3)

SELMANI, Bajram

FILOZOFIA : për vitin IV të gjimnazit të reformuar / Bajram
Selmani. - Shkup: Prosvetno delo, 2005, - 144 str. ; 26 cm

ISBN 9989-0-0437-4

I. Bajram Selmani

COBISS. MK-ID 60157194